

KREU I. Fjalëformimi dhe mënyrat e tij

I.1. Fjalëformimi në përgjithësi

Gjuha ndodhet në një proces të pandërprerë zhvillimi, pasi ajo ka lindur bashkë me njerëzimin si një mjet shumë i rëndësishëm komunikimi dhe bashkë me të ndryshon, shndërrohet dhe zhvillohet në mënyrë të pandërprerë duke pasqyruar ndryshimet në veprimtarinë shoqërore, politike, ekonomike, kulturore dhe shkencore të vetë shoqërisë që e flet atë. Këto ndryshime dhe evoluime, pasqyrimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë e gjejnë veçanërisht në leksikon e gjuhës. Një nga rrugët më të rëndësishme për zgjerimin e leksikut është fjalëformimi.

Duke qenë një aspekt shumë i rëndësishëm i gjuhësisë, problematika e fjalëformimit është trajtuar gjerësisht nga shumë gjuhëtarë në të dyja gjuhët¹. Ndonëse në formë sporadike, fjalëformimi i gjuhës shqipe ka qenë pjesë e studimeve dhe artikujve të ndryshëm edhe të gjuhëtarëve të huaj².

Nga literatura gjuhësore vijnë përkufizime dhe përcaktime thuajse të njëjta për objektin dhe detyrat e fjalëformimit. Kjo gjë duket qartë në përkufizimet e mëposhtme:

“Fjalëformimi është formimi i fjalëve të reja në një gjuhë.”³

“*Die Wortbildung ist derjenige Zweig der Sprachwissenschaft, in der die Muster rekonstruiert und beschrieben werden, nach denen die Wörter einer Sprache intern strukturiert sind und wie neue Wörter gebildet werden.* / Fjalëformimi është ajo degë e gjuhësisë, e cila merret me rindërtimin dhe përshkrimin e modeleve, sipas të cilave janë strukturuar fjalët e një gjuhe brenda saj dhe formohen fjalë të reja.”⁴

“*Unter Wortbildung versteht man die Gesamtheit der Verfahren, mittels derer in einer Sprache neue Wörter auf der Basis schon vorhandener Wörter gebildet werden. Das geschieht dadurch, daß mehrere einzelne Wörter zu neuen komplexen Wörtern zusammengefügt oder daß einzelne Wörter durch grammatische Mittel zu neuen umgeformt werden.* / Me fjalëformim kuptohet tërësia e proceseve, me anë të të cilave një gjuhë formon fjalë të reja mbi bazën e fjalëve ekzistuese. Kjo gjë ndodh nëpërmjet bashkimit të disa fjalëve të veçanta në fjalë me komplekse, ose nga shndërrimi i fjalëve të veçanta në fjalë të tjera me anë të mjeteve gramatikore.”⁵

“*Wortbildung ist die Produktion von Wörtern (Wortstämmen) auf der Grundlage und mit Hilfe vorhandenen Sprachmaterials, wobei auch besondere – frei beweglich im Satz nicht vorkommende – Bildungselemente verwendet werden: Umgehung(s)straße ...* / Fjalëformimi është prodhimi i fjalëve (rrënjëve të fjalëve) mbi bazën dhe me ndihmën e materialit gjuhësor ekzistues, ku mund të përdoren edhe elemente të veçanta

¹ Enver Hysa në artikullin e tij “Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe”, botuar në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë 1975, f.58, liston një pjesë të punimeve bërë nga autorë të ndryshëm

²A. Dhrimo, Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe, botuar në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II*, Tiranë, 1975, f. 141-142

³ Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 2002, f.340

⁴ Metzler-Lexikon Sprache, 1993, f. 693-694

⁵ Hentschel / Weydt, Handbuch der deutschen Grammatik, Berlin-New York, 1990, f. 21

fjalëformimi, të cilat nuk shfaqen në fjali si elemente që mund të lëvizin lirisht: *Umgehung(s)-straße ...*”⁶

Thea Schippan-i fjalëformimin e sheh si formimin e fjalëve të reja nga elemente të gjuhës duke u bazuar në modele dhe shembuj ekzistues⁷. Sipas saj objekti i tij përbëhet nga proceset e fjalëformimit, mjetet fjalëformuese ekzistuese, shembujt e modelet e përdorura si dhe fjalët e reja të formuara, të cilat janë dhe rezultati final i proceseve fjalëformuese⁸. Edhe në gramatikën e gjuhës shqipe⁹ fjalëformimi shihet si procesi i formimit të fjalëve të reja. Objektin e tij e përbëjnë të gjitha mjetet fjalëformuese, analiza si nga pikëpamja e përbërjes morfemore, ashtu edhe ajo e mënyrës së formimit të fjalës, si dhe krijimi i modeleve, mënyrave dhe tipave të fjalëformimit.

Të gjitha përshkrimet dhe përkufizimet që i bëhen fjalëformimit nxjerrin në pah lidhjen e ngushtë që ekziston mes tij dhe gramatikës nga njëra anë, dhe leksikologjisë nga ana tjetër. Duke qenë se objekt i fjalëformimit janë veç të tjerash dhe pjesët përbërëse të fjalëve, temat e morfemat, analiza e krijimit të tyre, e mënyrës si lidhen me njëra-tjetrën, e ndryshimit të marrëdhënieve sintaksore mes elementeve të fjalës së re, si dhe duke qenë se fjalëformimi ndikon në procesin morfologjik të kalimit nga një pjesë ligjrate në një tjetër, siç është rasti i formimit të fjalëve të reja me konversion, krijohet dhe lidhja e drejtpërdrejtë e fjalëformimit me gramatikën. Por dihet se produkti i procesit të fjalëformimit është një njësi e re leksikore. “*Kuptimi leksikor i fjalës nuk mund të zbulohet e të studiohet i shkëputur nga ndërtimi i fjalës, nga morfemat e saj.*”¹⁰ Ky fakt e lidh fjalëformimin me leksikologjinë. Kjo është dhe arsyeja pse fjalëformimi është pjesë përbërëse e studimeve gramatikore dhe leksikore. Por çështja nëse fjalëformimi është një disiplinë e pavarur e gjuhësisë apo jo, është diskutuar mjaft nga gjuhëtarët gjermanë.¹¹ Römer-i/Matzke-ja në veprën e tyre “*Lexikologie des Deutschen. Eine Einführung*” e shohin fjalëformimin si një disiplinë të veçantë gjuhësore. Të njëjtin qëndrim mbajnë edhe Stepanova/Fleischer-i.¹² Edhe disa gramatika gjermane e lënë jashtë objektin të tyre çështjen e fjalëformimit.¹³ Edhe Lloshi është i mendimit që studimet në fushën e fjalëformimit me kalimin e viteve janë thelluar shumë. Krahas analizave etimologjike të mëparshme janë bërë analizime më të thella gramatikore për elementet fjalëformuese, si dhe përpjekje dhe për të plotësuar inventarin e morfemave

⁶ Fleischer / Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 5

⁷ T. Schippan, Lexikologie der deutschen Sprache, Tübingen, 1992, f.45

⁸ po aty

⁹ Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976, f. 193-202 dhe Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 1995 f. 43-61

¹⁰ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011, f.24

¹¹ Römer / Matzke, Lexikologie des Deutschen. Eine Einführung, Tübingen, 2005, f. 61

¹² Stepanova /Fleischer, Grundzüge der deutschen Wortbildung, Leipzig, 1985, f.11

¹³ Disa vepra ku trajtohet dhe përshkruhet gramatika e gjuhës gjermane, nuk e bëjnë pjesë të objektit të tyre çështjen e fjalëformimit, siç ndodh me “*Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*” Helbig/Buscha, 1999, apo “*Deutscher Sprachbau*”, Admoni, 1982, “*Grammatik der deutschen Sprache*”, Zifonun, 1997, apo “*Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*”, Sommerfeldt/Strake, 1998

fjalëformuese, me rezultat “*përvijimin e fjalëformimit si disiplinë më vete, me objektin, metoden dhe detyrat e veta.*”¹⁴

Përpara se të flitet për mënyrat e fjalëformimit që veprojnë në shqipe dhe gjermanishte, është me rëndësi t’i hidhet një vështrim edhe terminologjisë së përdorur nga gjuhëtarët në trajtimin që ata i kanë bërë fjalëformimit. Vihet re se në disa raste ajo është e panjësuar, madje paqartësi ka edhe në terminologjinë e përdorur nga i njëjti gjuhëtar. I tillë është rasti i I.D.Sheperit¹⁵, i cili në gramatikën e tij fjalëformimin e quan “*etimollogjia*” dhe dallon *fjalë të para*, të cilat më pas i quan edhe origjinale, *fjalë të prejardhura*, si të tilla trajton fjalët e formuara me prapashtesa, dhe *fjalë të përngjitura*, ku përfshin fjalët e formuara me parashtesim dhe fjalët e përbëra. Në këtë punim I.D.Sheperi përdor edhe termin fjalë e thjeshtë: “*Fjalët që bëhen më shtim në krye quhen “fjalë të përngjitura”, shtim’ i tyre quhet “parashitim” ose “pjes’ e parë e fjalës së përngjiturë” dhe fjala pa parashitim quhet “fjal’ e thjeshtë*”.¹⁶ Gjithashtu, sipas tij shumë fjalë, duke u bërë të përngjitura, bëhen njëkohësisht edhe të prejardhura.

Edhe Cipo¹⁷ përdor terma të ndryshëm për të emërtuar të njëjtën gjë. Emrat i ndan në të pammë dhe derivatë, ndërsa numërorët nga njëshi deri te dhjeta i quan të thjeshtë. Foljet e formuara me parashtesë i quan folje të përngjitura, dhe brenda grupit të fjalëve të formuara me përngjitje trajton edhe kompozitat.

Më e njësuar shfaqet terminologjia e Demirajt¹⁸, i cili nga pikëpamja e përbërjes i ndan fjalët në fjalë të para, të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

Në një artikull të veçantë problematikën e kësaj terminologjie e ka trajtuar Lafe¹⁹, i cili i klasifikon fjalët nga pikëpamja e përbërjes strukturore në fjalë të thjeshta dhe fjalë të përbëra. Ky përcaktim jepet edhe në “Gramatikën e gjuhës shqipe, 1”²⁰. Ndërsa, duke u nisur nga pikëpamja e fjalëformimit, duket të ketë diversitet, pasi Lafe i ndan fjalët e gjuhës shqipe në fjalë të parme dhe fjalë të prejardhura, ndërsa në “Gramatikën e gjuhës shqipe 1” ato ndahen në fjalë të parme dhe jo të parme. Lafe propozon termin “fjalë e rrjedhurar” për fjalët e formuara me derivacion, por ky term duket mos të ketë gjetur mbështetje në “Gramatikën e gjuhës shqipe 1”, pasi në të për derivatet përdoret termi “fjalë të prejardhura”.

Terminologjia e fjalëformimit duket të jetë me e njësuar në literaturën gjuhësore gjermane; ndryshimet shfaqen lidhur me çështjen e klasifikimit të tipave të fjalëformimit, të cilët do të trajtohen më hollësisht në një nga kapitujt në vijim.

¹⁴ Xh. LLoshi, Mbi rezultatet kryesore të studimit të leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe pas Çlirimit, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972, f 485

¹⁵ I.D. Sheper, Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927, f. 125-137

¹⁶ I.D. Sheper, po aty, f. 125

¹⁷ K. Cipo, Gramatika shqipe, Tiranë, 1949, f. 38 - 47

¹⁸ Sh. Demiraj, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962, f. 12

¹⁹ E. Lafe, Mbi disa terma të klasifikimit të fjalëve sipas përbërjes strukturore dhe sipas fjalëformimit, në: *Studime Filologjike* 1/1972, f. 127-130

²⁰ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 1995, f. 55

I.2. Mënyrat e fjalëformimit në gjuhën shqipe

“Mënyra është nëndarja më e madhe e sistemit të fjalëformimit. Sistemi i fjalëformimit përbëhet nga tërësia e mënyrave dhe tipave fjalëformues. Të gjitha fjalët e formuara me të njëjtin lloj formanti i takojnë një mënyre fjalëformimi.”²¹ Ky është përkufizimi i mënyrës së fjalëformimit sipas hartuesve të punimit “Gramatika e gjuhës shqipe, I”.

Duke analizuar gramatikat e ndryshme të hartuara ndër vite, vihet re se klasifikimi i fjalëve sipas mënyrës së fjalëformimit ka qenë jo gjithnjë i njëjtë, ndaj dhe qëndrimet lidhur me këtë çështje janë të ndryshme.

I. D. Sheperi në gramatikën e tij²² i njeh shqipes dy mënyra për formimin e fjalëve të reja. Fjalët e formuara sipas mënyrës së parë i quan *fjalë të prejardhura*, të cilat sipas tij gjuha i formon “duke shtuar në fund të tyre një ose më shumë tinguj”²³, ndërsa fjalët e formuara sipas mënyrës së dytë i quan *fjalë të përngjitura*, të cilat shqipja i formon “duke shtuar në krye tinguj ose rrënjë fjalësh të tjera.”²⁴ Si fjalë të prejardhura Sheperi dallon emra të formuar me prapashtesë nga emra të tjerë, nga mbiemra, nga folje dhe nga ndajfolje. Gjithashtu si të prejardhur ai trajton edhe mbiemrat e formuar me nyjëzim nga pjesoret dhe ndajfoljet si dhe mbiemrat e formuar me prapashtesë nga foljet e nga ndajfoljet. Në grupin e fjalëve të përngjitura I. D. Sheperi përfshin pjesë të ndryshme të ligjeratës të formuara me parashtesa, me kompozim e përngjitje. Shumë fjalë sipas tij duke u bërë të përngjitura bëhen njëkohësisht dhe të prejardhura, gjithashtu edhe pse i trajton në grupin e fjalëve të përngjitura ai pranon si të prejardhura edhe disa fjalë që formohen me parashtesa.²⁵

Diçka më gjerë e shqyrton Cipo temën e fjalëformimit në gramatikën e tij, së cilës jo vetëm që i kushton një nënçështje të veçantë të quajtur “Struktura dhe formimi i fjalëve”²⁶, por dhe e riprek teksta analizon pjesët e ndryshme të ligjeratës. Gjithsesi vihet re se edhe Cipoja nuk e bën dallimin e qartë mes prejardhjes dhe përngjitjes. Fjalët e formuara me prapashtesa ai i quan “*derivate*” (të prejardhura); të tillë janë për Cipon edhe emrat që formohen me parashtesa e prapashtesa,²⁷ ndërsa foljet e formuara me parashtesa ai i quan “*të përngjitura*”.²⁸ Si produkt të përngjitjes së fjalëve ai trajton edhe kompozitat.²⁹ Me të drejtë i quan të përngjitur numërorët njëmbëdhjetë deri nëntëmbëdhjetë.

Një vëmendje të veçantë i kushton strukturës së fjalës, pjesëve përbërëse të saj, mjeteve fjalëformuese dhe tipave të fjalëformimit Demiraj në veprën e tij “*Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*” (Tiranë, 1962). Gjithashtu në këtë vepër shqyrtohet më gjerë edhe

²¹ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f. 58

²² I. D. Sheperi, Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927, f.125-137

²³ I. D. Sheperi, po aty, f. 125

²⁴ I. D. Sheperi, po aty, f. 125

²⁵ I. D.. Sheperi, në gramatikën e tij të vitit 1927 teksta trajton fjalët e formuara me përngjitje në faqen 134 shkruan: “*Të tjera bëhen të prejardhura duke marrë parashtesimin s (sh) ose n (m). P.sh. i bardhë, sbardh; faqe, shfaq ...*”

²⁶ K. Cipo, Gramatika shqipe, Tiranë 1949, f.35

²⁷ K. Cipo, Gramatika e shqipes, Tiranë, 1949, f. 38

²⁸ K. Cipo, po aty, f. 39

²⁹ K. Cipo, po aty, f. 43

formimi i pjesëve të ligjeratës. Duke u mbështetur në përbërjen strukturore të fjalëve, Demiraj bën ndarjen e fjalëve të gjuhës shqipe në: “*fjalë të para, të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.*”³⁰ Brenda fjalëve të prejardhura ai njih vetëm formimet me parashtesë, prapashtesë dhe parashtesë e prapashtesë njëkohësisht. Si fjalë të prejardhura dallohen emra, mbiemra, folje dhe ndajfolje. Në grupin e fjalëve të përbëra përfshihen emra, mbiemra dhe pak folje. Ndërsa si fjalë të përngjitura njih disa numërorë, përemrat e pacaktuar (të cilët i quan “të pakufishëm”), ndajfolje dhe parafjalë. Mbiemrat e formuar nga pjesoret e foljeve vetëm me anë të nyjeve, trajtohen si mbiemra të prejardhur.³¹ “*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*”³² (Tiranë, 1976) pjesën e tretë ia kushton çështjeve të formimit të fjalëve. Këtu gjejmë një analizë më të gjerë dhe të hollësishme të fjalëve sipas ndërtimit dhe sipas formimit të tyre. Analizohen tipat fjalëformues, të cilët shqyrtohen nga pikëpamja e prodhimtarisë e shihet njëkohësisht dhe sa aktivë janë ata. Analizohen disa nga elementet fjalëformuese parashtesore dhe prapashtesore të gjuhës shqipe, përdorimi i tyre, kategoritë leksikogramatikore me të cilat bashkohen si dhe kategoritë e reja leksikogramatikore që formojnë. Nga pikëpamja e formimit bëhet ndarja e fjalëve në fjalë të parme dhe fjalë jo të parme. Këto të fundit ndahen më tej në fjalë të prejardhura, ku dallohen fjalët e formuara me parashtesa, me prapashtesa, me parashtesa e prapashtesa njëkohësisht si dhe fjalë të formuara pa ndajshtesa a prapashtesa, në fjalë të përbëra ose kompozita, fjalë të formuara njëkohësisht me kompozim dhe parashtesim, si dhe fjalë të përngjitura. Te tipat e fjalëve që formohen pa ndajshtesë dallohen emërzimi, mbiemërzimi, ndajfoljezimi dhe parafjalëzimi. Por shqyrtimin më të plotë çështjes së fjalëformimit të gjuhës shqipe, analizën më të hollësishme morfologjike të fjalës, mënyrave dhe tipave të fjalëformimit e gjejmë te “*Gramatika e gjuhës shqipe*”, (Tiranë 1995), ku shqyrtohet gjerësisht jo vetëm fjalëformimi si një çështje më vete, por edhe formimi i secilës pjesë ligjerate. Gjuha shqipe është e pasur me mënyra fjalëformuese. Numërohen gjashtë të tilla; disa kanë dhe nëndarjet e tyre:

³⁰ Sh. Demiraj, Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e I. Morfologjia, Tiranë 1962

³¹ Sh. Demiraj, po aty, Tiranë 1962, f. 87

³² A. Kostallari e të tjerë, Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976, f.191-f.254

PREJARDHJA	parashtesore
	prapashtesore
	parashtesoprapashtesore
	pa ndajshtesë
NYJËZIMI	
KOMPOZIMI	
PËRNGJITJA	
KONVERSIONI	
MËNYRAT E PËRZIERA	përngjitje dhe prapashtesim
	kompozim dhe prapashtesim
	nyjëzim dhe prapashtesim
	nyjëzim dhe parashtesoprapashtesim
	nyjëzim dhe përngjitje

I.2.1. Prejardhja

Prejardhja është mënyra e formimit të fjalëve të reja nëpërmjet bashkimit të ndajshtesave fjalëformuese me tema fjalësh, sipas modeleve fjalëformuese të gjuhës. Është tashmë fakt që prejardhja përbën dhe mënyrën më prodhimore e më të larmishme të sistemit fjalëformues të gjuhës shqipe. Për këtë gjë nuk flet vetëm numri shumë i madh i fjalëve të prejardhura të formuara me ndajshtesim. Prejardhja apo derivacioni³³ është bërë objekt studimi edhe nga albanologë të huaj, si nga Meyer-i, Pedersen-i dhe Jokli. Një vëmendje të veçantë u ka kushtuar ndajshtesave fjalëformuese Aleksandër Xhuvani, i cili ka mbledhur dhe analizuar rreth 170 prapashtesa dhe bashkë me Çabejn rreth 80 parashtesa. Në shkrimin e tij “*Mbi prejardhjen e fjalëve*”³⁴, ai paraqet në formë kronologjike studimet që i janë bërë derivacionit që nga Kristoforidhi. Hysa prodhimtarinë e madhe të mjeteve fjalëformuese ndajshtesore e sheh edhe te bashkimi i tyre me tema të ndryshme fjalëformuese, si tema foljore, emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore, të cilat përbëjnë dhe klasat më të pasura të leksikut të gjuhës shqipe.³⁵ Për prejardhjen, si mënyra më prodhimore e pasurimit të leksikut të gjuhës shqipe ndër kohëra, flet edhe Dhimitër S. Shuteriqi.³⁶ Ndërsa Kole, pasi ka studiuar zhvillimin e leksikut të gjuhës shqipe, duke krahasuar “*Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*” të vitit 1954 me atë të vitit 1980, shkruan: “*Emrat e prejardhur duket të përbëjnë grupin më të madh ndër të gjitha fjalët e tjera të*

³³ Ky term është përdorur nga shumë gjuhëtarë të vjetër, si Sheperi, Myderrizi, madje dhe Xhuvani e përdor atë krahas termit “prejardhje”

³⁴ Në: Aleksandër Xhuvani, Vepra 1, f. 355-358

³⁵ E. Hysa, Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare, në: *Gjuha Jonë* 1/1985, f. 112

³⁶ Dhimitër S. Shuteriqi në “*Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut*” (në Studime filologjike, 1/1983, f.197-209) në korpusin e fjalëve të mbledhura dallon se sasia e fjalëve të prejardhura është pesë herë më e madhe se ajo e fjalëve të përbëra, duke treguar kështu që për gjuhën shqipe formimi i fjalëve të prejardhura është një mënyrë e njohur dhe e lehtë.

formuara me ndajshitesa fjalëformuese, bile edhe ndër të gjitha fjalët jo të parme në gjuhën e sotme shqipe.”³⁷

I.2.1.1. Prejardhja me parashtesim

Prejardhja me parashtesim formon fjalë të reja me anë parashtesash. Si tema motivuese mund të shërbejnë fjalë të thjeshta ose dhe fjalë të prejardhura, me parashtesa:

i paaftë, përflas, shqep, zhvesh, çlodh, mosarsye, stërnip, mbiçmoj, jokonkret etj. shpërqendroj, çarmatos, i panatyrshëm, ndërkontinental, zhvendos, përpunoj etj.

Ky nëntip fjalëformimi është bërë goxha prodhimtar në gjuhën shqipe, por gjithsesi zë një vend më të vogël sesa prapashtesimi, i cili është dhe nëntipi më prodhimtar i prejardhjes. Numri i parashtesave të gjuhës shqipe është goxha më i vogël se numri i prapashtesave. Në punimin e Xhuvanit dhe Çabejt³⁸, i cili është një analizë e prejardhjes, përdorimit dhe prodhimtarisë së elementeve parashtesore të gjuhës shqipe, përfshihen 82 parashtesa, ndërsa në punimin e vitit 1962 “Prapashtesat e gjuhës shqipe”³⁹ përfshihen dhe studiohen nga të njëjtat këndvështrime si dhe parashtesat, 168 prapashtesa të shqipes. Por brenda këtij grupi parashtesash ka parashtesa të cilat janë zgjerime apo variante të njëra-tjetrës, sikurse ka dhe nga ato parashtesa, të cilat janë vjetëruar aq shumë sa që në shqipen e sotme nuk trajtohen më si parashtesa, apo një pjesë tjetër që nuk janë më prodhimtare. Si të tilla mund të përmendim: **f-** fshij; **g(ë)-** gdhij; **d(ë)-** dëborë, dëboj; **n(ë)-** ndaj, ndez, ngordh etj.

Një tjetër çështje problemore që lidhet me parashtesat dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në mënyrën e formimit të fjalëve me parashtesë, është kufiri jo fort i qartë mes parashtesimit dhe përngjitjes nga njëra anë, dhe kompozimit nga ana tjetër. Duke qenë se shndërrimi i disa parafjalëve dhe pjesëzave në parashtesa e ka burimin te përngjitja, marrëdhëniet midis këtyre dy mënyrave të fjalëformimit janë dhe sot mjaft të gjalla, aq sa ndonjëherë e kemi të vështirë të dallojmë se me cilën prej mënyrave është formuar një fjalë e caktuar. Problem përbën dhe raporti i parashtesave me atë grup elementesh, të cilat njihen si prefiksoide. A janë prefiksoidet parashtesa, gjysmëparashtesa apo elemente të fjalës së përbërë? Këto çështje do të shqyrtohen dhe analizohen hollësisht më poshtë, kur të flitet për kompozitat dhe fjalët e përngjitura.

Një tjetër çështje që mendojmë se duhet të shqyrtohet në këtë punim, lidhet me pyetjen: Kanë apo jo parashtesat kuptim klasifikues? Lidhur me këtë çështje dallojmë tri qëndrime. Në “Gramatikën e gjuhës shqipe” (1995) shkruhet shprehimisht: “Parashtesa nuk ia ndërron kategorinë leksikogramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj vetëm një kuptim të ri plotësues.”⁴⁰ Por vetëm një paragraf më poshtë njihen një varg fjalësh, të cilat duke u bashkuar me parashtesën për të formuar fjalën e re, kalojnë në një tjetër kategori leksikogramatikore, si p. sh.: emra që kthehen në folje: *përbalt* nga *baltë*, *përbuz* nga *buzë*, *përdor* nga *dorë*, *përgjak* nga *gjak*, *përligj* nga *ligj* etj. Formimin e

³⁷ Kole, Josif, Prirje të zhvillimit të leksikut në dritën e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, në: *Studime filologjike*, 4/1986, f. 27

³⁸ A. xhuvani / E. Çabej, Parashtesat e gjuhës shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1975, f. 5-55. Ky është një punim I vitit 1956.

³⁹ A. Xhuvani / E. Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, në: *Vepra I*, Tiranë 1980, f. 359-418

⁴⁰ Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë 1995, f. 61

këtyre fjalëve kjo gramatikë e shpjegon me formimin e tyre në mënyrë të përzier, me parashtesim dhe prejardhje pa ndjashtesë. Por nëse do ta pranoni këtë shpjegim, atëherë na lind e drejta të bëjmë pyetjen, përse fjalët e këtij tipi trajtohen si fjalë të prejardhura me parashtesim dhe nuk trajtohen si një nëntip i veçantë i fjalëve të formuara me prejardhje?

J. Thomai⁴¹ është i mendimit se parashtesimi zakonisht nuk e ndërron kategorinë leksiko-gramatikore fjalës. Duke përdorur fjalën “zakonisht”, dhe duke njohur veç fjalëve të përmendura më lart edhe shembuj foljesh të formuara me parashtesë nga tema mbiemrash e ndajfoljesh, si p.sh. *zbardh* nga mbiemri *i bardhë*, *mposht* nga ndajfolja *poshtë*. Ai i njeh këto fjalë si fjalë të prejardhura me parashtesim dhe u njeh një funksion klasifikues parashtesave.

Për këtë çështje ka mbajtur qëndrim edhe Hysa⁴². Për të kuptim klasifikues kanë vetëm prapashtesat, vetëm ato mund t’i sjellin ndryshim temës lidhur me përkatësinë e saj në ndonjë pjesë ligjrate. Ndaj dhe për të kuptuar formimin e fjalëve të tilla na vjen në ndihmë një formant që gjuha shqipe e njeh mirë në çëshjten e fjalëformimit, formanti zero. Duke e vazhduar më tej analizën, Hysa me të drejtë i klasifikon këto fjalë si formime pashitesoprapashtesore me prapashtesë zero. Pra, nëse do të mbështesim karakterin jo klasifikues të parashtesave, gjejmë me vend përcaktimin e këtyre fjalëve si fjalë të formuara me parashtesim dhe prapashtesë zero.

Ndonëse numri i parashtesave është gati tri herë më i vogël se numri i prapashtesave⁴³, duhet pranuar se parashtesimi është një mënyrë mjaft e gjallë dhe e rëndësishme në gjuhën shqipe. Parashtesat bashkohen me tema emërore, mbiemërore dhe foljore.

Parashtesat e gjuhës shqipe ndahen në dy grupe: parashtesa të mirëfillta dhe parashtesa të prejardhura. **ç-**, **sh-**, **zh-**, **z-**, **m-**, **n-**, **stër-**, **ri-**, **shpër-** etj. janë elemente të gjuhës, të cilat në shqipen e sotme shërbejnë vetëm si parashtesa ndaj dhe klasifikohen si të mirëfillta:

çarmatos, *çnderoj*; *shqep*, *shndërroj*; *zhvesh*, *zhvlerësoj*; *zbath*, *zbuloj*; *mbath*, *mbuloj*; *ngarkoj*, *ngjit*; *shkarkoj*, *shthur*; *stërnip*, *i stërmadh*; *rivendos*, *rikrijoj*; *shpërndaj*, *shpërngul* etj.

Disa parashtesa të mirëfillta, si p.sh.: **m-**, **z-**, **n-** e **sh-**, janë bashkuar me rrënjë të lidhura duke formuar çifte fjalësh me kuptime të ndryshme por të motivueshme nga e njëjta rrënjë: *mbath* – *zbath*, *ngarkoj* – *shkarkoj* etj.

Shumë parashtesa që sot janë mjaft prodhimtare, nuk janë parashtesa të mirëfillta, por kanë dalë prej fjalësh të tjera, ndaj dhe klasifikohen si parashtesa të prejardhura. Kështu **mbi-**, **më-**, **në-**, **nën-**, **për-**, **pa-** e **ndër-** janë parashtesa që kanë dalë prej parafjalësh, ndërsa **jo-**, **mos-**, **sapo-**, **porsa-** prej pjesëzash. Këto elemente i gjejmë në gjuhë të përdoren si pjesë të veçanta të ligjeratës, por njëkohësisht i gjejmë edhe në përbërjen e fjalëve jo të thjeshta. Në rastin e dytë ato nuk janë më parafjalë apo pjesëza, por formante fjalëformuese, konkretisht parashtesa. Duke kaluar në parashtesa këto elemente gjuhësore “i dobësojnë lidhjet me kategoritë leksiko-gramatikore nga kanë dalë dhe afrohen me parashtesat e tjera të mirëfillta, duke fituar kuptime përgjithësuese, karakteristike për

⁴¹ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011, f. 172

⁴² E. Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975, f. 62 dhe 79-80

⁴³ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f. 61

ndajshesat fjalëformuese.”⁴⁴ Kështu parashtesa **nën-** është bërë prodhimtare në formimin e fjalëve jo me kuptimin hapësinor të parafjalës *nën*, por duke formuar fjalë që emërtojnë zakonisht një veprim që është më pak intensiv se veprimi i temës motivuese ose që qëndron një shkallë më poshtë se ai. *nënçmoj, nënkuptoj, nëndaj, etj; nëndialekt, nëndrejtor, nënfushë, etj; nëndetar, nënligjor, nëntokësor, etj.*

Grupi i parashtesave të prejardhura është edhe më i gjerë, nëse pranohen si të tilla edhe ato elemente, të cilat njohin dhe një përdorim të mëvetësishëm si pjesë të veçanta të ligjeratës. Këto janë fjalë që përdoren edhe si ndajfolje edhe si parafjalë, si p.sh.: *para, pas, prapa, kundër, sipër* e ndonjë tjetër. Qëndrimet lidhur me formimet, ku si pjesë e parë del një element i tillë janë të ndryshme. Ato herë shihen si kompozita e herë si fjalë të prejardhura, dhe ndonjëra edhe si fjalë e përngjitur, gjë që tregon edhe një herë se kufijtë mes parashtesimit dhe kompozimit nga njëra anë, apo parashtesimit dhe përngjitjes nga ana tjetër, nuk janë të prerë. Kompozitat dhe fjalët e formuar me parashtesim janë “*akte krijimi*”⁴⁵. Ky fakt i afron ato me njëra-tjetrën. Por elementet përbërëse të tyre kanë karakteristika të ndryshme. Kështu kompozitat përbëhen nga pjesë të mëvetësishme të ligjeratës, ndërsa fjalët e prejardhura me parashtesim vetëm njërin element të tyre e kanë të tillë, temën motivuese. Përdorimi i elementeve të përmendur më lart edhe si fjalë të mëvetësishme të ligjeratës, e bën të vështirë përcaktimin e mënyrës fjalëformuese të formimeve me pjesë të parë një element të tillë. Mendojmë se në raste të tilla veç mënyrës së motivimit dhe natyrës leksikogramatikore të elementit të parë, duhet pasur parasysh edhe kriteri semantik për të arritur në një përfundim sa më të drejtë.⁴⁶

Më poshtë disa shembuj fjalësh të formuara me parashtesim:

pa-: *pabarazi, padurim etj; i paaftë, i padenjë etj. mos-*: *mosarritje, mosbesim etj., mosmirënjohës, mospërfillës etj. për-*: *përafroj, përçaj etj.; i përtafërt, i përdalë etj. mbi-*: *mbiçmoj, mbijetoj etj.; mbiemër, mbilodhje etj.; i mbifuqishëm, mbinjerëzor etj.; jo-*: *jobujqësor, jodemokratik; para-*: *paraardhës, paradhënie etj.; parakaloj, paraqes etj.; paraushhtararak, parafundor etj.; ndër-*: *ndërveprim, ndërkat etj.; ndërhyj, ndërmarr etj.; ndërkrashinor, ndërqelizor etj.; kundër-*: *kundërsulm, kundërgaz etj.; kundërkimik, kundërfetar etj.*

Parashtesat, veçanërisht **pa-**, **jo-**, **mos-** e **kundër-** kanë shtuar dhe plotësuar klasat e emrave dhe mbiemrave veçanërisht të leksikut politikoshoqëror.⁴⁷

Në gjuhën shqipe veprojnë edhe disa parashtesa të huazuara të cilat kanë hyrë në gjuhë bashkë me fjalën me të cilën janë huazuar, si p.sh. **a-** (*amoral*), **anti-** (*antikushetues*), **de-** (*demoralizoj*), **dez-** (*dezinformoj*), **dis-** (*disnivël*), **super-** (*superfuqi*) etj. Me pas disa prej tyre kanë shërbyer edhe për formimin e fjalëve të reja duke u bashkuar me tema fjalësh shqipe (antipopullor, afetar).

Edhe parashtesat e huaja kanë qenë pjesë e studimeve që janë bërë në gjuhën shqipe për parashtesimin. Përpjekja e parë për të vënë në dukje dhe për t’i analizuar parashtesat e

⁴⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 62

⁴⁵ E. Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme*, II, Tiranë 1975, f.67

⁴⁶ Lidhur me elementet “*para*” e “*kundër*” shiko qëndrimin e mbajtur në fq. 58 të këtij punimi.

⁴⁷ M. Samara, Zhvillimi i leksikut politiko-shoqëror të shqipes, pas Çlirimit, në *Gjuha Jonë*, 1/ 1985, f. 106

huazuara vjen nga Podgorica⁴⁸, i cili shqyrton në studimin e tij rreth 77 parashtesa të huazuara, ndonëse disa prej tyre është shumë e vështirë të dallohen pa ditur më parë se si janë formuar këto fjalë në gjuhën e huaj.⁴⁹ Gjithsesi në shqipen e sotme vërehet prirja për t'i zëvendësuar këto parashtesa të huaja me elemente nga fondi i gjuhës shqipe. Në disa raste për këto zëvendësime flasin edhe format paralele si p.sh: *afetar / jofetar, anormal / jonormal, antifetar / kundërfetar, antiajror / kundërajror, deformat / shformat, demobilizoj / çmobilizoj* etj.

I.2.1.2. Prejardhja me prapashtesim

Prejardhja me prapashtesim është formimi i fjalëve të reja duke i vendosur temës së fjalës prapashtesën, p.sh. fjalët: *punoj, lexim, vrasje, përtac, gramatikor, rregullisht* janë formuar nga bashkimi i temave fjalëformuese *punë, lexoj, vras, përtoj, gramatikë* dhe *rregull* me prapashtesat përkatëse **-o, -im, -je, -ac, -or** dhe **-isht**.

Si temë prodhuese mund të jetë një fjalë e parme si p.sh: *freski, ecje, barkas, vonesë, mesatar, ditor, bukurosh* etj.; ose dhe një fjalë jo e parme, si p.sh.: *detari, prodhimtar, rrobaqepsi, zemërgjerësi, thellësisht, fluturimthi, përbuzje, përkufizim* etj.

Prapashtesimi është jo vetëm nëntipi më prodhimtar i prejardhjes, por krahas kompozimit ai përbën dhe mënyrën më prodhimtare në gjithë sistemin e fjalëformimit të gjuhës shqipe. Ja si shprehet Kostallari për prapashtesimin të cilin e quan edhe *sufiksimit*: “Veçoria themelore që mund të quhej si «normë fjalëformuese» e përgjithshme e shqipes së sotme letrare është mbizotërimi i theksuar i sufiksimit e i kompozimit; ...”⁵⁰

Në prodhimtarinë më të madhë të prapashtesimit dhe përparësinë që ka ai krahasuar edhe me parashtesimin, ndikon jo vetëm fakti që numri i prapashtesave të gjuhës shqipe është gati tri herë më i madh se numri i parashtesave dhe shumë prej tyre janë goxha prodhuese, por edhe fakti se temat me të cilat bashkohen prapashtesat mund të jenë tema të një fjale të parme (*punoj*), të një fjale të prejardhur (*zhvendosje*) apo edhe të një fjale të përbërë (*fatkeqësi*).

Me mënyrën fjalëformuese të prapashtesimit formohen emra, mbiemra, folje dhe ndajfolje nga po ajo pjesë ligjrate, por edhe prej pjesësh të tjera të ligjeratës. Kjo gjë shpreh dhe karakterin klasifikues të prapashtesës, e cila duke iu bashkangjitur një teme fjalëformuese bashkë me kuptimin e ri që i jep fjalës së re, përcakton dhe përkatësinë e saj në njërin nga klasat e pjesëve të ligjeratës. Kështu p.sh. nga foljet *punoj, banoj, ndal* etj. formohen emrat **punim, banesë, ndalesë**; nga emrat *njerëzi, vazhdim, bark, nxitim* etj. formohen ndajfoljet **njerëzisht, vazhdimisht, barkas, nxitimthi**, etj. Por ka dhe raste kur fjalët e reja të formuara me prapashtesim, nuk e ndërrojnë kategorinë gramatikore të temës fjalëformuese më të cilin është bashkuar prapashtesa për formimin e tyre. Kështu p.sh. nga emrat *gazetë, mal, vend, akull, kopësht* etj. formohen me prapashtesim emrat: **gazetar, malësor, vendas, akullore, kopshtar** etj; ose nga mbiemrat i *bardhë, i gjatë, i kaltër* etj, formohen mbiemrat **bardhosh, gjatosh, kaltërosh** etj.

⁴⁸ F. Podgorica, Parashtesat e huazuara, në: *Kongresi i Manastirit*, Shkkođer, 1969, f. 65 - 79

⁴⁹ E. Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975, f. 60

⁵⁰ A. Kostallari, Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1972, f. 38

Një tjetër ndryshim midis mjeteve fjalëformuese prapashtesore dhe mjeteve fjalëformuese parashitesore ka të bëjë edhe me shprehjen e nuancave të ndryshme kuptimore të vlerësimit subjektiv. Në gjuhën shqipe gjejmë prapashtesa që kanë kuptimin e zvogëlimit, të zmadhimit, të përkëdheljes, apo dhe nga ato që kanë kuptim negativ. Një tjetër fakt ky që i jep përparësi prapashtesimit në prodhimitarinë e tij. Xhuvani në studimin që u ka bërë prapashtesave⁵¹ numëron rreth njëzetë e pesë prapashtesa të tilla, disa prej të cilave janë goxha aktive dhe gjejnë përdorim veçanërisht në gjuhën e folur dhe në dialekte, si p.sh.:

-ac: *burrac, qullac* etj.; **-acak** në disa raste dhe **-acuk:** *frikacak, rrjepacak / rrjepacuk, verdhacak / verdhacuk*, etj.; **-alaq:** *ngordhalaq, shkurtalaq*; **-alec:** *bichtalec, kambalec* etj.; **-z(ë):** *copëz, çupëz, folezë* etj.; **-th:** *birth, zëth, syth* etj.; **-ush:** *mamush, lepurush, vogëlush* etj.; **-ushkë:** *fletushkë, llambushkë, miushkë* etj.

Këto prapashtesa në pjesën më të madhe të rasteve janë prapashtesa të zgjeruara, sepse disa prapashtesa në gjuhën shqipe janë formuar nga bashkimi i dy prapashtesave të thjeshta. Ky bashkim ka ndodhur pasi fjala e prejardhur me prapashtesë ka marrë edhe një prapashtesë tjetër, duke ruajtur përkatësinë e saj në po atë pjesë ligjrate si dhe duke ruajtur pak a shumë të njëjtin kuptim, p.sh. **burrac** dhe **burracak**.

Në gjuhën shqipe njihet edhe një formë tjetër prapashtesimi, sipas së cilës fjala e re e formuar nga një fjalë ekzistuese nuk paraqitet në formën e një fjale të prejardhur, por në formën e një fjale të parme dhe quhet *prapashtesim prapaveprues*⁵². Si të tilla gjejmë fjalët *çudi*⁵³ (nga folja çudit), *habi* (nga folja habit), *mërzi* (nga folja mërzit), *padi* (nga folja padit) e ndonjë fjalë tjetër.

Siç është thënë dhe më lart me anë të prapashtesimit formohen emra, mbiemra, folje dhe ndajfolje⁵⁴. Më poshtë disa nga prapashtesat më të përdorura dhe prodhimitare të gjuhës shqipe shoqëruar me shembuj përkatës.

-im dhe **-je:** *besim, vërtetim* etj; *ecje, vuajtje* etj. Këto dy prapashtesa bashkohen me tema fjalëformuese foljore dhe formojnë emra që tregojnë veprim, disa prej tyre mund të tregojnë edhe rezultatin e një veprimi. Sipas rregullave të gjuhës shqipe⁵⁵ prapashtesa **-je** bashkohet me ato folje me të cilat nuk mund të bashkohet prapashtesa **im**, por ndërkohë në gjuhë kanë zënë vend dhe përdoren edhe forma paralele si: *ajrim* dhe *ajrosje*, *armatim* dhe *armatosje*, *ngjyrim* dhe *ngjyrosje* etj. Në këtë rast bëhet fjalë për emra që emërtojnë të njëjtin veprim ndaj dhe përdorimi i të dyja formave në vend të njëra tjetrës është i përligjur⁵⁶.

⁵¹ Vepër e cituar

⁵² Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 1995, f. 67

⁵³ Lidhur me këtë fjalë, “Gramatika e gjuhës shqipe I” (1995) sqaron se ajo në sistemin e sotëm fjalëformues paraqitet semantikisht dhe strukturalisht si e prejardhur nga emir *çudi*.

⁵⁴ Në shkrimin e tij “Formimi i ndajfoljeve”, në “Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme I”, f.288, E. Hysa e shikon prapashtesimin si mënyrën kryesore të formimit të ndajfoljeve.

⁵⁵ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë 1995, f. 141;

⁵⁶ L. Buxheli, Rreth formimeve paralele me prapashtesat **-im** dhe **-je** në shqipen e sotme letrare, në: *Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë, 1986, f. 401 - 404

-i, -(ë)si dhe **-(ë)ri**: *agronomi, largpamësi* etj.; *aftësi, zemërgjerësi* etj.; *besnikëri, rrjedhshmëri* etj.; **-(ë)s**: *blerës, dëgjues*, etj. *dallues, helmues* etj. **-ar** dhe **-tar**: *argjendar, fshatar* etj.; *kujdestar, luftëtar* etj.; *arbitrar, bregdetar* etj.; *amtar, kombëtar* etj.; **-or**: *ajror, yjor* etj.; **-ore, -tore** dhe **-ishte/ishtë**: *akullore, bregore* etj.; *barishte, ullishtë* etj. **-o**: *afroj, vrapoj* etj.; **-(i)sht**: *besnikërisht, zyrtarisht* etj.; *krejtësisht, thjeshtësisht* etj.; **-as**, bashkë me variantet e saj: *-az, -azë, -azi, -aza*: *barkas e barkazi, doras, fytas e fytazi* etj.; *anasjelltas, fshehtas e fshehtazi* etj.; **-shëm**: *fuqimisht, rrjedhshëm* etj.

Në gjuhën shqipe përdoren edhe disa prapashtesa të huaja për formimin e fjalëve. Ndër to përmendim: **-izëm**: *alpinizëm, optimizëm* etj.; prapashtesën **-azh**: *grupazh, tonazh* etj.; prapashtesën **-ik**: *atletikë, metodikë* etj., prapashtesën **-iv**: *administrativ, sportiv* etj.

I.2.1.3. Prejardhja me parashtesim e prapashtesim njëkohësisht

Prejardhja parashtesoprapashtesore është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës formohen fjalë të reja duke iu bashkangjitur drejtpërdrejt temës fjalëformuese parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht. Në fjalët e formuara sipas kësaj mënyre fjalëformuese parashtesa dhe prapashtesa kanë të dyja bashkë vlerën e një formanti të vetëm fjalëformues. Nëse një fjale të prejardhur, formuar sipas kësaj mënyre do t'i hiqnim njërin nga ndajshtesat atëherë do të na mbetej një temë e cila nuk është e gjallë në gjuhën shqipe. P.sh. nëse fjalës *zbukuroj* do t'i largonim parashtesën **z-**, do të na mbetej tema *bukuroj*, një fjalë që nuk ekziston në gjuhën shqipe. Në të njëjtin përfundim do të mbërrinim edhe nëse po kësaj fjale do t'i hiqnim prapashtesën **-o(j)**. Në këtë rast do të na mbetej tema *zbukur*, e cila gjithashtu nuk përbën një fjalë në gjuhën shqipe.

Fjalëformimi parashtesoprapashtesor është një mënyrë shumë më pak prodhimtare krahasuar me dy llojet e tjera të prejardhjes. Formime parashtesoprapashtesore janë pak emra dhe disa folje si:

përbindësh, përdhes, përjetësi, përkrenare, përqindje, etj.; *nguros, përgjithësoj, përgënjeshtroj, përjetësoj, përmalloj, përtërit, përvetësoj, shfletoj, shfrytëzoj, shkripëzoj, shpronësoj, zgjeroj* etj.

Siç mund të vihet re edhe nga shembujt e sjellë, si temë fjalëformuese në të shumtën e rasteve shërben një temë emërore dhe më pak një temë mbiemërore e përemërore. Parashtesat që marrin pjesë në këtë tip fjalëformimi janë **për-**, **sh-**, **z-** e më rrallë **n-**. Ndërsa si prapashtesa shfaqen **-si**, **-ar**, **-je** dhe **-o**, **-so** e **-zo**.

I.2.1.4. Prejardhja pa ndajshtesë

Prejardhja pa ndajshtesë nuk është një mënyrë fjalëformuese prodhimtare në gjuhën shqipe, por gjithsesi ka disa fjalë të cilat ndonëse nga forma nuk kanë ndonjë ndajshtesë, janë të motivueshme nga pikëpamja kuptimore. Pra, formimi i këtyre fjalëve bëhet pa ndonjë ndajshtesë⁵⁷, por vetëm me kalimin e saj nga një kategori e caktuar leksiko-

⁵⁷ Emrat e gjinisë femërore, në analogji me emrat e tjerë, formësohen fonetikisht me anë të shtimit të zanores ë pas bashkëtingëllores fundore.

gramatikore në një tjetër. Në këto raste kemi të bëjmë me formantin fjalëformues ndajshesor zero, i cili bashkë me paradigmen e re të fjalës bëhen shprehës të kuptimit që fiton fjala e re e formuar në raport me temën e saj fjalëformuese. Me këtë mënyrë fjalëformuese formohen vetëm disa emra dhe disa folje. Si tema fjalëformuese për formimin e emrave, si: *hap-i, mund-i, kyç-i, shkul-i, kullotë, lojë, pritë, rrjedhë, mburojë, shtrajtje*⁵⁸ etj. shërbejnë foljet: *hap, mund, kyç, shkul, kullot, luaj, rrjedh, mburoj, shtrajt*; ndërsa temat fjalëformuese emërore dhe mbiemërore shërbejnë për të formuar pa ndajshesa disa folje: *huaj, krip, kujdesem myk, ndryshk, qelb, sit, shëllij, shosh* etj.; *sëmur, kuq, verdh, shëndosh, trash* etj.

I.2.2. Nyjëzimi

Nyjëzimi, formimi i fjalëve të reja me anë të nyjës, është një tjetër mënyrë fjalëformuese mjaft prodhimore në gjuhën shqipe. Me anë të nyjëzimit formohen mbiemra si dhe emra prejfoljorë asnjansës e femërorë.

Nyjat janë kryesisht morfema trajtëformuese, shprehëse të kategorive gramatikore, por ato mund të jenë njëherazi edhe fjalëformuese, si ndodh në rastet kur nëpërmjet tyre formohen mbiemra të nyjshëm, duke kryer në këtë mënyrë dy funksione.

Si tema fjalëformuese për formimin e mbiemrave të nyjshëm shërbejnë: tema fjalëformuese foljore, tema emërore dhe ndajfoljore si dhe togfjalëshat e përngjitur parafjalë + emër⁵⁹.

Grupin më të madh të mbiemrave të formuar me nyjëzim e përbëjnë ata që formohen nga pjesorja e foljeve. Këta mbiemra kanë qenë objekt studimi prej kohësh nga gjuhëtarët shqiptarë. Karakterin e tyre kuptimor pësor, në disa raste edhe vepror, e gjejmë të shprehur dhe në gramatikën e I. D. Sheperit⁶⁰, i cili i quan “*mbiemra pjesorë*” ose “*pjesore të nyjëshme*”. Si të tillë cilësohen këta mbiemra edhe sa i takon mënyrës së formimit edhe nga Demiraj⁶¹. Ndonëse nuk trajtohen hollësisht, edhe për Cipo⁶² këto formime janë mbiemra foljorë. Në analizën që i bën Dhrimo⁶³ formimit të mbiemrave, i kushtohet një vëmendje e madhe edhe mbiemrave prejpjesor të formuar me anë të nyjëzimit. Madje Dhrimo dallon edhe disa mbiemra formuar me analogji si p.sh. *i skamur* apo *i talentuar*, pasi nuk ekzistojnë në shqip foljet përgjegjëse.

Një tjetër qëndrim mban Çeliku lidhur me këto formime. Ai njeh dy trajta të pjesores së shqipes, trajtën pa mbaresë të përparme (*punuar*) dhe trajtën me mbaresë të përparme (*i*

⁵⁸ Emrave të prejardhur pa ndajshesa nëse janë të gjinisë femërore u shtohet zanorja *ë* në analogji me emrat e tjerë femërorë.

⁵⁹ Mbiemrat e formuar nga nyjëzimi i togfjalëshave të përngjitur parafjalë + emër, trajtohen më poshtë në një nënçështje tjetër, pasi në formimin e mbiemrave të këtij tipi bashkëveprojnë dy mënyra fjalëformuese, nyjëzimi dhe përngjitja njëkohësisht, shiko në f. 18 të këtij punimi

⁶⁰ I. D. Sheper, Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927, f. 131

⁶¹ Sh. Demiraj, Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa e I, Morfologjia, Tiranë, 1962, f.87

⁶² K. Cipo, Gramatika shqipe, Tiranë, 1949, f. 78

⁶³ A. Dhrimo, Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe, në: Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, Tiranë, 1975, f.141 - 190

punuar)⁶⁴. Duke pranuar pjesoren e nyjzuar, ai i shqyrton mbiemrat e mësipërm si mbiemra të formuar “*sipas tipit të fjalëformimit me konversion (pa ndajshesë), duke mos pranuar në këtë rast formimin me nyjzim...*”.⁶⁵ Për ne këta mbiemra janë formuar me nyjzim nga pjesoret e foljeve.

Numri i mbiemrave prejpjesor të nyjzuar është shumë i madh: *i besuar, i bindur, i caktuar, i çliruar, i dashuruar, i ndarë, i rrëmbyer, i shtruar, i shkëlqyer, i shkuar* etj.

Ndërsa grupi i lartpërmendur përbën dhe numrin më të madh të mbiemrave të formuar me nyjzim, mbiemrat e formuar me nyjzim nga ndajfolje cilësore vendi e kohe janë më të kufizuar në numër: *i afër, i çiltër, i përpjetë, i shumë, i tatëpjetë, i vonë, i verbër* etj.

Dhrimo⁶⁶ dallon edhe disa mbiemra formuar nga paranyjzimi i disa temave emërore që përdoren kryesisht në gjuhën e folur: *i balë, i limë, i sorrë, i tinë, i valë, i vlerë*.⁶⁷

Grupin e dytë të fjalëve të formuara me nyjzim e përbëjnë emrat prejfoljorë asnjans dhe femërore si p.sh.: *të ecurit, të goditurit* apo *e goditura, të qeshurit* apo *e qeshura, e shkuara, të qarët* apo *e qara*, etj. të cilët sot vështrohen si të formuar drejtpërdrejt nga nyjzimi i pjesores dhe jo nga emërimi i mbiemrave prejpjesorë asnjans apo femërorë nga e kanë burimin. Ky tip është kufizuar mjaft pasi vendin e shumë prej këtyre fjalëve e kanë zënë formimet prapashtesore.

I.2.3. Konversioni

Konversioni është mënyra e formimit të fjalëve të reja si pasojë e kalimit të tyre në një pjesë tjetër të ligjeratës pa ndërhyrjen e ndonjë afiksi apo alternimi fonetik. Ky kalim i fjalës në një pjesë tjetër të ligjeratës ndodh për shkak të kushteve sintaksore në të cilat përdoret ajo. Fjala e re është homonime me fjalën nga e cila ka dalë. Ato ndryshojnë nga njëra-tjetra vetëm nga paradigmaticat e tyre, pra paradigmatica e re që fiton fjala e re, ose humbja e paradigmaticës së vjetër të saj si dhe lidhjet e reja sintaksore që ajo fiton, shërbejnë si formant fjalëformues për këto fjalë të formuara me konversion. Konversioni si mënyrë e mirëfilltë fjalëformuese ka nisur të shqyrtohet relativisht vonë në gramatologjinë shqipe, ndonëse shenja të tij gjejmë te disa shkrime deri diku të hershme.⁶⁸

⁶⁴ M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, shblu, Tiranë, 2000, f.74

⁶⁵ M. Çeliku, *po aty*, f. 211

⁶⁶ A. Dhrimo, *po aty*, f. 178

⁶⁷ Nga këta mbiemra që përmenden në artikullin e Dhrimos vetëm mbiemrat “*i balë*” dhe “*i valë*” gjenden edhe në “*Falorin e shqipes së sotme*”, botim i vitit 2002.

⁶⁸ I. D. Sheperi, në gramatikën e tij (1927, f.39) njih përdorimin e mbiemrave si emra, dhe i quan këta të fundit emra të prejardhur. Gjithashtu ai njih të përdoren si ndajfolje edhe rasa emrash e pjesoret (po aty, f.122). Edhe në gramatikën e Cipos (1949, f.78) gjejmë mbiemra të përdorur në vend të një emri të nënkuptuar, të cilët ai i quan mbiemra të substantivuar, si dhe për substantiva në kallëzore që përdoren si ndajfole (1949, f.181). Xhuvani në shkrimin e tij “*Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipe*” analizon ndajfoljet e formuara nga rasa emrash. Mjaft qartë shfaqet dhe analizohet konversioni si mënyrë fjalëformimi në gramatikën dhe shkrimet e mëvonshme të gjuhës shqipe. Hysa, në studimin e tij “*Formimi i ndajfoljeve*” (SF.3/1970), analizon me hollësi formimin e ndajfoljeve nga emrat, mbiemrat dhe nga foljet. Në “*Gjuha letrare*

Në gjuhën shqipe me konversion formohen si pjesë të pandryshueshme të ligjeratës ashtu edhe pjesë të ndryshueshme të saj. Gjejmë të formuar me konversion: emra, mbiemra, ndajfolje, parafjalë, lidhëza, pasthirrma dhe ndonjë përemër. Më poshtë gjenden shembuj më konkretë për disa nga modelet kryesore të konversionit:

mbiemër:	Letër <i>e bardhë</i>	→	emër:	<i>E bardha</i> e syrit
emër:	Bën punën e <i>armikut</i>	→	mbiemër:	Ushtri <i>armike</i>
emër:	Kush ka <i>ditën</i> , të mos presë mesditën	→	ndajfolje:	<i>Ditën</i> të lëpin këmbët natën të ngul dhëmbët
parafjalë:	Luftoi <i>kundër</i> armikut	→	ndajfolje:	I rrinte <i>kundër</i>
ndajfolje:	I qëndroi <i>përballë</i> shkollës	→	parafjalë:	Gjendet <i>përballë</i>
emër:	Kafshoi <i>buzën</i>	→	parafjalë:	<i>Buzë</i> detit
ndajfolje:	<i>Ku</i> shkon?	→	lidhëz:	Do të vijmë <i>ku</i> të shkosh ti.

Nisur dhe nga fakti se konversioni shërben si mënyrë fjalëformimi për shumë pjesë të ligjeratës, veçanërisht për pjesët e pandryshueshme të saj, kjo dhe për faktin se mënyrat morfologjike nuk veprojnë te fjalët shërbyese⁶⁹, mund të thuhet se luan një rol me rëndësi në sistemin fjalëformues të gjuhës shqipe.

Nëpërmjet konversionit formohen emra nga mbiemra dhe nga pjesore, të cilët kur emërzohen, nuk emërtojnë më cilësi e tipare të personave ose sendeve, apo një veprim si tipar të një sendi, por vetë personat e sendet, apo veprimin të marrë si send. Të tillë janë: *besniku, i gjalli, veriori, i dashuri, e keqja, e shkuara, të kuqtë, të ftohtët* etj; *të ardhurat, të lashtat, të palarat* etj.

Me konversion formohen edhe shumë mbiemra. Në mbiemra kalojnë pa marrë ndonjë ndajshitesë emra dhe disa ndajfolje, si ato të formuara me prapashtesat *-çe* dhe *-ishte* si: *armik, bullgar, çalaman, elbasanas, kukull, mishngrënës* etj; *fshatçe, pleqërishte* etj.

Në gjuhën shqipe ndajfoljet formohen edhe nga rasat e ndryshme të emrave, si dhe nga foljet, kryesisht nga pjesorja e foljes dhe më pak nga përcjellorja mohore e mënyrës⁷⁰: *fare, herët, krejt; ditën, natën*, etj.; *motit, sheshit, një nate* etj.; *fshehur, prerë, shkoqur; papritur, padashur* etj.

shqipe për të gjithë" (1976), në pjesën e tretë, veç të tjerash shqyrtohen si nënçështje më vete emërzimi, mbiemërzimi, ndajfoljezimi dhe parafjalëzimi. Ndërsa Dhirmo në studimin që i ka bërë formimit të mbiemrave në gjuhën shqipe, në "*Çështje të gramatikës së shqipes së sotme*" (1975), shqyrton si nënçështje më vete mbiemrat e formuar me konversion. Shumë qartë dhe hollësisht trajtohet konversioni si mënyrë fjalëformimi në "*Gramatikën e gjuhës shqipe, 1*", 1995

⁶⁹ Në "*Gramatikën e gjuhës shqipe, 1*" (1995 dhe 2002) bëhet ndarja e e mënyrave të fjalëformimit në mënyra morfologjike dhe jomorfologjike. Në mënyrat morfologjike përfshihen ndajshitesimi, nyjëzimi dhe kompozimi, pasi këto janë mënyrat që formojnë fjalë të reja nga temat e ndajshitesat fjalëformuese të gjuhës bazur tek analogjia. Parafjalët, lidhëzat dhe pasthirrmat, të cilat kanë një kuptim leksikor të kushtëzuar nga shërbimi që ato kryejnë në fjali, quhen fjalë shërbyese.

⁷⁰ Kështu e quan M. Çeliku formën e pashtjelluar mohore formuar nga pa + pjesore në "*Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*", Tiranë, 2000

Ndërsa në Gramatikën e gjuhës shqipe⁷¹, në formën e një shënimi gjejmë ndajfoljen *kundër* të formuar me konversion nga parafjala *kundër*. Gjithashtu me konversion janë formuar edhe disa përemra të pacaktuar si *kush* nga përemri pyetës *kush*, përemrat *gjë* dhe *njeri* nga emrat përkatës *gjë* dhe *njeri*.

Me anë të kësaj mënyre fjalëformimi nuk formohen vetëm pjesë të ndryshueshme të ligjeratës, por edhe pjesë të pandryshueshme. Kështu formohen disa parafjalë jo të parme të gjuhës shqipe, të cilat përkojnë formalisht e deri diku edhe semantikisht, me pjesën e ligjeratës nga e cila kanë dalë. Parafjalë ndajfoljore, të cilat përbëjnë dhe grupin më të madh të parafjalëve formuar me konversion janë: *afër*, *anës*, *poshtë*, *rreth*⁷², *tej* etj.; parafjalë emërore: *anë*, *ballë*, *bri*, *faqe*, *rrëzë* etj. Si parafjalë foljore që dalin nga pjesoret e foljeve, përveç parafjalës *falë*, Çeliku rendit edhe katër të tjera: *përfshirë*, *përrjashtuar*, *shkuar* dhe *kaluar*; si dhe pak pjesore që janë duke u kthyer në parafjalë si: *shtuar*, *drejtuar*, *kushtuar*⁷³. Gjithsesi këto fjalë nuk janë pranuar në “*Fjalorin shqipes së sotme*” si parafjalë.

Me konversion formohen gjithashtu edhe lidhëza, si p.sh. lidhëzat përemërore dhe ato ndajfoljore: *që*, *sa*, *se*, formuar nga përemrat përkatës lidhorë e pyetës dhe lidhëzat *ku*, *kur*, *nga*, *tek*, *veç* dalë nga ndajfoljet përkatëse. Ne gjuhën shqipe kemi dhe lidhëzat *daç* e *qoftë* të cilat kanë dalë nga fojet *dua* dhe *jam*⁷⁴.

Formohen disa pjesëza ardhur kryesisht nga lidhëza: *dhe*, *edhe*, *porsa*, *pra*, *sa* etj.; nga ndajfolje: *gati*, *plot*, *rreth*, *vetëm* etj.; nga pasthirrma: *a*, *e*, *ë*, *de* etj.

Si pasthirra të formuara me konversion në shqipe kemi disa forma të ngurosurra të emrave dhe mbiemrave të emëruar si: *forca*, *korba*, *qyqja*, *e zeza* etj.

I.2.4. Mënyrat e përziera

Më sipër janë shqyrtuar disa nga mënyrat e fjalëformimit të gjuhës shqipe bashkë me nëndarjet e tyre dhe shpesh është vërejtur se kufijtë mes tyre nuk janë fort të qartë. Në ndonjë rast është e vështirë të përcaktosh ku mbaron parashtesimi dhe ku fillon kompozimi apo përngjitja, shpesh gjejmë forma të cilat ndodhen në një proces të ndërmjetëm. Edhe qëndrimi i gjuhëtarëve për fjalë apo mënyra të caktuara nuk duket të jetë i njëjtë⁷⁵. Pra çështja e fjalëformimit duket të jetë shumë më komplekse. Gjithashtu

⁷¹ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 1995, f. 384

⁷² Lidhur me prejardhjen e parafjalës *rreth* ka pasur qëndrime të ndryshme. Demiraj në “*Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, II*” (1961, f. 271) dhe Xhuvani në “*Parafjalët*” (Vepra I, 1980, f.329) e klasifikojnë si parafjalë emërore. Por në “*Gramatika e gjuhës shqipe, I*” (1995, f. 384) emri *rreth* është shndërruar fillimisht në ndajfolje dhe më pas në parafjalë.

⁷³ Çeliku dhe të tjerë, Gramatika praktike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004, f. 227

⁷⁴ Lidhëza “*daç*” ka dalë nga trajta e vetës së dytë njëjës të dëshirores së foljes *dua*, ndërsa lidhëza “*qoftë*” nga trajta e vetës së dytë njëjës të dëshirores së floyes *jam*.

⁷⁵ Mjafton të përmendim këtu qëndrimin e kundërt të Demirajt lidhur më ndajfoljet formuar nga rasat e emrave. Gjithashtu Dhrimo mbiemrat e formuar me përngjitje dhe nyjëzim i shqyrton brenda grupit të mbiemrave të formuar me nyjëzim, ndërsa mbiemrat e formuar me nyjëzim, përngjitje dhe prapashtesim njëkohësisht i gjejmë brenda tipit me nyjëzim e prapashtesim njëkohësisht. Por duke qenë se një nga qëllimet kryesore të këtij punimi është edhe përqasja e

në mjaft raste mënyrat e fjalëformimit kanë bashkëvepruar me njëra-tjetrën duke krijuar tipa të rinj fjalësh, të cilët nuk mund të klasifikohen në asnjë nga tipat e trajtuar më lart. Mbiemri “*i rëndësishëm*” është një mbiemër i prejardhur ku dallohet qartazi që si temë fjalëformuese ka shërbyer emri abstrakt *rëndësi*, por ky mbiemër nuk është formuar as me prapashtesim, edhe pse prapashtesa –*shëm* duket fort qartë, as me nyjëzim, por nga gërshetimi i këtyre dy mënyrave. Por mbiemrat e këtij tipi nuk përbëjnë të vetmin rast të bashkëveprimit të mënyrave të ndryshme fjalëformuese. Kjo ka bërë që në gjuhën shqipe të shqyrtohen si një tip i veçantë fjalëformi edhe mënyrat e përziera bashkë me nëndarjet përkatëse, të cilat nuk janë të pakta, ndonëse disa janë më shumë prodhimore e të tjera më pak. Më poshtë shqyrtohen gërshetimet më të zakonshme të mënyrave.

I.2.4.1. Nyjëzim dhe prapashtesim

Nga gërshetimi i nyjëzimit me mënyrën e prapashtesimit është pasuruar shumë klasa e mbiemrave të gjuhës shqipe me fjalë të reja, duke e bërë këtë mënyrë fjalëformimi ndër më prodhimore në formimin e mbiemrave. Katër janë prapashtesat, të cilat duke vepruar me tema fjalëformuese emërore, ndajfoljore, mbiemërore, foljore, madje në disa raste si temë fjalëformuese shërbejnë edhe numërorët, dhe me nyjen, roli si formant fjalëformues i së cilës në këtë rast nuk mund të mohohet, kanë formuar një numër shumë të madh mbiemrash.

-shëm⁷⁶: *i arsyeshëm, i begatshëm, i përhershëm* etj.; *i admirueshëm, i rrëmbyeshëm* etj.; **-(ë)m(ë)**: *i andejmë, i jashtëm* etj. *i fisëm, i larmë* etj.; prapashtesa **-(ë)t(ë)** veç te tjerash edhe me numërorë⁷⁷: *i acartë, i mermertë* etj.; *i çelët, i fishkët* etj.; *i afërt, i barabartë* etj.; *i dytë, i katërt* etj.; **-ë** (jo fort prodhimore): *i drejtë, i kotë* etj.; *i dyzetë, i tridhjetë* etj.

I.2.4.2. Nyjëzim dhe parashtesoprapashtesim

Ky është një tjetër tip fjalëformimi i cili gërsheton mënyrën e nyjëzimit me atë të parashtesoprapashtesimit. Me anë të kësaj mënyre formohen mbiemra nga tema fjalëformuese emërore, ndajfoljore dhe përemërore, të cilat bashkohen njëkohësisht me parashtesën *për-* dhe prapashtesat *-ëm, -të* dhe *-shëm*. Si mbiemra të formuar sipas kësaj mënyre mund të përmenden: *i përciptë, i përpiktë, i përvajshëm, i përgjithshëm* etj.

mënyrave të fjalëformimit në gjuhën shqipe dhe atë gjermane është menduar që mënyrat e formimit të këtyre mbiemrave të shqyrtohen më vete.

⁷⁶ Këtë prapashtesë A. Dhrimo në studimin e tij mbi formimin e mbiemrave, vepër e cituar dhe më parë, e sheh si prapashtesën më prodhimore në formimin e mbiemrave duke e dalluar atë jo vetëm për prodhimtarinë e saj dhe numrin shumë të madh të mbiemrave të formuar me të, por edhe për faktin se ajo lidhet më shumë me tema prodhuese. Sipas tij thuajse çdo folje është në gjendje të formojë me anë të kësaj prapashtese dhe nyjës një mbiemër.

⁷⁷ Me paranyjëzim dhe këtë prapashtesë formohen nga numërorë një numër i pafund mbiemrash. Argumentat për përfshirjen e tyre në klasën e mbiemrave i ka sjellë Dhrimo në studimin e tij mbi fjalëformimin e mbiemrave, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975, f. 172

I.2.4.3. Nyjëzim dhe përngjitje e prapashtesim

Disa mbiemra në gjuhën shqipe janë formuar me anë të përngjitjes së një togu parafjalor, por jo vetëm, dhe të nyjëzimit e prapashtesimit njëkohësisht.

Kështu nga përngjitja e togut parafjalë + emër dhe nyjëzimi e prapashtesa –shëm ose –t(ë) janë formuar mbiemrat: *i panumërt, i parakohshëm, i pathemeltë, i përjavshëm* etj.

Nga temat ndajfoljore të cilat gjatë formimit të mbiemrave me paranyjëzim dhe prapashtesim i nënshtrohen edhe përngjitjes formohen mbiemra të tjerë si: *i mëtejshëm, i mëtejme, i deriatëhershëm, i derisotëm, i herëpashershëm, i mëparshëm* etj.

Gjithashtu sipas kësaj mënyre janë formuar edhe mbiemrat: *i njëhopshëm, i njëkohshëm, i njëpasnjëshëm* etj.

I.2.4.4. Nyjëzim dhe përngjitje

Me anë të kësaj mënyre formohen mbiemra të nyjshëm nga një tog parafjalor, i cili shërben si temë fjalëformuese. Në togun parafjalor merr pjesë parafjala *pa* dhe një *emër në rasën kallëzore të pashquar*. Duke qenë se pjesë përbërëse e mbiemrave të këtij tipi është parafjala *pa*, ata mohojnë zotërimin e sendit të karakterizuar prej tyre: *i paanë, i pafytyrë, i papërvojë, i pashtëpi* etj.

I.2.4.5. Përngjitje dhe prapashtesim

Në gjuhën shqipe ka fjalë të cilat janë formuar nga bashkëveprimi në të njëjtën kohë i përngjitjes dhe i prapashtesimit. Kështu gjejmë emra të formuar nga përngjitja e togut parafjalë + emër dhe një prapashtesë: *mëditje, mëkëmbës, nëndetëse, nëpunës, pagjumësi, pakujdesi, përshpirtje* etj.

Me përngjitje dhe prapashtesim janë formuar edhe disa ndajfolje si: *njëherazi, papritmas, përgjumësh* etj.

Edhe pse nuk është shumë i madh grupi i fjalëve të formuara sipas kësaj mënyre fjalëformimi, ajo shihet si e rëndësishme në këtë punim, pasi dëshmon për pasurinë dhe larmishmërinë e mënyrave fjalëformuese të gjuhës shqipe.

I.3. Mënyrat e fjalëformimit në gjuhën gjermane

Qysh në gramatikat më të vjetra të Gjermanishtes së re të lartë (*Neuhochdeutsch*) gjejmë ndarjen e fjalëve në *fjalë të thjeshta* “simplicia” dhe në *fjalë të përbëra* “composita” si dhe dallimin mes fjalëve *originale* (primitive) dhe fjalëve të *prejardhura* (derivativa). Por fjalëformimi do të bëhej pjesë e gramatikave në shekullin 19-të dhe 20-të, duke kristalizuar e nxjerr në pah modelet e mënyrat e ndryshme të formimit të fjalëve në gjuhën gjermane⁷⁸.

⁷⁸ J. Erbsen, Einführung in die deutsche Wortbildungslehre, Erich Schmidt Verlag, Berlin 2006, f.10

Fjalëformimi është një temë e shqyrtuar shumë nga gjuhëtarët gjermanë, qoftë si pjesë përbërëse e gramatikave, qoftë edhe si çështje më vete trajtuar në shumë vepra nga autorë të ndryshëm, çka tregon dhe përpjekjen e gjuhëtarëve gjermanë për ta nxjerrë fjalëformimin si një disiplinë të veçantë gjuhësore.

Gjuha gjermane është një gjuhë shumë e pasur në fjalë. Jung⁷⁹, bazuar në disa studime vlerëson se leksiku i gjuhës letrare gjermane përfshin rreth 500 000 fjalë, nga të cilat më shumë se gjysma janë emra. Foljet përbëjnë një të katërtën e këtij leksiku, ndërsa mbiemrat dhe ndajfoljet një të gjashtën e tij. “*Die Substantive, Verben und Adjektive vermehren und verändern ihren Bestand standing, Pronomen und Fügewörter bleiben in Form und Umfang nahezu konstant.* / Emrat, foljet dhe mbiemrat ndryshojnë dhe e pasurojnë vazhdimisht klasën e tyre me fjalë të reja, ndërsa përemrat dhe fjalët lidhëse (“Fügewörter”⁸⁰) mbeten thuajse konstante në formë dhe numër”. Ndoshta kjo është dhe një nga arsytet pse pjesa më e madhe e literaturës gjuhësore fjalëformuese i përqëndron shqyrtimet dhe analizat e saj në fjalëformimin e emrave, foljeve dhe mbiemrave, dhe më pak në atë të ndajfoljeve.

Ndonëse qëndrimet lidhur me klasifikimin e mënyrave të fjalëformimit kanë qenë të ndryshme, nisur dhe nga fakti se ndarjet janë bërë sipas kritereve të ndryshme, duket se të gjithë ndajnë të njëjtin mendim lidhur me përcaktimin e objektit të fjalëformimit dhe pranojnë në teoritë e tyre si dy mënyrat kryesore të fjalëformimit kompozicionin dhe prejardhjen (derivacioni)⁸¹.

Eichler/Büntig⁸² në kapitullin kushtuar fjalëformimit, duke u bazuar në modelet e fjalëformimit si dhe në strukturën morfologjike të fjalës, dallojnë *fjalë të thjeshta*, ku përfshihen ato fjalë që përbëhen nga një leksemë me ose pa morfemë trajtëformuese, *fjalë të prejardhura*, të cilat përbëhen nga një leksemë, një ose disa morfema fjalëformuese, me apo pa morfema trajtëformuese, si dhe *fjalë të përbëra*, të cilat përfshijnë fjalët që kanë në përbërjen e tyre të paktën dy leksema me apo pa morfema fjalëformuese dhe trajtëformuese.

Duke u mbështetur në gramatikën tradicionale dhe duke marrë parasysh si kriterin formal ashtu dhe atë semantik, Jung⁸³, Naumann⁸⁴, Fleischer⁸⁵ dhe Duden⁸⁶ dallojnë si mënyra kryesore të fjalëformimit: **kompozimin**, **prejardhjen** dhe **parashtesimin**, të cilave u njohin dhe nënndarjet përkatëse. Kjo nuk do të thotë se këta gjuhëtarë nuk pranojnë mënyra të tjera fjalëformimi, por nuk i shohin kaq të rëndësishme sa tri të lartpërmendurat.

Ndërsa Hentschel-i dhe Weydt-i i bashkohen qëndrimit të Coseriu⁸⁷ dhe i ndajnë fjalët nga pikëpamja e fjalëformimit nisur nga dy kritere semantike: së pari nëse fjala e re e formuar ndryshon kategorinë leksikogramatikore duke u kthyer në një tjetër pjesë

⁷⁹ W. Jung, *Grammatik der deutschen Sprache*, Leipzig, 1980, f. 369

⁸⁰ parafjalët dhe lidhëzat

⁸¹ T. Schippan, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache*, Niemeyer, Tübingen, 1992, f. 115

⁸² W. Eichler, K.D. Bünting, *Deutsche Grammatik*, Königstein, 1994, f. 227

⁸³ W. Jung, *Grammatik der deutschen Sprache*, Leipzig, 1980

⁸⁴ B. Naumann, *Wortbildung in der deutschen Gegenwartssprache*, Niemeyer, Tübingen, 1972

⁸⁵ W. Fleischer, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, VEB, Leipzig, 1983

⁸⁶ Duden, *Die Grammatik*, Band 4, Mannheim, 1998

⁸⁷ E. Hentschel / H. Weydt, *Handbuch der deutschen Grammatik*, VdG, Berlin, 1990, f. 23

ligjerate, dhe së dyti duke pasur parasysh numrin e temave fjalëformuese dhe pjesëmarrjen e kuptimit të tyre në formimin e fjalëve të reja. Nisur nga këto kritere, edhe ata dallojnë tri mënyra kryesore fjalëformimi: *kompozimin*, nëpërmjet të cilit formohen fjalë të reja nga bashkimi i dy ose më shumë temave fjalëformuese, *transformimin*, proces sipas të cilit nga pjesëmarrja e një teme fjalëformuese dhe një ndajshtese fjalëformuese formohen fjalë të reja duke u transformuar në një pjesë tjetër ligjerate, si dhe *modifikimin*, i cili edhe pse formon fjalë të reja nëpërmjet një teme fjalëformuese dhe afikseve, ndryshon nga transformimi pasi fjala i përket po asaj pjese ligjerate sikurse dhe tema prodhuese. Pra, bëhet fjalë po për të njëjtat mënyra fjalëformuese vetëm se ndryshojnë emërtimet.

Në botimin e vitit 2007⁸⁸, një punim në bashkëpunim me Barz-in, Fleischer-i e zgjeron spektrin e mënyrave të rëndësishme të fjalëformimit duke trajtuar më vete edhe konversionin e formimin e fjalëve me shkurtim. Konversioni është cilësuar si një mënyrë po aq e rëndësishme sa dhe kompozimi e prejardhja edhe për Duden-in⁸⁹ dhe Eisenberg-un⁹⁰. Ky i fundit parapëlqen termin ndajshtesim në vend të termit prejardhje, pasi parashtesimin ai e sheh si një nga nënndarjet e prejardhjes dhe jo si një mënyrë fjalëformimi më vete.

Për të dhënë një paqyrë sa më të saktë të mënyrave fjalëformuese që ekzistojnë në gjuhën gjermane, duke iu referuar edhe punimeve dhe gramatologjive të autorëve të përmendur më lart, për t'i shërbyer sa më mirë dhe njërit prej qëllimeve të këtij punimi, krahasimit dhe nxjerrjes në pah të të përbashkëtave dhe dallimeve mes sistemeve fjalëformuese të të dyja gjuhëve, po hartojmë këtë klasifikim të mënyrave të fjalëformimi që veprojnë në gjermanishte:

PREJARDHJA	parashtesore
	prapashtesore
	parashtesoprapashtesore
	pa ndajshtesa
	prapavepruese
KOMPOZIMI	
KONVERSIONI	
PËRNGJITJA	
SHKURTESAT	
KONTAMINIMI	
DYFISHIMI	
MËNYRA E PËRZIER	kompozim dhe prapashtesim

I.3.1. Prejardhja / Derivacioni

⁸⁸ W. Fleischer / I. Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Niemeyer, Tübingen, 2007

⁸⁹ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim-Leipzig, 1998


⁹⁰ P. Eisenberg, Das Wort, Grundriss der deutschen Grammatik, Band 1, Stuttgart-Weimar, 2006

Prejardhja së bashku me kompozimin përbëjnë dy mënyrat më të rëndësishme dhe prodhimtare të gjuhës gjermane. Në gramatologjinë dhe studimet mbi fjalëformimin prejardhja është parë në forma të ndryshme. Shpesh është bërë dallimi mes prejardhjes së shprehur (eksplícite) dhe prejardhjes së nënkuptuar (implicite). Por shpesh me të njëjtin term nuk nënkuptohet e njëjta gjë, pasi disa gjuhëtarë si Kuhn-i⁹¹, Jung-u⁹² dhe Fleischer-i⁹³ shohin si prejardhje të shprehur procesin e bashkimit të një teme motivuese me një prapashtesë. Parashtesimin ata e trajtojnë si një mënyrë të veçantë fjalëformimi. Ndërsa me prejardhje të nënkuptuar kemi rastin e formimit të fjalës së re pa ndonjë ndajshtesë, por vetëm me apofoni. Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme, në këtë punim do t'i bashkohemi qëndrimin të atyre gjuhëtarëve si Erben-it, Eisenberg-ut, Donaliesit, Weinrich-ut dhe Barz-it⁹⁴ e Lohde-es⁹⁵, të cilët prapashtesimin e kanë parë si një nga nënndarjet e prejardhjes.

Në gjuhën gjermane parashtesat dhe prapashtesat nuk janë të vetmet ndajshtesa fjalëformuese (Affixe). Krahas tyre në fjalëformim veprojnë edhe bimorfemat apo cirkumfikset (Zirkumfixe)

I.3.1.1. Parashtesimi

Parashtesat i paravendosen temave fjalëformuese duke formuar fjalë të reja sipas skemës:



Siç u theksua edhe më lart, parashtesimi është shqyrtuar si një mënyrë e veçantë brenda sistemit të fjalëformimit të gjermanishtes. Arsyet lidhen me natyrën dhe karakteristikat e parashtesës si morfemë fjalëformuese dhe me ndryshimet e saj me morfemat e tjera fjalëformuese, bimorfemën dhe prapashtesën. Parashtesat (prefikset) janë morfologjikisht njësi të lidhura, pra nuk mund të përdoren as më vete si fjalë të lira, dhe as mund të bashkohen me morfema trajtëformuese. Ato mund të modifikojnë kuptimin e temës fjalëformuese. Të tilla janë edhe prapashtesat, por teksa këto të fundit i paravendosen temës fjalëformuese dhe kanë karakter klasifikues, parashtesat i paravendosen temës fjalëformuese dhe nuk i sjellin ndonjë ndryshim asaj lidhur me përkatësinë e saj në ndonjë pjesë të ligjeratës. Ato në shumicën dërrmuese të rasteve janë neutrale nga

⁹¹ I. Kuhn, Lexikologie, eine Einführung, Niemeyer, Tübingen, 1994, f. 30

⁹² W. Jung, vepër e cituar

⁹³ Për Fleischer-in duhet thënë së ai këtë qëndrim mban në veprën e tij *Wortbildung der Gegenwartssprache* të vitit 1983, pasi në botimin e vitit 2007, në të cilin është bashkautor me I. Barz, edhe ai e sheh parashtesimin si pjesë të prejardhjes së shprehur.

⁹⁴ Të gjithë autorë të veprave tashmë të cituara.

⁹⁵ M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr- und Übungsbuch, gnv, Tübingen, 2006

pikëpamja gramatikore⁹⁶. Një tjetër ndryshim lidhet me theksin. Prapashtesat zakonisht nuk janë mbartëse të theksit, ndërsa parashtesat janë dy llojesh, të theksuara dhe të patheksuara. E njëjta parashtesë mund të përdoret me të njëjtin kuptim për të formuar pjesë të ndryshme ligjrate, në varësi edhe të temës fjalëformuese me të cilën lidhet, ndërsa prapashtesat janë të përcaktuara se çfarë pjese ligjrate formojnë dhe rrallë mund të ndodhë që të krijojnë homonime. Prapashtesa *-heit* si në rastin *Freiheit* formon emra, prapashtesa *-ig* si në rastin *eilig* mbiemra, ndërsa parashtesa *un-* mund të përdoret edhe për të formuar emra, si *Unsinn*, edhe mbiemra si *unabhängig*, duke ruajtur të njëjtën nuancë kuptimore në të dyja rastet. Gjithashtu, ndryshe nga prapashtesat, ndonjë parashtesë mund të përdoren edhe e dyfishuar: *Ururenkel*, *Ururenkelin*, *Urugroßeltern*, *Ururvater* etj. Githashtu parashtesat mund të vendosen edhe para fjalëve të tjera të prejardhura me parashtesim: *abziehen*, *abverkaufen*, *abvermieten*, *beantragen*, *beauftragen*, *vorbearbeiten*, *vorbekommen* etj.

Pjesa më e madhe e parashtesave e modifikojnë kuptimin e temës fjalëformuese në pjesën më të madhe të rasteve duke e përforcuar apo intensifikuar, ose duke e mohuar, por krahas tyre ka dhe parashtesa të tjera të cilat i japin tjetër kuptim leksikor (*verstehen*) ose gramatikor (*beantworten*) fjalës së re të formuar prej tyre. Disa Parashtesa në gjuhën gjermane bashkohen me tema fjalëformuese emërore, mbiemërore dhe foljore, të cilat mund të jenë fjalë të thjeshta apo edhe të prejardhura. Tipi parashtesor emëror është më pak i zhvilluar krahasuar me të tjerët. Më poshtë gjejmë disa nga parashtesat më të përdorura dhe më aktive të gjuhës gjermane.

erz-: *Erzamt*, *Erzengel* etj.; *erz böse*, *erzdumm* etj.; **miss-:** *Missachtung*, *Misserfolg* etj.; *missgebildet*, *missstönig* etj.; *missachten*, *missverstehen* etj. **un-:** *Unart*, *Ungleichgewicht* etj.; *unabhängig*, *unbequem*, etj.; *Unsumme*, *Unzahl*; **ur-**, *Urangst*, *Urzeit* etj.; *uralt*, *urdeutsch* etj.

Një çështje e diskutueshme dhe që interpretohet në forma të ndryshme në gramatologjinë gjermane dhe teorinë e fjalëformimit është çështja e fjalëformimit të foljeve në përgjithësi dhe e foljeve të ndashme në veçanti. Folja zë një vend shumë të veçantë në gjithë sistemin e gjuhës gjermane për vetë karakteristikat e veçanta gramatikore që ajo zotëron. Në ndryshim nga emrat dhe mbiemrat e përbërë dhe të prejardhur, pjesa e parë e disa foljeve të prejardhura dhe të përbëra ndahet, duke bërë që gjuhëtarët ta shqyrtojnë në mënyra të ndryshme fjalëformimin foljor dhe veçanërisht mënyrën e formimit të foljeve të ndashme. Gjithsesi për foljet e prejardhura ata pranojnë rëndësinë dhe rolin më të madh që luan parashtesimi krahasuar me nëntipet e tjera të prejardhjes, ku shpesh parashtesimi e bën më të qartë dhe kuptimin e vetë foljes si p.sh: *steigen – besteigen – einsteigen – aussteigen*.

Foljet e ndashme kur përdoren në një fjali të thjeshtë në kohën e tashme (Präsens) pakryer/të kryer të thjeshtë (Präteritum), ndahen duke formuar një kallëzues dygjymtyrësh:

Der Zug kommt pünktlich an. (Übungsgrammatik DaF, f. 38)

Der Zug kam pünktlich an. (Übungsgrammatik DaF, f. 38)

⁹⁶ Sipas Olsen, cituar nga Donalies në *Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick*, 2002, f. 55, *Righthand Head Rule*, përcakton në formën e një parimi të përgjithshëm, se fjalëve komplekse veçoritë morfologjike u përcaktohen nga elementi përbërës që ndodhet në të djathtë.

Në formën e pashtjelluar të paskajores (Infinitiv) dhe të pjesores (Partizip) si dhe kur përdoret në një fjali të varur me nënrenditje ky tip foljesh nuk ndahet.

Der Zug sollte pünktlich ankommen. (Übungsgrammatik DaF, f. 38)

Der Zug ist pünktlich angekommen. (Übungsgrammatik DaF, f. 38)

Der Zug, der pünktlich ankamm, hielt nicht lange. (Übungsgrammatik DaF, f. 38)

Ndarja e pjesës së parë të këtyre foljeve kushtëzohet kryesisht nga theksi. Që pjesa e parë e një foljeje të ndahet duhet të jetë bartëse e theksit të fjalës, në rast të kundërt folja është e pandashme.

Por disa pjesë foljesh përdoren edhe si të ndashme edhe si të pandashme. Në raste të tilla është semantika e foljes ajo që përcakton se ku bie theksi, duke përcaktuar njëkohësisht nëse folja është e ndashme apo jo. Te këto folje vihet re se kur janë të ndashme ato shpesh kanë kuptim konkret, ndërsa kur janë të pandashme kanë kuptim abstrakt⁹⁷.

Der Zug hält hier nicht, er fährt durch. (Übungsgrammatik DaF, f. 49)

Ein schrecklicher Gedanke durchfuhr sie. (Übungsgrammatik DaF, f. 49)

Por ndërsa të gjithë gjuhëtarët i shohin të gjitha foljet e pandashme si folje të formuara me parashtesim, foljet e ndashme shqyrtohen në mënyra të ndryshme. Për Wellmann-in⁹⁸ këto folje janë produkt i parashtesimit, por ndërsa foljet e pandashme i sheh si të formuara me parashtesë, pjesën e ndashme të foljeve të ndashme ai e quan gjysmëparashtesë. Edhe për Fleischer-in/Barz-in këto folje formohen me parashtesim, por ata pasi bëjnë ndarjen në folje të ndashme dhe të pandashme përdorin emërtimin parashtesë për të dyja grupet e foljeve. Për Lohde-n dhe Erben-in kemi të bëjmë me parashtesa të ndashme dhe parashtesa të pandashme. Ndërsa për Weinrich-un foljet e pandashme formohen sipas një mënyre të veçantë fjalëformimi, ndryshe nga foljet me pjesën e parë të pandashme, të cilat formohen me parashtesim. Këtë mënyrë ai e quan “*Konstitution/konstitucion*” dhe pjesën e ndashme e sheh si fjalë. Shumë i afrohet mënyrës së konstitucionit Donalies-i në mënyrën si i trajton nga pikëpamja e fjalëformimit foljet e ndashme, duke i analizuar ato si struktura sintaksore⁹⁹, ndërsa pjesën e ndashme e sheh si një element që shoqëron foljen. Dhe Eisenberg-u¹⁰⁰ dallon foljet e formuara me parashtesa duke klasifikuar si të tilla ato folje, elementi parashtesor i të cilave nuk ndahet asnjëherë gjatë përdorimit të tyre në fjali. Ndërsa foljet me strukturë morfemore jo të thjeshtë, që formojnë një kallëzues dygjymtyrësh, pra foljet e ndashme, ai i quan “*Partikelverben*” (folje me pjesëza) dhe brenda këtij grupi foljesh, veç të tjerash, si gjymtyrë të parë të foljes dallon edhe pjesëzat foljore parafjalore. Këto folje

⁹⁷ G. Helbig/H. Buscha, Deutsche Grammatik, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Langenscheidt, Leipzig, 1996, f. 223-224

⁹⁸ H. Wellmann, Duden, die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998. Veprat e të gjithë autorëve të përmendur në këtë paragraph janë cituar më parë.

⁹⁹ E. Donalies, Die Wortbildung des Deutschen, ein Überblick, Tübingen, 2002, f. 30

¹⁰⁰ P. Eisenberg, Grundriss der deutschen Grammatik, das Wort, Stuttgart, 2006, f. 266-267

në këtë punim do të trajtohen si folje të prejardhura, pasi në momentin e bashkimit të tyre me foljet rrënjë për të formuar folje të reja, ato nuk përdoren më me të njëjtin kuptim si fjalët e klasës nga kanë dalë, edhe pse ato nuk janë të palëvizshme si parashtesat e mirëfillta. Por kjo gjë shpjegohet me natyrën e foljes së gjermanishtes.

Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme lidhur me mënyrën apo emërtimin e fjalëformimit të foljeve të pandashme e të ndashme me gjymtyrë të parë prejparafjalore, të gjithë gjuhëtarët i bashkon qëndrimi se kjo është mënyra më prodhimtare e formimit të foljeve në gjuhën gjermane. “*Vështirë të gjenden folje në gjuhën gjermane që nuk mund të përdoren edhe me parashtesim*”¹⁰¹

Parashtesat në pjesën më të madhe të rasteve bashkohen më tema fjalëformuese foljore dhe ndonëse ato nuk ndryshojnë kategorinë leksikogramatikore të temës fjalëformuese, ato modifikojnë kuptimin gramatikor, apo semantik, apo edhe të dyja kuptimet bashkë të foljes bazë. Ndryshimet e kuptimit gramatikor lidhen kryesisht me valencën e temës fjalëformuese foljore, ndërkohë që ndryshimet semantike mund të jenë kohore, mënyrore, vendore apo ndryshime në çështjen e aspektit¹⁰².

In vielen Filmen *kämpft* der Held *gegen eine Übermacht* von Gangstern.

In vielen Filmen *bekämpft* der Held *eine Übermacht* von Gangstern.

(Übungsgrammatik Daf, f.16)

Die Blume ist *aufgeblüht*. / Sie hat *geblüht*. / Sie ist *verblüht*.

(Übungsgrammatik Daf, f.16)

Parashtesat nëpërmjet të cilave formohen krahas foljeve edhe pjesë të tjera të ligjeratës u përmenden më lart. Tani do të vijohet me një përmbledhje të parashtesave të cilat përdoren për të formuar vetëm folje. Të tilla janë: *be-*; *ent-*; *er-*; *ver-* dhe *zer-*. Këto parashtesa janë të patheksuara, mund të quhen polisemantike pasi marrin pjesë në formimin e tipave të ndryshëm semantik. Kështu p.sh. parashtesa **ver-**, e cila sipas Duden (1998, f. 459) është më prodhimtarja në parashtesimin foljor me 45% të foljeve të formuara, është një nga parashtesat më polisemantike. Fjalori Duden, “*Deutsches Universalwörterbuch*”, i njej asaj tetë kuptime të ndryshme: *verachten*, *verändern*, *verbleiben*, *verblühen*, *verdecken*, *verlachen* etj. Shpesh këto parashtesa modifikojnë kuptimin gramatikor të foljes rrënjë, duke ndryshuar valencën apo rektionin e tyre. Bashkohen kryesisht me tema fjalëformuese foljore të thjeshta si *kommen* – *bekommen*; *fallen* – *entfallen*; *finden* – *erfinden*; *stehen* – *verstehen*, *legen* – *zerlegen* etj. Në pak raste ato kanë si temë fjalëformuese një emër apo mbiemër si në shembujt: *bedachen*, *bemuttern*, *entkernen*, *entkorken*, *verarmen*, *vergolden*¹⁰³. Ndërkohë që folje të këtij tipi, për *Fleischer-in/Barz-in* dhe *Lohde-n*¹⁰⁴ shqyrtohen si të formuara me konversion dhe parashtesim.

¹⁰¹ Fleischer/Helbig/Lerchner, Deutsche Sprache, kleine Enzyklopedie, Frankfurt am Main, 2001, f. 211

¹⁰² Aspekti është kategori gramatikore që shpreh mënyrën se si rrjedh veprimi. Ndërsa valenca është aftësia e fjalës për të krijuar lidhje semantikosintaksore me fjalët e tjera në fjali.

¹⁰³ H. Wellmann, Die Grammatik, Band 4, Duden, Mannheim, 1998, f. 460-461


¹⁰⁴ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f.308 dhe M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr-und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f. 49

Ashtu siç është theksuar edhe më lart, pjesët e para të foljeve të ndashme të gjuhës gjermane, të cilat janë mbartëse të theksit të foljes dhe formojnë bashkë me rrënjën e foljes një kallëzues të vetëm, në këtë punim do të shqyrtohen si parashtesa. Si të tilla përmendim: *ab-* (*abdrehen, abwarten* etj.); *an-* (*anlachen, ansprechen* etj.); *auf-* (*aufstehen, aufwachen* etj.); *aus-* (*auslachen, ausschalten* etj.); *bei-* (*beibringen, beistehen* etj.); *ein-* (*einfallen, einschlafen* etj.); *los-* (*losgehen, losschreien* etj.); *nach-* (*nachbauen, nachfragen* etj.); *vor-* (*vorfahren, vorziehen* etj.) dhe *zu-* (*zubereiten, zumachen* etj.). Ato u bashkohen kryesisht temave foljore të thjeshta (*absagen*) dhe më pak atyre të prejardhura (*abschrägen*).

Në gjuhën gjermane ka edhe disa parashtesa të huaja të cilat shërbejnë për të formuar emra, mbiemra e folje dhe janë huazuar bashkë me fjalën e huaj. Këto parashtesa kanë kuptime të ndryshme, disa shprehin të kundërtën e kuptimit të temës motivuese, si **a-/an-, anti-, dis-, de-/des-, in-** (*Antialkoholiker, antikomunistisch* etj.; *amoral, anorganisch* etj.; *disharmonieren, disfunktional* etj.; *demaskieren, desinformativ* etj.; *illegal, inaktiv, inkorporieren* etj.); disa të tjera kanë kuptim përforcues apo theksues e zmadhues si **super-** apo **hyper-**: *Superbenzin, Superfrau, superfein, superklug* etj.; *Hypererregung, Hyperfunktion, hypernervös* etj.; parashetsa **ko-** me variantet e saj, e cila në pjesën më të madhe të rasteve ka kuptimin e bashkëpërfshirjes: *kooperieren, Koautor, koexistent* etj; apo parashtesa **ex-**, e cila ka kuptimin “i dikurshëm”: *Exfrau, Exfreund, Exkönig* etj.

I.3.1.2. Prapashtesimi

Nëpërmjet prapashtesimit formohen fjalë të reja duke iu prapavendosur temës fjalëformuese ndajshetsa fjalëformuese sipas skemës:



Prapashtesimi, bashkë me kompozimin, është një nga mënyrat më prodhimtare dhe më të rëndësishme për pasurimin dhe zgjerimin e leksikut të gjuhës gjermane me fjalë të reja. Kjo gjë lidhet jo vetëm me numrin e madh në inventarin e prapashtesave të gjuhës gjermane, por edhe me një sërë faktorësh të tjerë. Pikësëpari prapashtesat duke qenë se kanë karakter klasifikues, që do të thotë se janë në gjendje ta kalojnë temën fjalëformuese në një tjetër pjesë ligjrate duke ndryshuar në këtë mënyrë kategorinë leksikogramatike të fjalës së re të formuar, bashkohen me një gamë më të gjerë temash fjalëformuese, të cilat mund të jenë falë të thjeshta por edhe fjalë të prejardhura dhe deri të përbëra, si edhe emra të përveçëm si p.sh.: *Arbeiter, Echtheit, heilbar, Lehrling; Beerdigung, verwendbar, Wirksamkeit, urzeitlich; arbeitsgerichtlich, Kindergärtnerin, Schwergewichtler; Leninismus, Luthertum, marxistisch* etj.

Në shumë raste prapashtesa e zgjeron klasën e temës fjalëformuese thjesht duke ndryshuar ose modifikuar kuptimin e saj leksikor, por jo atë gramatikor. Madje

Eisenberg-u¹⁰⁵ është i mendimit se thujse në pesëdhjetë përqind të rasteve prapashtesimi nuk ia ndryshon kategorinë gramatikore fjalës së re që formon. Kështu pasurohet e zgjerohet klasa e emrave nga tema fjalëformuese emërore, ajo e mbiemrave nga tema fjalëformuese mbiemërore si dhe klasa e foljeve nga tema fjalëformuese foljore si: *Arzt – Ärztin*, *Freund – Freundschaft*, *Pferd – Pferdchen* etj.; *froh – fröhlich*, *süß – süßlich*, *dick – dicklich* etj.; *brummen – brummeln*, *steigen – steigern* etj.

Gjithashtu e njëjta temë fjalëformuese mund të bashkohet me prapashtesa të ndryshme duke formuar fjalë të ndryshme të së njëjtës pjesë ligjrate me temën fjalëformuese:

Eigenheit – Eigenschaft – Eigentum; *furchtbar – fürchterlich – furchtlos – furchtsam* etj.

Prapashtesat janë kryesisht të patheksuara, me disa përjashtime si prapashtesa *-erei* apo *-ei* (*Drückerei*, *Schweineerei*), pra mbi to nuk bie theksi i fjalës. Kanë një vend të ngulitur, pas temës fjalëformuese dhe zakonisht çdo prapashtesë përcakton gramatikisht një pjesë ligjrate. Kështu nëpërmjet prapashtesës *-ig* formohen mbiemra si: *kräftig*, *schmutzig* etj.; prapashtesat *-heit*, *-keit*, *-schaft* shërbejnë për të formuar emra të gjinisë femërore, si p.sh. *Freiheit*, *Fröhlichkeit*, *Bürgerschaft* etj.; prapashtesa *-weise* formon ndajfolje si p.sh.: *bedauerlicherweise*, *schrittweise* etj.

Prapashtesimi në literaturën fjalëformuese dhe në gramatologjinë gjermane është parë herë si një mënyrë e veçantë fjalëformimi dhe herë si nëntip i prejardhjes, derivacionit, dhe jo vetëm nga gjuhëtarë të ndryshëm, por edhe nga i njëjti gjuhëtar në kohë të ndryshme si ka ndodhur me *Fleischer-in*, i cili në “*Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*” të vitit 1983 e shqyrton prapashtesimin si një mënyrë fjalëformimi më vete, ndërsa në “*Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*”, botim i vitit 2007 punuar bashkë me *Barz-in*, e shqyrton së bashku me prapashtesimin dhe prapashtesoprapashtesimin si një nga mënyrat e prejardhjes së shprehur (*explizite Derivation*), ku duhet thënë se kjo ndarje bëhet duke pasur parasysh strukturën morfologjike të fjalës dhe ndarjen e saj në dy përbërës të drejtpërdrejtë (*unmittelbare Konstituenten*)

Prapashtesat e gjuhës gjermane bashkohen edhe me tema fjalësh të formuara edhe këto me prapashtesim, si p.sh.: *Freund – freundlich – Freundlichkeit*; *Freund – freundlich – freundlicherweise*; *hoffen – Hoffnung – hoffnungslos – Hoffnungslosigkeit*

Me prapashtesim formohen emra, mbiemra, folje dhe ndajfoje ku duhet thënë se pjesën më të madhe të fjalëve të prapashtesuara e përbëjnë emrat formuar nga tema fjalëformuese emërore, mbiemërore dhe foljore. Ndërsa folja më shumë rëndësi për prapashtesimin ka në funksionin e saj si temë fjalëformuese.¹⁰⁶ Rëndësi të veçantë ka prapashtesimi për formimin e ndajfoljeve, pasi ky është i vetmi nëntip i derivacionit që ndihmon në pasurimin e klasës së tyre.

Në gjuhën gjermane si shprehëse të nuancave të ndryshme kuptimore të vlerësimit subjektiv krahas prapashtesës *un-* dhe *erz-*, të cilat veç të tjerash shpehin dhe kuptimin e zmadhimit, ekzistojnë edhe dy prapashtesa shumë prodhimtare, pikërisht prapashtesat *-chen* dhe *-lein*, të cilat duke iu bashkangjitur emrave formojnë fjalë me kuptim zvogëlues, i cili në pjesën më të madhe të rasteve është i lidhur dhe me një kuptim emocional që qartësohet nga konteksti në të cilin përdoren falët e formuara me këto

¹⁰⁵ P. Eisenberg, Grundriss der deutschen Grammatik, Band 1 das Wort, Stuttgart, 2006, f. 272

¹⁰⁶ P. Eisenberg, Grundriss der deutschen Grammatik, Band 1, das Wort, Stuttgart, 2006, f. 281

prapashtesa. Prapashtesat *-chen* dhe *-lein* janë konkruuese me njëra-tjetrën duke bërë të mundur që të bashkohen me të njëjtën temë fjalëformuese. Ato bashkohen me tema fjalëformuese emërore duke formuar emra të gjinisë asnjësore dhe zakonisht shoqërohen edhe me një ndryshim tingëllor të temës fjalëformuese: *Bärchen, Blümchen/Blümlein, Kaninchen*¹⁰⁷, *Tischlein* etj.

Siç është shprehur dhe më lart, numri i prapashtesave të gjermanishtes është i madh. Në vijim disa nga prapashtesat më prodhimtare dhe më të rëndësishme të gjuhës gjermane nëpërmjet të cilave formohen, emra, mbiemra, folje dhe ndajfolje:

- **er**, bashkë me variantet e saj të zgjeruara *-ler* dhe *-ner*: *Arbeiter, Albaner, Redner, Wissenschaftler* etj.; **-heit, -keit** dhe **-igkeit**, (kjo e fundit formuar nga bashkimi i prapashtesës mbiemërore *-ig* dhe asaj emërore *-keit*): *Ausgeschlossenheit, Betroffenheit* etj.; *Anwendbarkeit, Heiligkeit* etj.; *Eindeutigkeit, Gerechtigkeit* etj.; **-ung**: *Abteilung, Wohnung* etj.; **-e** dhe **-ei**: *Breite, Fläche* etj.; *Bäckerei, Zauberei* etj.; **-tum**: *Altertum, Königtum* etj.;

Interesante paraqitet prapashtesa **-bar**. Me anë të saj formohen mbiemra nga tema fjalëformuese kryesisht foljore, madje “*man zu fast jedem transitiven Verb – ob einfach, präfigiert oder zusammengesetzt – ein entsprechendes Adjektiv bilden kann / thuajse për çdo folje kalimtare – të thjeshtë, të prejardhur apo të përbërë - mund të formohet një mbiemër përgjegjës*”¹⁰⁸. Aftësia e prapashtesës *bar-* për t’u bashkuar me tema foljore kalimtare por jo vetëm, e bën këtë tip më prodhimtarin në formimin e mbiemrave prejfoljorë, të cilët tregojnë se diçka mund të bëhet.

Mbiemrat e këtij tipi fjalëformimi mbartin kuptim pësor dhe shërbejnë si forma konkruuese të fjalivë pësore me faktor modal.

Der Wunsch ist erfüllbar. = Der Wunsch kann erfüllt werden.

Ja disa mbiemra të formuar me këtë prapashtesë: *anwendbar, ausführbar, brauchbar, brennbar*¹⁰⁹, *deklinierbar, lesbar, trennbar, zerlegbar* etj.

Ka edhe mbiemra të formuar me këtë prapashtesë nga një temë fjalëformuese emërore dhe mbiemërore, por këto tipa jo vetëm që nuk janë aktiv dhe prodhimtarë, por janë dhe shumë të rrallë: *dienstbar, flugbar, schiffbar, steuerbar; sonderbar, offenbar*.

-ig, -isch dhe **-lich** janë tri prapashtesa të tjera shumë prodhimtare në formimin e mbiemrave të gjuhës gjermane: *dreckig, fleißig* etj.; *dichterisch, regnerisch* etj.; *beachtlich, zärtlich* etj.

Prapashtesat **-(e)l(n)** dhe **-(e)r(n)** shërbejnë për të formuar folje të reja duke u bashkuar me tema fjalëformuese foljore: *dudeln, klingeln, lächeln* etj.; *flüstern, folgern, kichern*, etj.

Prapashtesat **-s** prapashtesa **-ens** si dhe **-weise** janë ndër më produktivet në formimin e ndajfoljeve: *abends, bereits, besonders* etj.; *bestens, frühestens, höchstens, drittens, viertens* etj.

¹⁰⁷ Fjalë si *Kaninchen, Mädchen* apo *Fräulein* nuk përdoren më pa prapashtesën zvogëluese.

¹⁰⁸ Duden, Die Grammatik, Band 4, 1998, f. 541

¹⁰⁹ Disa mbiemra të këtij tipi fjalëformimi kanë kuptim vepror: *brennbares Gas = Gas, das brennt*


Në gjuhën gjermane ka dhe shumë prapashtesa të huazuara të cilat edhe pse nuk janë aq prodhimore dhe aktive sa prapashtesat e vetë gjuhës gjermane, kanë fituar përdorim në këtë gjuhë. Këto prapashtesa formojnë kryesisht emra dhe mbiemra nga tema fjalëformuese foljore, emërore dhe mbiemërore, të cilat nga ana e tyre janë dhe ato fjalë të huaja. Kështu p.sh.: **-är** (*Aktionär, Funktionär* etj.); **-age** (*Passage, Spionage* etj.); **-ament/-ement** (*Abonnement, Engagement* etj.); **-ismus** (*Humanismus, Provinzialismus* etj.). Nëpërmjet prapashtesës **-ier(en)** formohen folje: *asphaltieren, diplomieren, hausieren, organisieren, protesitieren* etj. **-abel/-ibel** (*akzeptabel, diskutabel, disponibel, praktikabel* etj.); **-al** (*genial, universal, zentral* etj.); **-ant** (*brilliant, tolerant* etj.); **-ell** (*prinzipiell, rituell, zeremoniell* etj.). Në disa raste këto formime i konkurojnë formimet me prapashtesa të gjuhës gjermane, si p.sh.: *reparable – reparierbar, balladesk – balledenhaft* etj.

I.3.1.3. Formimi i fjalëve me parashtesë dhe prapashtesë njëkohësisht

Në gramatologjinë gjermane dhe literaturën e fjalëformimit vihen re dy qëndrime të ndryshme lidhur me formimin e fjalëve të tilla si: *Gerede, gefügig* dhe *besänftigen*. Fleischer-i/Barz-i dhe Jung-u i shqyrtojnë si fjalë të formuara me parashtesë dhe prapashtesë njëkohësisht, duke e quajtur mënyrën e formimit të këtyre fjalëve prejardhje të kombinuar (*kombinatorische Derivation*)¹¹⁰, ndërsa për Donalies-in¹¹¹ këto fjalë formohen me prejardhje nëpërmejt një ndajshtese tjetër, duke i njohur kështu gjuhës gjermane krahas morfemave fjalëformuese parashtesore dhe prapashtesore dhe bimorfemat (*Zirkumfixe*), të cilat “*werden morphologisch definiert als gebundene Einheiten, die stets um eine Basis herum positioniert sind. / morfologjikisht përkufizohen si njësi të lidhura që rrethojnë temën fjalëformuese*”¹¹². Këtë qëndrim ajo e mbështet në rregullën e binaritetit, në zbërthimin e drejtpërdrejtë të fjalës në dy pjesë përbërëse. Edhe Eisenberg-u¹¹³ e njeh bimorfemën *Ge-e*.

Interesant është qëndrimi i Wellmann-it, i cili me prejardhje (*Ableitung*) nënkupton prapashtesimin. Formimet prapashtesore ai i ndan në dy grupe: prejardhje të thjeshtë (*einfache Ableitung*), ku përfshin të gjitha formimet vetëm me prapashtesa; dhe prejardhjen e kombinuar (*kombinierte Ableitung*), në të cilën përfshin formimet parashtesoprapashtesore. Gjithashtu ai e pranon edhe termin bimorfemë.¹¹⁴

Grafikisht kjo mënyrë fjalëformimi mund të paraqitet si më poshtë:



¹¹⁰ Fleischer/Barz, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 2007, f.46

¹¹¹ E. Donalies, *Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick*, Tübingen, 2002, f. 33

¹¹² E. Donalies, *Die Wortbildung des Deutschen, ein Überblick*, Tübingen, 2008, f. 33

¹¹³ P. Eisenberg, *Grundriss der deutschen Grammatik, Band 1 das Wort*, Stuttgart, 2006, f. 252

¹¹⁴ Duden, *Die Grammatik, Band 4*, fMannheim, 1998, f. 435, f. 840, f.517

Në gjuhën gjermane me parashtesoprapashtesim formohen emra, mbiemra dhe folje. Krahasuar me dy pjesët e tjera të ligjeratës, formimi i emrave me parashtesë dhe prapashtesë njëkohësisht është shumë i kufizuar, pasi me këtë mënyrë fjalëformimi formohen emra vetëm nëpërmjet veprimit të njëkohësishtëm të parashtesës **Ge-** dhe prapashtesës **-e**. Si tema fjalëformuese në një rast të tillë shërbejnë foljet të cilat mund të jenë të thjeshta por edhe të prejardhura. Emrat e formuar me parashtesoprapashtesim janë emra abstraktë të gjinisë asnjane dhe në të shumtën e rasteve emërtojnë veprim ose proces duke u shoqëruar edhe nga një nuancë kuptimore negative. Në një rast të tillë veprimi shprehet si i përsëritur dhe i tejzgjatur. Por ato mund të emërtojnë edhe objekte apo mjete. Këto emra nuk njohin numër shumës.

Gebelle, Gefahre, Gefluche, Gefrage, Gehüpfе, Gelache, Gelaufe, Gerede, Gerufe, etj.

Këto fjalëformime në disa raste konkurohen nga emrat e formuar me mbaresën **-(er)ei**: *Gefrage – Fragerei, Gelaufe – Lauferei, Gehacke – Hackerei* etj.

Parashtesoprapashtesimi vepron edhe në klasën e mbiemrave. Kështu nga tema fjalëformuese foljore, formohen me anë të parashtesë **ge-** dhe prapashtesës **-ig**, duke u shoqëruar edhe me ndryshim tingulli të temës fjalëformuese, disa mbiemra. Ky model fjalëformimi nuk është prodhimtar: *gefrässig, gehässig, geläufig, gelehrig*. Një tjetër model fjalëformimi për mbiemrin është parashtesa **ge-** ose **be-** dhe prapashtesa **-t**, të cilat u bashkangjiten temave fjalëformuese emërore:

bebrillt, behandschuht, bemüzt etj.; *geblumt, gefleckt, gestiefelt* etj.

Ka edhe disa mbiemra të formuar me parashtesa të ndryshme dhe të njëjtën prapashtesë, prapashtesën **-t**, por këto kanë mbetur raste të izoluara si p.sh.: *ausgefuchst, entgeistert, eingefleischt, übernächtigt*. Mbiemrat e formuar sipas këtij modeli fjalëformimi nuk duhen ngatërruar me mbiemrat e formuar me konversion nga pjesoret e foljeve si: *gefragt, gebildet, gedient, bedacht, bewölkt, begnadet* etj.

Tipi fjalëformues parashtesoprapashtesues nuk vepron vetëm për të formuar emra e mbiemra por edhe për të formuar folje. Kështu tema fjalëformuese emërore dhe mbiemërore duke u bashkuar njëkohësisht me parashtesën **be-** dhe prapashtesën **-ig(en)** dhe më rrallë me parashtesën **ver-** dhe prapashtesën **-ig(en)** formojnë folje si në rastet e mëposhtme:

beaufsichtigen, beerdigen, beseitigen, beteiligen, vergewaltigen, verkündigen etj.

Në shumë pak raste parashtesat **ver-** dhe **ent-** bashkohen me emra të huazuar dhe prapashtesën **-ier(en)** duke formuar folje si *verklausulieren* apo *entkoffeinieren*.

I.3.1.4. Prejardhja pa ndajshesë ose prejardhja e nënkuptuar

Në gjuhën gjermane krahas fjalëve të formuara me parashtesim, prapashtesim apo me parashtesim dhe prapashtesim njëkohësisht, ka dhe fjalë të prejardhura të formuara pa ndonjë ndajshesë të dallueshme, vetëm me ndryshim tingullor të rrënjës, të cilën Erben e quan “alternim rrënjor”¹¹⁵. Ky fenomen gjuhësor përbërë një mënyrë të veçantë fjalëformimi, e cila në gramatologjinë gjermane dhe literaturën fjalëformuese është

¹¹⁵ “*Stammalternation*” nga J. Erben, Einführung in die deutsche Wortbildungslehre, Berlin 2006, f.31

quajtur prejardhje e pashprehur apo prejardhje e nënkuptuar (*implizite Ableitung*), ndërsa gjuhësia historike e njeh si “prejardhje e brendshme” (*innere Ableitung*)¹¹⁶. Wellmann¹¹⁷, teksa flet për fjalëformimin e emrave përdor dhe termin “preardhje zero” (*Nullableitung*). Prejardhja pa ndajshesë si mënyrë fjalëformimi sot nuk është më prodhimtare, kjo për vetë faktin se ndryshimi i zanores së rrënjës e ka origjinën e tij te apofonia, një dukuri gjuhësore jo më prodhimtare në gjermanishte. Prejardhja pa ndajshesë ndeshet kryesisht në klasën e emrave dhe të foljeve. Emrat e formuar pa ndajshesë e kanë prejardhjen e tyre nga foljet, kryesisht nga foljet e forta¹¹⁸ të thjeshta por edhe nga foljet e prejardhura. Kështu nga forma të foljeve të forta: *binden, beißen, fliegen, werfen, zwingen* etj. janë formuar emrat: *Band, Biss, Flug, Wurf, Zwang*.

Nga foljet e rregullta *danken, kaufen loben, scherzen* etj. në analogji me format e mësipërme janë formuar edhe emrat: *Blick, Dank, Kauf, Lob, Scherz*.

Nëpërmjet prejardhjes pa ndajshesë janë formuar edhe shume emra nga folje të prejardhura si:

Abwurf, Beschluß, Entwurf, Verbot, Verbund, Verfall, Vergleich, Verlag, Verlauf, Verzug etj.

Pa ndajshesë formohen edhe disa folje, edhe pse duhet thënë se kjo mënyrë fjalëformuese nuk është me aq peshë sa mënyrat e tjera për këtë pjesë ligjerate. Numri i foljeve të formuara me këtë mënyrë fjalëformimi është shumë i kufizuar. Kuptimi i këtyre foljeve në të shumtën e rasteve lidhet me aspektin foljor. Vihet re se njëra është kalimtare ndërsa tjetra është jokalimtare. Por gjithsesi në shumë raste ato kanë pësuar zhvillime semantike duke i zbehur marrëdhëniet motivuese mes tyre. Në këtë mënyrë janë formuar: *fallen – fällen, liegen – legen, schwanken – schwenken, schwimmen – schwemmen* etj.

Fleischer-i në “*Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*”, botim i vitit 1983, njeh dhe një grup fare të vogël mbiemrash të formuar pa ndajshesë nga foljet duke theksuar se te mbiemrat ky lloj fjalëformimi zë një vend shumë periferik, si: *rege* nga *regen*, *starr* nga *starren*, *wach* nga *wachen*, ndërsa në botimin e vitit 2007 në bashkëpunim me Barz-in sheh si mundësi formimi të këtyre fjalëve edhe konversionin.¹¹⁹

I.3.1.5 Prejardhja prapavajtëse

Rreshtat e fundit të prejardhjes do t’i kushtohen prejardhjes prapavajtëse “*Rückbildung*”, e cila në literaturën e fjalëformimit njihet edhe si pseudokompozicion, pasi mënyra e fjalëformimit të disa fjalëve mund të motivohet edhe si kompozim. Sipas kësaj mënyre fjalëformuese fjalët e prejardhura humbasin ndajshesën fjalëformuese duke formuar një fjalë të re. Si raste tipike të prejardhjes prapavajtëse njihen fjalët: *Eigensinn, Mondsucht, Sanftmut, Unnatur*, formuar nga rënia e prapashtesës së fjalëve *eigensinnig, freimütig*,

¹¹⁶ B. Naumann, *Wortbildung in der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 1972, f. 7

¹¹⁷ Duden, *Die Grammatik*, Band 4, 1998, f. 516

¹¹⁸ Foljet e forta janë folje të parregullta, të cilat gjatë zgjedhimit në kohën e pakryer/e kryer të thjeshtë (Präteritum) dhe në formimin e pjesores së shkuar (Partizip Perfekt), pësojnë ndryshime tingullore, kryesisht zanoreje, në rrënjën e tyre si p.sh. *trinken – trank – getrunken* apo *gehen – ging – gegangen* etj.

¹¹⁹ Fleischer/Barz, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 2007, f. 276

mondsüchtig, sanftmütig, unnatürlich. Si të tilla analizohen edhe foljet *kopfrechnen* ← das Kopfrechnen, *maßschneidern* ← maßgeschneidert, *notlanden* ← Notlandung, *segelfliegen* ← Segelflug. Karakteristikë e disa foljeve formuar sipas kësaj mënyre është paradigma e tyre jo e plotë, duke njohur vetëm formën e pashtjelluar të paskajores dhe të pjesores si *segelfliegen* apo *generalüberholt*.

Fjalët e formuara me prejardhje prapavajtëse janë jo vetëm të kufizuara në dy pjesë ligjerate, te emrat dhe foljet, por edhe të kufizuara në numër. Gjithashtu disa gjuhëtarë mendojnë se për t'i klasifikuar formimet e mësipërme si formime me prejardhje prapavajtëse të ndihmon vetëm analiza diakronike¹²⁰. Për Donalies-in¹²¹ kjo mënyrë fjalëformimi nuk është e nevojshme për analizimin e formimeve të gjuhës së sotme.

I.3.2 Konversioni

Në teorinë e fjalëformimit duket se nuk ka një qëndrim unikal lidhur me përcaktimin e termit “konversion”. Kështu për shembull Fleischer-i/Barz-i shqyrtojnë si produkte të konversionit edhe fjalë si *Ruf* nga *rufen*, të cilat në këtë punim janë pranuar si fjalë të prejardhura pa ndjashtesë. Konversioni është formimi i fjalëve të reja duke kaluar, pa iu bashkangjitur asnjë ndajshesë dhe pa ndryshim tingullor të fjalës, nga një pjesë ligjerate në një tjetër. Ky përkufizim përkon me përkufizimin e “konversioni të pastër”¹²². Njëpërmjet konversionit pasurohen dhe zgjerohen me tej klasat e pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës si klasa e emrave, e mbiemrave dhe klasa e foljeve. Por edhe pjesë të pandryshueshme të ligjeratës formohen me konversion si disa ndajfolje apo parafjalë. Në momentin që një fjalë kalon njëpërmjet procesit të konversionit në një pjesë tjetër ligjerate ajo humbet paradigmen e mëparshme duke fituar paradigmen e re, nëse bëhet fjalë për fjalë që i përkasin pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës. Ndërsa kur një pjesë e ndryshueshme ligjerate kalon në një pjesë të pandryshueshme atëherë ajo e humbet paradigmen e mëparshme pa fituar asnjë të re.

folje: Ich habe lange <i>geschwiegen</i> .	→ emër: Es herrschte peinliches <i>Schweigen</i>
emër: Kein Wort <i>des Dankes</i> sagen	→ parafjalë: <i>Dank</i> eines Zufalls wurde die Tat entdeckt.

(Duden, Universalwörterbuch, 1996)

¹²⁰ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 422; E. Donalies, Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick, Tübingen, 2002, f.133-f.135, si dhe Bergenholtz/Mudgan, cituar në veprën e Fleischer-it/Barz-it “Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache”, Tübingen 2007, f. 51. Ndërsa vetë autorët e këtij punimin mendojnë se kjo mënyrë fjalëformimi është ende aktive edhe në ditët e sotme, derisa krijohen ende modele si në rastin e fjalës *Elast* nga *elastisch*.

¹²¹ E. Donalies, vepër e cituar, f. 132

¹²² M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr- und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f. 45

Modeli më prodhimtar dhe domethënës i konversionit është emërimi, madje Eichinger-i e quan “*Kernfall der Konversion / bërthama e konversionit*”¹²³. Nëpërmjet konversionit pasurohet klasa e emrave jo vetëm nga forma foljore dhe mbiemërore, por edhe nga pjesë të tjera ligjrate, madje për Jung-un “*Wörter aller Wortarten können substantiviert werden. / Fjalët e të gjitha pjesëve të ligjeratës mund të emërzohen.*”¹²⁴ Forma foljore e pashtjelluar e paskajores (*Infinitiv*) shërben për të formuar emra të gjinisë asnjëse, të cilat në pjesën dërrmuese të rasteve janë emra abstraktë, nuk formojnë numrin shumës dhe emërtojnë proces. Por në disa raste ato janë leksikalizuar duke mos emërtuar me procese por deri dhe objekte konkrete si: *das Unternehmen, das Verfahren, das Einkommen, das Schreiben* (= shkresë) etj. “*Dieses Wortbildungsverfahren ist uneingeschränkt produktiv, so daß grundsätzlich von jedem Verb spontan ein nominalisierter Infinitiv gebildet werden kann. / Kjo mënyrë fjalëformimi është aq prodhimtare, saqë parimisht nga çdo formë e paskajores së një foljeje spontanisht mund të formohet një emër.*”¹²⁵ *ablehnen* → *das Ablehnen*, *beten* → *das Beten*, *bilden* → *das Bilden* etj.

Reden ist Silber, Schweigen ist Gold (Thënie)

Gjithashtu nëpërmjet konversionit formohen emra edhe nga format e pashtjelluara të pjesoreve foljore të gjuhës gjermane. Ndryshe nga emërzimet e mësipërme, pjesoret e emëruara mund të jenë të gjinive të ndryshme: *ankommen* – *angekommen* → *der/die Angekommene*, *delegieren* – *delegiert* → *der Delegierte*, *einladen* – *eingeladen* → *der Eingeladene* etj.

Die Reisenden werden gebeten, Ihre Plätze einzunehmen.

Bundesversicherungsanstalt für *Angestellte* (Duden, Universalwörterbuch)

Në klasën e emrave kalojnë pa ndonjë ndjashtesë apo ndryshim tingëllor edhe mbiemrat. p.sh.: *das Gute, das Böse*, *alt* → *der/die/das Alte*, *ernsthaft* → *der/die/das Ernsthafte* etj.

Ihr Sohn war in jugendlichem Alter. (Duden Universalwörterbuch)

Die Veranstaltung wurde vorwiegend von *Jugendlichen* besucht.

Siç është thënë dhe më lart ekziston teoria se çdo pjesë ligjrate mund të emërzohet. Pjesët e tjera të ligjeratës kur emërzohen, përdoren kryesisht në gjininë asnjëse. Kështu si emra mund të përdoren edhe përemrat: *das Ich, das Du, das Es, das Wenige* etj. numërorët: *die Eins, die Zwei, die Drei, die Vier* etj. Emërzohen ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat madje dhe gërmat të cilat në një pjesë të mirë të rasteve paraqiten në formë shprehjesh: *das A* und *O*, *das Danach, das Für* und *Wider, das Gegenüber, das Heute, das Wenn* und *Aber*.

Zwei Personen / Sie hat die Prüfung mit Zwei bestanden.

(Duden Universalwörterbuch)

¹²³ L.M. Eichinger, *Deutsche Wortbildung, eine Einführung*, Tübingen, 2000, f. 168

¹²⁴ W. Jung, *Grammatik der deutschen Sprache*, Leipzig, 1988, f. 388

¹²⁵ H. Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Hidesheim, 2007, f. 981

Me konversion nuk formohen vetëm emra por edhe mbiemra, ndonëse krahasur me ermëzimin, mbiemërzimi qëndron goxha më mbrapa, kjo për vetë faktin se me konversion kalojnë në mbiemra fjalë vetëm nga dy pjesë ligjrate: një numër i kufizuar emrash si dhe pjesoret. Emrat që kanë kaluar me konversion në mbiemra dhe që përdoren kryesisht si predikativë janë shumë pak: *angst, ernst, not, schuld, schade*.

Hast du das im *Ernst* gemeint? Es ist ihre *ernste* Absicht, sich zu bessern.

Por ndërsa mbiemërzimi i emrave nuk është prodhimtar, pjesoret e mbiemëruara e bëjnë shumë prodhimtar konversionin për këtë pjesë ligjrate. Ashtu si ndodhte në rastin e kthimit të pjesoreve në emra edhe në mbiemra kalojnë me konversion si pjesorja e së tashmes (*Partizip Präsens*), ashtu edhe pjesorja e së shkuarës (*Partizip Perfekt*).

Mbiemri i formuar me konversion nga pjesorja e së tashmes ka kryesisht kuptim vepror, e cilëson emrin me të cilin përdoret si personin që bën veprimin e shprehur nga folja prej së cilës rrjedh mbiemri: ein *weinendes* Kind ist ein Kind, das weint; ein *schlafender* Hund ist ein Hund, der schläft etj. Ndërsa mbiemrat e formuar nga pjesorja e së shkuarës kanë kryesisht kuptim pësor, tregojnë një gjendje të arritur nga sendi apo personi i karakterizuar prej tyre: eine *angewandte* Methode ist eine Methode, die angewandt worden ist.

Nëpërmjet konversionit formohen edhe folje nga emrat dhe mbiemrat. Kështu shumë emra kalojnë në folje pa marrë ndonjë ndajshitesë. Atyre u shtohet vetëm mbaresa e formës së pashtjelluar të paskajores (Infinitiv): Aal → *aalen*, Bremse → *bremsen*, Donner → *donnern*, Duft → *duften*, Farbe → *farben*, Öl → *ölen* etj.

Më pak e zgjerojnë klasën e foljeve mbiemrat që kalojnë me konversion në folje, si p.sh: bleich → *bleichen*, gar → *garen* etj.

Por me konversion formohen edhe pjesë të pandryshueshme të ligjeratës. Nga forma rasore të emrave janë formuar me konversion ndajfoljet: Abend – des Abends → *abends*, das Heim → *heim*, der Mittag – des Mittags → *mittags*, der Morgen – dem Morgen → *morgen* etj. si dhe parafjalët e formuar gjithashtu me konversion nga emrat si: der Dank → *dank*, der Laut → *laut*, der Betreff – des Betreffs → *betreffs*, das Mittel – des Mittels → *mittels*, die Zeit → *zeit* etj.

I.3.3 Dyfishimi (*Reduplikation*)

Dyfishimi është formimi i fjalëve të reja nga përsëritja e një fjale. Në gjuhën gjermane kjo mënyrë fjalëformimi është pak prodhimtare.¹²⁶ Fleischer-i/Barz-i dallojnë tri lloje dyfishimesh¹²⁷: *dyfishimin e thjeshtë (einfache Doppelung)*, i cili realizohet nga përsëritja e së njëjtës fjale, si p.sh. *soso, jaja, Klein-Klein; dyfishime me rimë (Reimdoppelungen)*, të cilat ndeshen më shpesh sesa dyfishimet e thjeshta, dhe shihen si produkte të ligjëritimit gojor¹²⁸: *Hokuspokus, ruckzuck, Techtelmechtel* etj. Ky tip dyfishimesh realizohet përmes

¹²⁶ M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen. Ein Lehr-und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f. 43

¹²⁷ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 48

¹²⁸ M. Lohde, veper e cituar, f.44

kombinimit të fjalëve jo të njëjta; tipi i tretë përbëhet nga *dyfishimet me apofoni*, ku vihet re ndryshimi i zanores *i* në *a*: *Tingeltangel*, *Mischmasch*, *Singsang* etj. Duden¹²⁹ njeh si dyfishim edhe fjalët e formuar nga përsëritja e një rrokje si në rastin e fjalës *Papa* (baba). Gjithashtu si dyfishim ai njeh edhe formimet *wortwörtlich*, *tagtäglich*, të cilat i quan *dyfishime të zgjeruara (erweiterte Doppelungen)*, të cilat në këtë punim janë shqyrtuar si kompozita mbiemërore, formuar nga një emër dhe një mbiemër. Interesant është qëndrimi i Donalies-it, e cila formime të tilla bashkë me kontaminimet i klasifikon si kompozita.¹³⁰

I. 3.4. Kontaminimi (Kontamination)

Kontaminimet janë formime që realizohen nga shkrirja e dy fjalëve në një të vetme. Në rastin e kontaminimit nuk kemi të bëjmë me bashkim fjalësh, pasi një pjesë e fjalës së parë apo e fjalës së dytë, gjatë formimit të fjalës së re humbet, duke bërë që të dyja fjalët të shkrihen në një, si në rastet e fjalëve: *Kurlaub* – Kur + Urlaub apo *verschlimmbessern* – *verschlimmern* + *verbessern*. Kontaminimet janë kryesisht emra: *Stagflation* (Stagnation + Inflation), *Medyziniker* (Medizin + Zyniker), dhe më pak pjesë të tjera të ligjeratës: *angeheitert* (angetrunken + aufgeheitert), *jein* (ja + nein). Kontaminimet janë kryesisht formime rastësore.¹³¹ Shpesh ato shoqërohen edhe me një dozë ironie: *Formularifari* (Formular + Larifari).¹³²

Këto nuk janë mënyrat e vetme të formimit të fjalëve në gjuhën gjermane. Në tabelën e paraqitur në fillimin e këtij kapitulli shohim se ka edhe mënyra të tjera fjalëformuese. Në kapitullin në vijim bashkë me kompozimin shqyrtohen si nënçështje më vete edhe fjalët e formuara me kompozim dhe prapashtesim njëkohësisht, të cilat në gjermanishte njihen me termin “*Zusammenbildungen*”. Gjithashtu bashkë me kompozitat shqyrtohen dhe shkurtesat, ndërsa përngjitja shqyrtohet si një kapitull i veçantë në këtë punim.

¹²⁹ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f.439

¹³⁰ E. Donalies, Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick, Tübingen, 2002, f. 88

¹³¹ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, f. 438

¹³² M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen; Ein Lehr-und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f.44

KREU II. Kompozimi në gjuhën shqipe

II. 1. Qëndrime mbi kompozitat e shqipes

Është tashmë një fakt i njohur dhe i pranuar nga të gjithë gjuhëtarët se përbërja ose kompozimi, bashkë me prejardhjen dhe nëntipet e saj, nga të cilat peshën dhe rëndësinë më të madhe e ka prapashtesimi, përbëjnë mënyrat fjalëformuese më prodhimtare të gjuhës shqipe. Këto mënyra fjalëformimi ndihmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zgjerimin dhe pasurimin e leksikut të shqipes me fjalë të reja sipas nevojave të gjuhës. Gjuha shqipe e shkruar është dokumentuar për herë të parë me një shkrim të plotë në vitin 1555, me Mesharin e Gjon Buzukut. Mungesa e materialeve të shkruara para kësaj vepre bën që për shumë çështje gjuhësore të ketë paqartësi dhe qëndrime të ndryshme, ndaj dhe përpjekjet për të hedhur dritë mbi shqipen e para Buzukut të mbeten në kuadrin e hipotezave të pavërtetueshme. Nga kjo mosqartësi nuk ka shpëtuar as fjalëformimi. Megjithatë ka disa përpjekje për të mbledhur fjalë, mes tyre dhe fjalë të përbëra, edhe para kohës së Buzukut siç është punimi i Shuteriqit¹³³, i cili nxjerr në pah veç fjalëve të prejardhura edhe fjalë të përbëra, duke arritur në përfundimin se “*shqipja mesjetare kishte një sistem fjalëformimi të gjerë, që i lejonte një pasurim të shumanshëm, në të gjitha fushat ku ajo mund ta ndiente nevojën e shprehjes së përditshme dhe të shprehjes letrare.*”¹³⁴

Dokumentimin më të lashtë të fjalëve të përbëra në gjuhën shqipe para periudhës së Buzukut, Kostallari¹³⁵ e sheh në onomastikë dhe veçanërisht në toponomastikë. Në punimin e tij “*Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*” ai liston si shembuj 17 fjalë të përbëra nominale që datojnë nga viti 1304 deri në vitin 1431 si: *buzëgjanë, bukëzezë, burrëmadh, bythëdosë, buzëgjarpën* etj.

Pavarësisht dokumentimit të hershëm, Kostallari vëren se çështja e përbërjes dhe kompozitave të shqipes është trajtuar dhe analizuar relativisht vonë në gramatikat tona. Ai dallon dy etapa kryesore të pasqyrimin të fjalëve të përbëra: etapën e parë që nis në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe shkon deri në gjysmën e shekullit të njëzetë, periudhë kjo në të cilën janë mbajtur qëndrime shumë skeptike lidhur me fjalët e përbëra të gjuhës shqipe, kryesisht nga gjuhëtarët të huaj, disa madje kanë mohuar ekzistencën e kompozitave në shqipe¹³⁶. Por në këtë periudhë janë punimet e Kristoforidhit dhe Sami Frashërit, të cilat ndonëse nuk trajtojnë në mënyrë të veçantë dhe eksplicite fjalët e përbëra, janë të rëndësishme për fillesat e krijimit të një tradite të re në gramatologjinë e shqipes, “*e cila mbështetet drejtpërdrejt në gjuhën popullore shqipe dhe jep një pasqyrim më objektiv të fjalëve të përbëra*”¹³⁷. Janë pikërisht këto gramatika që i hapin rrugë etapës së dytë të shqyrtimit të fjalëve të përbëra të shqipes, e cila merr një formë më të plotë

¹³³ Dh. S. Shuteriqi, Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut (879-1553), në: *Studime filologjike*, 1/1983, f. 197 – 209,

¹³⁴ Po aty, f. 209

¹³⁵ A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972, f. 75-94

¹³⁶ Qëndrim të tillë Kostallari konstaton në gramatikat e Hahn-it, Dozon-it dhe Weingand-it. Në veprën e cituar f. 76

¹³⁷ Kostallari, po aty, f. 76

nëpërmjet punimeve të Cipo dhe punimit të Xhuvanit mbi fjalët e përbëra. Edhe pse trajtimi i kompozitave nga këta autorë nuk është i plotë, duke u shoqëruar edhe nga përfundime jo të qarta e të mangëta, ato janë shumë të rëndësishme sepse përbëjnë përpjekjet e para të shqyrtimit të kompozitave si një çështje më vete.

Cipo në punimet¹³⁸ e tij trajton si kompozita, të cilat i quan “sui generis”¹³⁹, edhe togfjalëshat e formuar nga dy emra të tipit “gurë kufiri” “bukë gruri” apo “zoq pulash”, “lule dhënsh” etj., të cilat për të duket të kenë përparësi krahasuar me kompozitat e mirëfillta të shqipes. Cipo shqyrton edhe kompozitat e mirëfillta, veçanërisht në punimin e tij “Kompozitat determinative”, por trajtimin e kompozitave ai e bën në kuadrin e një vëzhgimi krahasues pasi i krahason me ato të greqishtes së vjetër dhe persishtes, duke dhënë dhe përkthimin latin për çdo kompozitë. Nëpërmjet studimit të mënyrës si janë krijuar kompozitat, ai kërkon të nxjerr në pah të përbashkëtat dhe afritë që kanë ato me kompozitat e gjuhëve të tjera. Ndonëse shkurt, në punimet e tij shqyrtohen kompozitat e mirëfillta përcaktore, të cilat ai i quan determinative, si dhe kompozitat e pronësisë (Bahuvrihi). Për këto të fundit veç shembujve mbledhur në ligjërimin popullor, ai sheh si burim edhe gjuhën letrare të Naim Frashërit. Shqyrtohet si ana strukturore ashtu edhe ajo semantike e këtyre kompozitave, si dhe rendi, sjellja dhe funksioni i gjymyrëve të tyre. Por Cipo duke u nisur vetëm nga kriteri semantik, pranon ekzistencën në gjuhën shqipe edhe të kompozitave këpujore si *shkeleshko*, e cila në fakt është një fjalë e përngjitur. Këto formime parapëlqen t’i quajë me emërtimin e sanskritishtes *Dvandva*, ku krahas disa kompozitave “plaka” klasifikon edhe “*neologjizmat si veshmbathje, shitblerje, shitblerës*”¹⁴⁰, duke i parë si formime të rralla dhe jashtë natyrës së shqipes. Por gjithsesi ai pranon si tipin më të pasur kompozitën emër + mbiemër, duke i quajtur dhe fjalë të përngjitura.

Cipo nuk është i vetmi që nuk e bën qartë ndarjen e kompozitave nga përngjitja. Paqartësi lidhur me këtë çështje gjejmë edhe te punimet e Xhuvanit i cili shprehet: “*Si çdo gjuhë tjetër indoevropiane, kështu edhe shqipja e përtërin dhe e shton leksikun e saj me anë të kompozimit të derivacionit të fjalëve, d.m.th. krijon fjalë të reja tue i vu dy fjalë për brijë njena-tjetrës në juktapozicion...*”¹⁴¹. Akoma më i paqartë na shfaqet qëndrimi i I. D. Sheperit lidhur me mënyrat e fjalëformimit në përgjithësi, dhe fjalët e përbëra në veçanti, si: *atdhe, bukurshkrim e dorëshkrim*, të cilat ai i klasifikon brenda “përngjitjes”¹⁴² krahas fjalëve të përngjitura të mirëfillta si *domosdo, sikur, dymbëdhjetë* etj. dhe fjalëve të tjera si *përshkruaj, ngjit, shfaq* etj. apo *i dypërngjitur*, duke mos vendosur kufij të qartë mes parashitesimit dhe përngjitjes, apo kompozitave të mirëfillta të shqipes.

Pavarësisht se për Xhuvanin kompozitat janë fjalë të përngjitura dhe se punimi i tij mbi kompozitat është një punim i shkurtër, i cili ka në fokus të tij vetëm dy tipe kompozitash,

¹³⁸ Kostaq Cipo i ka shqyrtuar kompozitat në dy punime të veçanta “*Rreth disa kompozitave*” dhe “*Kompozitat determinative*” botime të vitit 1948 në Buletinin e Institutit të Shkencave si dhe në gramatikën e tij “*Gramatika shqipe*”, botim i vitit 1949.

¹³⁹ K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, f. 43

¹⁴⁰ K. Cipo, *Rreth disa kompozitave*, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë 1972, f. 61

¹⁴¹ A. Xhuvani, *Mbi prejardhjen e fjalëve*, në *Vepra I*, Tiranë, 1980, f. 355

¹⁴² I. D. Sheper, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, f. 133-137

kompozitat e formuara nga një folje dhe një emër e anasjelltas, si dhe kompozitat formuar nga dy emra, ai mbetet shumë i rëndësishëm për disa arsye. Ai është nga punimet e para ku kompozitat trajtohen si një temë e veçantë. Në të pasqyrohet vjetërsia dhe zhvillimi i tyre në gjuhë, si dhe prodhimentaria e tyre. Kemi të bëjmë me kompozita të mbledhura nga gjuha e popullit si dhe me një analizë semantike dhe strukturore të disa tipave kompozite. Ndonëse Xhuvani i ndan në dy grupe kryesore, fokusi është pak më i gjerë, pasi shembujt dhe analiza nuk flasin vetëm për kompozitat e formuara nga një folje e një emër, apo nga dy emra, por edhe për nëntipat, duke nxjerr në pah dhe ndryshimet mes tyre. Gjithashtu rëndësi i kushtohet dhe fjalëve të përbëra të tipit emër + emër, që shprehin një cilësi “*dhe përdoren si mbiemra*”¹⁴³ si: *zemërgur, gojëshpatë, buzëburbuqe, shpirtkazmë bishtgërshanë* etj. Këto formime nuk trajtohen vetëm nga ana strukturore dhe semantike, por shqyrtohen pak më gjerë. Shihet gjithashtu mundësia e tyre për t’u përdorur në dy gjini si dhe mundësia e sjelljes së tyre si tema fjalëformuese.

Gjithsesi edhe vetë autorët e këtyre punimeve e kanë shprehur se ekziston nevoja e një trajtimi akoma më të thellë dhe e një studimi më të detajuar që të përfshijë gjithë kompozitat e gjuhës shqipe, të cilat janë të shumta dhe të shumëllojshme. Kjo nevojë lindte jo vetëm për larmishmërinë dhe tipat ende të patrajtuar mirë dhe plotësisht të fjalëve të përbëra, por edhe për të sistemuar qëndrimet e ndryshme, për të saktësuar përfundimet e gabuara apo të paplota si dhe për të përcaktuar kufijtë midis përbërjes dhe përngjitjes si dy mënyra të veçanta fjalëformimi.

Në mënyrë sipërfaqësore, por të ndara qartas nga grupi i fjalëve të prejardhura dhe të përngjitura, trajtohen fjalët e përbëra në “*Gramatikën e gjuhës shqipe, pjesa I*”, botim i vitit 1962, të Shaban Demirajt, i cili e njeh përbërjen si një mënyrë të veçantë fjalëformimi dhe jep shembujt të disa prej tipave të kompozitave emërore, mbiemërore dhe foljore, duke u mjaftuar vetëm në listimin e tyre pa bërë asnjë analizë semantikogramatikore të tyre e duke i parë madje edhe si të kufizuara në numër.

Studimin më të gjerë dhe më të hollësishëm në lëmin e përbërjes si mënyrë fjalëformimi dhe fjalëve të përbëra në veçanti, e gjejmë nga Kostallari¹⁴⁴, i cili i ka kushtuar një vëmendje të veçantë dhe një punë të admirueshme kësaj çështjeje. Në punimin e tij “*Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*” ai bën një analizë të hollësishme të vendit dhe rëndësisë që zë shqyrtimi i fjalës së përbërë apo kompozitës në gramatologjitë apo studimet e gjuhëtarëve të huaj dhe vendas që nga Hahn-i, Bopp-i e Kamarda, Dozoni, Weinberg-u e Pekmezi¹⁴⁵ e deri te I. D. Sheperi, Cipo e Xhuvani, të cilët me sa duket

¹⁴³ A. Xhuvani, vepër e cituar, f. 72

¹⁴⁴ A. Kostallari, “Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe”, “Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese”, “Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes” dhe “Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes” në *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1972, f. 75-196

¹⁴⁵ Dr. Pekmezi në punimin e tij “*Grammatik der albanesischen Sprache*”, botuar në Vjenë në vitin 1908, ia njeh gjuhës shqipe kompozitat, kompozitat emërore, madje i shqyrton ato në një pjesë më vete, vetëm se bëhet fjalë për një shqyrtim shumë sipërfaqësor. Pekmezi mjaftohet me paraqitjen e vetëm katër tipave të kompozitave emërore: emer + mbiemër, emër + pjesore, emër + folje dhe emër + emër, duke shoqëruar çdo grup me shembuj pa bërë asnjë analizë apo koment për secilin tip. (f.227 – 229)

janë ndikuar nga njëri-tjetri në qëndrimet e tyre. Gjatë kësaj analize Kostallari nxjerr në pah dhe trajtimin sipërfaqësor që u është bërë kompozitave nga gjuhëtarët e huaj, mban qëndrim kritik mbi përfundimet e tyre, si dhe njih merita për çështje të caktuara siç është ajo e mbledhjes së fjalëve nga gjuha e popullit. Duke u njohur arritje të caktuara, veçanërisht Cipos dhe Xhuvanit, ai merr përsipër të zbërthejë strukturën e kompozitave të gjuhës shqipe duke përcaktuar tiparet themelore të fjalës së përbërë dhe dallimet e saj me fjalët e përngjitura, në mënyrë që të vërtetohet qartazi ekzistenca e kompozitave në shqipe. Kostallari mbron me forcë tezën se zhvillimi dhe gjallërimi i kompozitave është një proces që ka ndodhur dhe ndodh në përputhje me vetë natyrën e gjuhës shqipe, dhe se përbërja apo formimi i tipave të caktuar të fjalëve të përbëra nuk vepron në gjuhën tonë si pasojë e ndikimeve të jashme apo kalkimit. Për Kostallarit ekzistenca e kompozitave të mirëfillta të shqipes, disa tipa madje dhe shumë të vjetër, është një fakt i pakundërshtueshëm, për të cilin flasin një sërë argumentash duke nisur që nga dokumentimi i tyre në dialekte, në gjuhën e popullit, në toponime e deri te krahasimi i tyre me kompozitat e gjuhëve të tjera veçanërisht me ato të greqishtes së vjetër, latinishtes e sanskristesh, krahasim të cilin e ndërmer dhe vetë Kostallari në punimin e tij.

Fjalët e përbëra trajtohen në shumë këndvështrime, duke nisur që nga analiza semantikostrukture, funksioni, sjellja dhe lidhja sintaksore e gjymtyrëve përbërëse me njëra-tjetrën, karakteri leksikogramatikor i tyre, lidhja dhe kuptimi i tyre në raport me fjalën e krijuar, tipat dhe nëntipat e ndryshme, vjetërsia, prodhimtaria dhe historiku i dendurisë së përdorimit të tyre, veçoritë stilistikore deri dhe karakteri e produktiviteti fjalëformues i disa fjalëve të përbëra siç janë disa nga mbiemrat e përbërë ekzocentrikë. Mbiemrat ekzocentrikë apo mbiemrat pronësorë, të cilët njihen edhe me emërtimin sanskrit “Bahuvrihi”, zënë një vend shumë të rëndësishëm në studimin e fjalëve të përbëra në punimet e Kostallarit, punime në të cilat bazohet edhe një pjesë e mirë e këtij punimi, veçanërisht çështja e fjalëve të përbëra dhe të përngjitura.

II.2. Kompozimi dhe karakteristikat e kompozitave

Kompozimi, i cila njihet ndryshe edhe si përbërje, është një mënyrë fjalëformimi me prodhimtari që ka ardhur duke u rritur¹⁴⁶. Me anë të kompozimit formohen fjalë të reja

¹⁴⁶ Në punimet apo studimet e ndryshme që i janë bërë leksikut apo fjalorëve të gjuhës shqipe ndër vite, vihet re se ato pasurohen gjithnjë e më shumë edhe me fjalë të përbëra. Këtë gjë e shohim në punimin e E. Hysës “*Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare*” botuar në Gjuha Jonë 1/1985, f. 109-114, i cili vë re “*se një varg tipash të ndryshëm fjalësh të përbëra me prodhimtarinë e tyre kanë ndikuar në shtimin e njësisive të reja, duke rritur në mënyrë të ndjeshme dhe peshën e fjalëpërbërjes në përgjithësi në gjuhën tonë, sidomos në kategorinë e emrave dhe mbiemrave.*” (f.110) Gjithashtu rëndësinë dhe rritjen e prodhimtarisë së fjalëve të përbëra edhe në terminologjinë tekniko-shkencore e shohin edhe Ferdinand Leka e Agron Duro në punimet e tyre përkatëse “*Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore pas Çlirimit*” (në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, Tiranë 1972, f.197-200) dhe “*Fjalët e përbëra në terminologjinë teknikoshkencore*” (në: Studime

nga bashkimi i dy a më shumë temave motivuese, duke bërë që ajo të ndryshojë qartas nga mënyra tjetër shumë prodhimtare e prejardhjes. Si do të shihet më poshtë ndonjëherë është e vështirë të përcaktohet pa një analizë të hollësishme tipi i saktë fjalëformues i një fjale apo i një grupi fjalësh, kjo dhe për faktin se fjalët në procesin e zhvillimit të gjuhës kanë pësuar dhe pësojnë ndryshime të shumëllojshme jo vetëm fonetike e morfologjike, por edhe ndryshime semantike, por pa i shkëputur disa lidhje me format e tyre të mëparshme. Dhe janë pikërisht këto lidhje ato që i bëjnë ndonjëherë të lëkundshme kufijtë mes mënyrave të ndryshme të fjalëformimit.

Si përkufizim i fjalës së përbërë këtu do të përdoret përkufizimi që i ka bërë Kostallari. Ky përkufizim jo pak herë është bërë referues për shumë gjuhëtarë që kanë pasur në fokus të studimeve të tyre përbërjen në përgjithësi apo përbërjen e pjesëve të veçanta të ligjeratës në veçanti, siç ka ndodhur me Dhrimon në punimin e tij *“Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe”* apo Hysën në *“Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe”*, pasi mendojmë se është një përcaktim i saktë që i bëhet kësaj kategorie fjalësh, duke përfshirë të gjitha tiparet kryesore të saj.

“Fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfillët në shqipen është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformonjëse, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintatike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj.”¹⁴⁷

Kostallari me të drejtë thekson karakterin dygjymtyrësh të kompozitave, por ai i referohet vetëm kompozitave përcaktore. Këto kompozita edhe kur përbëhen nga tri tema motivuese mbeten dygjymtyrëshe. Njëra prej këtyre gjymtyrëve është fjalë e përbërë, si në rastin e kompozitës *“atdhedashuri”*, gjymtyra e parë e së cilës *“atdhe”* është gjithashtu një kompozitë dhe zërthehet më tej edhe ajo në dy gjymtyrë, në *“at”* e *“dhe”*. Ndërsa kompozitat këpujore mund të kenë edhe më shumë se dy gjymtyrë, kjo për shkak të lidhjeve bashkërenditëse mes tyre.

Është e rëndësishme të theksohet së fjalët e përbëra nuk formohen nga bashkimi i dy apo më shumë fjalëve¹⁴⁸, por nga bashkimi i dy apo më shumë temave motivuese, pasi kjo përbën edhe një nga dallimet mes fjalëve të përbëra dhe fjalëve të përngjitura. Nga këto tema motivuese të fjalës së përbërë njëra, tema mbështetëse e formëson gramatikisht

filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit, Tiranë 1986, f.639-643), të cilët vënë re se kompozimi dhe tipa të caktuar fjalësh të përbëra bëhen prodhimtare dhe gjejnë përhapje të gjerë në këtë stil, si pasojë e ngarkesës semantike më të madhe të tyre dhe e shprehjes më të drejtpërdrejtë të nocionit krahasuar me fjalët e formuara sipas mënyrave të tjera të fjalëformimit.

¹⁴⁷ A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, Tiranë, 1972, f. 83

¹⁴⁸ *“Në gjuhën shqipe ka edhe një sasi fjalësh, që janë formuar nga bashkimi i dy ose më shumë fjalëve. Këto quhen fjalë të përbëra.”* shprehet Shaban Demiraj në f. 15 të Gramatikës së gjuhës shqipe, pjesa I, botim i vitit 1962.

gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër ose temat e tjera, në rast se janë më shumë, janë të neutralizuara nga kuptimet gramatikore.

Gjuhësia historike e krahasuar¹⁴⁹ ka arritur në përfundimin se fjalët e përbëra e kanë burimin e tyre te togfjalëshat, të cilët me kalimin e kohës pësojnë ndryshime gramatikore, fonetike dhe semantike. Temat fjalëformuese gjatë procesit të bashkimit në një fjalë të vetme, i rrëzojnë elementet formale të paradigmës së tyre si p.sh.

bregdet:	nga <i>breg deti</i> ,
vendbanim:	nga <i>vend banimi</i> ,
ditëlindje :	nga <i>ditë lindjeje</i>
pikënisje:	nga <i>pikë nisjeje</i>

Siç mund të shihet dhe nga shembujt e mësipërm, kanë rënë morfemat trajtëformuese –i dhe –je të temave të dyta të fjalëve të përbëra. Rënia e këtyre morfemave neutralizon dhe marrëdhëniet gramatikore mes gjymtyrëve të togfjalëshit, të cilat formalisht shprehen pikërisht nëpërmjet tyre, duke krijuar përfundimisht fjalën e përbërë dhe duke e dalluar atë nga togfjalëshi tek i cili e ka burimin. Por nuk mjafton vetëm struktura e mbyllur për ta bërë një fjalë të përbërë dhe për ta dalluar atë nga togfjalëshi. Natyrisht është dhe kuptimi tërësor që ato mbartin, si dhe fakti se ato shprehin një koncept të vetëm, dhe se marrëdhëniet kuptimore të gjymtyrëve janë më të përgjithshme. Një fjalë e përbërë kur krijohet nuk ndërtohet për të shprehur marrëdhëniet midis dy gjymtyrëve të saj siç ndodh me gjymtyrët e togfjalëshit. Të dyja temat fjalëformuese kur bashkohen në një kompozitë, i humbasin ose i zbehin marrëdhëniet e brendshme sintaksore të togfjalëshit nga i cili kanë dalë, deri diku edhe ato semantike, duke emërtuar kështu një koncept të ri. Edhe gramatikisht fjala e përbërë sillet si një fjalë e vetme. Në togfjalëshin *kokë e madhe* shprehet raporti cilësor midis emrit *kokë* dhe mbiemrit *e madhe*, pra mbiemri shpreh një tipar të emrit. Ndërsa fjala e përbërë *kokëmadh* është krijuar si mbiemër për të shënuar një tipar të caktuar të një emri, të një djali në rastin *djalë kokmadh*, duke iu përshtatur edhe në gjini emrit që cilëson, apo të një vajze në rastin *vajzë kokëmadhe*, ku mbaresa –e shpreh gjininë e mbiemrit të përbërë, që i përshtatet emrit tiparin e të cilit emërton. Në disa raste, si p.sh. në fjalët *vajguri*, *qymyrguri* apo *panxharsheqeri* edhe pse në fjalor i gjejmë trajtat *vajgur* apo *qymyrgur* të këtyre fjalëve, ato përdoren rrallë në ligjërimin e shkruar apo të folur. Vihet re se kur përdoren në rasën emërore apo kallëzore të pashquar, këto fjalë ruajnë mbaresën rasore të temës së dytë, siç e gjejmë madje dhe në “*Fjalorin e shqipes së sotme*”, botim i vitit 2002:

Furnelë	=	Pajisje për të zier gjellët etj., e cila punon <i>me vajguri</i> , me gaz ose me rrymë elektrike.
Vajgur/i	=	Lëndë djegëse e lëngshme, që nxirret nga përpunimi i naftës dhe që përdoret në industri e në teknikë, për

¹⁴⁹ A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, Tiranë 1972, f. 80

Panxharsheqeri = ngrohje etj. *Furnelë me vajguri*.
Lloj panxhari, nga rrënja e të cilit nxirret sheqer.

Këto raste Kostallari i shpjegon si fjalë që janë bashkëngjitur por që ndodhen ende në proces të pambyllur kalimi në një fjalë të përbërë me përcaktim rasor¹⁵⁰, ndryshe nga emrat “vendbanim” apo “vendlindje”, të cilat kanë kaluar në klasën e fjalëve të përbëra. Ndërsa për Thomain fjalët e tipit “vajgur/i” “*duhet trajtuar si një tip me strukturë gjysmë të hapur: në të shquarën si fjalë dhe në të pashquarën si togfjalësh*”,¹⁵¹ Më poshtë ai vijon duke dhënë mes të tjerash si shembuj dhe: (ngarkoj) panxharsheqerin dhe panxhar sheqeri, (përdor) gurkalin dhe gur kali.


Një tjetër veçori e fjalëve të përbëra është dygjymtyrësia. Pjesa dërrmuese e fjalëve të përbëra të shqipes krijohen nga bashkimi i dy temave motivuese, por kjo nuk do të thotë se shqipja nuk i pranon krijimet e fjalëve me më shumë se dy tema të tilla. Në Fjalorin e shqipes së sotme, botim i vitit 2002, krahas kompozitave dygjymtyrëse me dy tema motivuese, ka edhe kompozita gygjymtyrëse me më shumë se dy tema motivuese. Ndonëse si të tilla janë pasqyruar vetëm pak fjalë, pikërisht emrat: *bashkëmarrëdhënie*, *bishtfurkabukur* (emërtim krahinor i nuse lalës), *lulekëmbëpulë* (bimë barishtore), *vajgursjellës*, *shtatëpëllëmbëmjekër* (figurë e përrallave popullore), *zhytkryekuqe* (shpend uji); fjala *aeroplanmbajtës*, e cila është mbiemër por gjen edhe përdorim emëror; mbiemrat: *derëbabëshuar* dhe *vajgurmbajtës* si dhe emri *aktmarrëveshje*, i cili është formuar nga emri *akt* dhe emri *marrëveshje*, ky i fundit një kompozitë emërore jo e mirëfilltë pasi është formuar me kompozim dhe prapashtesim, ato i gjejmë veçanërisht në gjuhën e letërsisë artistike si krijime të lira të shkrimtarëve, apo në stilin teknikoshkencor¹⁵². Megjithatë duhet theksuar se kjo nuk është një shfaqje shumë e zakonshme në shqipe.

Në përcaktimin e përbërës luajnë rol: tema (e mëvetësishme) si dhe motivimi i lidhjes së temave që kanë pasojë përbërjen ose e thënë ndryshe rruga e bashkimit të këtyre temave. Pavarësisht nga numri i temave që bashkohen për të krijuar fjalën e përbërë, ajo është gjithnjë dygjymtyrëse. Kështu edhe fjalët e përbëra me tri tema fjalëformuese janë dygjymtyrëse, nga të cilat njëra gjymtyrë është e thjeshtë, ndërsa gjymtyra tjetër e kompozitës është një fjalë e përbërë si ndodh në rastin e fjalëve *lulekëmbëpulë* apo *vajgursjellës*. Fjala *lulekëmbëpulë* është e përbërë nga një gjymtyrë e përbërë dhe një gjymtyrë e thjeshtë. Skema e mëposhtme e zbërthen më mirë strukturën e kësaj fjale:

¹⁵⁰ A. Kostallari, po aty, f. 82

¹⁵¹ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011, f. 38

¹⁵² A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, fq. 83



Rendi i gjymtyrëve të fjalës së përbërë është i përcaktuar dhe shumë i rëndësishëm. Ndryshimi i tij do të shoqërohet me ndryshim apo dhe prishje të fjalës së përbërë. Cipo vëren se vetëm në greqishte është i mundur ndryshimi i rendit të gjymtyrëve të fjalës së përbërë pa shkaktuar ndryshim në kuptimin e saj, ndërsa shqipja nuk e lejon një gjë të tillë¹⁵³.

Fjalët e përbëra duke pasur në përbërjen e tyre të paktën dy tema motivuese, mbartin një ngarkesë semantike më të madhe se fjalët e tjera të prejardhura, ndaj dhe koncepti që ato shprehin paraqitet më qartë dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë. Te temat prodhuese që formojnë fjalën e përbërë, ruhen pak a shumë qartë kuptimet e tyre semantike duke bërë që ato të krijojnë lidhje të ndryshme dhe të shumta semantikosintaksore sipas modeleve dhe lidhjeve sintaksore ekzistuese të gjuhës shqipe. Por pavarësisht se në disa raste kuptimi semantik i fjalës së përbërë tingëllon si shuma e kuptimeve të gjymtyrëve të saj, nuk duhet marrë si e tillë, pasi siç është theksuar dhe më lart, si pasojë e marrëdhënieve në të cilat hyjnë temat prodhuese formohet një fjalë që shpreh një koncept të ri, e cila i shpreh të bashkuara kuptimet e dy gjymtyrëve të saj duke i shtuar kështu diçka më shumë radhitjes së thjeshtë të tyre jashtë kompozitës¹⁵⁴. Kështu në rastin e fjalës *marrëdhënie* kuptimi i saj nuk është vetëm të marrësh (*marrje*) dhe të japësh (*dhënie*), por të marrësh dhe të japësh në mënyrë të ndërsjelltë. Kjo fjalë kuptohet si si një unitet i asaj që shprehin të dyja temat prodhuese përbërëse.

Një kuptim afërsisht të barabartë me shumën e kuptimeve të gjymtyrëve përbërës kanë mbiemrat e përbërë, temat motivuese të të cilëve kanë të njëjtën mëvetësi semantike dhe sintaksore madje dhe funksionale duke plotësuar deri diku njëri-tjetrin. Gjymtyrët e këtyre mbiemrave të përbërë mund të lidhen edhe me anë të zanores lidhëse *-o-* dhe *-a-*. Këto zanore nuk përbëjnë gjymtyrë, ato kryejnë vetëm funksion lidhës. Shumica e kompozitave të gjuhës shqipe formohen nga bashkimi i temve fjalëformuese pa pjesëmarrjen e zanores lidhëse. Kostallari këtë fakt e sheh si një nga veçoritë karakteristike të strukturës së kompozitave të gjuhës shqipe, dhe mungesën e saj ai e lidh

¹⁵³ K. Cipo, Kompozitat determinative, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, Tiranë, 1972, f. 65-66

¹⁵⁴ A. Kostallati, po aty f. 83

me zhvillimin historik të temave nominale të shqipes¹⁵⁵. Kompozitat me zanore lidhëse janë të pakta, veçanërisht ato, gjymtyrët e të cilave lidhen me zanoren lidhëse –a-. Këto kompozita përbëjnë një grup krijimesh të vjetra popullore që nuk është më prodhimtar.

gushtovjeshtë, peshkaqen, dashamir, dashakeq, dredhalesh, puthador, rrahaderë, djegagur, teknikoshkencor, auströhungarez, afroaziatik etj.

Një tipar karakteristik i fjalës është theksi i vetëm me intensitet të plotë që ajo mbart. Por edhe fjala e përbërë, ndonëse krijohet nga bashkimi i dy temave prodhuese ka vetëm një theks kryesor për të gjithë kompozitën. Thuhet një theks kryesor pasi për disa fjalë të përbëra pranohet veç theksit kryesor me intensitet të plotë në njërin gjymtyrë të tyre, edhe një “*theks i dytë*” me intensitet të dobët në gjymtyrën tjetër¹⁵⁶.

Fjalët e përbëra janë njëkohësisht dhe fjalë të motivueshme. Këto të fundit përbëhen prej temës fjalëformuese dhe prej formantit fjalëformues. Fjalët e përbëra kanë brenda tyre të paktën dy temave fjalëformuese ndërsa rolin e formantit fjalëformues e luajnë disa elemente: rendi i përcaktuar i gjymtyrëve të fjalës së përbërë, theksi i vetëm kryesor i gjithë fjalës së përbërë, si dhe për disa fjalë të përbëra edhe zanorja lidhëse, e cila është në rolin e një ndajshitesë fjalëformuese.¹⁵⁷

Gjithashtu duhet theksuar se përbërja është një proces krijimi fjalësh të reja sipas modeleve ekzistuese të gjuhës. Nëse nuk ekziston modeli, atëherë dhe gjuha nuk e lejon krijimin e një fjale të re të përbërë. Në momentin e krijimit të saj, fjala e përbërë hyn menjëherë në një klasë leksikogramatikore duke përvetësuar të gjitha tiparet e funksionet e saj si dhe lidhjet që realizon kjo klasë.

Në fushën e fjalëformimit përbërja apo kompozimi, njihet si një nga dy mënyrat më prodhimtare të formimit të fjalëve të reja dhe zgjerimit e pasurimit të leksikut të shqipes, kjo ndoshta dhe për faktin se me anë të saj formohen shumë emra, edhe më shumë mbiemra si dhe një numër i kufizuar foljesh e ndajfoljesh. Të gjitha këto formime krijohen nga bashkimi i temave fjalëformuese të ndryshme si temave emërore, mbiemërore, foljore, ndajfoljore, përemërore si dhe tema numërorësh, gjë që vërehet edhe në shembujt e mëposhtëm:

emra: atdhe, bukëpjekës, besëlidhje, dëmshpërblim, ditëlindje, letërkëmbim, orëndreqës, vargmal, votëbesim etj.; drejtshqiptim, mirëbesim, mirëkuptim, mbarëvajtje etj.; dyluftim etj.; gushëkuq, lulëkuqe etj.; vëmendje, djegagur, thirravajë etj.; mbiemra: bishtcung, hungëshkabë, kokëderr, mjekërcjap, zemërlepur etj.; belhollë, cipëplasur, derëbardhë, fatkeq, fuqimadh, gojëëmbël, zemërkeq etj.; tringjyrësh, njërrokësh, disaditësh, shumëkatesh etj.; folje: buzëqesh, duartrokas, udhëheq etj.; mirëmbaj, mirëkuptoj, keqpërdor, keqtrajtoj etj.; ndajfolje: buzagaz, fytafyty, turravrap etj.

Por fjalë të përbëra janë edhe një grup numërorësh të gjuhës shqipe. Të tillë janë numërorët: tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë, tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë, formuar nga bashkimi i numërorëve themelorë tre, pesë, gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë me numërorin dhjetë, si dhe numërorët njëqind, dyqind, treqind, katërqind,

¹⁵⁵ A. Kostallari, po aty, f. 86

¹⁵⁶ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011, f. 42

¹⁵⁷ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f. 55

pesëqind, gjashtëqind, shtatëqind, tetëqind dhe nëntëqind, formuar nga bashkimi i numërorëve themelorë nga njëshi deri te nënta dhe emrit *qind*.¹⁵⁸

Në krijimin e fjalëve të përbëra marrin pjesë tema fjalëformuese kuptimplota, gjë që bën që secila nga gjymtyrët e fjalës së përbërë të ketë një kuptim të qartë e të mëvetësishëm leksikor, duke ndikuar dhe në kuptimin e gjithë fjalës së përbërë. Por se në ç’raport qëndron kuptimi i gjymtyrëve të fjalës së përbërë me kuptimin e gjithë kompozitës, kjo gjë varet nga marrëdhënia apo lidhja sintaksore midis këtyre gjymtyrëve. Lidhja midis gjymtyrëve të fjalës së përbërë mund të jetë lidhje bashkërenditëse ose lidhje nënrenditëse, duke krijuar kështu dy tipa kryesorë kompozitash: fjalë të përbëra me marrëdhënie bashkërenditëse mes gjymtyrëve të tyre, ose *kompozita këpujore*, dhe fjalë të përbëra me marrëdhënie nënrenditëse mes gjymtyrëve të tyre ose *kompozita përcaktore*.

II.2.1. Kompozitat këpujore

Gjymtyrët e kompozitave këpujore, duke pasur marrëdhënie bashkërenditëse me njëra-tjetrën, krijojnë raporte barazie mes tyre dhe asnjëra nuk mbizotëron tjetrën. Këto kompozita kanë një kuptim deri diku të barabartë me shumën e kuptimeve të gjymtyrëve të tyre. Themë deri diku pasi për arsyet e përmendura dhe më lart, ky kuptim nuk mund të jetë asnjëherë i barabartë. Kompozita do të shprehë gjithnjë diçka më shumë, pasi nga bashkimi i dy gjymtyrëve formohet një fjalë e re e cila emërton një nocion të ri. Gjymtyrët e këtyre kompozitave kanë barazi dhe pavarësi funksioni, prandaj dhe lidhja midis tyre është më e dobët sesa te kompozitat me lidhje nënrenditëse. Ato plotësojnë reciprokisht njëra-tjetrën. Fjala *juglindje* nuk emërton edhe pikën e horizontit që është përkundrajt veriut (*jugun*) edhe pikën e horizontit nga lind dielli (*lindjen*) njëkohësisht, pasi kjo do të ishte e pamundur, por anën e horizontit ose drejtimin që ndodhet midis jugut dhe lindjes. Gjithashtu edhe fjala *hekurbeton* nuk emërton thjesht një përzierje të betonit me hekurin, por është një element ndërtimi i rëndësishëm që përdoret në ndërtime të ndryshme, i realizuar nga *forcimi* i betonit me shufra hekuri, sikurse *dritëhije* nuk shpreh vetëm dritën e hijen bashkë, por edhe një *mënyrë pikturimi* për të arritur një efekt të caktuar, efektin e kontrastit me dritën e me hijen.

Kompozitat këpujore shfaqen në punimin e Cipos “*Rreth disa kompozitave*” si një grup i vogël fjalësh. Sipas tij gjuha shqipe i njeh dvandva-t¹⁵⁹, vetëm se “*duket mos t’i ketë me*

¹⁵⁸ Në punimin e tij “*Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa e I, Morfologjia*”, botim i vitit 1962, Shaban Demiraj i klasifikon këta numërorë në grupin e numërorëve të përngjitur. Si fjalë të përngjitura shqyrtohen numërorët e tipit *njëqind e dyqind* edhe në punimin “*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*”, botim i vitit 1976.

¹⁵⁹ Duke u bazuar në llojin e marrëdhënies dhe lidhjeve që krijojnë gjymtyrët e kompozitës me njëra-tjetrën dallohen: *Dvandva* (Dvandva është emërtimi në sanskritisht për kompozitat këpujore), *Karmadharaya* (emërtimi sanskrit për kompozitat endocentrike ndajshtimore), *Tatpuruṣha* (emërtimi në sanskritishte për kompozitat endocentrike, me përcaktim rasor) dhe *Bahuvrihi* (emërtimi në sanskritishte për kompozitat ekzocentrike ose pronësore).

qejf formime të tilla”¹⁶⁰. Gjithsesi, Cipo i njej gjuhës shqipe një tjetër lloj dvandvash, të cilat i cilëson edhe si të bukura, dhe bashkë me togfjalëshat ai rendit në këtë grup edhe kompozitat e lidhura me këpujoren *e*.

Faktikisht kompozitat me lidhje bashkërenditëse mund të zërthehen në togfjalësha me gjymtyrë të lidhura me lidhëzën këpujore *e* ose edhe: *shitblerje* → *shitje dhe blerje*; *ngarkim-shkarkim* → *ngarkim dhe shkarkim*; *teknikoshkencor* → *teknik dhe shkencor* etj. Duhet thënë se në krahasim me kompozitat me lidhje nënrenditëse, në gjuhën shqipe kompozitat me lidhje bashkërenditëse ose kompozitat këpujore, përbëjnë një grup goxha më të vogël. Në Fjalorin e shqipes së sotme, botim i vitit 2002, ky grup nuk e kalon numrin gjashtëdhjetë, mes të cilëve 30 janë emra, 4 janë ndajfolje dhe pjesa tjetër mbiemra: *bar-bufe*, *bar-lulishte*, *bardhëkuq* (gjen edhe përdorim mbiemëror), *bar-lulishte*, *deledash*, *dritëhije*, *fakirfukara*, *gazavaj* (gjen edhe përdorim mbiemëror), *gushtovjeshtë*, *hekurbeton*, *hijedritë*, *hyrje-dalje*, *indoevropian*, *juglindje*, *jugperëndim*, *marrëdhënie*, *molladardhë*, *mollaftua*, *ngarkim-shkarkim*, *peshkaqen*, *postë-telegraf*, *radiotelevizion*, *shitblerje*, *vajtje-ardhje*, *verilindje*, *veriperëndim* etj.; *ballaballë*, *ballafaqe*, *bukagjellë*, *cekapreka*; *administrativotokësor*, *agraroindustrial*, *bujqësor-industrial*, *ekonomikofinanciar*, *ekonomikoshoqëror*, *eterovajor*, *feudaloborgjez*, *gjuajtës-bombardues*, *indoevropian*, *juglindor*, *jugperëndimor*, *kërkimorshkencor*, *kuqezi*, *monarkofashist*, *nacionalçlirimtar*, *politikoshoqëror*, *shkencor-popullor*, *shurdhmemec*, *teknikoshkencor*, *verilindor*, *veriperëndimor* etj.

“Gramatika e gjuhës shqipe, 1”, si në botimin e vitit 1995 ashtu edhe në atë të vitit 2002, rendit krahas emrave të përbërë këpujorë edhe emrin *veshmbathje*. Por duke qenë se kjo fjalë nuk përbën një kompozitë të mirëfilltë, pasi është formuar me kompozim dhe prapashtesim njëkohësisht, mendojmë se nuk duhet rradhitur brenda grupit të kompozitave këpujore, pavarësisht se fjalët e bashkuara me kompozim *vesh* dhe *mbath* qëndrojnë në marrëdhënie bashkërenditëse me njëra-tjetrën.

Kompozitat këpujore kanë qenë të pakta në gjuhën shqipe, por janë shtuar dhe po shtohen gjithnjë e më tepër me krijime të reja sipas modeleve ekzistuese të gjuhës. Veçanërisht prodhimtar është bërë ky tip fjalëformimi për mbiemrat në shqipen letrare¹⁶¹. Më poshtë disa kompozita këpujore:

ballafaqe, *bar-restorant*, *hotel-restorant*, *kafe-restorant*, *marksizëm-leninizëm*, *postë-telegraf-telefon*, *pritje-përcjellje*, *fytafyt*, *pësore-vetvetore*, *analitikosintetik*, *historikogjografik*, *politikokulturor*, *indoevropian*, *teknikomaterial*, *angloamerikan*, *austrohungarez*, *anglosakson*, *serbokroatisht*, *baltosllav*, *frankogjerman*, *shqiptarogrek*, (fjalor) *frëngjisht-shqip*, *gjermanisht-shqip* etj.

Siç mund të dallohet edhe nga këta shembujt e mësipërm, gjymtyrët e kompozitave këpujore, veçanërisht të atyre mbiemërore, mund të lidhen me anë të zanores lidhëse –o–, më rrallë me zanoren lidhëse –a–, me anë të një vize, ose edhe me zanoren lidhëse –o–

¹⁶⁰ K. Cipo, Rreth disa kompozitave, në: *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, Tiranë, 1972, f. 61.


¹⁶¹ A. Dhrimo, Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe, në: *Çështje të gramatikës së sotme shqipe*, Tiranë, 1975, f. 180

edhe me vizën. Nuk duhet harruar se zanorja lidhëse nuk mbart kuptim, kryen vetëm funksion lidhës pa u bërë gjymtyrë e fjalës së përbërë. Tipi i mbiemrave këpujorë më zanoren lidhëse –o- është i huazuar dhe ndeshet më shumë në formimet terminologjike¹⁶². Veç zanores lidhëse në disa raste këto mbiemra shkruhen me vizë në mes. Dhrimo nuk e përlligj, madje është kundër vendosjes së vizës midis gjymtyrëve të mbiemrave të përbërë këpujorë, pasi ai këtë gjë e sheh si shprehje të mëvetësisë relative të elementëve përbërës të këtyre mbiemrave. Ai shprehet se “*këta mbiemra duhen shkruar si një fjalë e vetme, pa vizë në mes.*”¹⁶³ Por sipas “*Drejtshkrimit të gjuhës shqipe*”¹⁶⁴ këto mbiemra shkruhen me vizë në mes, megjithëse gjejmë dhe raste kur gjymtyrët përbërëse shkrihen në një fjalë të vetme si në rastin e fjalës *nacionalçlirimtar*, ku nuk gjejmë as vizë dhe as zanore lidhëse, apo në raste të tjera si: *ideopolitik*, *ideoartistik* etj.

Ne mendojmë se një element lidhës është mëse i mjaftueshëm për të lidhur bashkë gjymtyrët e një kompozite këpujore. Ndaj në rastet kur në kompozitë gjendet zanorja lidhëse –o-, nuk ka pse kjo lidhje të përforcohet edhe përmes vizës. Ndërsa kur mungon zanorja lidhëse, mendojmë se viza duhet shkruar në rastet kur lidhja kuptimore mes gjymtyrëve të kompozitës është e dobët dhe kompozita nuk perceptohet si një formim i njësuar plotësisht, siç dhe është vepruar në shembujt e mësipërm.

Në grupin e kompozitave këpujore bëjnë pjesë edhe disa fjalë si ndajfolje dhe mbiemra shumë të vjetër të shqipes¹⁶⁵ të formuar nga përsëritja e të njëjtit emër në shumësin e pashquar. Edhe këto mbiemra të përbërë shkruhen me vizë në mes: *copë-copë*, *brigje-brigje*, *fara-fara*, *fije-fije*, *fletë-fletë*, *katrorë- katrorë*, *klapa-klapa*, *lara- lara*, *ngjyra-ngjyra*, *rripa-rripa*, *vargje-vargje* etj.

Në formimin e emrave të përbërë me bashkërenditje bashkohen dy tema emërore, me ose pa zanoren lidhëse a/o, apo vizën lidhëse :




¹⁶² Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f. 72




¹⁶³ A. Dhrimo, vepër e cituar, f. 181

¹⁶⁴ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1972, f. 134

¹⁶⁵ Gramatika e gjuhës shqipe 1, tiranë, 2002, f.198



Ndërsa në formimin e mbiemrave të tillë bashkohen dy tema mbiemërore. Edhe në formimin e kompozitave këpujore mbiemra, bashkimi mund të jetë i drejtpërdrejtë ose edhe me zanoren lidhëse apo vizën lidhëse.



Teorikisht në formimin e kompozitave këpujore mund të bashkohen më shumë se dy tema prodhuese, edhe tri apo më tepër, duke formuar kompozita shumëgjymtyrëshe. Por praktikisht fjalë të tilla ndeshen rrallë, më tepër në letërsi, si krijime të rastit, si dhe në terminologjinë shkencore: *postë-telegraf-telefon*, *sovjetoangloamerikan*, *fetarobejlerotregtar* etj.

II.2.2. Kompozitat përcaktore

Gjymtyrët e kompozitave përcaktore janë në marrëdhënie nënrenditëse me njëra-tjetrën dhe në ndryshim nga kompozitat e shqyrtuara më lart, njëra nga këto gjymtyrë përcakton

gjymtyrën tjetër duke e saktësuar, konkretizuar apo edhe ngushtuar nga pikëpamja e kuptimit. Në rastin e fjalëve të përbëra të këtij tipi nuk mund të flasim për shumë kuptimesh, pasi nga kuptimet e gjymtyrëve përkatëse të kompozitës del një kuptim i ri, i cili vërtet motivohet prej tyre, por nuk është krejtësisht i barabartë as me shumën e tyre dhe as me kuptimin e togfjalëshit në të cilin mund të zërthehet fjala e përbërë. Kështu kuptimi fjalës *brendashkruaj* nuk është thjeshtë “shkruaj brenda”, por vizatoj një figurë brenda një figure tjetër; fjala *bregdet* nuk do të thotë vetëm “breg deti”, por nëpërmjet saj emërtohet edhe një krahinë që ndodhet pranë bregut të detit, ndërsa fjala *botëkuptim* nuk do të thotë “kuptimi i botës”. Kuptimi i kësaj fjale është shumë më i gjerë, pasi nëpërmjet saj shprehet tërësia e pikëpamjeve për botën, për natyrën dhe për shoqërinë, ashtu sikurse dhe fjala *ballëprerë* nuk nënkupton “një ballë të prerë, apo dikë me ballë të prerë”, por dikë që është shumë i shqetësuar apo i tronditur nga diçka.

Siç u tha dhe më sipër, gjymtyrët e kompozitave me lidhje nënrenditëse përcaktojnë njëra-tjetrën. Në disa raste gjymtyra e parë përcakton të dytën duke treguar dhe objektin e veprimit të saj, siç ndodh me fjalët: *zëvendësministër, mirëmbaj, libralidhës, flakëhedhëse*, ku gjymtyrët e para përcaktojnë të dytat, pasi fjala *zëvendës* tregon personin që zëvendëson apo ndihmon në detyrë ministrin, fjala *mirë* tregon mënyrën si kryhet veprimi i shprehur nga folja “mbaj”, ndërsa fjalët *libra* dhe *flakë* tregojnë se çfarë lidh personi apo çfarë hedh arma. Mund të jetë edhe gjymtyra e dytë ajo që përcakton gjymtyrën e parë si në rastet e fjalëve *fatbardhë, ditëlindje, mesditë, vendbanim* etj. Në këto formime janë gjymtyrët e dyta ato që duke i përcaktuar të parat bëjnë dhe dallimin e tyre nga fjalët e temave fjalëformuese të gjymtyrëve të para. Kështu në fjalën *ditëlindje* bëhet fjalë jo për një ditë të çfarëdoshme, por për *ditën e lindjes*, apo në fjalën *vendbanim* nënkuptohet jo një vend çfarëdo por *vendi ku banon dikush*.

Në fjalët e përbëra njëra nga temat motivuese, tema mbështetëse, mbart kuptimet gramatikore të gjithë kompozitës duke e formësuar gramatikusht atë. E tillë paraqitet rëndom tema e dytë, ndërsa tema tjetër ose temat e tjera, në rastet kur ka më shumë se dy tema motivuese, është ose janë të neutralizuara gramatikusht, nuk mbartin kuptime gramatikore. Por në disa fjalë të përbëra me lidhje nënrenditëse, shprehëse e kategorive gramatikore të fjalës së përbërë nuk është tema e dytë por e para, e cila është dhe gjymtyra e përcaktuar duke bërë që këto formime të mbeten struktura gjysmë të hapura dhe të shkruhen me vizë në mes. Kjo ndodh në fjalët e tipit *vinç-urë, kalë-fuqi, vit-dritë, shtëpi-muze, peshk-sharrë* etj., të cilat janë kompozita emërore dhe gjymtyrët e tyre janë në lidhje përcaktore-ndajshimorë me njëra-tjetrën. Gjatë përdorimit në fjali në rasta të ndryshme, apo kur formojnë numrin shumë, ndryshon vetëm gjymtyra e parë.

peshk-shpatë, peshku-shpatë, peshq-shpatë, peshqit-shpatë

Ndryshimi vetëm i gjymtyrës së parë i dallon këto fjalë të përbëra nga togfjalëshat e ngjashme me to, si p.sh nga togfjalëshi “gjuhë motër” i cili shumësin e bën “gjuhë motra”.

Por jo të gjitha kompozitat e këtij tipi kanë si shprehëse të kategorive gramatikore gjymtyrën e parë. Në formimet *qen-ujk, grup-moshe* etj. kategoritë gramatikore shprehen përmes gjymtyrës së dytë:

vinç-kullë, vinç-kulla, vinç-kullat, vinç-kullave

Përcaktimi se cila gjymtyrë është shprehëse e kategorive gramatikore të këtyre kompozitave, varet nga lloji i bashkimit. Në rastet e bashkimit të një emri dhe një mbiemri (qytet-muze, vit-dritë), shprehëse është gjymtyra e parë. Në rastet e bashkimit të dy emrave, shprehëse është gjymtyra e dytë (grup-armatë, shpim-kërkim)

Ndonëse në Fjalorin e shqipes së sotme, botim i vitit 2002, figurojnë vetëm 15 kompozita të tilla:

ditë-punë, grup-armatë, grup-moshë, kalë-fuqi, kilovat-orë, peshk-sharrë, peshk-shpatë, qen-ujk, qytet-muze, shtëpi-muze, shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, vinç-urë, vinç-kullë dhe vit-dritë,

ato përbëjnë një tip prodhimtar e aktiv veçanërisht në gjuhën e shkruar dhe në terminologjinë tekniko-shkencore ku veç të përmendurave më lart gjejmë edhe kompozitat: *ditë-njeri, dhomë-muze, dyqan-shtëpi, gram-molekulë, grup-kulturë, grup-mallra, hotel-pension, orë-makinë, orë-normë, orw-njeri, organizatë-bazë, plan-detyrë, qytet-hero, sëpatë-daltë, shpim-vlerësim, ton-kilometër, vagon-cisternë etj.*

Kompozitat përcaktore janë kryesisht emra dhe mbiemra e më pak folje e ndajfolje. Në formimin e tyre marrin pjesë tema fjalëformuese të ndryshme. Duke u nisur nga ndërtimi, sipas vlerës leksiko-gramatikore të gjymtyrëve të tyre, fjalët e përbëra ndahen në disa grupe, ku dallohen veçanërisht fjalët e përbëra formuar nga dy tema emërore, nga një temë emërore dhe një temë mbiemërore, nga një temë emërore dhe një ndajfoljore si dhe anasjelltas, e shumë tipa të tjerë që trajtohen më gjerësisht dhe hollësisht në kreun VI. Më poshtë vetëm disa shembuj nga tipat më prodhimtarë:

emër + emër

ajërftohës, ajërmatës, armëndreqës, armëpushim, artikullshkrues, atdhe, bakërmbajtës, botëkuptim, dëmshpërblim, dhëmbërruazë, erëprirës, ëndërrshpjegues, kallimbledhës, këmbëdrapër, luleshitës, mjekërcjap, mustaqegjemb, orëndreqës, pijeshitës, pikëpamje, rrobalarës, syshqiponjë, sqepgjilpërë, truprojë, ujësjellës, vargmal, vendburim, zemërgur etj.

emër + mbiemër

barkgjerë, bishtartë, derëbardhë, ditëzi, dorëçelur, dorëhollë, dritëshkurtër, eshtëtrashë, fjalëëmbël, faqethatë, farëkuq, fatbardhë, fatzi, gojëlig, grykëngushtë, guakëhollë, gjakftohtë, gjumëlehtë, hallemadh, hundëmprehtë, kokëmadh, kokëngjeshur, lëkurëzi, nazemadh, ogurzi, punëshpejtë, qafëgjatë, qimekuq, valëshpejtë, veshgjatë, yjendezur, zemërlig, zëmëbl etj.

ndajfolje + emër

drejtpeshim, drejtqëndrim, drejtshkrim, drejtshqiptim, drejtvendosje; keqbërës, keqinterpretim, keqkuptim, keqpërdorim; mirëadministrim, mirëbesim, mirëbërës, mirëkuptim, mirëmbajtje, mirënjohje, mirënjohës, mirëqënie; mbarështues, mbarëvajtje etj.

numëror/përemër i pacaktuar
+
mbiemër

njëbazik, njëboshtor, njëbuzor, njëfazor, njëditor, njëmujsor, njëvjeçar, dyballor, dyflatrorë, dyfletësh, dykrenor, dyvjeçar, treqindvjeçar, disavjeçar, disaditor, disamujsor, shumëbërthamor, shumëfazor, shumëshekullor, shumëqelizor etj.


Siç vihet re edhe nga shembujt e mësipërm në krijimin e kompozitave përcaktore marrin pjesë zakonisht dy tema prodhuese, ndërsa në rastë të tilla si *sy-e-vetullzezë*, në të vërtetë dy të parat janë të bashkërenditura me njëra-tjetrën dhe të nënrenditura ndaj temës së tretë. Por këto janë më tepër raste krijimesh letrare dhe njihen si kompozita pa takim. Këto tipa si dhe lidhjet kuptimore të gjymtyrëve të secilit prej tyre, shqyrtohen më hollësisht në kreun VI.

II.2.3. Sindajshtesat dhe gjymtyrët e kompozitave

Kompozimi dhe prejardhja ose ndajshtesimi¹⁶⁶, njihen si dy mënyrat më prodhimtare të gjuhës shqipe, duke formuar vargje të tëra fjalësh të reja. Por ky fakt nuk përben lidhjen e vetme mes këtyre dy mënyrave fjalëformuese, ato janë më pranë njëra-tjetrës nga ç' mund të mendohet. Lidhje të ngushta ka kompozimi veçanërisht me parashtesimin, një nëntip ky që paraqet një rëndësi të veçantë për prejardhjen. Këto lidhje kanë të bëjnë jo vetëm me mënyrën si formojnë ato fjalë të reja, pasi të dyja mënyrat fjalëformuese krijojnë fjalë të reja nëpërmjet bashkimit, (ndajshtesimi nëpërmjet bashkimit të ndajshtesave fjalëformuese me tema fjalësh, ndërsa kompozimi nëpërmjet bashkimit të temave prodhuese, sipas modeleve ekzistuese të gjuhës, duke bërë që të dyja të jenë akte krijimi), por edhe me elementët që ato përdorin për këtë qëllim. Dihet tashmë se mjaft parashtesa e kanë burimin te pjesë të ndryshme të ligjeratës, veçanërisht te parafjalët, si parashtesa “*për*” apo parashtesat “*mbi*”, “*nën*”, “*para*” apo “*pa*”, “*mos*” e të tjera, të cilat

¹⁶⁶ Prejardhje ose ndryshe ndajshtesim, pasi nëpërmjet saj formohen fjalë të reja me anë të ndajshtesave.

i gjejmë edhe si njësi të lira në gjuhë, duke ushtruar funksionin e tyre si parafjalë, ndajfolje apo pjesëza.




(Fjalori i shqipes së sotme, 2002)

Dihet se kur kalojnë në formante fjalëformuese, këto njësi të veçanta të gjuhës, i humbasin të gjitha veçoritë e tyre si pjesë ligjrate dhe fitojnë një kuptim të përgjithshëm e abstrakt, që është kuptimi fjalëformues. Kuptimin e tyre gramatikor e humbasin edhe fjalët që bashkohen me këto ndajshitesa, pasi ato marrin pjesë vetëm si tema motivuese. Bashkimi i tyre me elementët e çsemantizuar formon një fjalë të re, me një kuptim të ri gramatikor e semantik.

Por edhe ato fjalë që marrin pjesë në formimin e fjalës së përbërë, zhvishen nga veçoritë dhe tiparet e tyre gramatikore duke marrë pjesë vetëm si tema motivuese në procesin e bashkimit të tyre, ndërkohë që jashtë këtij bashkimi apo lidhjeje ato janë të pavarura dhe sillen si pjesë ligjrate të mëvetësishme. Pra në të dyja këto mënyra fjalëformimi fjala hyn në veprim si temë prodhuese, duke u afruar kështu me mjetet fjalëformuese, siç ka ndodhur me parashtesat e përmendura më lart. Kjo bën që dhe kufijtë mes dy mënyrave të fjalëformimit në mjaft raste të mos jenë fort të qarta duke formuar “zona të ndërmjetme, me një lëvizje të vazhdueshme nga temat e fjalëve të përbëra në drejtim të ndajshitesave”¹⁶⁷. Pra, gjuhëtarët kanë vërejtur te disa kompozita se gjymtyrët e tyre

¹⁶⁷ E. Hysa, Sindajshitesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, në: *Studime filologjike* 2, 1986, f. 92

funksionalisht dhe kuptimisht po marrin tipare të një ndajshtese e po sillen si të tilla duke krijuar raste kalimtare.



Kjo afri vërehet më tepër në ndërtimet:

emër + temë emërore / temë mbiemërore

kryeagronom, kryeartikull, kryebandit, kryebari, kryecung, kryedasmor, kryefamiljar, kryefjalë, kryegjahtar, kryegeolog, kryehajdut, kryeinfermier, kryeinxhinier, kryellogaritar, kryemësues, kryeministër etj.; gjysmëbosht, gjysmëburrë, gjysmëdrejtëz, gjysmëfinale, gjysmëfushë, gjysmëgjallë, gjysmëhënë, gjysmëhije, gjysmëkafshë, gjysmëkodrinor, gjysmëkoloni, gjysmëlëmsh, gjysmëmalor, gjysmëmbrojtës, gjysmëmbrojtje, gjysmëmugëtirë, gjysmënatë, gjysmëndenjur, gjysmëndihmës, gjysmësulmues, gjysmëshekull, gjysmështizë, gjysmështirë, gjysmëvdekur, gjysmëzanore, gjysmëzejtari, gjysmëzyrtar etj.;

ndajfolje + temë emërore / foljore dhe më rrallë ndajfolje + temë mbiemërore:

bashkanëtar, bashkatdhetar, bashkautor, bashkekzistencë, bashkëbisedim, bashkëjetesë, bashkëluftëtar, bashkëmarrëdhënie, bashkësundimtar, bashkëshoqërues, bashkëshort, bashkështetas, bashkëtingëllore, bashkëtrashëgimtar, bashkëpunim, bashkëqenie, bashkëqytetar, bashkëreferat, bashkërendues, bashkëvajtje, bashkëvarësi, bashkëveprim, bashkëveprues; bashkëjetoj, bashkekzistoj, bashkëbanoj, bashkëbisedoj, bashkëluftoj, bashkëpunoj, bashkësundoj, bashkëudhëtoj; bashkëkohor, bashkëmoshatar, bashkëqendror etj.

përemër + temë emërore / foljore:

vetëbesim, vetëdemaskim, vetëdënim, vetëdigjet, vetëdije, vetëdrejtoj, vetëflijim, vetëgjykim, vetëjetoj, vetëkënaqem, vetëkuptohet, vetëkurdiset, vetëlavdërim, vetëmbyllet, vetëmjekim, vetëmohim, vetëndikim, vetëndizet, vetëngrohet, vetëpërbuzje, vetëpërmbajtje, vetëpërtëritje, vetëpllenim, vetëposhtërim, vetëqeveris, vetëquaj, vetëriprodhim, vetësiguri, vetësugjestionim, vetëshërbim, vetëshfajësim, vetëshkarkim, vetëshkrues, vetëshlyerje, vetëshuhet, vetëvendos, vetëveproj, vetëvlerësim, vetëvrasës, vetëvrasje, vetëzhvillim etj.;

si dhe në rastet e formimeve të një emri dhe një emri tjetër prejfoljor që tregon një veprues:

bucelabërës, çelësabërës, fshësabërës, fuçibërës, gjellëbërës, kapelebërës, këpucëbërës, opingabërës, qiribërës, qymyrbërës; argjendpunues, bakërpunues, çibukpunues, djathëpunues, duhanpunues, fuçipunues, gëzofpunues, hekurpunues, karrocapunues, leshpunues, lëkurëpunues, mermerpunues, qeleshepunues, teneqepunues, jorganpunues, samarpunues etj.

Siç mund të vihet re edhe nga shembujt, këto elemente kanë karakter prodhimtar, pasi marrin pjesë në formimin e një numri të madh kompozitash. Në “Fjalorin e shqipes së sotme”, botim i vitit 2002, numërohen rreth 50 fjalë të përbëra që kanë si gjymtyrë të parë fjalën “gjysmë”, 90 fjalë me gjymtyrë të parë ndajfojen “bashkë”¹⁶⁸, rreth 80 me gjymtyrë të parë fjalën “krye” dhe gati 100 kompozita me gjymtyrë të parë fjalën “vetë” (ndërkohë që fjalët e formuara “bërës” dhe “punues” janë shumë më të pakta, të dyja bashkë numërohen të jenë rreth 35). Është pikërisht ky karakter prodhimtar i tyre si dhe mundësia që krijojnë ato për formime të tjera, që e bën kuptimin e këtyre elementeve deri diku të ngjashëm me kuptimin e përgjithshëm e abstrakt të ndajshitesave duke i afruar veçanërisht për nga funksioni me to, ndaj dhe Hysa¹⁶⁹ propozon termin “sindajshitesë”, term i cili i përshtatet më së miri kësaj kategorie elementesh dhe ka zënë vend në terminologjinë gjuhësore të shqipes. Sindajshitesat mbeten elemente me kuptim leksikor të mëvetësishëm, pavarësisht se ky kuptim mund të ketë marrë nuancë përgjithësuese apo abstrakte, ai identifikohet lehtë brenda fjalës së përbërë. Pra, sindajshitesat sillen edhe si morfema rrënjore, gjë kjo e pamundur për ndajshitesat, pasi procesi i çsemantizimit të to është kryer i plotë duke bërë që ta humbasin mëvetësinë kuptimore dhe të bashkohen në tipa fjalësh të caktuar. Këto karakteristika mungojnë te sindajshitesat, ndaj dhe ato kanë lidhje më të forta me përbërjen, pasi vetëm karakteri prodhues që ato kanë dhe rregullsia e përdorimit në fjalë të përbëra nuk mjaftojnë për t’i klasifikuar si ndajshitesa të mirëfillta. Kur në gjuhë ekzistojnë forma paralele apo sinonime për të njëjtën fjalë, nga të cilat njëra është formim ndajshitesor, ndërsa tjetra është fjalë e përbërë, shprehet edhe më qartë afërsia funksionalokuptimore e sindajshitesave me ndajshitesat si p.sh. format:

¹⁶⁸ Ndajfolja “bashkë”, për arsye të përdorimit të gjerë në formim fjalësh të reja në seri, në gramatikën e vitit 1995 trajtohet si siparshitesë madje ajo shihet shumë pranë kufirit mes përbërjes dhe parashtesimit. Ndërsa Hysa në punimin e tij “Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe” verën se kur kemi bashkim të ndajfoljes “bashkë” me një folje kemi të bëjmë me fjalë të përbëra, ndërsa rastet e tjera shqyrtohen si formime me parashtesë. Këtë vlerë kanë për Hysën edhe formimet me “para-“, “pas-“ dhe “kundër-“. Por për Fjalorin e shqipes së sotme, botim i vitit 2002, “bashkë” vazhdon të jetë gjymtyra e parë e fjalëve të përbëra sikurse dhe “kundër” e “para”. Gjuhëtarët e Akademisë së Shkencave në gramatikën e vitit 1995 pranojnë që në pjesën më të madhe të rasteve këto dy të fundit kanë kaluar në parashtesa, duke theksuar edhe një herë sa e vështirë është të vendosësh një kufi të prerë mes mënyrave të fjalëformimit, veçanërisht parashtesimit dhe kompozimit e përngjitjes (f.63)

¹⁶⁹ E. Hysa, Sindajshitesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, në: *Studime filologjike* 2, 1986, f.91-99. Ky është termi propozuar nga Hysa në këtë punim, i cili më parë në punimin “Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe” përdor dhe termat “gjysmëparashtesë” e “pseudoprefiks”, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975, f. 58-81

nëndrejtor	dhe	zëvendësdrejtor,
nënkryetar	dhe	zëvendëskryetar,
këpucar	dhe	këpucëbërës,
argjendar	dhe	argjendpunues,
bakërchi	dhe	bakërpunues etj.,

Në rolin e sindajshesave paraqiten tema fjalëformuese të gjuhës shqipe si dhe tema prodhuese me burim nga gjuhë të tjera, më konkretisht nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja të cilat janë gjymtyrë të kompozitave ndërkombëtare¹⁷⁰. Ato përdoren bashkë me një temë tjetër, edhe kjo në një pjesë të mirë të rasteve e huaj, e cila nuk gjen përdorim si fjalë më vete:

aero-: *areodinamik, areodinamikë, aerodrom, aeronautikë, aeroplan, aeroport, aerostat* etj.

auto-: *autoambulancë, autobiografi, autoblindë, autobot, autobus, autodidakt, autogol, autograf, autoinspektoriat, autokinema, autokolonë, autokombajnë, autokritik, automjet, autoofiçinë, autopark, autoportret, autotransport* etj.

bio-: *biofiltër, biofizikë, biograf, biografi, biogjenezë, biokatalizator, biokimi, biolog, biologji, biorrymë, biosferë* etj.

foto-: *fotoaparatur, fotoamator, fotoekspozitë, fotoelement, fotograf, fotografi, fotgravurë, fotokimi, fotokopjo, fotokronikë, fotometër, fotomontazh, fotopllakat, fotoreportazh, fotoreporter, fotosintezë, fotostudio, fototelegraf, fototelegram, fototerapi* etj.

gjeo-: *gjeobotanikë, gjeofizikë, gjeograf, gjeografi, gjeolog, gjeologji, gjeometër, gjeometri, gjeokimi, gjeomagnetik, gjeometër, gjeopolitikë, gjeotektonik* etj.

hidro-: *hidrocentral, hidroenergjitik, hidrografi, hidrokarbur, hidroksid, hidrometeorologjik, hidropplan, hidrosferë, hidroteknik* etj.

kilo-: *kilogram, kilolitër, kilometër, kilovat*

makro-: *makrobotë, makroklimë, makrosistem, makrotoponimi* etj.

mikro-: *mikrobiolog, mikrobiologji, mikroborgjez, mikrobotë, mikrobus, mikroelement, mikrofilm, mikroflorë, mikrofon, mikroklimë, mikroorganizëm* etj.

pseudo-: *pseudodemokrat, pseudoshkrimtar, pseudoasnjanës, pseudoatdhetar, pseudoshkencor* etj.

radio-: *radioaktiv, radiodhënës, radiofonik, radiografi, radiogram, radiogramafon, radiolog, radiologji, radiolokacion, radiomarrës, radiondërlidhës, radiondërlidhje, radiopërhapje, radioskopi, radiostacion, radioteknikë, radiotelevizion, radiovalë* etj.

termo-: *termobërthamor, termocentral, termodinamikë, thermometer, termorregullator* etj.

-fil: *gjermanofil, shqiptarofil* etj.

-graf: *autograf, fotograf, gjeograf, leksikograf, sizmograf* etj.

-log: *biolog, gjeolog, radiolog, psikolog* etj.

¹⁷⁰ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë 1995, f.74

Për Hysën¹⁷¹ disa prej tyre nuk kanë të njëjtën denduri përdorimi në shqipe. Një pjesë e kanë ruajtur kuptimin e tyre ndërsa të tjera e kanë dobësuar atë, ndaj dhe disa prej tyre i sheh si ndajshitesa si p.sh. *auto-*, *geo-*, *pseudo-*, *-graf*, *-fil* apo *-log*, ndërkohë që për “*Fjalorin e shqipes së sotme*” ato vazhdojnë të kenë vlerën e gjymtyrëve përbërëse të kompozitës, me përjashtim të *-graf* e *-log*, për të cilat në fjalor nuk mbahet ndonjë qëndrim.

Ne mendojme se elemente të tilla, me burim në latinishte dhe greqishte e vjetër nuk mund të klasifikohen si ndajshitesa, pasi një ndajshitesë nuk mund të bashkohet me një ndajshitesë tjetër për të formuar një fjalë, ndërkohë që raste bashkimesh të këtyre temave ka plot, si p.sh. *bibliograf*, *geolog*, *biolog* etj.

Gjithashtu veç elementeve të përmendura më lart, si raste që kanë prirje të kalojnë nga gjymtyrë të një fjale të përbërë në parashtesë ndërmjet një formanti dhe një gjymtyrë të parë të një fjale të përbërë, ai shqyrton edhe temat motivuese:

drejt-: *drejtboshtor*, *drejtflatrorë*, *drejtkëndësh*, *drejtpeshoj*, *drejtpeshim*, *drejtqëndrim*, *drejtreshtoj*, *drejtshkrim*, *drejtshqiptim*, *drejtvendos*, *drejtvizor* etj.

gjithë-: i *gjithanshëm*, *gjithëfuqi*, *gjithëkombëtar*, i *gjithëpushtetshëm*, etj.

jashtë-: *jashtëbuxhetor*, *jashtëfisnor*, *jashtëgjinor*, *jashtëgjyqësor*, *jashtëkohor*, *jashtëligjor*, *jashtëligjshëm*, *jashtëmartesor*, *jashtëparlamentar*, *jashtëqendror*, *jashtëqit*, *jashtëshkollor*, *jashtëshkruaj*, *jashtëtokësor*, *jashtëzakonisht* etj.

mes(o)-: *mesditë*, *mesdhe*, *mesfushë*, *meshollë*, *mesjetë*, *meskëputur*, *mesnatë*, *mesoburrë*, *mesogrua*, *mesunazë* etj.

ndihmës-: *ndihmëslogaritar*, *ndihmësmjek*, *ndihmësmjeshtër* etj.

zëvendës-: *zëvendësdrejtor*, *zëvendëskomandant*, *zëvendëskryetar*, *zëvendësministër* etj.

plot-: *plotfuqi*, i *plotfuqishëm*, *plotpjesëtoj*, *plotpjesëtues*, i *plotpjesëtueshëm* etj.

sipër-: *sipërfaqe*, *sipërmarrje*, i *sipërpërmendur*, *sipërshtënuar*, *sipërvendosje* etj.

shumë-: *shumëbazik*, *shumëbërthamor*, i *shumëdashur*, i *shumëdëshiruar*, *shumëfazor*, i *shumëkuptimshëm*, i *shumënderuar*, *shumëpritur*, *shumëqelizor*, *shumëshekullor*, *shumëvalent*, *shumëvjeçar*, i *shumëvuajtur* etj.

veç të tjerash nisur dhe nga fakti se ato kanë krijuar “*formime modelore brenda tipit fjalëformues të përbërjes*”¹⁷², duke theksuar se zbehja e deridikushme e kuptimit të tyre semantik nuk është te të gjitha në të njëjtën masë. Më larg sindajshitesave për Hysën janë *zëvendës-*, *ndihmës-*, *-punues* dhe *-bërës*.

Nga ky grup gjymtyrësh të para të fjalëve të përbëra mund të themi se jo të gjitha kanë të njëjtën vlerë dhe të njëjtin përdorim në rolin e sindajshitesave. Ndryshime ka dhe sa i takon vargjeve fjalëformuese, pasi disa formojnë vargje më të gjata e të tjera vargje me më pak fjalë. Duke qenë se ato vijnë nga pjesë ligjrate të ndryshme, duke e ruajtur disa më shumë e disa më pak kuptimin e fjalës burimore, por pa arritur të çsemantizohen plotësisht, siç ka ndodhur me parashtesat, mendojmë se asnjëra prej tyre nuk është kthyer ende në një ndajshitesë të mirëfilltë, siç ka ndodhur me “*fish*”, “*kundër*” apo “*para*”, duke mbetur kështu ende të lidhura me kompozitat, edhe pse këto lidhje janë në dobësim e sipër. Për këtë arsye në këtë punim ato do të shqyrtohen dhe analizohen si kompozita.

Lidhur me elementin “*-fish*” i bashkohemi qëndrimit të gjuhëtarëve të Akademisë së Shkencave, të cilët në punimin “*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, si në botimin e vitit 1995

¹⁷¹ E. Hysa, po aty, f. 96

¹⁷² E. Hysa, po aty, f. 97

ashtu edhe në atë të vitit 2002, f. 74, e shohin të mbyllur procesin e kalimit të kësaj sindajshtesë në prapashtesë, dhe kjo jo vetëm për arsye të vargut fjalëformues të këtij elementi, apo për çsemantizimin e tij dhe vlerës së re kuptimore të përfutur, por edhe për faktin se ka pësuar ndryshim fonetik *fill* → *fish* (rrjedhorja shumë e pashquar). Edhe sa i takon parashtesës “kundër”, fjalë e cila nga ndajfolje ka kaluar në parafjalë, për t’iu nënshtruar më pas procesit të parashtesimit, mendojmë se është i qartë funksioni i saj si parashtesë, për të cilin veç të tjerash flet edhe fakti së krahas formave me këtë parashtesë ekzistojnë dhe format paralele të formuara me parashtesën e huaj *anti-*: *antiajror* – *kundërajror*, *antifetar* – *kundërfetar* etj. Disi më pak i qartë duket të jetë çështja për elementin “*para*”, për të cilin brenda gramatikës së lartpërmendur duket të ketë qëndrime të ndryshme. Ky element pranohet të ketë kaluar në parashtesë kur merr pjesë në formimin e emrave e mbiemrave, ndërsa sa i takon foljeve ndeshim në një qëndrim të dyfishtë. Në faqen nr. 353 foljet e formuara me këtë element dhe disa të tjera pranohen si folje të prejardhura, ndërsa dy faqe më tej elementi “*para*” shihet si sindajshtesë dhe foljet e formuara me të analizohen si folje të formuara me ndajfoljen “*para*”. Për ne elementi “*para*” ka fituar tashmë tiparët e një parashtesë, pasi jo vetëm është shumë prodhimtare duke formuar 134 fjalë të listuara në Fjalorin e shipes së sotme: 60 emra, 43 mbiemra, 27 folje dhe 3 ndajfolje¹⁷³, por ajo duke iu paravendosur temave fjalëformuese emërore: *parabimë*, *paradhomë*, *parakusht* etj., foljore: *parapëlqej*, *parashtroj*, *parakaloj*¹⁷⁴ etj. e mbiemërore: *parahistorik*, *parakombëtar* etj. ka humbur deri diku mevetësinë kuptimore, dhe duke fituar aftësinë modifikuese ndajshitesore, arrin të modifikojë kuptimin e temave fjalëformuese me të cilat bashkohet. Si parashtesa ndajfoljore vlejnë edhe “*prapa*”, “*sipër*” e “*pas*”, kjo edhe për faktin se shqipja e njeh procesin e kalimit nga parafjalë në parashtesë, pasi kështu ka ndodhur edhe me “*mbi*” apo “*nën*”. Ndërsa për elementin “*bashkë*” dhe “*vetë*” mendojmë se procesi i ndajshitesimit nuk është ende i përfundur, pasi këto fjalë vazhdojnë të njihen si morfema rrënjore që ruajnë lidhjet e tyre kuptimore me përgjegjëset e tyre: ndajfoljen “*bashkë*” dhe përemrin “*vetë*”, nga të cilët kanë dalë. Ndërkohë duhet thënë që për Fjalorin e shqipes së sotme këto element vazhdojnë të jenë gjymtyrët e para të fjalëve të përbëra, përfshirë këtu edhe “*kundër*”.

Pra mund të themi se disa nga këta elemente janë shumë më pranë sindajshtesave, ndërsa disa të tjera pak më larg. Kështu duke u nisur edhe nga prodhimtaria e lartë dhe numri relativisht i madh i kompozitave me gjymtyrë të parë këto fjalë, të njëvlerëshme me sindajshtesat *krye-*, *bashkë-*, *gjysmë-* e *vetë-* shohim edhe sindajshtën *shumë-*, e cila paraqitet si gjymtyrë e parë e 56 fjalëve të përbëra në “*Fjalorin e shqipes së sotme*”, shumica e të cilave janë mbiemra e më pak emra.

¹⁷³ Sa i takon ndajfoljeve, në këtë punim formimi i disa ndajfoljeve me element të parë morfemën për-, para- e pas- do të shqyrtohen si formime me përngjitje, shiko në nënçështjen përkatëse.

¹⁷⁴ Çsemantizimin e elementit “para” e shohim edhe në rastet kur ai është bashkuar me një temë foljore për të formuar folje, të cilat në disa raste nuk kanë më kuptimin e elementëve përbërës. Kështu *parakuptoj* nuk do të thotë “kuptoj përpara”, por “nënkuptoj”, *parapëlqej* nuk mbarë kuptimin “pëlqej përpara”, por “diçka e pelqej më shumë se të tjerat”, apo *parakaloj*, e cila nuk ka vetëm kuptimin “kaloj para”.

Hysa¹⁷⁵ sheh një lëvizje nga kompozimi drejt parashtesimit edhe te disa numërorë si *dy-*, *dhjetë-*, *gjashtë-*, *katër-*, *nëntë-*, *një-* e *shtatë-*, por duke theksuar se ato mbeten goxha pranë burimit të tyre. Dhe pavarësisht vargjeve fjalëformuese që ato kanë formuar, mendojmë se edhe pse janë duke iu afruar zonës së sindjashtesave, procesi i kalimit të tyre në sindjashtesa do të kërkojë kohë, për vetë faktin se burimi i tyre është klasa e numërorëve dhe do të jetë e vështirë që ato t'i dobësojnë lidhjet kuptimore dhe gjenetike me rrënjët përgjegjëse.

Ashtu si *-punues* dhe *-bërës* mendojmë se duhet të shihet edhe *-dashës*, që e gjejmë në fjalë të tilla si: *arsimdashës*, *atdhedashës*, *liridashës*, *mirëdashës* etj. Lidhur me fjalët e këtij tipi vihen re qëndrime të ndryshme brenda punimit “Gramatika e gjuhës shqipe”. Nga njëra anë në të nuk pranohet ekzistenca e fjalës *dashës*, si fjalë e mëvetësishme, të cilën në fakt nuk e njeh as “*Fjalori i shqipes së sotme*” botim i vitit 2002, duke i klasifikuar fjalët e tipit *liridashës* dhe *paqedashës*, jo si kompozita të mirëfillta, por si fjalë të formuara nga bashkëveprimi i kompozimit dhe prapashtesimit¹⁷⁶. Por kur shqyrtohet fjalëformimi i mbiemrave, pikërisht ai i mbiemrave të përbërë, mbiemri “*keqdashës*”, klasifikohet krahas mbiemrave *largpamës*, *largvajtës* e *mirëbërës* si kompozitë e formuar nga një ndajfolje dhe një emër vepruesi¹⁷⁷. Të njëjtin qëndrim mban edhe Dhrimo në punimin e tij “*Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*” duke renditur edhe ai mbiemrin “*keqdashës*” në tipin e kompozitave mbiemërore formuar nga një temë ndajfoljore dhe një emër vepruesi¹⁷⁸.

Xhuvani në punimin e tij “*Kompozitat*”¹⁷⁹, vëren se tipi i kompozitave me gjymtyrë të dytë një emër vepruesi ka nisur që në periudhën e Rilindjes, duke njohur Kristoforidhin si hartuesin e parë të këtij tipi kompozitash, pasuar më pas edhe nga Naimi e Rilindas të tjerë, të cilët në vargun e neologjizmave formuan edhe kompozita si *liridashës*, *paqedashës* e *njëridashës*.

Edhe Demiraj¹⁸⁰ i njeh si mbiemra të përbërë të formuar nga bashkimi i një emri dhe një emri foljor këto mbiemra, duke i rreshtuar krahas mbiemrave të tjerë si: *mishngrënës*, *gjakpirës* e *vëllavrasës*.

Sot në Fjalorin e shqipes së sotme numërohen pesëmbëdhjetë kompozita të tilla:

mbiemrat: *acidedashës*, *kulturëdashës*, *paqedashës*, *punëdashës*;

si dhe mbiemrat që përdoren edhe si emra: *arsimdashës*, *artdashës*, *atdhedashës*, *dijedashës*, *hijedashës*, *keqdashës*, *lavdidashës*, *liridashës* *mirëdashës*, *njeridashës* dhe *sportdashës*.

Nga ky grup mbiemrash vetëm dy kanë si gjymtyrë të parë një ndajfolje, ndërsa pjesa tjetër ka si të tillë një emër.

¹⁷⁵ E. Hysa, Sindjashtesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, në: *Studime filologjike* 2 / 1986, f. 95

¹⁷⁶ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f. 79

¹⁷⁷ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f. 200

¹⁷⁸ A. Dhrimo, Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II*, Tiranë, 1975, f. 184

¹⁷⁹ A. Xhuvani, Kompozitat, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I*, Tiranë, 1972, f. 70.

¹⁸⁰ Sh. Demiraj, Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e I, Morfologjia, Tiranë, 1962, f. 89

Nga sa u tha më lart nuk ka asnjë dyshim se “*dashës*” ka fituar të gjitha tiparet e një emri vepruesi. Mendojmë se fjalët e formuara me të nga ana semantike e mundësojnë interpretimin e tyre si kompozita. Në rastin e tyre kemi të bëjmë me kompozita përcaktore, komponenti i parë i të cilave përcakton komponentin e dytë, pikërisht emrin e vepruesit, emrin “*dashës*”.

Duke qenë se elementi –*dashes*, që del në fjalë të përbëra si gjymtyrë e tyre, lejon me lehtësi formimin e fjalëve të reja duke formuar dhe zgjeruar vargun fjalëformuese, po fiton vlera kuptimore më përgjithësuese, mendojmë se është duke u afruar me grupin e sindajshtesave, edhe pse në fjalor nuk gjejmë një formë me kuptim të afërt që të përdoret si fjalë e lirë, mendojmë se ajo është formuar ashtu sikurse janë formuar edhe emrat e tjerë veprues si *dhënës* apo *bërës*, me burim pjesoren e foljes nga vijnë.

Folje		Pjesore		Emër prejpjesor
jap	→	dhënë	→	dhënës
bëj	→	bërë	→	bërës
dua	→	dashë	→	dashës

Çështja e sindajshtesimit nuk ka kaluar pa rënë në sy edhe të gramatikave pak më të vjetra. Cipo¹⁸¹ në punimin e tij “Gramatika shqipe” teksa shqyrton strukturën dhe formimin e fjalëve, dallon në grupin e parashtesave dhe dy nëngrupe të veçanta të cilat i quan parafjalë si parashtesa, ku përfshin “*mbi*”, “*para*” dhe “*prapa*”; dhe fjalë si parashtesa, ku liston fjalët “*mirë*”, “*sipër*”, “*pjesë*” dhe “*tri*” me shembujt përkatës: *mirëbesim*, *sipërmarrje*, *pjesëmarrje*, *trikëndësh* etj., si dhe nëntë fjalë të huaja mes të cilëve dhe “*auto*”, “*hemi*”, “*poli*”, “*mono*”, “*filo*”, “*gjeo*” e “*termo*”, shoqëruar edhe këto me shembujt përkatës: *autobiografi*, *hemisferë*, *poliglot*, *filoshqiptar*, *kronometër*, *gjeometër*, *termometër* etj.

Formimet e shqyrtuara në këtë çështje, të cilat në përbërjen e tyre kanë një sindajshtesë mendojmë se duhet të klasifikohen si kompozita. Edhe pse ato kanë tendenca drejt shndërrimit në ndajshtesa, për aq kohë sa ky proces nuk është mbyllur, dhe për qa kohë sa nuk ekziston një mënyrë fjalëformi që të qëndrojë mes kompozimit dhe ndajshtesimit formime të tilla mbeten kompozita.

II.2.4. Kompozim dhe prapashtesim

Në grupin e fjalëve të përbëra duhen dalluar kompozitat e mirëfillta nga disa fjalë të përbëra të cilat nuk janë thjesht krijime fjalësh nga bashkimi i dy apo më shumë temave prodhuese, por janë formuar me kompozim dhe ndjashtesim, më konkretisht prapashtesim, njëkohësisht duke përbërë dhe një mënyrë të veçantë të fjalëformimi të

¹⁸¹ K. Cipo, Gramatika shqipe, Tiranë, 1949, f. 40

shqipes, e cila në kreun e parë është renditur si një nga nëntipat e mënyrave të përziera. Këto formime nuk janë të shumta dhe vendin kryesor mes tyre e zënë emrat, të cilët formohen nga kompozimi i një togfjalëshi frazeologjik foljor duke iu shtuar njëkohësisht edhe një prapashtesë, e cila mund të jetë sipas rasteve ose prapashtesa *-ës* ose prapashtesa *-je*, në analogji me formime të tjera të këtij grupi. Zakonisht formimi këtyre emrave shoqërohet me zhvendosje të emrit fjalëformues të togut frazeologjik para foljes së tij, e cila përbën dhe gjymtyrën e dytë të fjalës së përbërë dhe merr njëkohësisht edhe prapashtesën.

lokucion foljor

+

prapashtesë

Kështu janë formuar emrat:

<i>pjesëmarrës</i>	nga togfjalëshi <i>marr pjesë</i>	dhe	prapashtesa <i>-ës</i> ,
<i>kryengritës</i>	nga togfjalëshi <i>ngre krye</i>	dhe	prapashtesa <i>-ës</i> po
ashtu dhe			
<i>kryengritje</i>	nga togfjalëshi <i>ngre krye</i>	dhe	prapashtesa <i>-je</i>
<i>marrëveshje</i>	nga togfjalëshi <i>marrë vesh</i>	dhe	prapashtesa <i>-je</i>
<i>frymëmarrje</i>	nga togfjalëshi <i>marr frymë</i>	dhe	prapashtesën <i>-je</i>
<i>dorëheqje</i>	nga togfjalëshi <i>heq dorë</i>	dhe	prapashtesa <i>-je</i> po
ashtu dhe			
<i>dorëheqës</i>	nga togfjalëshi <i>heq dorë</i>	dhe	prapashtesa <i>-ës</i>

Gjithashtu sipas kësaj mënyre formohen edhe:

breshkujse, frymëmarrës, frymënxjerrës, frymëqitje, frymëthithës, frymëthithje, kungullujës, kokëçarje, bashkëkohës etj.

si dhe një grup ndajfoljesh në formimin e të cilave marrin pjesë prapashtesat karakteristike të ndajfoljeve *-as, -azi* dhe *-thi*:

brezahypthi, bythëpraptazi, bythëprapthi, hapagjatas, hapaqorras, hapashalas, hapashalthi, këmbadoras, kokëngulthi, kryengulthi, kukafshehtas, kukafshehthi, pulaqorrthi, rrokapjekthi. symbyllas, symbyllazi, symbyllthi, topahipas, topagropthi.

Këto fjalë duhen dalluar mirë nga fjalët e përbëra që kanë si gjymtyrë të dytë një fjalë të prejardhur, si dhe nga fjalët e prejardhura të formuara nga tema e një fjalë të përbërë si në rastet:

gurëskalitës formuar nga *gur (ë) + skalitës*

Gjymtyra e dytë e kësaj kompozite është një emër prejfoljor, i formuar konkretisht nga folja *skalit* dhe prapashtesa *-ës*. Kjo prapashtesë u shtohet temave foljore për të formuar

emra prejfoljorë, që shënojnë një veprues sipas veprimit që kryen, shprehur përmes kësaj folje. Si temë foljore shërben pjesorja e foljes. Kështu janë formuar emrat *shitës* (shes), *nxënës* (nxë), *mbledhës* (mbledh), *shkelës* (shkel), *ngrënës* (ha) etj. Ndërsa emrat prejfoljor të tipit *dëgjues* (dëgjoj – dëgjue) janë formuar nga trajta e pjesores së dialektit verior të foljes dhe e njëjta prapashtesë, së cilës i ka rënë zanorja ë: *mësues*, *shikues*, *hetues*, *shkrues* etj. Duke qenë se kjo prapashtesë e ka formuar tashmë modelin e saj e duke qenë se ajo “është bërë shumë prodhimtare në gjuhën letrare dhe përdoret gjithnjë e më shumë për të formuar emra të rinj”¹⁸², mendojmë se në shumë raste ato kryejnë funksionin e një gjymtyre të dytë të një kompozite emërore ose mbiemërore edhe pse mund të mos gjenden si emra të pasqyruar në fjalor. Këtu kemi parasysht ato formime në bazë të të cilave nuk qëndron një shprehje frazeologjike. Kështu edhe fjala “*zindjellës*” duhet klasifikuar si një kompozitë e mirëfilltë, pasi është krijuar mbi bazën e togfjalëshit me përdorim figurativ *ndjell zi*, apo “*gjetherënës*” me kuptimin *që i bien gjethet*. Mendojmë se shqipja është një gjuhë e hapur ndaj formimeve të këtij lloji.

Dallim duhet bërë edhe dhe në raste të tilla si:

<i>kryeqytetas</i>	formuar nga	<i>kryeqytet + as</i>
<i>këmbëçalthi</i>	formuar nga	<i>këmbëçal + thi</i>

Në gramatikën e gjuhës shqipe, hartuar nga gjuhëtarët e Akademisë së Shkencave, siç u shqyrtua dhe analizua në nënçështjen e mësipërme, ka një qëndrim të dyfishtë lidhur me fjalë të tipit “keqdashës”, të citat trajtohen edhe si fjalë të formuara me kompozim dhe prapashtesim edhe si kompozita të mirëfillta me komponent të dytë një emër prejfoljor vepruesi. Në mbështesim qëndrimin e dytë, duke e njohur elementin “*dashës*” si një emër të mirëfilltë, ndaj trajtimi i këtij tipi fjalësh në këtë çështje mendojmë se është i pavend.

Në rastet e tipit *brezahypthi* e *marrëveshje*, dallimi si fjalë të formuara me kompozim dhe prapashtesim është disi më i lehtë, për vetë faktin se shqipja nuk ka fjalë si “*brezahyp*” apo “*veshje*”, kjo e fundit si formim nga emri *vesh*. Ato janë formuar si të tilla brenda kompozitës dhe jashtë saj nuk ekzistojnë. Disi më problematike paraqiten rastet e tipit *kryengritës* dhe *pjesëmarrës*, të cilat kanë nevojë për më tepër analizë. *Kryengritës* është “*dikush që ngre krye*” dhe jo “*ngritës i kryes*”, *pjesëmarrës* është “*dikush që merr pjesë*” dhe jo “*marrësi i pjesës*”. Në formime të tilla vepron një shembullim i dyfishtë. Si model herë merret e gjithë kompozita, herë një pjesë e saj, praktikisht pjesa e dytë e saj.

Edhe pse formime të tilla fjalësh, nëpërmjet bashkimit të gjymtyrëve të një togfjalëshi dhe pjesëmarrjes së një prapashtese nuk janë prodhimtare dhe aktive në gjuhën shqipe, gjë për të cilën flet dhe fakti se ato nuk i kalojnë të dyzetat duke përbërë dhe brenda grupit të fjalëve të përbëra një përqindje të vogël, ato kanë rëndësi pasi janë shprehëse të shumëllojshmërisë së mënyrave fjalëformuese të shqipes.

¹⁸² Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002, f. 134

II.2.5. Kompozitat si tema fjalëformuese

Shqipja është një gjuhë e pasur me mënyra fjalëformuese, një pjesë e mirë e të cilave është shumë prodhimtare dhe aktive si në rastin e kompozimit dhe prejardhjes. Karakteristikë e gjuhës shqipe nuk është vetëm larmishmëria e mënyrave fjalëformuese dhe bashkëveprimi i tyre në pasurimin e leksikut me formime të reja fjalësh. Shqipja zotëron edhe një fond të pasur mjetesh fjalëformuese, i cili nuk përfshin vetëm një numër të madh ndajshtesash fjalëformuese, por edhe një gamë të gjerë temash prodhuese të cilat lidhen në kombinime të ndryshme me njëra-tjetrën dhe me ndajshtesa të ndryshme. Si tema fjalëformuese në shqipe marrin pjesë të gjitha pjesët e ligjeratës, mes të cilëve dallojnë për pjesëmarrje më të madhe emrat, mbiemrat, foljet dhe ndajfoljet: *përpunoj*, *mosbesim*, *guximtar*, *luftoj*, *barkas* etj.; *aftësi*, *zbukuroj*, *kokëmadh*, *urtësisht* etj.; *brendashkruaj*, *frymëmarrje*, *përmbledhës* etj.; *bashkërendit*, *bashkëkohor*, *largpamës* etj. Temat fjalëformuese mund të jenë fjalë të thjeshta apo edhe të prejardhura, formuar me një ose edhe me më shumë ndajshtesa sipas mënyrave të ndryshme të fjalëformimit.

Në gjuhën shqipe aftësinë për të marrë ndajshtesa, më konkretisht prapashtesa, nuk e kanë vetëm temat e parme apo të prejardhura. Prapashtesa marrin edhe një kategori e caktuar fjalësh të përbëra të cilat në një rast të tillë dalin në funksionin e temave fjalëformuese.

Pjesa më e madhe e fjalëve të prejardhura formuar nga një temë fjalëformuese e përbërë dhe një prapashtesë janë emra. Vetëm në “*Fjalorin e shqipes së sotme*”, botim i vitit 2002 numërohen gati dyzetë emra të tillë, ndërkohë që numri është edhe më i madh nëse do t’u referohemi edhe rasteve të krijimeve të ndryshme në fushën e letrave apo asaj popullore, të cilat nuk janë pjesë e fjalorit të cituar më sipër. Ja çfarë gjejmë në Fjalorin e shqipes:

besëkotësi, dritëgjatësi, dritëlargësi, dritëshkurtësi, dorëgjerësi, dorëhapësi, gjakbutësi, gjakftohtësi, gjaknxehësi, fatkeqësi, fatbardhësi, fatmirësi, jetëgjatësi, kokëfortësi, kokëtrashësi, kryelartësi, kryenecësi, mendjelehtësi, mendjemadhësi, mendjemprehtësi, mendjetrashësi, symprehtësi, shpirtbardhësi, shpirtbutësi, shpirtgjerësi, shpirtligësi, shpirtmadhësi, shpirtmirësi, shpirtngushtësi, shpirtvogëlsi, zemërbardhësi, zemërbutësi, zemërdhembshuri, zemërgjerësi, zemërligësi, zemërmadhësi, zemërmirësi, zemërngushtësi, zemërvogëlsi

Siç mund të vërehet edhe nga shembujt e mësipërm si tema fjalëformuese të këtyre emrave shërbejnë mbiemrat: *besëkotë, dorëgjerë, dritëgjatë, dritëlargët, dritëshkurtër, dorëhapët, fatkeq, fatbardhë, fatmirë, gjakbutë, gjakftohtë, gjaknxehë, jetëgjatë, kokëfortë, kokëtrashë, kryelartë, kryenec, mendjelehtë, mendjemadh, mendjemprehtë, mendjetrashë, symprehtë, shpirtbardhë, shpirtbutë, shpirtgjerë, shpirtlig, shpirtmadh, shpirtmirë, shpirtngushtë, shpirtvogël, zemërbardhë, zemërbutë, zemërdhembshur, zemërgjerë, zemërlig, zemërmadh, zemërmirë, zemërngushtë, zemërvogël*, të cilët janë mbiemra ekzocentrik apo pronësorë, ose siç njihen ndryshe dhe me termin e sanskrishtes *bahhuvrihi*. Ndërsa si ndajshtesë në këto raste gjejmë prapashtesën –*si*. Këto formime jo vetëm pasurojnë leksikun dhe gjuhën e shqipes me fjalë të reja, por zgjerojnë edhe më tej grupin e fjalëve të formuara me prapashtesim.

Emrat e formuar nga tema mbiemrash të përbërë janë emra abstraktë që shprehin cilësi, dhe kjo gjë lidhet si me temën fjalëformuese, ashtu edhe me ndajshitesën fjalëformuese, e cila është një prapashtesë që bashkohet kryesisht me tema fjalëformuese mbiemërore cilësore për të formuar “emra femërorë që tregojnë një veçori ose cilësi abstrakte”¹⁸³ si p.sh.:

i bardhë → bardhësi, i ftohtë → ftohtësi, i ligë → ligësi, poshtër → poshtërsi, i urtë → urtësi etj.

Vihet re se komponenti i dytë i kompozitave emërore është pikërisht një mbiemër cilësor i tipit të mësipërm. Mbiemri *i gjatë* duke u bashkuar me prapashtesën *-si*, formon emrin *gjatësi*. Gjithashtu edhe mbiemri i përbërë *dritëgjatë* për të formuar një emër abstrakt që shpreh të pasurit e një cilësie të tillë, emrin “*dritëgjatësi*”, bashkohet me të njëjtën prapashtesë sikurse dhe komponenti i dytë i tij kur sillet si fjalë e mëvetësishme.

Edhe temat mbiemërore të thjeshta me të cilat bashkohet prapashtesa, janë kryesisht mbiemra cilësorë, ata emërtojnë veçori e cilësi. Po kështu ndodh edhe me mbiemrat pronësorë. Edhe ato janë mbimera cilësore, por ndryshe nga mbiemrat e thjeshtë cilësorë, të cilët tiparin e sendit e shënojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, mbiemrat pronësorë e shënojnë këtë tipar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, kjo edhe për faktin se kemi të bëjmë me fjalë, të cilat dhe nocionin shprehin e shënojnë në mënyrë të përbërë e në formë të zgjeruar. Gjithashtu këta mbiemra përcaktojnë një emër duke cilësuar një pjesë që zotëron personi apo sendi i cilësuar nga ky mbiemër.

Kështu *mendjemprehtë* buron nga togfjalëshi *mendje e mprehtë* dhe cilëson dikë që e ka mendjen e tillë, dikë që i kap dhe i kupton gjërat shumë shpjet. Ndërsa emri *mendjemprehtësi* shpreh të qenurit i tillë, të pasurit e një mendje të mprehtë si një cilësi më vete, dhe jo që i vishet dikujt.

“Mbiemrat e tipit *bahuvrihi* përfaqësojnë një nga tipat më të pasur dhe më produktivë të fjalëve të përbëra në gjuhën shqipe. Formimi dhe përdorimi i tyre kanë ardhur duke u gjallëruar si në gjuhën e folur është edhe në gjuhën e shkruar”¹⁸⁴, shprehet me të drejtë Kostallari.

Duke analizuar këtë tip mbiemrash dhe sjelljen e tyre si tema fjalëformuese, Kostallari¹⁸⁵ njeh si faktor kryesor që përlligj këtë lloj sjelljeje vjetërsinë dhe produktivitetin e madh të këtyre mbiemrave ekzocentrikë. Por mundësia fjalëformuese e tyre ka natyrisht edhe kufizime. Arsyet e këtij kufizimi ai i sheh në tri drejtime. Së pari i referohet strukturës dhe karakterit leksiko-gramatikor të gjymtyrëve të mbiemrit të përbërë. Siç mund të vihet re edhe nga shembujt e dhënë, emra abstraktë formojnë mbiemrat pronësorë të formuar nga një emër dhe një mbiemër (*zemërgjerë* → *zemërgjerësi*), ndërkohë që mbiemrat e formuar nga dy emra, edhe pse mbiemra pronësor nuk mund të formojnë një emër tjetër pasi, emri i dytë i tyre është një emër konkret që shpreh lëndë, dhe natyra e gjuhës shqipe nuk e lejon që ky tip emrash të formojë vetëm me anë të prapashtesave një emër abstrakt cilësor. Kështu nga mbiemrat *zemërgur*, *shpirtkazëm*, *gojëspec*, *gjuhëshpatë*, *gjuhënëpërkë* etj. nuk mund të formohen emra abstraktë që të shprehin cilësi.


¹⁸³ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f. 139

¹⁸⁴ A. Kostallari, Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972, f. 99

¹⁸⁵ A. Kostallari, po aty

Një tjetër arsye që e kufizon formimin e emrave abstraktë edhe brenda mbiemrave të përbërë formuar nga një emër dhe një mbiemër, sipas Kostallarit është edhe natyra semantike e këtyre mbiemrave të përbërë. Kështu mbiemrat e përbërë me gjymtyrë të dytë një mbiemër, që tregon cilësi fizike e trupore: *buzëhollë, buzëtrashë, hundëmadh, qimekuq, mustaqezi* etj.; cilësi që lidhet me pamjen e jashtme: *futëzezë, kësulëkuq, shamibardhë, shamizezë* etj. e mbiemrat që cilësojnë jofrymorë: *cipëplasar, lëkurtrashë, fletëgjerë, fjiëhollë* etj., nuk mund të formojnë emra abstraktë cilësie. Duket se një pjesë e mirë e këtyre emrave formohen nga disa mbiemra të tillë që cilësojnë veti të karakterit apo botës shpirtërore e mendore të njeriut, por jo nga të gjithë. Sipas Kostallari rol të rëndësishëm luajnë edhe veçoritë stilistikore të këtyre mbiemrave, nga të cilët prirjen për t'u bashkuar me prapashtesa duke formuar emra abstraktë e kanë ato mbiemra ekzocentrikë që kanë hyrë në leksikon e zakonshëm, ndërsa ata me ngjyime të veçanta stilistikore e kanë të vështirë të formojnë një fjalë të re e cila do të bëjë pjesë në një shtresë tjetër stilistikore, siç është rasti i emrave *zemërgjerësi* dhe *gjakftohtësi*, ndërkohë që mbiemrat *zemërkëllirë* apo *derëzi* nuk e lejojnë këtë mundësi.

Interesant është qëndrimi i Xhuvanit sa i takon sjelljes së këtyre mbiemrave si tema fjalëformuese. Në punimin e tij “Kompozitat” Xhuvani nuk pranon formimin e emrave abstrakt nga ky tip mbiemrash të përbërë, duke u shprehur se “*gjuha nuk e qas formimin*”¹⁸⁶. Edhe formimin e emrit *besëtytni* nga mbiemri *besëtytë* ai e sheh si një formim në kundërshtim me rregullat e shqipes. Por më pas, në punimin e tij “*Për pastërtinë e gjuhës shqipe*”¹⁸⁷ gjejmë fjalë të tilla si: *fatkeqësi, fatbardhësi, shpirtulësi* deri dhe *shpirtrobëri*¹⁸⁸, të cilat jo vetëm i pranon, por nxit dhe përdorimin e tyre në gjuhë. Pra mund të themi se formime të tilla bëhen sipas skemës:



Është e qartë se nga mbiemra të përbërë të tipit cilësor formohen emra të rinj, ashtu sikurse është e qartë se kjo prodhimtari nuk është e përmasave të mëdha, ndaj dhe me të drejtë Kostallari i quan “*tema fjalëformuese me prirje produktive, por me produktivitet të kufizuar*”¹⁸⁹.

¹⁸⁶ A. Xhuvani, Kompozitat, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I*, Tiranë, 1972, f. 72

¹⁸⁷ A. Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956

¹⁸⁸ Këtë fjalë nuk e përmban as “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*”, botim i vitit 1980 dhe as “*Fjalori i gjuhës shqipe*”, Tiranë 2002.

¹⁸⁹ A. Kostallari, po aty, f. 122

Më pak prodhimtare në formimin e emrave nga tema fjalësh të përbëra paraqitet prapashtesa *-i*, nëpërmjet së cilës janë formuar emrat:

<i>rrobaqepësi</i>	nga kompozita emërore	<i>rrobaqepës,</i>
<i>bamirësi</i>	nga kompozita emërore	<i>bamirës,</i>
<i>dashamirësi</i>	nga kompozita emërore	<i>dashamirës,</i>
<i>dorëzani</i>	nga kompozita emërore	<i>dorëzanë,</i>
<i>skllavopronari</i>	nga kompozita emërore	<i>skllavopronar,</i>
<i>mirëbërësi</i>	nga kompozita emërore	<i>mirëbërës,</i>
<i>zemërdhembshuri</i>	nga kompozita mbiemërore	<i>zemërdhembshur.</i>

Edhe pse në pak raste, emra dhe mbiemra nga tema fjalëformuese të përbëra formohen edhe me anë të prapshitesave *-as* apo *-(t)ar*. Nëpërmjet tyre formohen emra që tregojnë banorin e një vendi apo prejardhjen e tij si dhe mbiemra që tregojnë marrëdhënie përkatësore të sendit të karakterizuar ndaj një sendi tjetër, si në rastet:

kryeqytet	+	<i>as</i>	=	kryeqytetas
bregdet	+	<i>as</i>	=	bregdetas
bregdet	+	<i>ar</i>	=	bregdetar
mëmëdhe	+	<i>tar</i>	=	mëmëdhetar

Këto kompozita, kur shërbejnë si tema motivuese pranojnë prapashtesa që u përshtaten përbërësve të tyre. Kështu në të gjitha rastet e lartpërmendura, komponentët e dytë të temës së përbërë motivuese, kur përdoren si pjesë të mëvetësishme të ligjeratës mund të bashkohen me prapashtesat përkatëse për të formuar fjalë të reja të prejardhura: qytet + as = qytetas; det + as = detas; det + ar = detar; dhe + tar = dhetar¹⁹⁰

Nga tema motivuese të përbëra gjejmë të formuara edhe pjesë të tjera ligjerate, pa përbërë ndonjë tip fjalëformues aktiv apo prodhimtar, si në rastin e shqyrtuar më lart.

Nga tema motivuese të përbëra është formuar edhe ndonjë ndajfolje si në rastet:

<i>këmbëngultas</i>	nga folja <i>këmbëngul</i>	dhe prapashtesa <i>-as</i>
<i>fytafytas</i>	nga ndajfolja <i>fytafyt</i>	dhe prapashtesa <i>-as</i>
<i>këmbëçalthi</i>	nga mbiemri <i>këmbëçalë</i>	dhe prapashtesa <i>-thi</i>
<i>guraçokthi</i>	nga emri <i>guraçok</i>	dhe prapashtesa <i>-thi</i>

Edhe këto kompozita pranojnë prapashtesa që u përshtaten komponentëve të tyre.

Gjithashtu nga një temë fjalëformuese e përbërë, nga ndajfolja *fytaftas* është formuar edhe folja *fytafytem*.

¹⁹⁰ Në Fjalorin e shqipes së sotme, botim i vitit 2002, në faqen 283, “*dhetar*” paraqitet si fjalë me kuptimin “anas, rrënjës; e kundërta e ardhës”. Ndërsa “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*”, botim i vitit 1980, nuk e përmban këtë fjalë si leksemë të veçantë, gjë që na bën më mendojmë se duhet të jetë një hyrje e re në fjalorin e shqipes.


II.2.6. Kompozita të veçanta

Një rast të veçantë fjalësh të përbëra përbëjnë emrat dhe mbiemrat e tipit:

njëdegësh, njëdirekësh, njëmbëdhjetëmetërsh, njëmbëdhjetërrokësh, njëqindgradësh, dydirekësh, dyfaqësh, dyfazësh, dyvegjësh, dyvendësh, trekëmbësh, tremuajsh, trepalësh, katërgrykësh, pesëkatësh, pesëkëndësh, pesëminutësh, gjashtëmuajsh, gjashtërrokësh, gjashtëvargësh, gjashtorësh, shtatëballësh, tetërrokësh, tetorësh, dhjetëvjetësh, shumëdegësh, shumëfaqësh, shumëmilionësh, shumëngjyrësh, shumëpalësh, shumëvëllimësh, shumëzërësh, disakatësh etj.

Këto fjalë e kanë burimin e tyre në përngjitjen e togëfjalëshit numëror apo përemër i pacaktuar dhe emër, i cili përfundon gjithnjë me elementin *-sh*, duke përbërë një tjetër rast të kalimit nga përngjitja në kompozim dhe më pas për analogji¹⁹¹ janë formuar në mënyrë të drejtpërdrejtë sipas këtij modeli shumë fjalë të tjera.

Elementi *-sh* e ka burimin në mbaresën e rrjedhore së shumësit të pashquar.



Bashkimi i gjymtyrëve të këtij tipi togfjalëshi (numëror apo përemër i pacaktuar dhe emër në dhanoren e pashquar të shumësit) në një fjalë të vetme u shoqërua me shndërrim e morfemës trajtëformuese *-sh*, e cila e humbi kuptimin e mëparshëm rasor, në morfemë fjalëformuese, duke mundësuar në këtë mënyrë kalimin nga përngjitja në kompozim të këtij tipi fjalëformimi.¹⁹²

Për fitimin e vlerës prapashtesore të kësaj morfeme flet edhe fakti se emrat që e formojnë shumësin me *-a* dhe *-e* e shndërrojnë atë në *-ë* kur marrin pjesë në këto

¹⁹¹ A. Dhrimo, Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975, f. 186

¹⁹² A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I*, Tiranë, 1972, f. 83

formime, si dhe fakti që ato mund të marrin nga pas prapashtesë të numrit shumës ose të gjinisë femërore,

ngjyrë	–	ngjyra	→	shumëngjyrësh
vend	–	vende	→	dyvendësh

Elementi –sh nuk mund të luajë me rolin e mbaresës edhe për faktin se ai mund të marrë një prapashtesë, siç është ajo e numrit shumës apo ajo e gjinisë femërore, gjë që mund ta lejojë vetëm një prapashtesë, por e pamundur për një mbaresë si në rastet:

(një) trekëndësh	-	(disa) trekëndësha
pallat shumëkatësh	-	ndërtesë shumëkatëshe

Ky tip kompozitash pranohet se është formuar si përngjitje në rastet e përdorimit të emrave në formën e rrjedhore së shumësit (prej dy fletësh) dhe mandej është abstraguar dhe përdorur edhe para numërorëve të tjerë e përemrave *disa* e *shumë*.

“Në Fjalorin e shqipes së sotme” listohen 124 fjalë të tilla, nga të cilat 30 janë kompozita me gjymtyrë të parë numërorin *dy*, 23 kompozita me gjymtyrë të dytë përemrin e pacaktuar *shumë* duke u ndjekur më pas nga kompozitat me gjymtyrë të dytë numërorin *një*, ku si të tilla numërohen 14 kompozita. Më pas duke formuar një numër më të vogël kompozitash marrin pjesë edhe numërorët *tre*, *katër*, *pesë*, *gjashtë*, *shtatë*, *tetë*, *njëmbëdhjetë*, *dymbëdhjetë*, *pesëmbëdhjetë*, *gjashtëmbëdhjetë*, *pesëdhjetë*, *njëqind* dhe *njëmijë*. Gjithashtu vihet re se në këtë fjalor nuk pasqyrohet asnjë kompozitë e tillë me gjymtyrë të parë përemrin e pacaktuar *disa*. Vlerësojmë se numri i këtij tipi kompozitash është shumë më i madh, dhe pasurohet me kompozita rastësore pasi është formuar tashmë modeli.

II.2.7. Kompozita pa takim

Brenda kategorisë së kompozitave ndeshet dhe një tip i veçantë kompozitash të cilat janë quajtur kompozita pa takim. Ky tip kompozitash është karakteristik për gjuhën e shkruar veçanërisht atë të specialitetit dhe gjuhën letrare.

Kompozitat pa takim krijohen nga bashkimi i dy apo më shumë fjalëve të përbëra me njëra-tjetrën, bashkim i cili ndodh në kushte të caktuara dhe jo për çdo lloj kompozite. Që dy fjalë të përbëra të bashkohen me njëra me tjetrën, duhet që gjymtyrën e dytë ta kenë të përbashkët dhe të jenë të bashkërenditura ndëmjete tyre.

Këto kompozita kanë lindur me qëllim shkurtimin e shprehjes, duke e vendosur gjymtyrën e përbashkë vetëm një herë, pikërisht në kompozitën e dytë apo të fundit (në rastet kur kemi më shumë se dy kompozita që bashkohen), ndërsa në kompozitën e parë ajo zëvendësohet me një vizë.

ndërtesa *pesëkatëshe* dhe *gjashtëkatëshe* → ndërtesa *pesë-* dhe *gjashtëkatëshe*
 kaminonë *tretonësh*, *pesëtonësh* dhe *shtatëtonësh* → kaminonë *tre-*, *pesë-* dhe *shtatëtonësh*

moshat *tridhjetëvjeçare*, *dyzetvjeçare* dhe *pesëdhjetëvjeçare* → moshtat *tridhjetë-*, *dyzet-* dhe *pesëdhjetëvjeçare*

(Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973/125)

Në Fjalorin e shqipes së sotme nuk e gjejmë të pasqyruar këtë tip kompozitash, ndoshta dhe për faktin se kompozitat pa takim janë krijime të gjuhës së shkruar lindur për arsye shkurtimi në të shprehur.

II.2.8. Shkurtesat

Shkurtesat përbëjnë një lloj të veçantë kompozimi. Duke u nisur dhe nga vetë emri, ky tip fjalësh të përbëra përfshin ato fjalë, të cilat formohen nga bashkimi i dy ose më shumë temave të shkurtuara. Pra, këto kompozita janë bashkimet e shkurtimeve të fjalëve dhe dallojnë nga kompozimi i zakonshëm për dy arsye:

së pari kompozimi vepron vetëm në fushën e emrave, pra shkurtimeve janë vetëm emra; së dyti fjalë të tilla mund të formohen edhe nga bashkimi i disa temave motivuese, jo vetëm i dy temave të tilla siç ndodh rëndom me kompozitat e tjera të zakonshme, duke bërë që këto kompozita edhe pse janë të tipit përcaktor të jenë më shumë se dygjymtyrëshe.

Shkurtesat kanë hyrë në shqipe nga ndikimi i modeleve të huaja dhe janë përhapur kryesisht pas Çlirimit.¹⁹³ Shkurtesat janë zakonisht shkurtimeve e emërtimeve të shprehura me togfjalësh të institucioneve, ndërmarrjeve, partive politike, organizatave si dhe të disa shteteve.

Në gjuhën shqipe dallohen dy tipa kompozitash formuar nga shkurtimi i temave:

1. shkurtesat rrokjesore
2. shkurtesat nistore

Shkurtesat rrokjesore formohen nga bashkimi i rrokjeve të para të fjalëve përbërëse të togfjalëshit që emërton institucionin apo organizatën. Kompozimi i shkurtesave rrokjesore nuk është prodhimtar në gjuhën shqipe. Shkurtesa të tilla janë p.sh.:

<i>mapo</i>	→	magazina popullor
<i>agjitprop</i>	→	agjitacion dhe propogandë
<i>Profarma</i>	→	prodhime farmaceutike
<i>GESTAPO</i>	→	“Geheime Staatspolizei”
<i>INTERPOL</i>	→	“International Police”
<i>BENELUX</i>	→	“Belgique – Nederland – Luxemborg” (Bashkimi doganor i Belgjikës, Hollandës dhe Luksemburgut) etj.

¹⁹³ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f. 151

Por pjesa dërrmuese e shkurtesave formohen duke bashkuar shkronjat ose tingujt e parë apo nistorë të fjalëve, ndaj dhe grupi i dytë i fjalëve të shkurtuara është quajtur “shkurtesat nistore”. Brenda këtij grupi dallohen tri tipa:

Tipi *nistor-shkronjor*, si p.sh.

<i>SMT</i>	→	Stacioni i m akinave dhe i t raktorëve
<i>ATSH</i>	→	Agjencia T elegrafike S hqiptare
<i>AQSH</i>	→	Arkivi Q ëndror i S htetit
<i>FBS</i>	→	F ederata B otërore e S indikatave
<i>ILP</i>	→	Instituti i L artë P edagogjik
<i>BSHSH</i>	→	B anka e S htetit S hqiptar
<i>KS</i>	→	K lubi sportiv
<i>TPE</i>	→	T regu i P ërbashkët E uropian
<i>NTU</i>	→	Ndërmarrja t regtare u shqimore
<i>DPA</i>	→	“ D eutsche P resse A gentur” (Agjencia Gjermane e Shtypit)
<i>OSSH</i>	→	O peratori i S istemit të S hpërndarjes etj.

Në këtë tip gjejmë shkurtesat e formuara nga bashkimi i shkronjave nistore të fjalëve të një emërtimi të përbërë, të cilat theksohen në rrokjen e fundit dhe shqiptohen ashtu si shqiptohen shkronjat e alfabetit p.sh. *SMT* – SëMëTë apo *ATSH* - ATëShë etj. Këto shkurtesa janë të gjinisë femërore: *OKB-ja* (Organizata e Kombeve të Bashkuara), *BE-ja* (Bashkimi Europian) etj.

Tipi i dytë përbëhet nga *shkurtesat tingullore*, të cilat formohen nga bashkimi i tingujve nistorë të fjalëve të një emërtimi të përbërë, si p.sh.:

<i>TEC</i>	→	T ermoelektrocentral
<i>DEBATIK</i>	→	D jemtë e B ashkuar A nëtarë të I deve K omuniste
<i>FUD</i>	→	F orcat u shtarako- d etare
<i>NATO</i>	→	“ N orth A tlantic T reaty O rganization” (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
<i>MENA</i>	→	“ M iddle E ast N ews A gency” (Agjencia e Lajmeve e Lindjes së Mesme)
<i>TIR</i>	→	“ T ransports I nternationals R outiers” (Transporti Ndërkombëtar Rrugor)
<i>KEMP</i>	→	K omisioni i e kspertimit m jekësor të p unës
<i>KESH</i>	→	K orporata E lektroenergjitike S hqiptare, etj.

Këto shkurtesa kur mbarojnë me bashkëtingëllore janë mashkullorë si p.sh.: *KON-i* (Komiteti Olimpik Ndërkombëtar), *TEC-i*, *KEMP-i* etj., ndërsa kur mbarojnë me zanore janë të gjinisë femërore si p.sh.: *NATO-ja*, *UNESKO-ja* (UNESCO = “United Nations Educational Scientific and Cultural Organization” – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën) etj.

Ka dhe disa shkurtesa të cilat përbëjnë një përzierje të dy tipeve të lartpërmendura duke përbërë tipin e përzier, i cili është dhe tipi i tretë, *tipi shkronjor-tingullor ose tingullor-shkronjor*, si p.sh.:

<i>FSHAÇ</i>	→	Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe e Çiklizmit
<i>NTUS</i>	→	Ndërmarrja tregtare e ushqimit social
<i>NTAN</i>	→	Ndërmarrja tregtare e artikujve të ndryshëm
<i>NSHAFES</i>	→	Ndërmarrja shtetërore e artikujve farmaceutike e sanitare, etj.

Mënyra se si shqiptohen këto fjalë të shkurtuara përcaktojnë dhe gjininë e tyre. Kështu, nëse fundi i shkurtesës shqiptohet sipas tipit shkronjor emri është i gjinisë femërore, p.sh. *NISHPF-ja* (shqiptohet: nish-pë-fë = Ndërmarrja industriale shtetërore e prodhimeve farmaceutike), por në qoftë se fundi i shkurtesës shqiptohet sipas tipit tingullor, atëherë emri është i gjinisë mashkullore si p.sh. *NTLUS-i* (shqiptohet në-të-lus = Ndërmarrja tregtare lokale e artikujve ushqimorë), *NKEM-i* (shqiptohet në-kë-em = Ndërmarrja komunale elektromekanike) etj.

Emërtimet e përbëra të shkurtuara ose shkurtesat e gjuhës shqipe, janë të gjitha emra dhe si të tillë janë fjalë të lakueshme. Në bazë të rregullave të drejtshkrimit këto fjalë shkruhen me gërmë të madhe dhe pa pikë në mes apo në fund të tyre¹⁹⁴.

Në “*Fjalorin e shqipes së sotme*”, botim i vitit 1984, në fund të tij, gjejmë të bashkangjitur shtojcën e shkurtimeve dhe shkurtesave shqipe dhe të huaja, ku krahas shkurtesave më shumë të përdorura të periudhës së pas Çlirimit, gjenden edhe shkurtesat e përdorura më parë, si p.sh. *KONARE* → Komiteti Nacional Revolucionar (1925 – 1927), apo ato të vjetëruara që nuk përdoren më, si p.sh. *KK* → Kooperativa e konsumit. Në këtë shtojcë janë listuar 243 emërtime të përbëra të shkurtuara, nga të cilat vetëm 22 janë shkurtesa rrokjesor, ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë shkurtesat nistore. Megjithatë duhet thënë se kjo pasqyrë nuk është më aktuale, pasi shumë prej shkurtesave nuk përdoren më ditët e sotme, ndërkohë që të tjera shkurtesa janë krijuar, si p.sh. emërtimet e përbëra të shkurtuara të partive politike, ministrive, organizatave dhe institucioneve të reja krijuar pas viteve '90, si p.sh. :

<i>PAD</i>	→	Partia Aleanca Demokratike
<i>PD</i>	→	Partia Demokratike
<i>PS</i>	→	Partia Socialiste
<i>PSD</i>	→	Partia Socialdemokrate
<i>MASH</i>	→	Ministria e arsimit dhe e Shkencës
<i>MPÇSSHB</i>	→	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
<i>METE</i>	→	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
<i>KLD</i>	→	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
<i>AMF</i>	→	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare

¹⁹⁴ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f. 155

etj.

Brenda “Fjalorit të shqipes së sotme”, botim i vitit 2002, gjejmë vetëm një emërtim të përbërë të shkurtuar, SMT me shënimin e një fjale të vjetëruar dhe shpjegimin përkatës bashkë me shembujt.

Gjithashtu në të njëjtin fjalor gjejmë dhe fjalën “DEBATIKAS”¹⁹⁵, nëpërmjet së cilës emërtohet anëtari i organizatës antifashiste të fëmijëve e njohur me shkurtesën DEBATIK. Siç mund të vihet re ky emër, i cili gjen përdorim edhe si mbiemër, është formuar nga shkurtesa “DEBATIK” dhe prapashtesa –as, nëpërmjet së cilës, formohen “emra vetash që tregojnë banorin e një vendi ose prejardhjen e tij nga një vend.”¹⁹⁶ Edhe në rastin konkret, nga bashkimi shkurtesës dhe kësaj prapashtese është formuar një emër, i cili emërton një person duke e lidhur atë me temën fjalëformuese, më konkretisht duke shprehur përkatësinë e tij në këtë organizatë, duke formuar në këtë mënyrë një model fjalëformimi prapashtesor brenda gjuhës shqipe, i cili duket të jetë ndjekur edhe nga raste të tjera të cilat gjejnë përdorim vetëm në ligjërimin e folur siç ndodh me shprehjet “pëdëist” apo “pësëist” të formuara nga bashkimi i shkurtesave nistore PD dhe PS dhe prapashtesës –ist, e cila në gjuhën shqipe është shumë prodhimtare dhe formon “emra që tregojnë veta të karakterizuara sipas mjeshhtërisë që ushtrojnë, ose punës që kryejnë”¹⁹⁷, ndërsa në rastin e bashkimit të saj me shkurtesat nistore emërton persona sipas bindjeve partiake përkatëse.

¹⁹⁵ Fjalor i shqipes së sotme, Toena, Tiranë, 2002, f. 216

¹⁹⁶ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiarnë, 1995, f.134

¹⁹⁷ Po aty, f. 135

KREU III. Kompozimi në gjuhën gjermane

Përbërja ose kompozimi, siç quhet ndryshe, bashkë me prejardhjen apo derivacionin përbëjnë jo vetëm dy mënyrat kryesore dhe më prodhimtare të formimit të fjalëve të reja në gjuhën gjermane, por janë njëkohësisht dhe mënyrat më të vjetra, pasi qysh në gramatikat më të hershme të gjermanishtes së re të lartë (Neuhochdeutsch¹⁹⁸) (Albertus 1573; Ölinger 1573; Clajus 1578), bëhet dallimi mes fjalëve “të thjeshta” dhe atyre “të përbëra” si dhe mes fjalëve “të parme” dhe fjalëve “të prejardhura”.¹⁹⁹

Fjalëformimi si rrjedhje edhe kompozimi, si një nga mënyrat më të rëndësishme të tij, kanë qenë gjithnjë objekt studimi për gjuhëtarët gjermanë. Veçanërisht të rëndësishme në aspektin diakronik, janë punimet e Paul-it, Brugmann-it dhe Henzen-it²⁰⁰, të cilët janë përpjekur veç të tjerash të zbërthejnë dhe të formulojnë ligjet dhe rregullat gjuhësore mbi bazën e të cilave janë formuar fjalët e përbëra të gjuhëve indoevropiane në përgjithësi dhe ato të gjuhës gjermane në veçanti, duke arritur në përfundimin se ato i kanë rrënjët dhe zanafillën e tyre në ndërtime sintaksore të mëparshme që nuk kanë qenë kompozita. Gjithashtu ata njohin edhe krijime të reja, formuar me analogji mbi bazën e modeleve ekzistuese.²⁰¹

Në gjermanishte përdoret termi “*Zusammensetzung*”, i cili sipas Kuhn “*bezeichnet sowohl den Prozeß, als auch das Ergebnis / emërton si procesin ashtu edhe produktin.*”²⁰² Duket se mes gjuhëtarëve të kësaj gjuhe nuk ka diversitet lidhur me përdorimin e teminologjisë sa i takon kësaj mënyrë fjalëformimi, pasi te punimet e tyre (si p.sh. Wellmann, Fleischer, Erben apo Ortner)²⁰³ gjejmë të përdoret si termi “*Zusammensetzung*” ashtu edhe termi “*Komposition*”, i cili e ka prejardhjen nga latinishtja,

Kompozimi zë një vend të veçantë në sistemin fjalëformues të gjuhës gjermane duke përbërë dhe një karakteristikë të veçantë të saj, pasi dihet tashmë se sa “zemërgjerë” dhe

¹⁹⁸ Sipas H. Mettke-s, gjermanishtja ndahet në këto periudha kohore: 750 p.e.s.-1050 e.s. (Althochdeutsch / gjermanishtja e vjetër e lartë); 1050 e.s.-1350 e.s. (Mittelhochdeutsch / gjermanishtja e mesme e lartë); 1350 e.s.- rreth 1650 e.s. (Frühneuhochdeutsch / fillimet e gjermanishtes së re të lartë); nga 1650 e.s. e më pas (Neuhochdeutsch / gjermanishtja e re). H. Mettke, *Mittelhochdeutsche Grammatik*, Halle 1964, f 15

¹⁹⁹ J. Erben, *Einführung in die Wortbildungslehre*, Berlin, 1975, f. 9

²⁰⁰ Një vend me rëndësi zë lindja dhe formimi i kompozitave në “*Prinzipien der Sprachgeschichte*” 1880 dhe “*Deutsche Grammatik*”, Band V, 1920, të Hermann Paul-it, në “*Deutsche Wortbildung*”, 1947, të Walter Henzen-it si dhe “*Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen*”, Band 2, Teil 1, 1892, Brugmann.

²⁰¹ W. Kürschner, *Zur syntaktischen Beschreibung deutscher Nominalkomposita*, Tübingen, 1974, f. 5

²⁰² I. Kuhn, *Lexikologie, Eine Einführung*, Niemeyer, Tübingen, 1994, f. 24

²⁰³ H. Wellmann-i në punimin “*Die Grammatik, Band 4*” të Duden-Verlag, viti i botimit 1998; W. Fleischer-i dhe bashkëpunëtorët e tij I. Barz-i e M. Schröder-i në “*Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*”, ribotim i vitit 2007, L. Ortner-i dhe bashkautorë të tjerë në punimet “*Deutsche Wortbildung; Typen und Tendenzen in der Gegenwartssprache*”, botim i vitit 1991, si dhe “*Zur Theorie und Praxis der Kompositaforschung*”, botim i vitit 1984, por edhe në libra të tjerë mbi leksikologjinë, duke nisur nga Kuhn-i e të tjerë, si dhe në gramatika të autorëve të ndryshëm përdoren po këto dy terma për përbërje dhe fjalët e përbëra.

e hapur tregohet gjermanishtja kundrejt fjalëve të përbëra veçanërisht emrave të përbërë, ku kompozita e famshme *Donaudampfschiffahrtsgesellschaftskapitänswitwenrentenabholstellenvorsteher* është shembulli më tipik e njëkohësisht edhe më i ekzagjeruar, për mundësinë që të krijon kjo gjuhë në formimin e emrave të përbërë. Villiger-i²⁰⁴ madje e sheh aftësinë që ka gjuha gjermane për të bashkuar dy ose dhe më shumë fjalë në një të vetme, si një përparësi me të cilën ajo mund t'u bënte zili gjuhëve të tjera. Por nga ana tjetër ai thekson kujdesin që duhet treguar në formimin e fjalëve të përbëra, në mënyrë që kjo përparësi të mos kthehet në një problem apo pengesë gjuhësore. Miller-i²⁰⁵ e sheh kompozimin, bashkimin e fjalëve të vjetra, si rrugën më të thjeshtë për të formuar fjalë të reja. Ai pranon se një gjë e tillë është e mundur vetëm mbi bazën e një sistemi dhe rregullave të përcaktuara, të cilat nëse respektohen jo vetëm që lejojnë të formohen fjalë të reja edhe nga bashkimi i tri apo dhe më shumë fjalëve të tjera, si në rastet *Versandhauskatalog*, *Herzklappenfehler* apo dhe *Kraftfahrzeugreparaturwerkstatt*²⁰⁶, por edhe që ato të tingëllojnë normalisht duke u bërë pjesë si e zhargonit ashtu edhe e leksikut të gjuhës e duke zënë vend edhe në fjalorët e saj. Kjo gjë dëshmon aftësinë e gjuhës gjermane, e cila nëpërmjet një fjale të vetme, një kompozite, shpreh një fluks informacioni, madje ndonjëherë edhe përmbajtjen e një fjalie të tërë si në rastin e fjalës **Kraftfahrzeugreparaturwerkstatt = Werkstatt, in der Kraftfahrzeuge repariert werden.**²⁰⁷ (oficinë ku riparohen automjete), duke e bërë mjaft kompakt të shprehurin gjuhësor të saj, si dhe duke shprehur me këtë mënyrë edhe karakterin ekonomik të saj.

Përgjithësisht përngjitja dhe kompozimi janë produkte në gjuhë analitike, të cilat si tipar kryesor të lidhjes së fjalëve kanë rendin e ngulitur të fjalëve, siç është p.sh. anglishtja në gjuhët indoevropiane. Duke qenë se morfemat e fleksionit të këto gjuhë mungojnë, rendi i ngulitur mbetet i vetmi mjet për shprehjen e marrëdhënieve semantike. Edhe pse gjuha gjermane ka një sistem optimi më të zhvilluar, shembujt e mësipërm flasin qartë për aftësinë e saj për të formuar kompozita, madje dhe nga disa tema motivuese. Kjo edhe për faktin se edhe gjermanishtja karakterizohet nga një rend i ngulitur fjalësh, si p.sh vendi i gjymtyrës kryesore të togfjalëshit emëror, i cili paraprihet nga gjymtyra përcaktuese (die fremde Sprache). Kështu e shpjegon Erben-i²⁰⁸ ekzistencën e fjalëve të përbëra qysh në tekstet e gjermanishtes së vjetër të lartë (Althochdeutsch). Sipas tij gjatë zhvillimit të gjuhës, raporti mes formimit të grupeve sitaksore dhe fjalëformimit është zhvilluar në të mirë të këtij të fundit, duke i dhënë përparësi formimeve të fjalëve komplekse²⁰⁹. Kjo prirje e gjermanishtes për t'i zëvendësuar grupet sintaksore (Univerbierung) “*durch ein einziges Wort mit komprimierter Bedeutung* / me një fjalë të

²⁰⁴ H. Villiger, *Gutes Deutsch: Grammatik und Stilistik der deutschen Gegenwartssprache*, Hueber Verlag, Stuttgart, 1970, f. 39

²⁰⁵ G.A. Miller, *Wörter: Streifzüge durch die Psycholinguistik*, Heidelberg, 1993, f.137

²⁰⁶ Te treja këto fjalë gjenden në fjalorin gjerman: *Deutsches Universalwörterbuch*, Duden, 2002

²⁰⁷ *Duden-Deutsches Universalwörterbuch A-Z*, 2002

²⁰⁸ J. Erben, *Einführung in die deutsche Wortbildungslehre*, Berlin, 2006, f.140

²⁰⁹ J. Erben, po aty, f. 141

vetme, e cila shpreh kuptimin e gjithë sintagmës, sipas parimit të njëfjalëzimit”, gjendet qysh në fillimet e gjermanishtes së re të lartë (Frühneuhochdeutsch)²¹⁰.

III. 1. Kompozitat dhe llojet e tyre

“*Unter Zusammensetzungen (Komposita) verstehen wir Wörter, die ohne zusätzliche Ableitungsmittel aus zwei oder mehreren selbstständig vorkommenden Wörtern gebildet sind.*”²¹¹ / Me fjalë të përbëra (kompozita) kuptojmë fjalë, të cilat janë formuar pa mjete ndajshesore nga dy ose më shumë fjalë që përdoren edhe më vete. Ky është përkufizimi që i bëjnë autorët e gramatikës DUDEN fjalëve të përbëra.

Ndërsa për Kuhn-in²¹² kompozita është një ndërtim morfemor, gjymtyrët e së cilës mund të gjenden edhe si morfema të lira²¹³, përkufizim me të cilin bashkohet edhe Fleischer²¹⁴.

“*Der Terminus **Komposition** ... bezeichnet Wörter, die durch Zusammenfügung von zwei lexikalischen Elementen zustande kommen. Kompositionen, die aus mehr als zwei Lexemen bestehen, können als Kompositionen aus einem Lexem und einer Komposition (bei mehr als drei Lexemen auch: Kompositionen aus Kompositionen) erklärt werden.* /Termi **kompozitë** emërton fjalë që krijohen nga bashkimi i dy elementeve leksikore. Kompozitat e përbëra nga më shumë se dy leksema mund të shpjegohen si kompozita të përbëra nga një leksemë dhe një kompozitë tjetër (ato me më shumë se tri leksema si bashkime kompozitash)”²¹⁵

Për Jung-un²¹⁶ kompozimi apo përbërja bashkon në një fjalë të re dy a më shumë fjalë ose rrënjë fjalësh, “*Dadurch können Begriffe und Sachverhalte bezeichnet werden, die sonst durch längere syntaktische Fügungen wiedergegeben werden müßten / duke emërtuar rrethana apo koncepte, shprehja e të cilave do të kërkonte formime të gjata*

²¹⁰ P. Polenz, Deutsche Sprachgeschichte vom Spätmittelalter bis zur Gegenwart, Band I, Berlin, 2000, f. 193

²¹¹ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 432

²¹² I. Kuhn, Lexikologie: Eine Einführung, Tübingen 1994, f. 24

²¹³ Në punimin e tyre mbi leksikologjinë: “Lexikologie des Deutschen: Eine Einführung”, botim i vitit 2005, Römer dhe Matzke, i referohen Linke-s në përcaktimin që i bëjnë morfemave, duke i parë si njësitë më të vogla tingullore apo grafike, bartëse të një kuptimi leksikor apo funksioni gramatikor. Ato formojnë gjymtyrët e strukturës së fjalës dhe duke u kombinuar formojnë fjalë dhe fjalëforma të reja. Duke iu referuar Schippan-it, ata bëjnë ndarjen e morfemave sipas katër kriterëve, atij të kuptimit leksikor/funksionit, aftësisë për të qenë i mëvetësishëm, pozicionit dhe aftësisë për t’u riprodhuar apo përsëritur. Duke u bazuar në kriterin e dytë, shkallës së mëvetësisë, bëhet dallimi mes morfemave të lira (freie Morpheme) dhe morfemave të lidhura (gebundene Morpheme). Të parat janë ato morfema që janë në gjendje të formojnë një fjalë pa ndihmën e elementeve shtesë, gjë që është e pamundur për morfemat e lidhura, të cilat duhet të kombinohen gjithnjë me një morfemë bazë (Basismorphem = të cilat janë bartëse të kuptimit leksikor). Por edhe morfemat bazë, rrënjë, nuk përdoren gjithnjë si të lira, siç është rasti i morfemave rrënjore foljore, të cilat kanë nevojë për morfemat trajtëformuese për të formuar fjalët folje.

²¹⁴ W. Fleischer, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Leipzig, 1983, f. 53

²¹⁵ E. Hentschel / H Weydt, Handbuch der deutschen Grammatik, Berlin, 1990, f. 24

²¹⁶ W. Jung, Grammatik der deutschen Sprache, Leipzig, 1988, f. 373

sintaksore”, shprehet ai duke nxjerr në pah veçantinë e gjuhës gjermane në krijimin e fjalëve me përmbajtjen e një togu të tërë sintaksor.

Volmert-i ndjen nevojën e zgjerimit të përkufizimit që gjendet rëndom për kompozimin dhe kompozitat në gramatikat apo punimet mbi fjalëformimin e gjuhës gjermane, duke u shprehur se “... auch die nicht-wortfähigen Kernmorpheme von Wörtern kompositionsfähig sind. / edhe morfemat rrënjore, të paafta për të formuar fjalë, mund të jenë gjymtyrë të një fjale të përbërë”²¹⁷, duke iu referuar foljeve të cilat marrin pjesë si gjymtyrë të një fjale të përbërë vetëm nëpërmjet rrënjës së tyre, si p.sh.:

reit(en)	+	Schule	→	Reitschule
lehr(en)	+	Buch	→	Lehrbuch

Nga sa pamë më lart mund të thuhet se nuk ka diversitet mendimi lidhur me përkufizimin e kompozimit apo kompozitave të gjuhës gjermane, të cilat shihen nga gjuhëtarët si bashkim i dy ose më shumë fjalëve apo njësisive leksikore në një fjalë të vetme. Disa prej tyre tregojnë kujdes të shënojnë rrënjët (Stämme/Grundmorphem etj.), apo grupet e rrënjëve (Stammgruppen)²¹⁸ si njësi leksikore që marrin pjesë në formimin e kompozitave. Gjithsesi çështja e bashkimit të temave fjalëformuese në formimin e kompozitave është sqaruar dhe argumentuar kohë më parë²¹⁹, pikësëpari me mungesën e elementeve trajtëformuese, të cilat edhe kur janë të dukshme brenda kompozitës nuk luajnë funksionin e morfemave trajtëformuese por janë elemente lidhëse, nuk mbartin ndonjë kuptim, dhe janë quajtur *Fugenelemente*/elemente lidhëse. Këtyre elementeve u kushtohet një nënçështje më vete në këtë punim.

Mendojmë se një nga përkufizimet më të qarta të kompozimit është bërë në punimin e Römer-it/Matzke-s, të cilët kompozimin e përkufizojnë si vijon:

“*Die Komposition ist eine Wortbildungsart, bei der durch die Verbindung von mehreren, mindestens aber zwei Basismorphemen oder Stämmen ein neues Wort (Kompositum) entsteht.*”²²⁰ / Kompozimi është një mënyrë fjalëformimi, me anë të të cilës formohet një fjalë e re (kompozita) nga bashkimi i të paktën dy, ose edhe më shumë morfemave bazë, rrënjëve.

Më poshtë disa shembuj fjalësh të përbëra:

Abendkleid, abwechslungsreich, Autobahngebühr, Autobahnraststätte, Begrüßungskuss, Behandlungskosten, bioaktiv, Blutzelle, Briefsammler, Charakterstärke, Chorprobe, Damenuhr, Diskothek, Dolmetscherschule, Fabrikbesitzer, Familientreffen, freisprechen, Gewürzmischung, giftgrün, Halskette, hinzufügen, hochlaufen, Jahreswechsel, kirschrot,

²¹⁷ J. Volmert, Grundkurs Sprachwissenschaft, München, 1999, f. 106

²¹⁸ R. Kellermeier-Rehbein, Areale Wortbildungsvarianten des Standarddeutschen, Beiuntersuchung zum Variantenwörterbuch des Deutschen, Frankfurt am Main, 2005 f. 40; Fleischer / Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f 45

²¹⁹ K. Welke, Komposition und Derivation, në: *Deutsche Sprache*, 23 / 1995, Erich Schmidt Verlag, f. 73-89

²²⁰ Vepër e cituar, f. 71

Kissenbezug, Landschaftsmaler, nervenschwach, Mathematiklehrer, naturblond, Schreibtischstuhl, Straßenbahnhaltestelle, Wohnturm etj.

Siç mund ta kuptojmë nga përkufizimet dhe shembujt e mësipërm, për të formuar fjalën e përbërë mund të bashkohen:

tema motivuese, të cilat i ndeshim edhe si fjalë të lira jashtë kompozitës:

lesen	+	Buch	→	Lesebuch
Haus	+	Aufgabe	→	Hausaufgabe

kompozita ose kompozitë dhe një fjalë tjetër e cila mund të jetë edhe e prejardhur, duke formuar fjalë të përbëra me dy gjymtyrë por me disa elemente:

Lebensmittel	+	Abteilung	→	Lebensmittelabteilung
Kinder	+	Geburtstag	→	Kindergeburtstag
Autobahn	+	Raststätte	→	Autobahnraststätte

një temë, kryesisht me burim të huaj, por jo vetëm, e cila në gjuhën gjermane njihet me emrin "Konfix/konfiks"²²¹ me një temë motivuese:

²²¹ Sipas E. Donalies në punimin e saj "Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick", botim i vitit 2002 si dhe W. Fleischer në punimin "Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache", botim i vitit 2007, konfikset ndryshojnë nga fjalët pasi dalin në gjuhë si njësi të lidhura. Ato nuk mund të përdoren më vete dhe as të lidhen me morfema trajtëformuese, por përdoren si tema fjalëformuese dhe formojnë fjalë duke u bashkuar me morfema ndajshesore si në rastin e konfiksit *ident-*, i cili duke u bashkuar me prapashtesën *-isch* formon fjalën *identisch*. Gjithashtu ato mund të bashkohen edhe me morfema fjalëformuese ose edhe me konfikse të tjera duke formuar në këtë mënyrë fjalë të përbëra, si p.sh.: *Thermojacke, Thermostat, Biotop, bibliophil, Aquadrom* etj. Konfikset janë tema kryesisht me burim të huaj, dhe kanë hyrë në gjuhë si pasojë e huazimeve nga gjuhët e tjera. Por në gjuhën gjermane ka edhe një numër shumë të vogël fjalësh, të cilat i trajtohen si konfikse, pasi zotërojnë dy cilësitë kryesore të këtij tipi morfemash, janë të lidhura dhe formojnë vargje fjalësh të reja. Këto konfikse të gjuhës gjermane janë *stief-* dhe *schwieger-*: *Stiefvater, Stiefbruder, Schwiegermutter, Schwiegersohn* etj.; si dhe *zimper-*, i cili bashkohet me morfema ndajshesore si p.sh. *zimperlich*.

Konfikset duhen dalluar nga "unikale Bestandteile der Wortbildung"/pjesë përbërëse unike të fjalëformimit", (Duden, Band 4, f. 416) ku përfshihen fjalë të tipit *Him* – në *Himbeere, Brom-* në *Brombeere, Sams-* në *Samstag* apo *Bern-* në *Bernstein*, pasi ato shfaqen vetëm në një rast si pjesë përbërëse të një fjalë duke mos u bashkuar me të tjera fjalë.


Bio + Laden → Bioladen
 Schwieger + Vater → Schwiegervater


ose edhe dy konfikse:

Disko + Thek → Diskothek

Pra gjymtyrët e fjalës së përbërë mund të jenë, fjalë të thjeshta, fjalë të prejardhura ose edhe kompozita.

Duke folur për fjalët apo elementet që bashkohen për të përftuar një kompozitë, kemi prekur njëkohësisht dhe një nga tiparet karakteristike të kompozitave. Pavarësisht nga numri i temave apo elementeve që bashkohen në formimin e kompozitave, thuajse të gjitha kompozitat janë dygjymtyrëshe, ndaj dhe mund të ndahen në dy pjesë sipas gjymtyrëve përbërëse, duke dëshmuar kështu strukturën e tyre dyshe, ose siç njihet ndryshe struktura binare. Një kompozitë mund të ndahet në pjesët e saj përbërëse, por kjo ndarje bëhet gjithnjë mbi bazën e strukturës dygjymtyrëshe si në rastet e mëposhtme:





Pjesa më e madhe e kompozitave të gjuhës gjermane janë formuar nga bashkimi i dy temave motivuese, pra janë me dy elemente. Rreth 85% e kompozitave që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*” janë të tilla.

Meibauer-i dhe bashkautorët e tjerë flasin për konceptin e “kokës” (*Kopf*) në fjalëformim. Koka është komponenti që përcakton kategorinë leksikogramatikore të gjithë kompozitës. Në gjuhën gjermane këtë funksion e kryen komponenti që ndodhet në të djathtë të kompozitës. Me konceptin e *kokës* lidhet edhe një karakteristikë e kompozitave përcaktore (*Determinativkompositum*), kompozita komponentët/gjymtyrët e të cilave janë në lidhje nënrenditëse me njëra-tjetrën. Në kompozitat e këtij lloji kuptimi i kokës (elementit të djathtë) përcaktohet nga kuptimi i elementit të majtë.²²² Ndërsa gjymtyrët e kompozitave këpujore (*Kopulativkompositum*) janë të barazvlefshme semantikisht. Për këta gjuhëtarë koncepti i “kokës” së një fjale jo të thjeshtë vepron edhe te fjalët e prejardhura. Sipas tyre “*Der Kopf ist das rechte Element einer Wortbildung. Es bestimmt die Kategorie, das Genus und die Flexionsklasse der Wortbildung.* / Koka është elementi i djathtë i një formimi. Ai përcakton kategorinë leksikogramatikore, gjininë dhe klasën e eptimit të formimit.”²²³

Kompozitat edhe pse janë të përbëra nga dy gjymtyrë dhe mund të formohen nga disa elemente, janë fjalë dhe si të tilla ato gëzojnë të gjitha karakteristikat e saj. Kompozitat e gjuhës gjermane mbartin një theks kryesor dhe në rastin kur ato janë fjalë të ndryshueshme të ligjeratës fitojnë të gjitha karakteristikat dhe paradigmen e klasës ku bëjnë pjesë. Me anë të kompozimit formohen kryesisht emra dhe mbiemra si dhe folje e më pak ndajfolje si p.sh.:

emra: *Atomkraft, Betäubungsmittel, Damenschuh, Kraftstoff, Lebensbereich, Mittelfeld, Nebensatz, Obstsaft, Probefahrt, Rotfuchs, Sechseck, Theaterstück, Unfallgefahr, Versdrama, Warteliste, Zeigefinger* etj.; mbiemra: *abhörsicher, barmherzig, computergesteuert, deutschfeindlich, fangfrisch, handtellergrößer, hellblau, jahrhundertealt, kaltherzig, linientreu, mutwillig, naturbelassen, rechtsuchend,*

²²² J. Meibauer u.a., Einführung in die germanistische Linguistik, Stuttgart-Weimar, 2007, f. 39

²²³ J. Meibauer, po aty.

schicksalsgläubig, tiefblau, umgangssprachlich, verantwortungsbewusst, waffentauglich, zeitgerecht etj. folje: *hochstellen, hinstellen, danksagen, davonlaufen, schlussfolgern, seiltanzen, sicherstellen, standhalten, teilnehmen, tiefbohren, vollenden, trockenlegen* etj. ndajfolje: *dorthin, irgendwoher, nebenher, rechtshin, vorhin, weiterhin, weitab, woher* etj.

Siç mund të vihet re edhe nga shembujt e mësipërm, gjymtyrët e fjalëve të përbëra mund të jenë nga pjesë të ndryshme të ligjeratës. Dhe në të vërtetë në formimin e kompozitave të gjuhës gjermane marrin pjesë si tema pjesësh të ndryshueshme ashtu edhe tema pjesësh të pandryshueshme ligjerate, si tema emërore: *Tischplatte, Warmwasser*; tema mbiemërore: *Schnellzug, meterlang*; tema foljore: *teilnehmen, Fahrkarte*; ndajfoljore: *Linkspartei, obenauf*; si dhe numërorë: *Dreieck, Nulldiät*; përemra: *Icherzähung, selbstbewusst*; parafjalë: *Abgrund, überdeutlich*, si dhe shkurtesa: *Mathearbeit, DDR-Bürger*.

Teksa lexon në literaturën e fjalëformimit të gjuhës gjermane në përgjithësi dhe të kompozimit në veçanti, të bie në sy fakti se hartuesit e gramatikave dhe librave mbi fjalëformimin kanë shqyrtuar në detaj, duke i kushtuar faqe të tëra fjalëformimit të pjesëve kryesore të ligjeratës, emrit, mbiemrit dhe foljes, dhe më pak ndajfoljes, të cilën e ndeshim rrallë në këto punime. Ndërsa jashtë fokusit të punimeve të tyre kanë mbetur pjesët e tjera të ligjeratës.

Hentschel-i/Weydt-i²²⁴ po ashtu edhe Erbsen-i²²⁵ dhe Motsch-i²²⁶ pasi trajtojnë në përgjithësi fjalëformimin dhe mënyrat e tij, shohin më gjerë brenda kreut të fjalëformimit të emrit, mbiemrit dhe foljes edhe formimet e tyre me anë të kompozimit. Ndërsa Fleischer-i²²⁷ si në punimin e tij të vitit 1983, ashtu edhe në punimin e vitit 2007²²⁸, të cilin e realizon bashkë me Barz-in, shton si një nënçështje më vete edhe fjalëformimin e ndajfoljeve duke shqyrtuar edhe kompozimin e tyre. Në gramatikën e Duden-it²²⁹ pasi shqyrtohet fjalëformimi me gjithë problematikën e tij, trajtohet si çështje më vete edhe fjalëformimi i foljes, emrit, mbiemrit si dhe fjalëformimi i ndajfoljes, brenda këtij të fundit edhe ndajfoljet e formuara me kompozim. Disa rreshta i kushtojnë autorët edhe fjalëformimit të pjesëve të tjera të ligjeratës në një nënçështje më vete brenda kreut të fjalëformimit. Sipas Duden-it fjalëformimi luan pak rol në zgjerimin dhe pasurimin e këtyre pjesëve të ligjeratës (parafjalës dhe lidhëzës), madje shfaqja e një parafjale apo lidhëze të re është produkt i një procesi që kërkon shumë kohë. Mënyrat fjalëformuese që shërbejnë për formimin e këtyre pjesëve të pandryshueshme të ligjeratës janë prejardhja, konversioni dhe përngjitja. Pra për hartuesit e Duden-it, nëpërmjet kompozimit nuk formohen parafjalë dhe lidhëza.²³⁰

²²⁴ Hentschel/Weydt, *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin, 1990

²²⁵ J. Erbsen, *Einführung in die deutsche Grammatik*, Berlin, 2006

²²⁶ W. Motsch, *Wortbildung in Grundzügen*, Berlin, 2004

²²⁷ W. Fleischer, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Leipzig, 1983

²²⁸ Fleischer/Barz, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 2007

²²⁹ Duden, *Die Grammatik*, Band 4, Mannheim, 1998

²³⁰ Duden, po aty, f. 552-553

Ndërsa Jung-u²³¹ e trajton fjalëformimin e ndajfoljeve, parafjalëve dhe lidhëzave si një nënçështje të quajtur “*Flexionslose Wortarten*”/pjesë ligjerate të pandryshueshme”, brenda kreut që i kushtohet fjalëformimit, duke i njohur fjalë të tilla si të formuara edhe me kompozim edhe me përngjitje, por pa i dalluar qartazi ato.

Sommerfeld-i/Starke²³² teksta trajtojnë pjesët e ligjeratës në gramatikën e tyre, nga pikëpamja e fjalëformimit veç të tjerash dallojnë dhe parafjalë të përbëra si *gegenüber* dhe *oberhalb*, si dhe lidhëza të përbëra: *indem*, *seitdem*, *nachdem*, *sooft*, *soweit*, *wengleich*.

Jung-u²³³ në fillim të kapitullit mbi fjalëformimin shkruan:

“*Neure Forschungen schätzen den Wortbestand unserer Literatursprache auf ungefähr 500 000 Wörter. Davon sind mehr als die Hälfte Substantive, etwa ein Viertel Verben, etwa ein Sechstel Adjektive und Adverbien. Dagegen gibt es insgesamt nur etwa zweihundert Präpositionen und Konjunktionen. Die Substantive, Verben und Adjektive vermehren und verändern ihren Bestand ständig, Pronomen und Fügewörter bleiben in Form und Umfang nahezu konstant.* / Studimet e reja vlerësojnë se gjuha jonë letrare ka rreth 500 000 fjalë, nga të cilat më shumë se gjysma janë emra, rreth një e katërta janë folje, gati një e gjashta janë mbiemra dhe ndajfolje, ndërsa parafjalë dhe lidhëza bashkë janë rreth dyqind. Emrat, foljet dhe mbiemrat shtohen dhe ndryshojnë vazhdimisht numrin e tyre, përemrat dhe fjalët me funksion lidhës²³⁴ mbeten thuajse konstante në formë dhe sasi.”

Ndërsa për Weinrich-un²³⁵ fjalëformimi luan një rol veçanërisht të rëndësishëm për klasën e emrave, pasi më shumë se gjysma e emrave të gjuhës gjermane përbëhet nga fjalë komplekse. Gjithashtu edhe klasa e mbiemrave përbëhet në pjesën më të madhe të saj nga fjalë komplekse, pasi vetëm një e treta e mbiemrave janë fjalë të thjeshta. Ndërsa folja, për vetë karakterin dhe pozicionin që zë në fjali përbën rëndësi dhe interes të shihet dhe nga pikëpamja e fjalëformimit.

Duke u nisur nga sa thamë më sipër mendojmë se kjo është një nga arsyet kryesore pse fjalëformimi i foljes, emrit dhe mbiemrit zënë vendin qëndror në literaturën gjermane të fjalëformit, ndaj dhe në këtë punim edhe sa i takon kompozimit vendin qëndror do ta zënë kompozitat emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore.

Siç u theksua dhe më lart pavarësisht nga numri i elementeve që marrin pjesë në formimin e një kompozite, pjesa më e madhe e kompozitave (përfshirë bënë kompozitat këpujore formuar nga më shumë se dy tema motivuese) përbëhen nga dy gjymtyrë dhe kuptimi semantik i gjithë kompozitës motivohet nga kuptimi i gjymtyrëve

²³¹ W. Jung, *Grammatik der deutschen Sprache*, Leipzig, 1988, f.421-422

²³² Sommerfeld/Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 1998, f.144 dhe f. 147

²³³ W. Jung, *Grammatik der deutschen Sprache*, Leipzig, 1988, f. 369

²³⁴ Termi “Fügewort” përdoret nga Flämig-u, i cili i ndan fjalët në pjesë ligjerate duke u bazuar fillimisht mbi kriterin morfologjik dhe vetëm kur ai nuk mjafton përdor dhe atë sintaksor. Kështu ai bën ndarjen në pjesë të ndryshueshme të ligjeratës dhe të pandryshueshme dhe te këto të fundit dallon fjalë lidhëse, ku përfshin parafjalët dhe lidhëzat dhe ato jo lidhëse, ku përfshin pjesëzat. (Sommerfeld/Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 1998, f. 48)

²³⁵ H. Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Hildesheim, 2007, f.917, f. 991, f. 1031

të saj. Në teoritë e fjalëformimit mbetet ende e diskutueshme çështja e shpjegimit semantik të kompozitave. Pranohet lidhja e tyre si me togfjalëshat ashtu edhe me fjalitë, nëpërmjet të cilave mund të bëhet perifrazimi i kompozitave, por problematik mbetet një përcaktim sa më i mirë i marrëdhënieve mes këtyre elementeve, pasi edhe pse në pjesën më të madhe të rasteve ruhet kuptimi i pjesëve përbërëse të kompozitës, kompozita fiton një kuptim të ri, një kuptim, i cili është më specifik sesa perifrazimi që mund t'i bëhet asaj nëpërmjet togfjalëshit apo dhe fjalisë. Pra, kompozita gjatë formimit dhe përdorimit të saj në gjuhë fiton përbërës semantik, të cilët ndikojnë në kuptimin e saj. Madje disa fjalë të përbëra janë leksikalizuar aq shumë, saqë duke u nisur nga gjendja aktuale e gjuhës ato nuk mund të motivohen apo të shpjegohen më nëpërmjet togfjalëshit nga e kanë burimin²³⁶, si p.sh.:

Jungfrau (virgjëreshë) → *junge Frau* (grua e re)

Zbërthimi i kësaj kompozite në togfjalëshin përkatës nuk e motivon kuptimin e saj.

III.1.1. Kompozitat si tema fjalëformuese

Kompozitat mund të përdoren edhe si tema fjalëformuese për formimin e fjalëve të reja brenda gjuhës gjermane nëpërmjet bashkimit të tyre me prapashtesa të caktuara. Edhe pse kompozitat si tema fjalëformuese bashkohen me një numër të konsiderueshëm prapashtesat, nuk vihet re një prodhimtari e lartë e këtyre rasteve. Kompozitat si tema fjalëformuese nuk mund të bashkohen me çdo lloj prapashtese. Janë vetëm disa prapashtesa, të cilat duke iu bashkangjitur kompozitave emërore, mbiemërore dhe foljore formojnë emra dhe mbiemra sipas kuptimeve që u japin prapashtesat fjalëve të reja.

sekundenschnell + e	→	Sekundenschnelle
Eisenbahn + er	→	Eisenbahner
Schergewicht + ler	→	Schergewichtler
Geheimdienst + ler	→	Geheimdienstler
Maskenbild + ner	→	Maskenbildner
treffsicher + heit	→	Treffsicherheit
breitbeinig + keit	→	Breitbeinigkeit
emporkommen + ling	→	Emporkömmeling
Staatsbürger + schaft	→	Staatsbürgerschaft
freistell(en) + ung	→	Übereinstimmung
Schwachsinn + ig	→	schwachsinnig
Abendland + isch	→	aberländisch
Kindergarten + in	→	Kindergärtnerin

²³⁶ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 434

Vihet re se prapashtesat që marrin kompozitat si fjalë motivuese janë prapashtesa që marrin dhe komponentët e tyre (gjymtyra e dytë) kur sillen si pjesë të mëvetësishme ligjrate.

Duke qenë se kompozitat e kanë prejardhjen e tyre te fjalët e përngjitura, të cilat janë formuar nga bashkimi i togjeve sintaksorë, mes gjymtyrëve të tyre ekziston një lidhje sintaksore e cila mund të jetë bashkërenditëse ose nënrenditëse. Kompozitat, gjymtyrët e të cilave ndodhen në marrëdhënie sintaksore bashkërenditëse me njëra-tjetrën quhen kompozita këpujore (Kopulativkomposita), ndërsa kur marrëdhëniet sintaksore mes gjymtyrëve të kompozitës janë nënrenditëse kemi të bëjmë me kompozita përcaktore (Determinativkomposita).

III.1.2. Kompozitat këpujore

Kompozita të tilla si:

Dichterkomponist, Gottkönig, Hassliebe, Hemdhose, Hosenrock, Kinocafé, Nordost, Ofenkamin, Radiowecker, Strichpunkt, Strumpfhose, Uhrenradio, Waisenkind, Waisenknabe, deutsch-albanisch, dummdreist, feuchtwarm, griechisch-orthodox, nasskalt, römisch-katholisch, schwarz-weiß, taubblind, taubstumm, wissenschaftlich-technisch etj., quhen kompozita këpujore (Kopulativkomposita).

Tipari kryesor që i karakterizon dhe dallon kompozitat këpujore nga ato përcaktore, duke përcaktuar njëkohësisht edhe emërtimin e tyre, është lidhja sintaksore e komponentëve të kompozitës. Gjymtyrët e kompozitave këpujore kombinohen dhe lidhen me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që të jenë të bashkërenditura mes tyre dhe të njëvlerëshme. Ato mund të zërthehen apo perifrazohen në një togfjalësh me lidhëzën *und*/dhe si p.sh.:

taubblind → taub *und* blind
(shurdh dhe i verbër njëkohësisht)

Dichterkomponist → Dichter *und* Komponist
(poet dhe kompozitor njëkohësisht)

Në gjuhën gjermane grupi i kompozitave këpujore është shumë i vogël, krahasuar me grupin e kompozitave përcaktore. Për këtë gjë flet dhe fakti se në literaturën e fjalëformimit kompozitave këpujore u kushtohen maksimumi disa faqe, ndërkohë që për kompozitat përcaktore janë shkruar kapituj të tërë.

Në një punim të tij Pittner-i teksta bën një përmbledhje të vendit që kanë zënë kompozitat këpujore në punimet e gjuhëtarëve të ndryshëm ndër shekuj, vëren se “*Bis ins 19. Jahrhundert hinein wurden Kopulativkomposita überhaupt nicht explizit erwähnt... / Deri në shekullin XIX kompozitat këpujore nuk përmenden shprehimisht...*”²³⁷, duke iu referuar veprave të Bödiker-it 1746, Aichinger-it 1754, Adelung-ut 1782 etj. Më vonë, në

²³⁷ R.J. Pittner, Der Wortbildungstyp “Kopulativkomposition” im heutigen Deutsch, në: Neue Fragen der Linguistik, Band 1: Bestand und Entwicklung, Tübingen 1991, f.267

periudhën e romantizmit, si pasojë edhe e hulumtimeve të sanskrishtes, dallohet ky tip kompozitash edhe në gjermanishte. Ato krahasohen me Dvandvat vetëm në aspektin semantic, si zbërthime në togfjalësha me lidhëzen *dhe*.

Ndërsa Donalies-i²³⁸ vëren se për kompozitat këpujore janë përdorur emërtime të ndryshme. Kështu ato janë quajtur:

appositive, appositionelle Komposita apo *Komposita mit appositionellem Verhältnis; Dvandva; koordinierte, koordinative* apo *Koordinativkomposita; konjunktive Komposita; Additiva, additive* apo *additionelle Komposita; Anreih-Komposita, Reihewörter* apo *Verbindungszusammensetzungen*.

Pavarësisht nga emërtimet e ndryshme gjuhëtarë i shohin këto kompozita si fjalë të përbëra, gjymtyrët e të cilave janë të lidhura në rend bashkërenditës mes tyre.

Gjuhëtarët e sotëm²³⁹ flasin vetëm për kompozita këpujore emërore dhe mbiemërore në punimet e tyre. Sipas Duden-it²⁴⁰ prodhimtaria e kompozitave këpujore emërore është e kufizuar, duke përbërë rreth 0,4% të kompozitave emërore. Këto kompozita ndeshen kryesisht në gjuhën terminologjike, si p.sh. në fushën e modës ku gjejmë kompozita të tilla si:

Strumpfhose, Hosenrock, Schürzenkleid, Pulloverjacke, Westenpullover, Manteljacke etj. Gjithashtu kompozitat këpujore emërore emërtojnë edhe persona, si p.sh.: *Dichterkomponist, Königinmutter, Sänger-Darsteller, Schauspieler-Regisseur, Ingenieurphilologe* etj. Shumë të tilla janë edhe emra të përveçëm, kryesisht emra e njerëzish si dhe emërtime gjeografike, si p.sh.: *Karl-Heinz, Grau-Günther; Schleswig-Holstein, Garmisch-Partenkirchen* etj.

Më i madh vlerësohet numri i kompozitave mbiemërore këpujore. Faktin që këto kompozita përbëjnë dhe numrin më të madh të kompozitave këpujore Naumann-i²⁴¹ e shpjegon duke u shprehur se “*Eigenschaften lassen sich besser addieren als Gegenstände oder Sachverhalte.*” / Cilësitë bashkohen më lehtësisht me njëra-tjetrën sesa objektet apo rrethanat.

Kjo gjë ka të bëjë edhe me faktin se si kompozita këpujore mbiemërore shfaqen mbiemrat që emërtojnë ngjyra si dhe ato që emërtojnë përkatësi gjuhësore. Në të dyja rastet mundësitë e kombinimeve janë të mëdha. Kështu në fjalorin “*Deutsches Universalwörterbuch*” gjejmë jo vetëm kombinimet:

blau + grau	→	blaugrau
blau + grün	→	blaugrün
braun + rot	→	braunrot
grün + grau	→	grüngrau
weiß + grau	→	weißgrau,

por edhe pesë kombinime të tjera me po të njëjtat ngjyra por me rend të ndërsjellë gjymtyrësh, gjë që dëshmon se këto kompozita mbiemërore janë këpujore:

²³⁸ E. Donalies, *Die wortbildung des Deutschen – Ein Überblick*, Tübingen, 2002, f. 86

²³⁹ Fleischer/Barz, Jung, Erben, Donalies, hartuesit e gramatikës së Duden-it etj.

²⁴⁰ Duden, *Die Grammatik*, Band 4, Mannheim, 1998, f. 481

²⁴¹ Cituar nga Michael Lohde në *Wortbildung des modernen Deutschen: Ein Lehr- und Übungsbuch*, Tübingen, 2006, f. 38

grau + blau	→	graublau
grün + blau	→	grünblau
rot + braun	→	rotbraun
grau + grün	→	graugrün
grau + weiß	→	grauweiß

Duke u nisur nga rendi i përmbysur, Sommerfeldt-i²⁴², i pranon këto kompozita si këpujore. Por nëse këta mbiemra që emërtojnë ngjyra i analizojmë sipas kriterit semantik, atëherë na duket më i drejtë qëndrimi i mbajtur nga Römer/Matze²⁴³, të cilët këto kompozita mbiemërore kuptimisht i klasifikojnë si përcaktore, pasi ato shprehin një përzjerje ngjyrash, ku mbizotëron ngjyra e shprehur përmes gjymtyrës së dytë të kompozitës. Për Römer-in/Matze-n kompozitat mbiemërore që emërtojnë ngjyra janë këpujore kur emërtojnë pjesë objektesh me ngjyra të ndashme si: *schwarz-weiß*, *rot-grün*²⁴⁴ etj. Grafikisht gjymtyrët e tyre lidhen me një vizë lidhëse, e cila është element lidhës.

Ndërkohë, lehtësisht të kombinueshme shfaqen edhe mbiemrat që emërtojnë përkatësi gjuhësore apo vendore duke shtuar madje edhe komponentë sipas rrethanave si p.sh.:

spanisch-potugiesische (Beziehungen) ose *portugiesisch-spanische* (Beziehungen)
englisch-französisch-russisch ose *französisch-englisch-russisch*

Fleischer-i/Barz-i përfshijnë në grupin e kompozitave këpujore mbiemërore edhe ato kompozita gjymtyrët e të cilave janë antonime të njëra-tjetrës. Këto kompozita ata i pranojnë si krijime kryesisht të letërsisë artistike, si p.sh.: *engweit*, *nahfern*, *ernstheiter* etj. apo edhe ndonjë kompozitë këpujore me gjymtyrë sinonimike, si *zierlich-zart*, por edhe këto shihen si krijime të rastësishme.²⁴⁵

Por çfarë i dallon kompozitat këpujore nga tipi tjetër i kompozitave, nga ato përcaktore? Kompozitat këpujore, siç u theksua dhe në fillim të kësaj nënçështjeje, përbëhen nga gjymtyrë të cilat janë në marrëdhënie bashkërenditëse mes tyre duke bërë teorikisht të mundur ndryshimin e rendit të tyre pa shkaktuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm semantik apo strukturor të vetë kompozitës. Por ky ndryshim i rendit të gjymtyrëve të kompozitës këpujore nuk mund të bëhet për secilën prej tyre, pasi rendi i këtyre gjymtyrëve në pjesën më të madhe të rasteve është i përcaktuar dhe është konvencionalizuar nga gjuha²⁴⁶. Edhe pse për disa mbiemra e emra të tipit *Kinocafé* apo *Cafékino*, *Pulloverjacke* apo *Jackenpullover*, *rot-gelb* apo *gelb-rot* ndryshimi i rendit të gjymtyrëve teorikisht nuk përbën ndonjë problem, një gjermanofolës do të korrigjonte çdokënd që do të thoshte “*Hosenstrumpf*” (geta) pasi kjo fjalë do t’i tingëllonte a

²⁴² K.E. Sommerfeldt, Zur Reihenfolge der Konstituenten kopulativer Komposita, në: Sprachpflege, 1984/7, f. 95

²⁴³ C.Römer / B. Matzke, Lexikologie des Deutschen: Eine Einführung, Tübingen, 2005

²⁴⁴ C. Römer / B. Matzke, po aty, f. 80

²⁴⁵ Fleischer/Barz, Wortbildung, der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f 247

²⁴⁶ Fleischer/Barz, po aty, f.128

pazakontë dhe e gabuar, sepse ajo ka zënë vend në fjalorin e gjuhës me rendin *Strumpfhose* (geta). Veç arsyeve të traditës, në këtë rast ndikon edhe motivimi kuptimor ose, më drejt, mënyra e motivimit kuptimor: nëpërmjet kompozitës këpujore *Strumpfhose* emërtohet një objekt (një rrobe) e cila ka diçka nga objekti “*Strumpf*” / çorapja dhe diçka nga objekti “*Hose*” / pantallona.

Në punimin e tij “*Zur Reihenfolge der Konstituenten kopulativer Komposita*”²⁴⁷ / “*Mbi rendin e gjymtyrëve të kompozitave këpujore*”, Sommerfeldt-i përpiket të gjejë arsyet mbi të cilat bazohet rendi i gjymtyrëve të këtyre kompozitave, rendi me të cilin kompozitat këpujore zënë vend në gjuhë dhe pasqyrohen më pas në fjalor. Lidhur me kompozitat këpujore gjeografike ai sheh si një arsye të mundshme vendosjen si gjymtyrë të parë të emrit të vendit apo shtetit më të rëndësishëm, si në rastin e *Österreich-Ungarn/Autro-Hungaria*. Edhe numri më i madh i shkronjave të emërtimit duket të jetë një kriter, pasi Sommerfeldt-i vëren se në pjesën më të madhe të rasteve të studiuara, ky emërtim përbën gjymtyrën e dytë të kompozitës. Për kompozitat këpujore mbiemërore që emërtojnë ngjyrat e flamujve, Sommerfeldt thekson se kur ngjyrat janë të vendosura vertikalisht emërtimi bëhet sipas ngjyrave nga lart poshtë, ndërsa kur ato janë të vendosura horizontalisht leximi bëhet nga majtas-djathtas si p.sh.:

Bulgarien/Bullgaria	→	weißgrünrot/bardhë-jeshile-e kuqe
Frankreich/Francë	→	blauweißrot/blu-e bardhë-e kuqe

Gjymtyrët e kompozitës këpujore janë fjalë të së njëjtës pjesë ligjrate, madje fjalë që janë emërtime të së njëjtës klasë²⁴⁸. Edhe vetë kompozita e formuar i përket po asaj pjese ligjrate sikurse dhe komponentët e saj, sepse lloji i lidhjes sintaksore përcakton edhe karakterin e pjesës së ligjeratës. Kështu formohen kompozita këpujore emërore nga emra dhe kompozita këpujore mbiemërore nga mbiemra, ku mbahet parasysh edhe kriteri semantik. Kështu mund të formohet kompozita këpujore *deutsch-albanisch*, pasi të dyja elementet janë mbiemra përkatësorë, por jo ajo *deutsch-schön* në të cilën elementi i parë është një mbiemër përkatësor ndërsa i dyti një mbiemër cilësor.

Kompozita këpujore nuk përbën një fjalë të re vetëm në aspektin morfologjik, duke pasur parasysh faktin që është gjymtyra e dytë ajo që e formëson gramatikisht kompozitën e formuar, pasi e para është e zhveshur nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore, por edhe në aspektin semantik. Fakti që gjymtyrët e kompozitave këpujore janë në marrëdhënie bëshkërenditëse me njëra – tjetrën, bën që në disa raste edhe kuptimi semantik i gjithë kompozitës të jetë pak a shumë i barabartë me shumën e kuptimeve të gjymtyrëve të saj, veçanërisht në rastet e kompozitave të tipit *deutsch-italienisch* (gjermanoitalian), apo *wissenschaftlich-technisch* (teknikoschkencor). Gjithsesi edhe në këto raste nuk kemi të bëjmë vetëm me një shumë kuptimesh, por me një nocion të ri, i cili në shumë raste nuk mund të perifrazohet vetëm me togfjalëshja ku gjymtyrët e kompozitës lidhen vetëm me lidhëzën *dhe*. Kështu fjala *Nordost* (verilindje) nuk emërton veriun dhe lindjen, por një drejtim horizonti të ri që ndodhet mes veriut dhe lindjes dhe që përcaktohet pikërisht me lidhjen mes tyre. Po kështu edhe emri *Österreich-Ungarn*

²⁴⁷ K.E. Sommerfeldt, *Zur Reihenfolge der Konstituenten kopulativer Komposita*, në: *Sprachpflege – Zeitschrift für gutes Deutsch*, 1984/7, f.93 - 96

²⁴⁸ Duden, *Die Grammatik*, Band 4, Mannheim, 1998, f. 481

(Autro-Hungaria) nuk emërton dy shtetet bashkë, atë të Austrisë dhe të Hungarisë, por një njësi politike që nuk ekziston më, e cila ishte më shumë se një bashkim dy shtetesh. Kompozitat këpujore duke qenë kompozita gëzojnë tiparet e tyre të përgjithshme, duke mbartur në pjesën më të madhe të rasteve një theks kryesor në gjymtyrën e parë, me ndonjë përjashtim.²⁴⁹

Duke qenë se gjymtyrët e kompozitave këpujore janë të barasvlershme, pasi marrëdhëniet mes tyre janë të tipit bashkërenditës, një kompozitë këpujore mund të ketë më shumë se dy gjymtyrë, por kompozita të tilla janë të rralla. Ato janë kryesisht formime rastësore në lëmin e letërsisë artistike apo në terminologjinë teknike dhe shkencore. Të tilla janë dhe emërtimet e ngjyrave të flamujve me më shumë se dy të tilla.

Edhe kompozitat këpujore shkruhen bashkë. Në disa raste, si p.sh. në emërtimet gjeografike apo emrat e personave (*Nordrhein-Westfalen, Österreich-Ungarn, Rheinland-Pfalz, Karl-Heinz Rummeigge, Karl-Ernst Sommerfeldt, Brigitta Grau-Günther*), mbiemrat, si: *deutsch-albanisch, blau-weiß, technisch-wissenschaftlich* etj. elementet e kompozitave këpujore lidhen me një vizë lidhëse. Për Gallmann-in “*Der Bindestrich macht hier deutlich, daß zwischen deren Teilen semantisch (nicht unbedingt grammatisch) eine Nebenordnung vorliegt. / Viza lidhëse bën të qartë se gjymtyrët e tyre janë semantikisht (jo domosdoshmërisht gramatikisht) të njëvlershme.*”²⁵⁰

III.1.3. Kompozitat përcaktore

Kompozitat përcaktore (Determinativkomposita) përbëjnë pa dyshim grupin më të madh dhe më prodhimtar të kompozitave të gjuhës gjermane. Më poshtë disa prej tyre:

Abgrund, Abschiedsfeier, Blutgruppenuntersuchung, bildhübsch, bitterböse, Diphtherieschutzimpfung, festdrücken, fleischfarbig, Filmproduzent, fingerdick, Geschirrspülmaschine, Haustier, hellblau, Hochleistungstraining, hochschauen, Innenbeleuchtung, Kaffeebohne, Kampfflugzeug, kastanienbraun, Kindergartenplatz, Manteltasche, nachtblind, Nebenraum, publikationsreif, Rückenschmerz, Schlafzimmer, Stadtbewohner, standhalten, staubsaugen, tiefbohren, Wirgefühel etj.


²⁴⁹ Sipas Fleischer-it/Barz-it vetëm ndonjë kompozitë si *Schleswig-Holstein* apo *Marxismus-Leninismus*, bëjnë përjashtim nga ky rregull, ku theksi kryesor bie mbi komponentin e dytë. Për Ortner-in në “*Zur Theorie und Praxis der Kompositaforschung*”, Tübingen, 1984, këtë rregull nuk e respektojnë as kompozitat këpujore me më shumë se dy komponentë, te të cilat theksi bie zakonisht te gjymtyra e fundit. Ndërsa për Donalies-in në “*Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick*”, Tübingen, 2002, komponentën e kompozitave këpujore theksohen njësoj. Në këtë punim do të mbështësim qëndrimin e Fleischer-it/Barz-it dhe Ortner-it, edhe për faktin se rënia e theksit kryesor vetëm në njërin prej elementeve përbërëse të kompozitës këpujore përbën dhe një tjetër dallim të kompozitës këpujore gjermane nga ajo angleze, (Ortner/Ortner, *Zur Theorie und Praxis der Kompositaforschung*, Tübingen, 1984, f.14)

²⁵⁰ P. Gallmann, *Syngrapheme an und in Wortformen – Bindestrich und Apostroph im Deutschen*, në: *Germanische Studien 97, Schriftsystem und Orthographie*, Tübingen, 1989, f. 85-110

Siç tregojnë edhe shembujt, në formimin e kompozitave përcaktore të gjuhës gjermane nuk marrin pjesë vetëm tema fjalëformuese emërore, mbiemërore dhe foljore, por edhe përemra, ndajfolje, numërorë dhe parafjalë.

Marrëdhënia që krijojnë gjymtyrët e këtij tipi kompozite me njëra-tjetrën është marrëdhënie përcaktore, ku njëra gjymtyrë përcakton gjymtyrën tjetër. Te kompozitat përcaktore të gjuhës gjermane është gjymtyra e parë ajo që përcakton gjymtyrën e dytë. Përfundimisht bën vetëm kompozita emërore “*Vierteljahr*”/çerek viti = *Viertel eines Jahres*. Në këtë rast të vetëm është gjymtyra e dytë ajo që përcakton të parën.²⁵¹

Gjymtyra e parë quhet dhe fjalë përcaktuese (*Bestimmungswort*), ndërsa e dyta, gjymtyra që përcaktohet nga e para dhe që qëndron gjithnjë në fund të fjalës së përbërë, e përcaktuara, quhet fjalë bazë (*Grundwort*). Kështu në fjalën *Wanduhr* (orë muri) është fjala *mur* (*Wand*) që përcakton llojin e orës (*Uhr*) dhe e dallon atë nga orët e tjera. Këto dy gjymtyrë të kompozitës përcaktore skematikisht mund të paraqiten si më poshtë²⁵²:



Marrëdhënia nënrenditëse që ekziston mes gjymtyrëve të kompozitës përcaktore bën që në ndryshim nga kompozitat këpujore, kompozitat përcaktore, pavarësisht nga numri i temave motivuese që marrin pjesë në formimin e tyre të jenë gjithnjë dygjymtyrëshe. Kështu, p.sh. kompozita *Haustür* (dera e shtëpisë) përbëhet nga dy tema motivuese, të cilat janë njëkohësisht edhe gjymtyrët e kësaj kompozite, dhe gjymtyra e parë (shtëpia) përcakton më nga afër të dytën (derën):

gjymtyrët		temat motivuese	
Haus	Tür	Haus	Tür

Po kështu edhe kompozita *Schaufensterpuppe* (manekinë vitrine), edhe pse përbëhet nga tri tema motivuese është dygjymtyrëshe, ku gjymtyra e parë përcakton llojin e manekinit:

Gjymtyrët		temat motivuese		
Schaufenster	Puppe	schau(en)	Fenster	Puppe

²⁵¹ L. Ortner u.a., Deutsche Wortbildung, Hauptteil 4, Substantivkomposita: Typen und Tendenzen in der Gegenwartssprache, DeGruyter, 1991, f. 112

²⁵²J. Volmert, Grundkurs Sprachwissenschaft, München, 1999, f. 108

Edhe *Geschirrspülmaschinenhersteller* (prodhues pjatararësesh), ndonëse përbëhet nga katër tema motivuese, është edhe ajo dygjymtyrëshe, nga të cilat gjymtyra e parë përcakton të dytën, përcakton se me cilin prodhues kemi të bëjmë:

Gjymtyrët		temat motivuese			
Geschirrspülmaschine(n)	Hersteller	Geschirr	spül(en)	Maschine(n)	Hersteller

Gjymtyra e parë, ose gjymtyra përcaktuese, (Bestimmungswort) mund të jetë e përbërë nga disa elemente, siç tregojnë dhe dy rastet e mësipërme (*Schaufensterpuppe* dhe *Geschirrspülmaschinenhersteller*), por brenda kompozitës ajo ka vlerën e një gjymtyre të vetme, duke respektuar në këtë mënyrë strukturën binare (dygjymtyrëshe) karakteristikë e këtyre kompozitave. Në rolin e gjymtyrës përcaktuese (Bestimmungswort) të fjalës së përbërë mund të marrin pjesë si pjesë të ndryshueshme ashtu edhe pjesë të pandryshueshme të ligjeratës, si p.sh.:

ermra: *Haarbürste*, *taghell*; mblimra: *Hochhaus*, *hellblau*; folje: *Ziehvater*, *vorführfertig*; ndajfolje: *Innendurchmesser*, *Soforthilfe*; numërorë: *Nullmorphem*, *Dreirad*; përemra: *Ichroman*, *Selbstabholer* apo parafjalë: *Übergewicht*, *vorchristlich*.

Gjymtyra e dytë (Grundwort), e cila është dhe fjala e përcaktuar, është dhe tema mbështetëse e gjithë kompozitës, pasi ajo e formëson gramatikisht kompozitën duke shprehur kategoritë gramatikore të saj dhe duke përcaktuar në këtë mënyrë dhe përkatësinë në pjesë ligjerate të fjalës së përbërë. Pra nëse fjala e përcaktuar është një emër, një mblimër, një folje apo ndajfolje, edhe kompozita e re e formuar do të jetë respektivisht, emër, mblimër, folje apo ndajfolje, si p.sh. :

die Reise + <i>der Führer</i>	→	<i>der Reiseführer</i> (udhërrëfyes)
die Reise + <i>das Büro</i>	→	<i>das Reisebüro</i> (agjenci udhëtimi)
die Reise + <i>die Decke</i>	→	<i>die Reisedecke</i> (batanije udhëtimi)
die Reise + <i>die Kosten</i> (sh.)	→	<i>die Reisekosten</i> (shpenzimet e udhëtimit)
der Zucker + <i>süß</i>	→	<i>zuckersüß</i> (sheqer i ëmbël)
schreiben + <i>faul</i>	→	<i>schreibfaul</i> (që përton të shkruaj)
frei + <i>halten</i>	→	<i>freihalten</i> (mbaj të lirë)
der Teil + <i>nehmen</i>	→	<i>teilnehmen</i> (marr pjesë)
der Berg + <i>ab</i>	→	<i>bergab</i> (tatëpjetë)
überall + <i>her</i>	→	<i>überallher</i> (nga të gjitha anët)

Por gjymtyra e përcaktuar (Grundwort) nuk përcakton vetëm përkatësinë kategoriale të kompozitës në një pjesë të caktuar të ligjeratës. Në pjesën më të madhe të rasteve²⁵³ ajo

²⁵³ Përrjashtim bëjnë kompozitat e pronësisë ose Bahuvrihi (Possessivkomposita)

përcakton edhe kuptimin leksikor të kompozitës. Kështu për shembull është gjymtyra “Tür” (derë) ajo që përcakton se si *Haustür* ashtu edhe *Schranktür* e *Autotür*, janë dyer, edhe pse lloje të ndryshme dyersh, e para është *derë shtëpie* (Tür eines Hauses) e dyta *derë dollapi* (Tür eines Schranks) dhe e treta *derë makine* (Tür eines Autos). Ndërsa gjymtyra përcaktuese është gjymtyra karakterizuese që i dallon këto tri dyer nga njëra-tjetra.

Ndryshe nga sa pamë për kompozitën këpujore, në teorinë mbi fjalëformimin dhe në gramatologji nuk ka diskutime lidhur me çështjen e theksit të kompozitës përcaktore. Gjuhëtarët ndajnë të njëjtin mendim dhe mbajnë të njëjtin qëndrim duke përcaktuar gjymtyrën përcaktuese (*Bestimmungswort*) si mbartësen e theksit kryesor (*Hauptakzent*) dhe gjymtyrën e përcaktuar (*Grundwort*) si mbartëse të theksit dytësor (*Nebenakzent*). Kjo lidhet edhe me veçorinë e theksit në gjuhën gjermane, i cili përgjithësisht bie në fillim të fjalës.

Ashtu si kompozitat këpujore edhe kompozitat përcaktore shkruhen bashkë. Prirja për t’i shkruar bashkë kompozitat e gjermanishtes vihet re që në fillim të shekullit XV, e cila zbehet në mesin e shekullit të XVI, për t’u theksuar sërish në gjysmën e dytë të tij. Deri në shekullin e XVIII përdoret shpesh viza lidhëze për kompozitat e reja.²⁵⁴

Por ndryshe nga kompozitat këpujore rendi i gjymtyrëve të kompozitave përcaktore është i mirëpërcaktuar dhe nuk mund të ndryshojë as teorikisht pasi një gjë e tillë ose do të prishte kompozitën, ose do të shkaktonte ndryshim semantik të saj duke formuar një kompozitë të re, sepse gjymtyra e përcaktuar kthehet në gjymtyrë përcaktuese dhe e kundërta.

Kështu p.sh. në rastet e fjalëve: *Eisenbahn* (hekurudhë), *Unterrichtsstunde* (orë mësimore) apo *Kinderzimmer* (dhomë fëmijësh) ndryshimi i rendit të gjymtyrëve është i pamundur. Fjalët “Bahneisen”, “Stundenunterricht” apo “Zimmerkinder” nuk ekzistojnë.

Ndërsa më poshtë kemi të bëjmë me fjalë të reja.

<i>Filmmusik</i> (muzikë fimi) një film ndërsa	→	është muzika e kompozuar posaçërisht për një film
<i>Musikfilm</i> (film muzikor)	→	është një film me shumë skena muzikore
<i>Wandschrank</i> (dollap në mur) ndërsa	→	është një dollap i ndërtuar brenda në mur
<i>Schrankwand</i> (mur prej dollapi) dollapësh	→	është një mur i formuar me elemente dollapësh
<i>Dachziegel</i> (tjegull çatie) ndërsa	→	është një tjegull që përdoret për çati
<i>Ziegeldach</i> (çati me tjegulla) tjegulla	→	është një lloj çatie, një çati e ngritur me tjegulla

²⁵⁴ P. von Polenz, *Deutsche Sprachgeschichte vom Spätmittelalter bis zur Gegenwart*, Band I, Berlin, 2000, f. 194

Një tip të veçantë brenda grupit të kompozitave përcaktore përbëjnë kompozitat ekzocentrike ose pronësore (*Possessivkompositum*), të cilat njihen ndryshe edhe me emrin *bahuvrihi*. Këto kompozita përbëjnë një tip të veçantë, pasi edhe pse gjymtyrët e tyre ndodhen në marrëdhënie përcaktore me njëra-tjetrën, gjymtyra e përcaktuar nuk emërton një klasë të caktuar ku të përfshihet edhe kjo gjymtyrë²⁵⁵, por diçka që ndodhet jashtë kompozitës, ndaj dhe ato quhen kompozita ekzocentrike (exozentrische Komposita).

Gjymtyra e dytë e fjalës së përbërë *Hängebauch* (bark që varet) emërton një lloj barku (*Bauch*), brenda klasës së këtij emri, ndërsa në kompozitën *Dickbauch* (barkmadh), e njëjta gjymtyrë emërton një person, pikërisht një njeri që e ka barkun të madh. E njëjta gjë ndodh edhe në rastet e fjalëve *Rotkehlchen* (gushëkuq) dhe *Löwenzahn* (lule radhiqe), me anë të të cilave nuk emërtohet një gushë e kuqe apo një dhëmb luani, por një lloj zogu, i cili karakterizohet nga gusha e kuqe dhe një lloj bime.

Kompozita të tjera pronësore janë edhe: *Bleichgesicht* (verdhacuk), *Dickwanst* (trashaluq), *Dickkopf* (kokëfortë), *Graukopf* (thinosh/kokëthinjur) *Milchgesicht* (buzqumësht), *Neunauge* (lloj peshku), *Ziegenbart* (mjekërrcjav), *Rittersporn* (lloj bime), *Rothaut* (lëkurëkuq), *Schlappschwanz* (zorraq), *Schreihals* (poteremadh), *Schöngeist* (njeri me shpirt artistik), *Starrkopf* (kokëfortë), *Wirrkopf* (njeri mendjehumbur/hutaq) etj.

Kompozitat pronësore emërtojnë kryesisht persona, bimë e kafshë. Numri i kompozitave emërore pronësore të gjuhës gjermane është rrudhur si pasojë e zëvendësimit të tyre me fjalë të formuara me kompozim dhe prapashtesim (bëhet fjalë për prapashtesën *-er*) si p.sh. *Dickhäuter* (kafshë lëkurëtrashë/lëkurëtrashë), *Dickschnäbler* (zog sqeptrashë/sqeptrashë) apo *Tausendfüßler* (shumëkëmbësh) etj.

Kompozitat pronësore i gjejmë kryesisht si emra, ndërsa si mbiemra ky model fjalëformimi nuk është më as prodhimtar dhe as aktiv në gjuhën gjermane, pasi edhe ky grup ashtu sikurse në rastin e kompozitave pronësore emërore, është zëvendësuar nga mbiemra me prapashtesën *-ig*: *kurzbeinig* (këmbëshkurtër), *hartköpfig* (kokëfortë), *langbeinig* (këmbëgjatë), *hochnäsiger* (hundëpërpjetë) etj.

I vetmi mbiemër i këtij lloji, të cilin *Fleischer-i/Barz-i*²⁵⁶ e quajnë relikte, ka mbetur *barfuß* (zbathur/këmbëzbathur), krahas së cilit ekziston edhe version *barfüßig*.

III.1.4. Kompozita në kufij

Çështja e kufijve mes kompozitave këpujore dhe atyre përcaktore mbetet një çështje e diskutueshme në teorinë e fjalëformimit gjerman. Kompozita të tipit *Hosenrock* (fundpantallona), *Radiowecker* (radio me zile), *Radiouhr* (orë radio), *Kinocafé* (kinema e kafene), *Strumphose* (geta) apo *Dichterkomponist* (poet-kompozitor) kanë hyrë në teorinë e fjalëformimit si kompozita këpujore.

*Fleischer-i*²⁵⁷ teksta flet për kompozitat këpujore thekson dhe dy tipare të rëndësishme që i dallojnë ato nga kompozitat përcaktore:


²⁵⁵ *Fleischer/Barz*, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 2007, f.125

²⁵⁶ *Fleischer/Barz*, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 2007, f.225

²⁵⁷ *W. Fleischer*, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Leipzig, 1983, 109

Së pari, marrëdhënien bashkërenditëse të gjymtyrëve të kompozitës këpujore, gjë që mundëson të paktën teorikisht shkëmbimin e vendit të gjymtyrëve të saj; ndërsa tipari i dytë ka lidhje me faktin se gjymtyra e dytë nuk mund ta përfaqësojë semantikisht gjithë fjalën e përbërë siç ndodh me kompozitat përcaktore.

Duke u nisur nga sa thamë më lartë edhe dallimi mes kompozitës *schwarzweiß* (bardhezi) = *schwarz und weiß* (i bardhë dhe i zi) dhe *Schneeweiß* (i bardhë borë) *weiß wie der Schnee* (i bardhë si borë) është më se i qartë, pasi e para i plotëson kushtet e një kompozite këpujore, ndërsa e dyta të një kompozite përcaktore. Këto dy karakteristika të kompozitave këpujore nuk vihen në diskutim nga gjuhëtarët. Diskutimi dhe qëndrimet e tyre ndahen lidhur me modelin e perifrazimit dhe shpjegimit që u bëhet kompozitave për të përcaktuar në janë këpujore apo përcaktore. Duke analizuar qëndrimet e gjuhëtarëve të tjerë si Ortner, Breindl/Thurmair, Eichinger, Fliesher/Barz etj., Donalies-i²⁵⁸ arrin në përfundimin se kompozitat këpujore emërore dhe foljore, këto të fundit dhe shumë të rralla, mund të lexohen edhe si kompozita këpujore edhe si kompozita përcaktore, në varësi të modelit që zgjidhet për perifrazimin e tyre:



Por ajo pranon qartë dhe nuk diskuton ekzistencën e disa mbiemrave, të cilët “*können nur mit dem Modell Kopulativkompositum erklärt werden*”²⁵⁹ / mund të shpjegohen vetëm me modelin e kompozitës këpujore, si p.sh. *armenisch-deutsch* (armenogjerman).

Pavarësisht interpretimeve dhe modeleve që zgjidhen për perifrazimin e kompozitave këpujore, mendojmë se për t’i klasifikuar kompozitat në kufij në një nga llojet e kompozitave, në kompozita përcaktore apo këpujore, duhet të mbështetemi te të gjitha tiparet që i dallojnë këto kompozita nga njëra-tjetra. Rendi i gjymtyrëve dhe mundësia për ndryshimin e tij nuk mendojmë se është një tipar i cili do të na ndihmonte shumë në të gjitha rastet, për aq kohë sa ai është i kushtëzuar edhe nga përdorimi në gjuhë duke u finalizuar më pas edhe me pasqyrimin në fjalor. Rolin kryesor në këtë çështe, sipas nesh

²⁵⁸ E. Donalies, *Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick*, Tübingen, 2002, f. 87

²⁵⁹ Donalies, vepër e cituar prej Donalies, po aty, f. 87

do ta luante gjymtyra e dytë. Nëse kjo gjymtyrë arrin ta përfaqësojë semantikisht të gjithë kompozitën atëherë kompozita është më pranë tipit përcaktor. Lidhur me kompozitat e sipërpërmendura nuk mendojmë se ato e plotësojnë këtë kriter si në rastin e kompozitës *Strumpfhose (geta)* apo *Radiowecker (orë me zile dhe radio)*, pasi fjalët *Hose* (pantallona) dhe *Wecker* (orë me zile) nuk arrijnë ta përfaqësojë të gjithë kompozitën. Edhe nëse do t'i referoheshim fjalorit, në atë Duden "*Deutsches Universalwörterbuch*" për fjalën *Radiowecker* gjejmë shpjegimin e mëposhtëm:

Radiowecker: *Gerät, das eine Kombination von Radio und Wecker darstellt* / Aparat, i cili paraqet kombinimin e një radioje dhe një ore me zile.

Nga ky shpjegime del qartë rendi bashkërenditës i gjymtyrëve të kësaj kompozite.

Ndërsa Fleischer-i/Barz-i²⁶⁰ njohin dy tipe kompozitash të cilat "*stehen an der Peripherie der Determinatikomposition.* / qëndrojnë në periferi të kompozicionit përcaktor."²⁶¹ Ky tip kompozitash u afrohet atyre këpujore, pasi gjymtyra e dytë mund të interpretohet apo lexohet edhe si e bashkërenditur me gjymtyrën e parë. Por gjithsesi ata mendojnë se këto kompozita nuk i përmbushin plotësisht dy tiparet kryesore të tyre, të cituara në fillim të kësaj nënçështjeje, ndaj dhe i klasifikojnë si përcaktore.

Si të tilla Fleischer-i/Barz-i klasifikojnë disa kompozita emërore, me gjymtyrë emërore, nga të cilat e para emërton persona si p.sh. "*Schwester*" *Schwesterschiff* (anije motër) apo "*Bruder*" *Bruderland* (vend vëlla).

Edhe në grupin e dytë të kompozitave gjymtyrët janë emërtime personash, si p.sh.: *Mördergeneral* (general vrasës), *Gastdozent* (docent që ushtron aktivitetin e tij për një periudhë të caktuar në një tjetër universitet), *Gaststudent*, *Lehrerforscher* etj.

Me të drejtë autorët i klasifikojnë këto kompozita në tipin e kompozitave përcaktore, pasi interpretimi këpujor i tyre, *Mördergeneral: General und Mörder gleichzeitig* (edhe general edhe vrasës njëkohësisht), apo *Lehrerforscher: Lehrer und Forscher gleichzeitig* (edhe mësues edhe hulumtues njëkohësisht) edhe pse në dukje i mundshëm nuk është i pranueshëm pasi nga të dyja gjymtyrat e kompozitës është e dyta ajo që mban dhe peshën kryesore semantike të gjithë kompozitës. Një *Schwesterschiff* (*Schiff gleicher Bauart*/anije e njëjtë për nga ndërtimi) / anije motër, identifikohet me gjymtyrën e dytë të kompozitës, pra është në radhë të parë një anije, sikurse një *Mördergeneral* (general vrasës) është në radhë të parë një general. Madje ndryshimi i rendit të gjymtyrëve të shembullit të fundit do të kishte si rezultat një kompozitë të re me tjetër kuptim, *Generalsmörder = Mörder eines Generals* (vrasës gjenerali = vrasës i një gjenerali).

III.1.5. Kompozita të veçanta

Kompozitat e tipit *Input-Output-Analyse*, *Herz-Kreislauf-Erkrankung*, të cilat në gjermanishte njihen si "*Durchkopplungen*", janë kompozita përcaktore, gjymtyra e parë e të cilave është e shprehur me një grup fjalësh, ne pjesën më të madhe të rasteve me dy emra, të cilët janë të bashkërenditur me njëre-tjetrën dhe të dy bashkë përcaktojnë gjymtyrën e dytë. Pra gjymtyra e dytë është gjymtyra bazë për të dy komponentën e

²⁶⁰ Fleischer/Barz, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 2007, f. 129

²⁶¹ Fleischer/Barz, po aty.

gjymtyrës së parë. Komponentët dhe gjymtyrët e kompozitive të tilla bashkohen me anë të vizave lidhëse:

Herz-Lungen-Maschine = Maschine, die für eine kürzere Zeit die Funktion des Herzens und der Lunge übernimmt.

Në një pjesë të mirë të rasteve komponentët e gjymtyrës së parë lidhen edhe me lidhëzën bashkërenditëse *und*, e cila nuk përdoret për të zëvendësuar vizën lidhëse, por përforcon më tepër marrëdhënien e dy komponentëve të gjymtyrës së parë:

Arbeiter-und –Soldaten-Rat = aus Arbeitern und Soldaten gebildeter Rat

Gjymtyra e parë mund të ketë në përbërjen e saj më shumë se dy komponentë:
Hals-Nasen-Ohr-Arzt

Në disa raste kuptimi i këtyre kompozitive motivohet nga kuptimi i përbërësve të tyre, si shembulli i mësipërm, por ka dhe raste kur kompozita është e leksikalizuar, si p.sh.

Vogel-Strauß-Politik = Art des Verhaltens, bei der man eine Gefahr nicht sehen will.

Këto kompozita janë pjesë e terminologjisë dhe formime rastësore. Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” ky tip kompozite nuk e kalon shifrën 50:

Wach-und Schließgesellschaft, Start-und-Lande-Bahn, Schwarz-Weiß-Malerei, Schwarz-Weiß-Aufnahme, Schwarz-Weiß-Fernseher, Rot-Grün-Blindheit, Preis-Leistungs-Verhältnis, Nutzen-Kosten-Analyse, Nacht-und-Nebel-Aktion, Mantel-und Degen-Film, Katz-und-Maus-Spiel etj.

III.2. Elementet lidhëse të gjymtyrëve të kompozitive

Në shumë raste elementet përbërëse të kompozitive lidhen me tinguj ose njësi tingullore, për të cilat në teoritë mbi fjalëformimin gjenden emërtimet: *Fugenelemente*²⁶² *Fugenzeichen*²⁶³, *Fugenmorphemen*²⁶⁴ apo thjesht *Fugen* (hapësirë)²⁶⁵. Më i parapëlqyeri

²⁶² 262 Duden në: Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998; L.M. Eichinger në: Deutsche Wortbildung: Eine Einführung, Tübingen, 2000; Fleischer/Barz në: Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007; W. Jung në: Grammatik der deutschen Sprache, Leipzig, 1988; Römer/Matzke në: Lexikologie des Deutschen: Eine Einführung, Tübingen, 2005; T. Schippan në: Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 1992


²⁶³ J. Erben në: Einführung in die deutsche Wortbildung, Berlin, 2006

²⁶⁴ P. Gallamann në: Fugenmorpheme als Nicht-Kasus-Suffixe, në: *Germanische Linguistik*, 1999, f 176 – 190, i cili krahas këtij termi përdor dhe termin më të përdorur “*Fugenelemente*”


dhe më shumë i përdoruri mes tyre duket të jetë emërtimi i parë. Pavarësisht nga emërtimet e ndryshme që gjuhëtarët kanë gjetur për këtë element me rëndësi brenda kompozitës, ata janë të një mendjeje dhe mbajnë të njëjtin qëndrim lidhur me funksionin dhe karakteristikat e tij brenda kompozitës.

Kompozitat e mëposhtme kanë këtë përbërje strukturore:


Topfblume (lule saksie):



Bundesstaat (shtet federal)



Sonnenschirm (çadër dielli)



Siç mund të vihet re edhe nga shembujt, kompozitat e gjuhës gjermane formohen me ose pa pjesëmarrjen e një elementi lidhës. Sipas Duden-it²⁶⁶ të cilit i referohen edhe shumë gjuhëtarë të tjerë në punimet e tyre mbi këtë temë, pjesa më e madhe e kompozitave të gjuhës gjermane kanë në përbërjen e tyre vetëm gjymtyrën përcaktuese dhe gjymtyrën e përcaktuar. Gati një e treta e tyre, rreth 30% realizon bashkimin e temave fjalëformuese me pjesëmarrjen e ndonjë elementi lidhës, të cilët nuk kanë asnjë kuptim semantik ndaj edhe nuk mund të quhen infikse. Schippan-i quan një element të tillë “*leeres Morph*” / morf të zbrazur, pa ndonjë ndikim në kuptimin e kompozitës duke u bërë kështu pjesë e strukturës fonemore të fjalës, por jo e asaj semantike.²⁶⁷

²⁶⁵ P. Eisenberg në: *Das Wort: Grundriss der deutschen Grammatik*, Stuttgart-Weimar, 2006 si dhe H. Weinrich në: *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Hildesheim, 2007, i cili krahas këtij termi përdor edhe termin më shpesh të ndeshur në teoritë e fjalëformimit “*Fugenelemente*”

²⁶⁶ Duden, *Die Grammatik*, Band 4, Mannheim, 1998, f. 494

²⁶⁷ T. Schippan, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, 1992, f. 84

Pra elementet lidhëse nuk kanë as kuptim gramatikor dhe as kuptim semantik. Në disa raste ato ngjajnë me mbaresat e eptimit, por edhe pse e kanë prejardhjen pikërisht prej tyre, në planin sinkronik nuk kanë lidhje me to.

Gjuhëtarët prejardhjen e këtyrë elementeve e shohin te morfemat trajtëformuese, të cilat kryenin një funksion gramatikor siç është për shembull ai rasës gjinore për *-s/ -es* apo *-en* në rastet si *Berufserfahrung, Jahresanfang, Bärenkraft*. Bëhet fjalë për kompozitat që e kanë origjinën e tyre në përngjitjen e togefjalëshave, si p.sh. *Herzensqual*/brenjë. Këto fjalë të përngjitura edhe pas kalimit të tyre në kompozita, e kanë ruajtur strukturën e tyre bashkë me morfemat trajtëformuese, të cilat me kalimin e kohës e humbën funksionin dhe kuptimin gramatikor dhe “*sind als ‘erstarrte’ Flexionsendungen anzusehen/duhet të trajtohen si mbaresa eptimi të ngurrosura.*”²⁶⁸ Në analogji me to janë formuar më pas edhe kompozita të tjera, të cilat e gjejmë elementin *-s-* me origjinë nga morfema trajtëformuese e gjinore së emrave mashkullorë dhe asnjans, ndonëse gjymtyra e parë është një emër femëror dhe si i tillë nuk e formon rasën gjinore të numrit njëjës me morfemën trajtëformuese *-s*, siç ndodh në rastet e fjalëve *Übungsbuch* / libër ushtrimesh, *Kindheits Erinnerung* / kujtim fëmijërie, *Freiheitsheld* / heroi i lirisë.

Në disa raste elementet lidhëse shërbejnë për të lehtësuar shqiptimin e kompozitës, si p.sh.: *Geburtstag*/ditëlindje, *Blutstropf*/pikë gjaku, por kjo nuk ndodh gjithnjë, sepse ka mjaft raste ku elementi lidhës mungon, si p.sh.: *Stadtteil*/rajon qyteti apo *Blutdruck*/tension gjaku.

Por edhe pse elementet lidhëse nuk janë mbartës kuptimor, ato në disa raste kanë funksion dallues pasi shërbejnë për të dalluar dy kompozita të ndryshme, si p.sh. *Kindbett* / lehoni dhe *Kinderbett* / krevat fëmijësh, ose tregojnë se gjymtyra përcaktuese është në numrin shumës si në rastin e fjalëve *Strahlenkranz = Kranz von Strahlen* / kurorë rrezesh, *Kinderbuch = für Kinder geschriebenes Buch* / libër fëmijësh (libër shkruar për fëmijë). Por këtë element lidhës e gjejmë edhe pas gjymtyrëve përcaktuese që kanë kuptimin e një emri në numrin njëjës, si p.sh. *Sonnenaufgang* / lindje e diellit = *das Aufgehen der Sonne am Morgen* (shfaqja e diellit në mëngjes), *Eulenflug* / fluturim kukuvaçke = *der Flug der Eule* (fluturimi i kukuvaçkës).

Në disa raste gjejmë variante të të njëjtës kompozitë me element lidhës dhe pa element lidhës, ose variante të së njëjtës kompozitë me elemente të ndryshme lidhëse. Arsyet mund të jenë të ndryshme, stilistikore apo edhe dialektore *Abfahrtsignal/Abfahrtssignal* (sinjal nisjeje), *Achtelfinal* / çerekfinale (në Gjermani) / *Achtelsfinal* (në Zvicër), *Waldrand* / skaj pylli (stili neutral) / *Waldesrand* (stili letrar), apo në rastet *Schweinebraten* / *Schweinsbraten* (mish i pjekur derri), *Rinderbraten* / *Rindsbraten* (mish i pjekur gjedhi).

Ndonjëherë bëhet elementi lidhës njësi dalluese për dy kompozita të ndryshme me gjymtyrë të njëjta, si në rastin e mëposhtëm:

Geschicht – **en** – buch → *Geschichtenbuch* = Buch mit Geschichten / libër me histori

Geschicht – **s** – buch → *Geschichtsbuch* = Lehrbuch für das Schulfach Geschichte / libri shkollor i lëndës së historisë

²⁶⁸ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, 495

Në të vërtetë elementet lidhëse, edhe pse në rrafsh diakronik burojnë nga njësi morfemore, në rrafsh sinkronik, përgjithësisht, dalin si elemente me vlerë bashkuese. Në rastet e formimeve, ku ato luajnë rol kuptimdallues, si shembulli i mësipërm, nuk kemi të bëjmë me vlera në vetvete, por me vlera të fituara a të ndërfituara me synime kuptimdalluese.

Siç u trajtua dhe më lart, elementet lidhëse zakonisht janë të varura nga gjymtyra përcaktuese (Bestimmungswort). Ato shënojnë në një mënyrë edhe kufijtë mes gjymtyrëve të kompozitës, por pa ndikuar aspak në kuptimin e tyre apo të vetë kompozitës.

Elementet lidhëse të gjuhës gjermane që marrin pjesë në formimin e kompozitave janë: **-(e)s-**, **-e-**, **-(e)n-**, **-(e)ns-**, **-er-** si dhe dy elemente lidhëse të huaja **-o-** dhe **-i-**, kjo e dyta me përdorim shumë të kufizuar. Këto elemente i gjejmë në pjesën dërrmuese të rasteve në kompozita me gjymtyrë përcaktuese emërore dhe më rrallë në kompozita me gjymtyrë përcaktuese foljore. Te këto të fundit merr pjesë vetëm elementi lidhës **-e-**. Sipas Duden-it²⁶⁹ 80-90% e kompozitave me gjymtyrë përcaktuese një folje nuk kanë element lidhës. Në rastet e shfaqjes së këtij elementi rol luan bashkëtingëllorja fundore e rrënjës së gjymtyrës foljore. Kështu elementin lidhës **-e-** e gjejmë kryesisht pas foljeve, rrënja e të cilave përfundon me **-d**, **-g**, **-s** apo **-t**, si p.sh.:

Badeanzug, Badearzt, Badegast etj.; *Hängeboden, Hängebrücke, Hängedach* etj.; *Sterbeamt, Sterbebett, Sterbebuch, Sterberate* etj.; *Warteliste, Warteraum, Wartezimmer* etj.; *Werbeabteilung, Werbeagentur, Werbeaktion, Werbeantwort, Werbeaussage* etj.

Ndërsa pas gjymtyrës përcaktuese foljore shfaqet vetëm elementi lidhës **-e-**, pas gjymtyrës përcaktuese emërore të kompozitave shfaqen të gjitha elementet lidhëse të gjermanishtes.

Sipas Duden-it në pjesën më të madhe të rasteve gjejmë elementin lidhës **-(e)s-**, i cili shfaqet jo vetëm kur gjymtyra përcaktore është një emër i gjinisë asnjansë apo asaj mashkullore, zakonisht një emër formuar me parashetsën **Ge-**, apo paskajore e emëruar, por edhe në rastet kur ajo shprehet me një emër të gjinisë femërore, i cili është formuar nga prapashtesat **-heit**, **-keit**, **-schaft**, **-ung** apo **-t**. Ja disa shembuj të kompozitave me element lidhës **-(e)s-**:

Abteilungsleiter, Ansichtskarte, Altertumswert, Angriffswaffe, Ankunftszeit, Arbeitswoche, Befehlsform, begeisterungsfähig, Blitzesschnelle, Bootslänge, Bundesregierung, Durchgangsstraße, Echtheitsnachweis, Empfangsantenne, erstrebenswert, Freiheitsheld, Freundschaftsspiel, Frühlinglied, Geburtstag, Gebrauchsanweisung, geltungssüchtig, gemenischtschaftsbezogen, Gesprächsthema, gesundheitschädigend, Handelsvertrag, kooperationsbereit, landesüblich, Liebesbrief, Organsationsstruktur, Prüfungstermin, Rechtsanwalt, tagesaktuell, Tageszeitung, Verkehrsschild, Wirtschaftskrise, Zufallsprinzip etj.

²⁶⁹ Duden, vepër e cituar, f. 496

Thuajse po aq shpesh sa dhe elementin lidhës të shqyrtuar më sipër, gjejmë në kompozita edhe elementin lidhës *-(e)n*. Kur gjymtyra përcaktuese mbaron me zanoren *-e*, atëherë ndeshim variantin *-n-* të këtij elementi lidhës, i cili e ka prejardhjen nga morfemat trajtëformuese të rasave të njëjësit dhe atyre të numrit shumës të emrave të lakimit të butë²⁷⁰. Por atë e gjejmë jo vetëm te emrat që i nënshtrohen këtij tipi, por edhe te disa emra të tjerë që e formojnë shumësin me mbaresën *-en*, te emra të gjinisë mashkullore dhe emra asnjans formuar me prapashtesa të huazuara.

Affenkäfig, Autorenfilm, Bärenfell, Datenbank, Dokumentensammlung, Expertengruppe, Farbenindustrie, Fürstenkrone, Grafentitel, Hasenjagd, Hirtenflöte, Heldenmut, Interessengruppe, Jungenklasse, Kollegenkreis, Kundenberatung, Löwenkraft, Maschinenfabrik, maschinengeschrieben, menschenähnlich, Menschenfeind, Mückenstich, Nachrichtenagentur, Ochsenblut, Patengeschenk, rabenschwarz, rentenpflichtig, Soldatenfriedhof, Studentenausweis, seitenrichtig, Studienplatz, Tatendrang, Tiefenzone, Zeugenbefragung, Zitatelexikon etj.

Elementi lidhës **-er-** nuk ndeshet aq shpesh sa dy elementet e lartpërmendur, por e gjejmë pas atyre gjymtyrëve përcaktuese që shprehen me emra, të cilët e formojnë shumësin me këtë mbaresë, por kjo nuk do të thotë se fjala përcaktuese duhet kuptuar gjithnjë si shprehëse e numrit shumës edhe brenda kompozitës. Shohim dy rastet e mëposhtme:

Bücherregal (raft librash)	=	Regal zum Aufstellen von Büchern (raft për vendosjen e librave)
Hühnerfleisch (mish pule)	=	Fleisch vom Huhn (mish pule)

(Duden, Deutsches Universalwörterbuch A-Z)

Në pjesën më të madhe të rasteve si gjymtyrë përcaktuese gjejmë emra të gjinisë asnjansë dhe më pak të gjinisë mashkullore:

Blätterwald, Bildersprache, Brettergerüst, Eierlöffel, Geistergeschichte, Geschlechterfolge, Gespensterschiff, Gliedersatz, Gräberfeld, Häuserblock, Hühnerbein, Kräutertee, Kinderauge, Kinderfilm, Kleiderbürste, Ländername, Liederabend,

²⁷⁰ Në gjuhën gjermane dallohen dy tipe kryesore lakimi: *die starke Deklination*/lakimi i fortë dhe *die schwache Deklination*/lakimi i butë. Karakteristikë e lakimit të butë është mbaresa *-(e)n* që merr emri në rasën gjinore, dhanore dhe kallëzore dhe në numrin shumës. Si p.sh:

	Nr. njëjës	Nr. shumës
emërore	der Mensch	die Menschen
gjinore	des Menschen	die Menschen
dhanore	dem Menschen	den Menschen
kallëzore	den Menschen	die Menschen

Männerberuf, Rinderfilet, Schilderwald, Völkername, Weiberfeind, Wörterbuch, Badewanne, Bindeglied etj.

Edhe elementi lidhës –e- shfaqet vetëm te kompozitat, gjymtyra përcaktuese e të cilave shprehet me emra, të cilët e formojnë shumësin me mbaresën –e. Bëhet fjalë për pak emra të të trija gjinive, kryesisht mashkullore e asnjëse dhe më pak femërore, por duhet thënë se ky element lidhës ndeshet më shumë pas gjymtyrëve përcaktuese foljore.

Hundehütte, Gänsebraten, Gästebuch, Geräteübung, Getränkeautomat, Händedruck, Kräfteverfall, Mausefalle/Mäusefalle, Pferderennen, Städteplanung, Schweinebauch, Tagebuch, Wegebau etj.

Një tjetër element lidhës të cilin e ndeshim vetëm kur në kompozitë gjymtyrë përcaktuese është emri “*Herz*”, “*Name*” dhe “*Wille*” është –ens-, i cili e ka burimin në rasën gjinore të njëjësit të këtyre emrave. Kompozitat që kanë në përbërjen e tyre këtë element janë edhe më të pakta se ato të dy grupeve të mësipërme. 21 janë kompozitat që kanë si gjymtyrë të parë “*Herz*”, 20 janë ato me “*Name*” dhe 12 me “*Wille*”, që gjenden të pasqyruara në fjalorin e Duden-it “*Deutsches Universalwörterbuch*”. Në vijim disa prej tyre:

Herzensangelegenheit, Herzensangst, Herzensbildung, Herzensbrecher, Herzensfreude, Herzensfreund, Herzenskind, Herzenslust, Herzensnot, Herzenssache, Herzenstrost, Herzenswärme, Herzenswunsch etj.; *Namensaktie, Namensänderung, Namenspapier, Namensschild, Namensträger, Namensweihe, Namenszeichen, Namenszug* *Namenverzeichnis* etj. *Willensakt, Willensäußerung, Willensbildung, Willensfreiheit, Willenskraft, Willensschwäche, willensstark* etj.

Dy elementet lidhëse të vetme të huazuara janë –o- dhe –i-, të cilat shfaqen kryesisht të lidhura me fjalë gjithashtu të huazuara. Të dyja këto elemente lidhëse rrjedhin nga latinishtja. Ndërsa i pari ndeshet më shumë, kompozitat me elementin lidhës –i- janë shumë më të rralla, përmendim këtu fjalën *Handikap*, huazim nga anglishtja. I ndeshim te kompozitat mbiemërore këpujore, në të cilat elementi lidhës parapëlqehet edhe për arsye stilistikore, duke shmangur përdorimin e dy mbiemrave me prapashtesën –isch²⁷¹. Atë e gjejmë edhe në ato kompozita gjymtyra e parë e të cilave është një konfiks (fjalë e huazuar) si Aero-, Chemo-Elektro- apo Techno-, por jo vetëm, siç tregohet edhe në shembujt e mëposhtëm:

anglo-amerikanisch, agro-industriell, audiovisuell, germano-slawistisch, magneto-optisch etj.; *Aerodynamik, aerodynamisch, Aeroklub, Aerometer, Aeropause, Aerosonde* etj.; *Chemokeule, Chemotechnik, Chemotherapie* etj.; *Elektroakustik, Elektroartikel, Elektroauto, Elektroberuf, Elektrogerät, Elektrogitarre, Elektrohandwerk, Elektroherd, Elektroindustrie, Elektrokocher, Elektromechanik, Elektromechaniker* etj.; *Technologie, Kristallographie, Gasometer* etj.

²⁷¹ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 251

Elementet lidhëse i gjejmë edhe te kompozitat e formuara nga më shumë se dy tema motivuese, madje në disa prej tyre temat motivuese lidhen me elemente te ndryshme lidhëse duke shfaqur po ato fenomene gjuhësore që u trajtuan pak rreshta më lart:

Aufsichtsratsvorsitzende, Augenblicksbildung, Augenblickssache, Augenbrauenstift, Augenzeugenbericht, Ausbildungsförderungsgesetz, Architektenwettbewerb, Bauherrenmodell, Beitragsbemessungsgrenze, Berufsfeuerwehr, Betriebskrankenkasse, Bildschirmarbeitsplatz, Bindegewebsfaser, Blutgruppenuntersuchung, Bundesnachrichtendienst, Dreifelderwirtschaft, Dreiwegkatalysator, Drogenberatungsstelle, Zentralnervensystem, Wochenarbeitszeit etj.

Një tjetër qëndrim mban Donalies-i lidhur me elementet lidhëse të gjymtyrëve të fjalëve të përbëra. Ajo duke u nisur nga teoria sipas së cilës “*die Ersteinheit eines komplexen Wortes kann ein Stamm, aber auch eine flektierte Wortform sein. Sie ist immer eine flektierte Wortform, wenn das Flexionsparadigma der Ersteinheit diese Form enthält /* komponenti i parë i një fjalë komplekse mund të jetë një temë fjalëformuese por edhe një fjalë e eptuar. Kemi të bëjmë me një fjalë të eptuar kur ajo është një formë e paradigmes së komponentit të parë të fjalës së përbërë”²⁷², pranon si elemente lidhëse vetëm ato elemente, të cilat nuk janë pjesë të eptimit të gjymtyrës së parë të fjalës së përbërë, siç është p.sh. elementi –s- në rastin kur atë e paraprin një gjymtyrë përcaktuese e shprehur me një emër të gjinisë femërore, pasi ky element nuk është pjesë e paradigmes së emrave femërorë: *emotionsstark, Geschwindigkeitsrausch, Hochzeitstorte* etj., si dhe elementet lidhës –o- dhe –i-. Një konceptim i tillë i lidh ato me fjalët me përngjitje.

Në këtë punim mbështetemi në qëndrimin e gjuhëtarëve të tjerë duke pranuar si elemente lidhëse ato të trajtuara më lartë, pasi për ne kompozitat formohen nga bashkimi i temave motivuese.

Një grup të veçantë përbëjnë kompozitat gjymtyrët e të cilave lidhen më njëra-tjetrën më një vizë lidhëse (*Bindestrich*). Vizën lidhëse e shqyrtoam edhe te kompozitat këpujore. Sipas drejtshkrimit të gjuhës gjermane (*deutsche Rechtschreibung*) me vizë lidhëse shkruhen: kompozitat me gjymtyrë të parë një shkurtesë (*EU-Bürger / qytetar i BE-së, Kfz-Werkstatt / ofiçinë për automjete*); kompozitat me gjymtyrë të parë një gërmë (*x-Achse / boshti x, O-Beine / këmbë shumë të shtrembëruara*). Gjithashtu viza lidhëse mund të vendoset edhe te kompozitat, gjymtyrët e të cilave kanë ngjashmëri tingëllore, pasi një gjë e tillë mund të sillte problem në dallimin e kufijve të gjymtyrëve të tyre dhe në interpretimin e saktë të tyre²⁷³ (*Rad-Artisten* dhe jo *Radar-tisten/ akrobat në cirk që luan mbi rrotë, Druck-Erzeugnis* dhe jo *Drucker-Zeugnis / material i shtypur*). Të njëjtin funksion ndihmës dhe dallues do të luante viza lidhëse edhe për kompozitat e gjatë dhe të

²⁷² E. Donalies, *Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick*, Tübingen, 2002, f. 46

²⁷³ P. Gallmann, *Syngrapheme an und in Wortformen – Bindestrich und Apostroph im Deutschen*, në: *Germanische Studien 97, Schriftsystem und Orthographie*, Tübingen, 1989, f. 85-110

komplikuara formuar me shumë tema motivuese, si në rastin e kompozitës *Hochschul-Strukturkommission*²⁷⁴/ komisioni për strukturat e shkollave të larta .

Viza lidhëse vendoset edhe te një tip i veçantë shkurtesash, i cili krijohet si pasojë e reduktimit në gërmën nistore të gjymtyrës së parë të kompozitës, ndërkohë që gjymtyra e dytë mbetet e plotë. Në këtë tip shkurtesash viza lidhëse lidh gërmën nistore me pjesën tjetër të shkurtesës:

U-Bahn (Untergrundbahn), *U-Haft* (Untersuchungshaft)

III.3. Sindajshtesat dhe gjymtyrët e kompozitave në gjermanishte

Një tjetër çështje e diskuteshme mes gjuhëtarëve të gjuhës gjermane është ajo lidhur me sindajshtesat / gjysmëndajshtesat (Halbaffixe) ose afiksoidet (Affixoide), term që parapëlqehet dhe përdoret më shumë në teorinë e fjalëformimit të gjuhës gjermane. Në këto teori vihen re dy qëndrime lidhur me këtë çështje.

Disa gjuhëtarë të ndikuar edhe nga Schmidt²⁷⁵ nuk i shqyrtojnë në punimet e tyre dhe “*verzichten auf den Affixoidbegriff*”²⁷⁶ / heqim dorë nga koncepti i sindajshtesave/afiksoideve. Po kështu edhe Donalies-i nuk e pranon klasën e afiksoideve duke ndarë edhe ajo mendimin e Schmid-it se me krijimin e një grupi të tretë (atij të afiksoideve mes grupit të ndajshtesave dhe gjymtyrëve të kompozitave) nuk arrihet asnjë përfitim.²⁷⁷ Edhe Schippan-i shtron pyetjen “*Sind Halbaffixe oder Affixoide anzunehmen?*”²⁷⁸ / A duhen pranuar gjysmëndajshtesat ose afeksoidet?

Por në gjuhësi ekziston edhe një qëndrim tjetër lidhur me këtë çështje. Kjo çështje ka rëndësi veçanërisht për gjuhëtarët rusë²⁷⁹, të cilët nuk janë të vetëm. Afiksoidet pranohen

²⁷⁴ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 78

²⁷⁵ Sipas Donalies, vepër e cituar, f. 25, G.D. Schmidt-i në punimin e tij “Das Affixoid. Zur Notwendigkeit und Brauchbarkeit eines beliebten Zwischenbegriffs der Wortbildung” në: Deutsche Lehnwortbildung, Tübingen 1987, e ka shqyrtuar hollësisht çështjen e afiksoideve: “*Nach allem was ich über Affixoide gelesen habe, kann ich dem Begriff keine besondere Nützlichkeit zuerkennen. Zwar gibt es die Möglichkeit, schwierige Fälle von den leichten abzutrennen und der Entscheidung für die eine oder andere der vorhandenen Kategorien auszuweichen, doch bringt er damit keine Lösung, sondern nur einen Aufschub. Dazu kommt, dass bei dem Versuch, eine Grenze zwischen den Kern- und den Zwischenphänomenen zu ziehen, die Differenzierung so weit getrieben wird, dass am Ende ein recht kompliziertes Bild entsteht, das die angestrebte Verinfachung oder Erleichterung wieder aufhebt.* / Pas gjithë atyre që kam lexuar për sindajshtesat/afiksoidet, ky koncept më duket pa ndonjë dobi të veçantë. Faktikisht nëpërmjet tij krijohet mundësia e ndarjes së rasteve të vështira nga ato të lehta si dhe për të vendosur se cila nga kategoritë ekzistuese mund të shmanget. Kjo gjë nuk sjell ndonjë zgjidhje, por vetëm një shtyrje të saj. Gjithashtu në përpjekje për të qartësuar dhe vendosur kujt mes fenomeneve thelbësore dhe atyre të tërthorta, në vend të lehtësimeve krijohen situata gjuhësore dhe modele edhe më të komplikuara.”

²⁷⁶ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f.28

²⁷⁷ E. Donalies, Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick, Tübingen, 2002, f. 26

²⁷⁸ T. Schippan, Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 1992, f. 115

²⁷⁹ T. Schippan, vepër e cituar, f. 115

edhe nga disa gjuhëtarë gjermanë si hartuesit e Duden²⁸⁰, apo Motsch-i i cili shprehet: “*Besonders in der Nomen- und Adjektivenbildung gibt es zahlreiche Wortbildungen, von denen angenommen wird, dass sie weder eindeutig als Komposita, noch eindeutig als Derivaten zu analysieren sind.* / Veçanërisht në formimin e emrave dhe mbiemrave gjejmë një sërë fjalësh për të cilat pranohet se nuk mund të analizohen në mënyrë të qartë as si kompozita dhe as si derivate.”²⁸¹

Sindajshesat apo afiksoidet janë morfema të cilat nga njëra anë i gjejmë si fjalë të lira me kuptimin e tyre semantik dhe të gjitha karakteristikat që gëzon fjala, por nga ana tjetër ato shfaqen si një element brenda një vargu fjalësh me kuptim deri diku të çsemantizuar, duke shfaqur në këtë mënyrë karakteristika të ndajshesës/Affix-it. Pra, afiksoidet formojnë një zonë të ndërmjetme midis grupit të fjalëve të përbëra dhe grupit të ndajshesave. Teoritë pro sindajshesave/afiksoideve kanë përcaktuar edhe disa nga karakteristikat e tyre. Sindajshesat/afiksoidet dalin nga klasa e fjalëve të përbëra. Që një element të quhet sindajshesë, duhet të përmbush disa kushte. Kështu, kërkohet që ky element të ekzistojë si fjalë e lire, por edhe si gjymtyrë e një fjale të përbërë, të ketë formuar një varg të pasur fjalësh të përbëra, kuptimi i saj të jetë drejt desemantizimit apo përgjithësimit si dhe të jenë në konkurrencë me ndajshesat e mirëfillta/Affixe-t.

Termi afiksoid përfshin prefiksoidet/siparashesat (Präfixoide) dhe sufiksoidet/siprapashesat (Suffixoide). Prefiksoidet “*die den Inhalt des Ausgangswortes modifizieren, d.h. abstufen und differenzieren.*”²⁸²/ modifikojnë përmbajtjen e fjalës nga e cila rrjedhin, që do të thotë se e përshkallëzojnë dhe e diferencojnë atë. Zakonisht ato i japin një kuptim plotësues, më të përgjithshëm elementit me të cilin bashkohen, brenda fjalës së përbërë. Ky kuptim zakonisht është zmadhues (augmentativ) ose vlerësues (evaluativ, taxativ). Kështu p.sh. fjala “*Riese*” (gjigand) duke u bashkuar me emrin “*Erfolg*” (sukses) formon fjalën “*Riesenerfolg*” i cili ka kuptimin e një suksesi të madh, të jashtëzakonshëm. Në këtë kontekst kuptimi dhe funksioni i gjymtyrës së parë është më i gjerë, pasi rrit ose zmadhon rëndësinë e gjymtyrës së dytë. Kjo fjalë është pjesë përbërëse e shumë kompozitave. Vetëm në “*Deutsches Universalwörterbuch*” numërohen 14 kompozita me gjymtyrë të parë fjalën “*Riese*”:

Riesebaby, Riesendummheit, Riesenerfolg, Riesenfelge, Riesengebirge, Riesengroß, Riesenrad, Riesenschlange, Riesenschritt, Riesenlalom, Riesenstadt, Riesenstark, Riesenstern, Riesenwuchs

Po kështu edhe fjala “*Blitz*” (rrufe, vetëtimë), e cila duke u bashkuar me mbiemra dhe emra fiton dhe një kuptim shtesë, kuptim përforcues, që diçka ndodh shpejt ose diçka gjendet në sasi të shumtë. 20 fjalë të formuara me element të parë fjalën “*Blitz*” janë të pasqyruara në fjalorin e Duden-it.

²⁸⁰ Afiksoidet i gjejmë jo vetëm në veprën “*Die Grammatik, Band 4*” të Duden-it, por veçanërisht në “*Das Bedeutungswörterbuch, Band 10*” të tij, në të cilin në faqet 16-18 gjejmë në listën e mjeteve të fjalëformimit krahas ndajshesave/affixe edhe sindajshesat/affixoide.

²⁸¹ W. Motsch, *Deutsche Wortbildung in Grundzügen*, Berlin, 2004, f. 10

²⁸² Duden, *Die Grammatik, Band 4*, Mannheim, 1998, f. 435

Blitzableiter, Blitzaktion, blitzartig, Blitzbesuch, blitzblank / blitzebank, blitzblau / blitzblau, Blitzesschnelle, Blitzgerät, blitzgescheit, Blitzkarriere, Blitzlicht, Blitzlichtaufnahme, Blitzlichtfoto, Blitzreise, blitzsauber, Blitzschach, Blitzschaden, Blitzschlag, blitzschnell, Blitzsieg, Blitzstart

Hartuesit e Duden “*Die Grammatik, Band 4*”, të cilët parapëlqejnë termin gjysmëparashtesë (Halbpräfix) dhe gjysmëprapashtesë (Halbsuffix), duke shmangur përdorimin e termit afiksoid, pranojnë si gjysmëparashtesa edhe *ab-, an-, auf-, aus-, bei-, durch-, ein-, mit-, nach-, vor-, um-, zu-*²⁸³, të cilat formojnë folje të përbëra. Klasifikimi i këtyre elementeve në prefiksoide bëhet duke u bazuar në aspektin semantik: “... *die als Verbbildungselemente nur noch lautlich (ausdrucksseitig) mit den Adverbien bzw. Präpositionen ... übereinstimmen, semantisch (inhaltsseitig) aber –wenigstens zum Teil- eher mit den Präfixen ver- er- usw.*” /...ato si elemente fjalëformuese foljore përputhen vetëm në formë me ndajfoljet apo parafjalët përgjegjëse, ndërsa nga ana e përmbajtjes përputhen më shumë – të paktën pjesërisht – me parashtesat si *ver-, er-* etj.²⁸⁴ Për këtë arsye ato shihen si elemente të një zone të ndërmjetme midis derivacionit dhe kompozicionit.²⁸⁵ Ndryshimi kuptimor i largon ato nga gjymtyrët e kompozitave, por pa i shkëputur krejtësisht prej tyre, ndërsa ekzistenca e tyre edhe si fjalë të mëvetësishme, si dhe ndarja e tyre në përdorimin në fjali (ato formojnë folje të ndashme) i dallon nga parashtesat e tjera foljore të gjuhës gjermane.

Ndryshe nga siparashtesat (Präfixoide), siprapashtesat (Affixoide) kanë edhe një funksion tjetër, ato vendosin përkatësinë në pjesë ligjrate të fjalës së re që formohet. Kështu elementet *-voll* apo *-frei*, të cilat e kanë prejardhjen e tyre nga mbiemrat “*voll*” dhe “*frei*” edhe kur kombinohen me emra formojnë një fjalë të përbërë mbiemërore, si p.sh.: *hoffnungsvoll* apo *risikofrei*.

Këto gjymtyrë të fjalëve të përbëra i plotësojnë të gjitha kriteret për të qenë sindajshtesa/afiksoide, më konkretisht siprapashtesa/sufiksoide, pasi ekzistojnë edhe si fjalë më vete (të dyja i gjejmë si mbiemra), fitojnë një kuptim më të përgjithshëm kur janë gjymtyrë të fjalës së përbërë (*-voll* ka kuptim zmadhues, që diçka ndodhet në masë të madhe, të plotë, ndërsa *-frei* tregon se diçka nuk përmban diçka tjetër, ose është e lirë nga diçka) dhe formojnë vargje fjalësh. Këto karakteristika i mbajnë këto siprapashtesa si dhe afiksoidet e tjera ende në grupin e fjalëve të përbëra si gjymtyrë të tyre.

Në fjalorin Duden “*Deutsches Universalwörterbuch*”, gjejmë rreth 80 fjalë të përbëra me gjymtyrë të dytë “*-voll*” dhe thujse po aq kompozita me “*-frei*”. Më poshtë disa prej tyre:

achtungsvoll, ahnungsvoll, blutvoll, charaktervoll, druckvoll, effektivvoll, erwartungsvoll, fantasievoll, gefühlvoll, gefahrvoll, geheimnisvoll, genussvoll, glanzvoll, hassvoll, hoffnungsvoll, hochachtungsvoll, humorvoll, klangvoll, knallvoll, krummelvoll, lichtvoll,

²⁸³ Sipas Duden, disa nga sindajshtesa (Halbpräfixe) dhe pikërisht: *durch-, um-, über-, unter-, wider- dhe hinter-*, shfaqen edhe si parashtesa. Të tilla janë ato kur nuk formojnë folje të ndashme, në këtë rast theksi bie në rrënjën e foljes, pra në foljen që shërben dhe si temë motivuese. Gjithashtu si të tilla, madje shumë më pranë gjymtyrëve të kompozitave, shohin autorët e Duden edhe *nach-, bei-, vor-, zu-, los-, wieder-, entgegen- dhe zurecht-*.

²⁸⁴ Duden, *Die Grammatik, Band 4*, Mannheim, 1998, f. 452-453

²⁸⁵ Duden, po aty, f. 463

machtvoll, mitleidvoll, mühevoll, neidvoll, prachtvoll, qualitativvoll, qualvoll, rahmenvoll, randvoll, ruhmvoll, rücksichtsvoll, schwärzvoll, schuldvoll, seelenvoll, sinnvoll, sorgenvoll, stilvoll, trostvoll, übervoll, verantwortungsvoll, verständnisvoll, wirkungsvoll, würdevoll etj.

alkoholfrei, akzentfrei, angstfrei, arbeitsfrei, bleifrei, beitragsfrei, blockfrei, bügelfrei, bündnisfrei, dienstfrei, eisfrei, emotionsfrei, fehlerfrei, fieberfrei, gebührenfrei, ideologiefrei, jugendfrei, keimfrei, kniefrei, knitterfrei, knöchelfrei, kreisfrei, kostenfrei, konfliktfrei, mietfrei, niederschlagsfrei, nikotinfrei, portofrei, rezeptfrei, rostfrei, rückenfrei, schadstofffrei, schmerzfrei, straffrei, steuerfrei, störungsfrei, textilfrei, unterrichtsfrei, vorlesungsfrei, vorurteilsfrei, wahlfrei, wartungsfrei etj.

Me përjashtim të prefiksoideve që shërbejnë për të formuar folje të ndashme, afiksoidet në gjuhën gjermane kanë dalë kryesisht nga klasa e emrave dhe ajo e mbiemrave. Gjithashtu si afiksoid gjejmë edhe përemrin *Selbst-* (vetë) Në fjalorin Duden “Das Bedeutungswörterbuch, Band 10”, listohen rreth 240 afiksoide. Aty gjejmë veç të tjerash këto sindajshtesa/afiksoide: *Affen-, Blitz-, Grund-, Haupt-, Heiden-, Hobby-, Höllen-, Mords-, Null-, Rahmen-, Riesen-, Über-, Voll-* etj. *-fabrik, -frage, -gut, -leute, -mann, -sache, -welt, -werk, -wesen*²⁸⁶ etj. *bitter-, heiß-, hoch-, -arm, -fähig, -fertig, -freundlich, -hungrig, -leer, -reich* etj.

Ideja e të trajtuarit të afiksoideve apo sindajshtesave si një kategori më vete brenda fjalëfomimit nuk mund të pranohet, për vetë faktin se nuk ekziston një proces fjalëformimi që të ketë si rezultat apo produkt të tij një sindajshtesë. Ne mendojmë se është e rëndësishme të pranohen dhe të analizohen sindajshtesat apo afiksoidet. Është e vërtetë se në planin sinkronik, pra në gjendjen aktuale të gjuhës ato nuk ndihmojnë shumë, madje ndonjëherë, për raste të vështira edhe mund ta kompikojnë disi modelin ose mund të çojnë në qëndrime të ndryshme mes gjuhëtarësh. Por si elemente që dalin nga klasa e fjalëve të përbëra me tendencë për t’u kthyer në ndajshtesa të mirëfillta, mendojmë se ato ndihmojnë për të kuptuar se “*wie aus selbständigen Wörter Suffixe entstehen können.* / si mund të krijohen prapashtesa nga nga fjalë të mëvetësishme.”²⁸⁷ Siç po ndodh p.sh. me elementin *-werk*, i cili kur përdoret bashkë me një element tjetër po i largohet gjithnjë e më shumë kuptimit të tij të parë *Arbeit*/punë “*und seit dem 14. Jh. Immer mehr die Rolle eines Kollektivsuffixes übernimmt.* / dhe po merr gjithnjë e më shumë qysh prej shekullit XIV kuptimin e një prapashtese me kuptim përmbledhës.”²⁸⁸ Madje në rastet kur përmes tij është formuar një fjalë përmbledhëse krahas një fjale tjetër ekzistuese si variant i saj, atëherë nuk kemi të bëjmë më me një sindajshtesë/afiksoid.

²⁸⁶ Për Fleischer/Barz disa nga afiksoidet e lartpërmendura kanë kaluar tashmë në ndajshtesa dhe trajtohen si të tilla, si p.sh. *-wesen, Haupt-, Grund-, Kern-, -werk* apo *-zeug*. Por ne mendojmë se kalimi nuk është kryer i plotë për sa kohë që këto elemente gjenden edhe si fjalë të mëvetësishme në fjalor dhe përdoren si të tillë. Ndaj në këtë punim ato do të shihen si gjymtyrë të fjalëve të përbëra apo si ndajshtesa duke u bazuar dhe në analizën semantike dhe motivuese të çdo rasti.

²⁸⁷ J. Erben, Einführung in die deutsche Wortbildungslehre, f. 148

²⁸⁸ J. Erben, po aty

Procesi i kalimit të këtij elementi nga gjymtyrë kompozite në ndajshesë është i përfunduar:

Buschwerk = Gebusch / grumbull shkurresh

Por jo në të gjitha rastet elementin *-werk* ka kaluar në ndajshesë. Kështu p.sh. në fjalën *Kunstwerk* (vepër arti) *-werk* ruan kuptimin e një fjale të mëvetësishëm dhe jo atë përmbledhës duke përbërë në këtë mënyrë gjymtyrën e dytë të një fjale të përbërë. Përmes afiksoideve kuptojmë dhe tendecat e gjuhës, mënyrat që ajo përdor për të pasuruar fondin e ndajshesave, por duke qenë se nuk ekziston një mënyrë e veçantë fjalëformimi që të bazohet vetëm te afiksoidet, duke qenë se një afiksoid nuk është kthyer ende në një ndajshesë të mirfilltë si dhe duke qenë se ne për të përcaktuar nëse një gjymtyrë e fjalës së përbërë ka marrë tiparet e një afiksoidi do të bazohemi në analizën semantike, fjalët që kanë një gjymtyrë të shprehur me një element të tillë në këtë punim do të klasifikohen te grupi i kompozitave, pasi mendojmë se janë më afër tyre.

III.4. Kompozim dhe prapashtesim (Zusammenbildungen)

Formimi i fjalëve të tilla si: *Frühaufsteher, Gesetzgebung, Viersitzer, kurzatmig, rotwangig, viertürig* përbën një tjetër çështje të diskutur jo pak nga gjuhëtarët gjermanë. Fjalë të tilla njihen në teorinë e fjalëformimit si “*Zusammenbildungen*” dhe janë kryesisht emra dhe mbiemra. Vihet re se fjalë të këtij tipi analizohen në mënyra të ndryshme nga gjuhëtarët, të cilët duket mos të jenë të një mendjeje edhe sa i takon klasifikimit të tyre në tipat e fjalëformimit.

Henzen-i duke marrë shkak nga Paul-i, i cili fjalë të tilla si “*schwerhörig*” apo “*Haussuchung*” i klasifikon brenda një tipi të veçantë fjalëformimi, të cilin e vendos krahas atij të fjalëve të përbëra dhe fjalëve të prejardhura, lindur si pasojë e bashkëveprimit të mënyrës fjalëformuese të kompozimit dhe asaj të prejardhjes²⁸⁹, përdor termin *Zusammenbildung* duke nënkuptuar fjalë “*die weder als Zusammensetzungen noch als Ableitungen glatt aufgehen und doch von beiden Züge an sich tragen.* / të cilat nuk janë krejtësisht as fjalë të përbëra dhe as fjalë të prejardhura, por që mbartin brenda tyre karakteristika nga të dyja tipat e fjalëve.”²⁹⁰ “*Es scheinen bei den genannten Fällen im Moment der Wortbildung Zusammensetzung und Ableitung zusammengewirkt zu haben.* / Gjatë formimit të rasteve të përmendura duket të kenë bashkëvepruar kompozimi dhe prejardhja.”²⁹¹

Pra në teorinë disi të hershme të fjalëformimit autorë si Wilmann-i, Behaghel-i, Henzen-i apo Schmidt-i²⁹², pranojnë një mënyrë të veçantë fjalëformimi, e cili ka lindur si pasojë e bashkëveprimit në të njëjtën kohë të dy mënyrave të tjera të fjalëformimit, kompozimit

²⁸⁹ M. Leser, Das Problem der ‘Zusammenbildungen’, Eine Lexikalistische Studie, Trier, 1990, f.16

²⁹⁰ E. Donalies, Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick. Tübingen, 2002, f. 91

²⁹¹ Cituar në M. Leser, Das Problem der ‘Zusammenbildungen’, Eine Lexikalistische Studie, Trier, 1990, f.20

²⁹² G. Starke. Zum Problem der Zusammenbildung in der deutschen Gegenwartssprache, në: Deutsch als Fremdsprache, Nr. 5, Leipzig, 1968, f.148-158

dhe ndajshitesimit, duke e quajtur si procesin ashtu edhe produktin e saj “*Zusammenbildung*”. Për këta gjuhëtarë fjalë si *viertürig* janë formuar nga bashkimi në një fjalë të vetme të togfjalëshit “*vier Tür*” dhe prapashtesës “*-ig*”.

Në gramatologjitë apo teoritë e mëvonshme të fjalëformimit gjejmë një tjetër qëndrim lidhur me mënyrën e formimit të këtyre fjalëve, madje disa autorë si Fleischer-i/Barz-i²⁹³, jo vetëm që nuk e njohin kompozimin dhe ndajshitesimin të veprojnë bashkë në një mënyrë të veçantë fjalëformimi, por heqin dorë edhe nga përdormimi i termit “*Zusammenbildung*”. Ata i klasifikojnë fjalët e këtij tipi brenda grupit të fjalëve të prejardhura dhe i analizojnë ato si fjalë të formuara nga një togfjalësh foljor ose emëror dhe një prapashtesë. Prapashtesat që marrin pjesë në formimin e fjalëve të këtij tipi janë: *-er*, *-(er)ei* dhe *-ung* për emrat si dhe *-ig* për mbiemrat. Togfjalëshi foljor merret edhe si temë fjalëformuese. Ai nuk është domosdoshmërisht frazeologjik dhe në rastet kur bashkohet me prapashtesën *-er* përmban kryesisht foljet “*nehmen*”, “*geben*”, “*halten*”, “*tragen*”, por jo vetëm ato.

Më poshtë raste të formimit të këtyre fjalëve nga togfjalësha frazeologjik:

einen Antrag stellen	+	-er	→	Antragsteller
Zeit nehmen	+	-er	→	Zeitnehmer
Einen Auftrag geben	+	-er	→	Auftraggeber
Angst machen	+	-er	→	Angstmacher
schwarz sehen	+	-er	→	Schwarzseher
Recht haben	+	-er	→	Rechthaber
Frage stellen	+	-ung	→	Fragestellung
Anklage erheben	+	-ung	→	Anklageerhebung
Macht ausüben	+	-ung	→	Machtausübung
jmdm. die Augen auswischen	+	-erei	→	Augenwischerei
Angst machen	+	-erei	→	Angstmacherei
schwarz malen	+	-erei	→	Schwarzmalerei
sich wichtig tun	+	-erei	→	Wichtigtuerei

Nga shprehje frazeologjike janë formuar fjalë edhe pa ndashtesë. Bëhet fjalë për rastet kur gjymtyrë e togfjalëshit frazeologjik është folja “*nehmen*”:

Stellung nehmen	→	Stellungnahme
Rücksicht nehmen	→	Rücksichtnahme
Bezug nehmen	→	Bezugnahme
Zeit nehmen	→	Zeitnahme
Einfluß nehmen	→	Einflußnahme

²⁹³ Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007

Në analogji me këto formime fjalë të këtij lloji janë formuar edhe nga togfjalësha jo frazeologjik:

Socken halten	+	-er	→	Sockenhalter
Staub saugen	+	-er	→	Staubsauger
Feuer löschen	+	-er	→	Feuerlöscher
Buch binden	+	-er	→	Buchbinder
lange schlafen	+	-er	→	Langschläfer
acht Silben	+	-ig	→	achtsilbig
kurze Beine	+	-ig	→	kurzbeinig

Interesant është qëndrimi i Fleischer-it/Barz-it lidhur me fjalët e grupit të parë, emrat e formuar nga një togfjalësh foljor dhe prapashtesa –er. Në këtë grup ata përfshijnë edhe emrat e formuar nga togfjalëshi me foljen “machen” si p.sh. Uhrmacher (eine Uhr machen + -er) apo Liedermacher (Lieder machen + -er), por duke i pranuar ato edhe si kompozita: “da “Macher” gelegentlich auch selbständig begegnet, ist bei manchen WBK²⁹⁴ auch die Erklärung als Kompositum möglich / duke qenë se Macher²⁹⁵ (bërës) më raste ndeshet edhe si fjalë më vete, disa prej fjalëve të formuara me të mund të trajtohen edhe si kompozita”.

Në të vërtetë prapashtesa –er është një morfemë ndajshitesore e cila formon emra prejfoljor që shprehin personin që kryen veprimin sipas foljes që e shpreh atë:

lesen – Leser, drehen – Dreher, erfinder – Erfinder, entdecken – Entdecker, anrufen – Anrufer, kaufen – Käufer, verkaufen – Verkäufer etj.

Ndaj dhe formimet e tipit *Uhrmacher*, formuar nga togfjalësha jo frazeologjik, në të cilat elementi i dytë është një emër prejfoljor dhe emërton personin që kryen një veprim të caktuar në lidhje me atë që shpreh gjymtyra e parë, mendojmë se duhet të interpretohen si kompozita.

Si e tillë shihet dhe analizohet ky grup fjalësh edhe nga Kuhn-i²⁹⁶, e cila sjell si shembuj të bashkimit të një togfjalëshi me një prapashtesë rastet:

Gepäck trag(en)	+	-er	→	Gepäckträger
alle Seit(en)	+	-ig	→	allseitig

Kundër përdorimit të termit “*Zusammenbildung*” është edhe Leser-i, i cili këtë tip fjalësh e klasifikon kryesisht si kompozitë (më përjashtim të ndonjë rasti si Muntermacher).²⁹⁷

²⁹⁴ WBK = Wortbildungskonstruktion

²⁹⁵ Në fjalorin Duden “Deutsches Universalwörterbuch, A-Z”, botim i vitit 2002, “-macher” e gjejmë si afiksoid (sindajshitesë)

²⁹⁶ I. Kuhn, *Lexikologie: Eine Einführung*, Tübingen, 1994, f. 27

²⁹⁷ M. Leser, *Das Problem der ‘Zusammenbildungen’*, Eine Lexikalistische Studie, Trier, 1990, f.107

Gjuhëtarë të tjerë si Eisenberg-u dhe Engel-i²⁹⁸, po kështu edhe Eichler-i/Bünting-u²⁹⁹ e klasifikojnë këtë tip fjalësh brenda grupit të kompozitive, por si një lloj të veçantë kompozite, pasi për gjuhëtarët e parë ato nuk mund të quhen kompozita të mirëfillta duke qenë se komponenti i dytë i tyre nuk mund të quhet as fjalë e mëvetësishme dhe as konfiks (fjalë e huazuar), ndërsa për të dytët bëhet fjalë për fjalë të cilat formohen nga “fjali” apo togfjalësha dhe prapashtesa.

“*Zusammenbildung*” nuk pranohet as si kategori dhe as si term edhe nga Donalies-i. Për të këto fjalë ose janë kompozita si në rastin e fjalës *Appetithemmer*, ku gjymtyra e parë përcakton të dytën (*Appetithemmer* = *Hemmer des Appetits*), ose janë fjalë të prejardhura si në rastin e fjalëve *Dickhäuter* apo *blauäugig*, të cilat janë derivate frazash (*dicke Haut* + *-er* = *Dickhäuter*)

Një qëndrim të ngjashëm, të cilin ne e gjejmë edhe si më të drejtin, gjejmë edhe në gramatikën Duden. Në këtë gramatikë pranohet dhe përdoret termi “*Zusammenbildung*” në çështjen e quajtur “*Besondere Bildungsweisen*” / mënyra formimi të veçanta duke iu dhënë sqarimi i mëposhtëm:

“*Als Zusammenbildungen werden besondere Arten der Zusammensetzung und Ableitung bezeichnet, und zwar diejenigen, deren erster Teil nicht als Wort, sondern nur als Wortgruppe existiert. / Me termin Zusammenbildungen emërtohen lloje të veçanta përbërjes dhe prejardhjes, dhe pikërisht ato, komponenti i parë i të cilave nuk ekziston si fjalë por si grup fjalësh.*”³⁰⁰

Kur këto fjalë kanë një prapashtesë klasifikohen si fjalë të prejardhura, ndërsa në rastet kur ato nuk marrin një prapashtesë dhe komponenti i parë është një togfjalësh shqyrtohen si kompozita, gjithnjë sipas kuptimeve të tyre

Fjalë të prejardhura:

rote Wangen	+	-ig	→	rotwangig
vier Sitze	+	-er	→	Viersitzer

Fjalë të përbëra:

Eine Familie	+	Haus	→	Einfamilienhaus
Vieh halten	+	Plan	→	Viehhalteplan

Fjalori Duden “*Deutsches Universalwörterbuch*” njih dhe pranon 63 fjalë si komponentë të dytë të një *Zusammenbildung*:

-achser, -achsig, -armig, -äugig, -beinig, -füßer, -gleisig, -gliederig/-gliedrig, -gradig/-grädig, -halsig, -jährig, -karäter, -karätig/-karatig, -köpfig, -malig, -maschig, -master, -mastig, -mäulig, -minutig/-minütig, -monatig, -motorig, -mütig, -nahme, -nasig, -ohrig, -pfündig, -phasig, -polig, -propellerig/-propellrig, -prozentig, -räderig/-rädig, -randig, -rangig, -reihig, -ruderig/rudrig, -sätzig, -schichtig, -semestrig, -silber/-sibler, -silbig, -sitzer, -sitzig, -spanner, -spännig, -sprachig, -sprachlich, -spurig, -stängelig/-stänglig, -

²⁹⁸ E. Donalies, *Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick*. Tübingen, 2002, f. 91

²⁹⁹ W. Eichler/K.D. Bünting, *Deutsche Grammatik*, Königstein, 1994, f. 231

³⁰⁰ *Die Grammatik*, Band 4, Duden, Mannheim, 1998, f. 437

stellig, -stichig, -stielig, -stimmig, -stöckig, -strophig, -täglich, -tonig/-tönig, -türig, -wandig, -wertig, -wöchig, -zylindrig

Gjithashtu në po këtë fjalor gjejmë 690 fjalë që kanë si komponent të dytë një nga fjalët e mësipërme, ku numrin më të madh e zënë mbiemrat.

Më poshtë disa shembuj:

Achtfüßler, achtbändig, achtblättrig, beidbeinig, beidfüßig, beidhändig, blauäugig, blondhaarig, breitkrempig, breitnasig, breitrandig, dickfellig, dickfleischig, dreiachsig, Dreimaster, dreiköpfig, dunkelhäutig, Einsilbler, einaktig, einjährig, feinkörnig, fünfstöckig, fünftägig, hartnäckig, kleinräumig, langnasig, mehrschichtig, neunmonatig, rotfleckig, scharfäugig, Sechssachser, sechskantig, siebenwertig, tausendmalig, Vielzeller, viermotorig, weitspurig, Zehnfüßer, Zweispänner etj.

Duke pasur parasysh analizat e bëra nga gjuhëtarë të ndryshëm lidhur me këtë temë, ne e shohim pozicionin tonë më pranë atij të mbajtur nga gramatika Duden. Mendojmë se termi *Zusammenbildung* edhe pse mund të duket i tepërt nuk duhet të humbasë, ndërsa sa i takon klasifikimit të këtyre fjalëve në fjalë të prejardhura apo kompozita, mendojmë se kur komponenti i dytë i këtyre fjalëve është kthyer tashmë në një fjalë që gjen përdorim të mëvetësishëm, si “*Geber*” apo “*Macher*”, ose kur kuptimi i fjalës e mundëson interpretimin e saj si kompozitë, atëherë ato duhet të klasifikohen si të tilla.

III. 5. Shkurtesat

Fjalët në gjuhën gjermanë nuk formohen vetëm nga bashkimi i dy apo më shumë temave motivuese me njëra-tjetrën, nga bashkimi i një teme motivuese dhe një ndajstese apo si pasojë e kalimit të një fjale në një pjesë tjetër të ligjeratës, por edhe nëpërmjet shkurtimeve. Në të vërtetë nëpërmjet shkurtimeve nuk formohet një fjalë e re në kuptimin e mirfilltë të saj, pasi shkurtimeve mbeten variante të fjalëve ekzistuese, duke bërë që si forma e gjatë e fjalës ashtu edhe ajo e shkurtuar të kenë të njëjtën përmbajtje. “*Die Formseite des Zeichenkomplexes wird zwar vereinfacht oder gar auf ein Minimum reduziert, seine Inhaltsseite hingegen verändert sich nicht.* / Është e vërtetë se ana formale e tërësisë së shenjave thjeshtësohet, ose edhe reduktohet deri në minimum, por ana kuptimore e saj mbetet e pandryshuar.”³⁰¹ Ndoshta kjo është dhe arsyeja pse në gramatologjitë dhe teoritë e fjalëformimit shkurtimeve zë një vend të veçantë duke mos u kategorizuar brenda asnjërës prej mënyrave të tjera të fjalëformimit si dhe duke u veçuar qartas prej tyre.

Fjalë të tilla si: *Ober, Bus, Uni, Bahn, EU, AG, Pkw, GmbH, Kombi, Kripo, StGB, UFO, NASA, SPD* etj. përbëjnë tipe të ndryshme shkurtesash.

Pra shkurtimeve (*Kurzwortbildung*) është një tjetër mënyrë fjalëformimi në gjuhën gjermane, e cila shihet si e tillë pasi “*aus vorhandenem Sprachmaterial nach angebbaren Regeln Wortbildungen erfolgen, die zu Änderungen im Wortschatz führen können.* / me anë të materialit gjuhësor ekzistues dhe sipas rregullave të përcaktuara realizohen

³⁰¹ Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 421

formime fjalësh, të cilat mund të çojnë në ndryshime në leksik.”³⁰² Gjithashtu shkurtesat ruajnë përgjithësisht karakteristikat gramatikore të fjalës prej së cilës formohen.³⁰³ Përjashtim bëjnë disa lloje shkurtesash, kryesisht ato shkronjore, të cilat nuk ndryshojnë dhe numrin shumës e formojnë duke marrë ndajshitesën trajtëformuese –s,³⁰⁴ si p.sh. :

Nom./E.	<i>der</i> Pkw	<i>die</i> AG
Gen./Gj.	<i>des</i> Pkw	<i>der</i> AG
Dat./Dh.	<i>dem</i> Pkw	<i>der</i> AG
Akk/K	<i>den</i> Pkw	<i>die</i> AG
Pl./Sh.	<i>die</i> Pkws	<i>die</i> AGs

Por shkurtimi nuk është një fenomen i ri në gjuhë. Polenz e quan atë “*den wirklichen ‘innovativen Teilbereich’ der Wortbildung im 19. Und 20. Jahrhundert.* / ‘pjesën e vërtetë innovative’ të fjalëformimit të shekullit të XIX dhe XX.”³⁰⁵

Shkurtimi i fjalëve dhe krijimi i shkurtesave është një fenomen prodhimtar i gjuhës gjermane dhe që gjendet në gjuhën e stileve të ndryshme, si në terminologjinë teknike, ekonomike, politike, shkencore, në stilin administrativ dhe atë publicistik. Shkurtesat i ndeshim gjithashtu edhe në gjuhën e përditshme, siç ndodh rëndom mes studentëve të përdoret *Uni* si formë e shkurtuar e fjalës *Universität* (universitet), apo nga adoleshentët shkurtsa *Abi* për *Abitur* (matura).

Shkurtimi është një mënyrë fjalëformimi, të cilin e ndeshim vetëm në klasën e emrave³⁰⁶ pasi dhe shkurtesat kanë dalë kryesisht prej kompozitave ose togfjalëshave, por jo vetëm prej tyre, siç do të shihet edhe në shembujt e mëposhtëm. Për Schippan-in³⁰⁷ formimi i fjalëve të shkurtuara u zhvillua si mënyrë fjalëformimi nga nevoja për emra produktesh. Kështu ajo e sheh fjalën *Persil* (markë ilaçi rrobash) si një nga shkurtesat e para formuar nga shkurtimi i fjalëve “*Perborat*” dhe “*Silikat*”.

Nga të gjithë autorët pranohet se reduktimi i fjalëve të gjata dhe shumëerrokëshe ndodh kryesisht për arsye të ekonomisë së gjuhës³⁰⁸.

Duke u bazuar në sasinë e pjesëve (të ashtuquajturat “*Segmente*”) të formës së plotë që përdoren për formimin e formës së shkurtuar, në gjuhën gjermane dallohen dy tipa kryesorë shkurtesash: shkurtesat njësegmentëshe (Unisegmentale Kurzwörter) dhe ato shumësegmentëshe (multisegmentale Kurzwörter).

Tipi i parë i shkurtesave, *shkurtesat njësegmentëshe*, përbëhen vetëm nga një pjesë e fjalës së plotë. Kjo pjesë mund të jetë pjesa e fillimit të fjalës si në rastet:

³⁰² J. Volmert (Hrg.), Grundkurs, Sprachwissenschaft, München, 1999, f. 113

³⁰³ E. Donalies, Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick, Tübingen, 2002, f. 139

³⁰⁴ Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 251

³⁰⁵ E. Donalies, Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick, Tübingen, 2002, f. 139

³⁰⁶ W. Fleischer/I. Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 84

³⁰⁷ T. Schippan, Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 1992, 65

³⁰⁸ Sipas *Duden – Rechtschreibung*, ekonomia e gjuhës është tendenca e folësit dhe dëgjuesit të një gjuhe për të zëvendësuar forma komplekse gjuhëse me ato më të thjeshta.

Limonade	→	<i>Limo</i>
Universität	→	<i>Uni</i>
Abitur	→	<i>Abi</i>
Demonstration	→	<i>Demo</i>
Automobil	→	<i>Auto</i>
Diapositiv	→	<i>Dia</i>
Oberkellner	→	<i>Ober</i>
Fotografie	→	<i>Foto</i>
Sanitäter	→	<i>Sani</i>
Akkumulator	→	<i>Akku</i>
Laboratorium	→	<i>Labor</i>
Lokomotive	→	<i>Lok</i>
Kriminalroman, Kriminalfilm	→	<i>Krimi</i>
Tachometer	→	<i>Tacho</i>
Kombiwagen	→	<i>Kombi</i>

Por ajo mund të jetë edhe pjesa e fundit e saj. Ku duhet thënë se shkurtesa të këtij tipi janë më të pakta në numër se ato të mësipërmet:

Eisenbahn	→	<i>Bahn</i>
Fahrrad	→	<i>Rad</i>
Omnibus	→	<i>Bus</i>
Antibabypille	→	<i>Pille</i>
Schallplatte	→	<i>Platte</i>
Regenschirm	→	<i>Schirm</i> ³⁰⁹
Violoncello	→	<i>Cello</i>

Tipi i dytë i shkurtesave, shkurtesat shumësegmentale, quhen të tilla sepse përbëhen nga bashkimi i disa pjesëve (segmenteve) të fjalës apo fjalëve të një togfjalëshi, të cilat mund të jenë, rrokje, shkronja ose edhe forma të përziera, duke bërë që dhe ky tip të përbëhet nga disa nëntipa.

Kështu dallojmë *tipin nistor*. Këto shkurtesa njihen ndryshe edhe si fjalë me initiale (*Initialwörter*), pasi formohen nga bashkimi i inicialeve të pjesëve përbërëse të fjalës kur ajo është kompozitë, ose të inivialeve të fjalëve përbërëse të togfjalëshit:

ABS (*Antiblockiersystem*), **ABV** (*Abschnittsbevollmächtigte[r]*), **ADAC** (*Allgemeiner Deutscher Automobil-Club*), **ADFC** (*Allgemeiner Deutscher Fahrrad-Club*), **AG** (*Aktiengesellschaft, Amtsgericht*), **AKW** (*Atomkraftwerk*), **BAT** (*Bundesangestelltentarif*), **BLZ** (*Bankleitzahl*), **BND** (*Bundesnachrichtendienst*), **BRD** (*Bundesrepublik Deutschland*), **BWL** (*Betriebswirtschaftslehre*), **CDU** (*Christlich-Demokratische Union*), **DBP** (*Deutsche Bundespost*), **DIHT** (*Deutscher Industrie- u. Handelstag*), **DV** (*Datenverarbeitung*), **EDV** (*elektronische Datenverarbeitung*), **EU** (*Europäische Union*), **Kfz** (*Kraftfahrzeug*), **LG** (*Landgericht*), **PLZ** (*Postleitzahl*), **DDR**

³⁰⁹ Në fjalorin Duden “Deutsches Universalwörterbuch”, botim i vitit 2002, fjalën “Schirm” e gjejmë si shkurtesë të tri fjalëve: “Fallschirm”, “Lampenschirm” dhe “Bildschirm”.

(*Deutsche Demokratische Republik*) **USA** (*United States of America = Vereinigte Staaten von Amerika*), **DAAD** (*Deutscher Akademischer Austauschdienst*), **Lkw** (*Lastkraftwagen*), **Pkw** (*Personenkraftwagen*) etj.

Zakonisht këto lloj shkurtesash lexohen duke u gërmëzuar, si p.sh. **GmbH** (*Gesellschaft mit beschränkter Haftung*) “Ge em be Ha”. Por kur është e mundur ajo lexohet edhe si një fjalë, si në rastin e shkurtesës **DIN** (*Deutsche Industrie-Normen*), e cila lexohet “DIN”

Gjithashtu dallohet *tipi rrokjesor* (*Silbenwörter*), i cili realizohet nga bashkimi i rrokjeve të para të fjalëve të togfjalëshit ose komponentëve përbërës të kompozitës si në rastet:

Sankra (*Sanitätskraftwagen*), **Soko** (*Sonderkommision*), **Growian** (*Großwindenergieanlage*), **Stamokap** (*staatsmonopolistischer Kapitalismus*), **KaDeWe** (*Kaufhaus des Westen*), **Schupo** (*Schutzpolizei*), **Kripo** (*Kriminalpolizei*), **Gestapo** (*Geheime Staatspolizei*), **Trafo** (*Transformator*), **Schuko** (*Schutzkontakt*) etj.

Një tip tjetër shkurtesash formohet nga kombinimi i dy tipave të mësipërm, atij të rrokjeve dhe atij të inicialeve, të cilin më shpesh e hasim në stilin tekniko-shkencor:

Azubi (*Auszubildender*), **BaföG** (*Bundesausbildungsförderungsgesetz*), **UFOKAT** (*Umweltforschungskatalog*) etj.

Një tip të veçantë shkurtesash përbëjnë ato si:

U-Bahn (*Untergrundbahn*), **S-Bahn** (*Schnellbahn*), **H-Milch** (*haltbare Milch*), **R-Gespräch** (*Rückfragegespräch*), **U-Boot** (*Unterseeboot*), **O-Ton** (*Originalton*), **U-Haft** (*Untersuchungshaft*) etj.

Ky tip fjalësh krijhet si pasojë e reduktimit në germën nistore të pjesës së parë të kompozitës ose togfjalëshit, ndërkohë që komponenti i dytë mbetet i pacënuar, duke bërë që ky tip fjalësh të quhen *shkurtesa të pjesshme* (*partielle Kurzwörter*), edhe për faktin se jashtë këtyre kompozitave gërmat nistore të pjesëve të para të këtij tipi shkurtesash nuk kanë të njëjtin kuptim siç e kanë brenda shkurtesës.

Siç mund të vihet re edhe nga shembujt e dhënë, duke iu referuar edhe fjalorit Duden “*Deutsches Universalwörterbuch*” mund të themi se grupin më të madh të shkurtesave e përbëjnë ato të tipit nistor.

Shkurtesat kanë një rëndësi të veçantë pasi ato kontribuojnë në formimin e fjalëve të reja të gjuhës gjermane. Atom und të shërbejnë pa vështirësi si tema motivuese duke u bashkuar me tema të tjera motivuese dhe formuar kompozita ose edhe me ndajstesa fjalëformuese duke formuar fjalë të prejardhura, ndonëse kjo mënyrë fjalëformimi vepron më pak se e para, të cilën e gjejmë rëndom:

<i>Bus</i>	+	<i>Haltestelle</i>	→	<i>Bushaltestelle</i>
<i>Auto</i>	+	<i>Bahn</i>	→	<i>Autobahn</i>
<i>Landes</i>	+	<i>CDU</i>	→	<i>Landes-CDU</i>

<i>CD</i>	+	Brenner	→	<i>CD-Brenner</i>
<i>DIN</i>	+	Format	→	<i>DIN-Format</i>
<i>EU</i>	+	Land	→	<i>EU-Land</i>
<i>EU</i>	+	Bürger	→	<i>EU-Bürger</i>

Për të formuar fjalë të prejardhura shkurtesat bashkohet kryesisht me ndajshtesën fjalëformuese **-i** dhe më pak me **-o**, si p.sh:

Ossi (**O**sstdeutscher), Wessi (**W**estdeutscher), Profi (**P**rofessional), Fundi (**F**undamentalist), Pulli (**P**ullover), Anarcho (**A**narchist) etj.

KREU IV Përngjitja në gjuhën shqipe

IV.1. Përngjitja dhe lidhjet e saj me disa nga mënyrat e tjera fjalëformuese

Fjalët e përngjitura janë fjalë që formohen nga bashkimi i dy ose edhe më shumë fjalëve të veçanta, zakonisht në një proces përdorimi të gjatë pranë njëra-tjetrës në një tog parafjalor, togfjalësh të qëndrueshëm, grup fjalësh ose dhe në një fjalie të tërë. Në këtë mënyrë janë formuar fjalët: *përmbi, sipas, tungjatjeta, mirupafshim, ecejake, njëmbëdhjetë, bëzaj, vërej, gjithsecili, dikush, asnjë, megjithatë, dikur, qëmoti, padashur, përdhe* etj.

Përngjitja është një tjetër mënyrë fjalëformimi me rëndësi në gjuhën shqipe, rëndësi e cila ka të bëjë jo vetëm me ndihmesën që jep kjo mënyrë fjalëformimi në pasurimin e fjalorit dhe leksikut të shqipes me fjalë të reja, por edhe me lidhjet e ngushta që ajo ka me mënyra të tjera fjalëformuese. Lidhje shumë të ngushta ekzistojnë mes përngjitjes dhe njëres nga mënyrat fjalëformuese më prodhimore siç është kompozimi, pasi shumë fjalë të përbëra e kanë burimin e tyre te përngjitja. Mjafton të përmendim këtu fjalët e përbëra *bregdet, vendbanim, vendgrumbullim, vendstrehim, fletëhyrje ditëlindje* apo *vargmal*, të cilat kanë dalë nga përngjitja e gjymtyrëve të togfjalëshave të tipit *emër në emërore njëjës + emër në rrjedhore njëjës* “breg deti”, “vend banimi” apo “varg mali”. Rënia e *i-së*, e cila është dhe shprehëse formale e marrëdhënies gramatikore që ekzistojnë mes gjymtyrëve të togfjalëshit, neutralizon këto marrëdhënie duke formësuar dhe kaluar përfundimisht këto fjalë në kompozita. Si shprehëse e procesit të kalimit nga përngjitja në kompozim, proces deri diku ende i papërfundur, janë rastet e fjalëve si *vajguri, panxharsheqeri* apo *gurkali*, të cilat ka raste që përdoren edhe me elementin flektiv *-i*, por edhe pa të, kështu fjala “*vajgur*” ka gjetur pasqyrimin e saj në Fjalorin e shqipes së sotme, botim i vitit 2002 pa *i-në* fundore, ndërsa fjala “*gurkali*” dhe fjala “*panxharsheqeri*” vazhdojnë ta ruajë atë.

Por ky nuk është i vetmi tip fjalësh që ka kaluar nga përngjitja në kompozim dhe vazhdon ta furnizojë klasën e fjalëve të përbërë me elemente të tjera. Një kalim i tillë vihet re edhe në formimet kryesisht mbiemërore të krijuara nga një numëror, një emër me prapashtesën *-sh(e)*, prapashtesë që e ka burimin në rrjedhoren e shumësit të pashquar. Kështu mbiemra të tillë si *dygjymtyrësh, disaditësh, shumëngjyrësh, tetorësh, pesëlekësh, pesëmbëdhjetëditësh, njëdegësh, katërrrokësh* etj. janë mbiemra të përbërë të cilët e kanë burimin e formimit të tyre në përngjitjen e togut *numëror/përemër i pacaktuar + emër në rrjedhoren e shumësit të pashquar*. “Procesi i bashkimit të këtyre togjeve në një fjalë të vetme, univërbizimi i sintagmës, shoqërohet nga transformimi i prapashtesës *trajtëformuese* të rrjedhores në prapashtesë *fjalëformuese*.”³¹⁰ Ndryshimet sintaktikomorfologjike që pësojnë fjalët e formuara i kalojnë ato në grupin e fjalëve të përbëra, pasi përngjitja, në ndryshim nga kompozimi është një mënyrë leksikosintaksore fjalëformimi.

Pra lidhjet e përngjitjes me kompozimin janë të forta, lidhje të pasqyruara dhe analizuara edhe më parë në këtë punim, pikërisht në kreun që bën fjalë për kompozimin.

³¹⁰ A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972, f. 82

Lidhje të ngushta duket të ketë edhe mes përngjitjes dhe ndajshtesimit, më konkretisht parashtesimit. Në punimin e tij “*Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*”³¹¹ Hysa u kushton një vëmendje dhe një analizë të veçantë marrëdhënieve dhe lidhjeve që krijohen mes parashtesimit dhe kompozimit e përngjitjes si tri mënyra fjalëformimi sa larg aq edhe pranë njëra-tjetrës. Nga njëra anë është mënyra e formimit të fjalëve ajo që i dallon dhe i mban larg njëra-tjetrës përngjitjen dhe parashtesimin, por nga ana tjetër, natyra gramatikore e elementeve përbërëse të fjalëve të formuara e afron parashtesimin me përngjitjen, duke bërë që në mjaft raste këto mënyra fjalëformimi të përzihen me njëra-tjetrën dhe si pasojë dallimi i kufijve të tyre të bëhet i vështirë, kjo edhe për faktin se shpesh fjala e përngjitur dhe e prejardhur kanë element të parë të njëjtën fjalë.³¹² Autori njeh dhe “*rastet kalimtare me drejtim nga përngjitja në ndajshtesim*”³¹³ duke dhënë si shembuj fjalët *përherë* dhe *përditë*, të cilat sot pranohen si fjalë të prejardhura formuar me parashtesim, por që burimin e kanë në përngjitjen e togfjalështit *për herë* dhe *për ditë*. Raste kalimesh nga përngjitja në parashtesim sipas Hysës kemi atëherë kur krijohet një tip i veçantë fjalëformimi, i cili e lë të hapur mundësinë e zgjerimit të tij edhe me formime të reja të këtij tipi. Kështu kemi mjaft raste të shqipes kur parafjala është shndërruar në parashtesë, duke humbur veçoritë e saj si e tillë dhe duke fituar kuptimin fjalëformues që është një kuptim i përgjithshëm abstrakt. I tillë është shndërrimi i modelit *parafjalë + emër në parashtesë + emër në rastet: mbibisht, mbiemër, mbifushë, mbikalim, mbikrah, mbilodhje, mbiprodhim, mbishkrim* etj., *nënçati, nëndrejtor, nënfletë, nëngrup, nënstacion, nënndarje* etj. Kalimin e rasteve të parafjalëve në parashtesa, sipas Hysës e përforcon edhe formimi i foljeve dhe mbiemrave me këto elemente, si p.sh.: *mbiçmoj, i mbifugishëm, mbiklasor, mbinatyror, mbingarkoj* etj., *nënçmoj, nëntokësor, nëndetar, nënkuptoj, nënshkruaj, nënujor* etj. Por në rast se kemi të bëjmë me një rast formimi të izoluar, i cili nuk ndiqet nga formime fjalësh të tjera, atëherë autori e përjashton mundësinë e kalimit nga përngjitja në parashtesim.

Për një tjetër ndryshim mes fjalëve të formuara me parashtesim dhe atyre formuar me përngjitje, sipas Hysës, flet dhe natyra leksikogramatikore e këtyre fjalëve, ku dihet se pjesa dërrmuese e fjalëve të përngjitura janë pjesë të pandryshueshme të ligjeratës, ndërsa fjalët e formuara me parashtesim janë pjesë të ndryshueshme të ligjeratës.

Janë ndoshta këto lidhje të forta gjenetike midis përngjitjes, parashtesimit dhe kompozimit, ato që kanë bërë që disa gjuhëtarë të hershëm të flasin për përngjitje duke përfshirë në të fjalë të përbëra, kompozita, siç ka ndodhur me S. Frashërin në punimin e tij “*Shkronjëto e gjuhës shqipe*”, në të cilin ai, teksa flet për “*mbiemrat e ngitura*”, jep si shembuj kompozitat mbiemërore: *syzi, faqekuq, jetëmadh, zemërgur, ditëgjatë e syhirë*.³¹⁴

Ndërsa për I. D. Sheperin përngjitja është proces edhe më i gjerë duke përfshirë edhe parashtesimin, pasi për të “*Bashkimi i një parashtesimi ose i një fjale me fjalë tjetër përbën fjalë të ra, të cilat i quajtmë të përngjitura*.”³¹⁵ Ai liston në grupin e fjalëve të

³¹¹ E. Hysa, *Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, Tiranë 1975*, f. 58-81

³¹² E. Hysa, po aty, f. 67-69

³¹³ E. Hysa, po aty, f. 67

³¹⁴ S. Frashëri, *Shkronjëto e gjuhës shqipe*, Bukuresht, 1886, f. 38

³¹⁵ I. D. sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, f. 133

përngjitura veç fjalëve *kushdo, këdo, cilido* edhe fjalët *atdhe, bukurshkrim, këthej, kryeqytet, kartmonedhë, ngjit, shqit, keqpërdor* etj.

Ndërkohë që Cipo në punimin e tij “Gramatika shqipe” nuk bën dallimin midis fjalëve të përbëra dhe fjalëve të përngjitura duke i përdorur të dyja termat për të emërtuar të njëjtën mënyrë fjalëformimi.³¹⁶

“Një nga çështjet e shumta të parrahura të gjuhës sonë është dhe ajo e fjalëve të përngjitura a të kompozitave”³¹⁷ shprehet që në rreshtat e parë të punimit të tij “Kompozitat” Xhuvani, duke shprehur shqetësimin dhe ngritur nevojën e një trajtimi dhe studimi të gjerë dhe të hollësishëm të fjalëve të përngjitura dhe të kompozitave, studim që u ndërmor dhe u realizua nga Kostallari. Ky i fundit në punimin e tij “Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe”, pasi bën një pasqyrim të dokumentimeve më të lashta të kompozitave të shqipes duke hedhur poshtë pretendimet e albanologëve të huaj në shkrimet e tyre se shqipja nuk njeh, ose në rastin më të mire zotëron një numër të vogël kompozitash, dhe pasi analizon vendin që kanë zënë kompozitat në punimet e gjuhëtarëve të vjetër të shqipes, duke kryer një analizë shkencore bazuar në argument, hedh dritë mbi dy çështje të rëndësishme të kompozimit dhe përngjitjes: së pari përcakton tiparët themelore të fjalës së përbërë duke na dhënë edhe një përkufizim të kompozitës dhe të fjalës së përngjitur, së dyti bën të qarta dallimet mes tyre.

Ashtu siç u veprua edhe me kompozimin në kreun përkatës, edhe në rastin e përngjitjes do t’i referohemi, duke e cituar, përkufizimit të dhënë nga Kostallari sipas të cilit “Fjalë e pranëvënë apo e bashkëvënë ose fjalë e bashkëngjitur (juxtaposition) në shqipen është ajo fjalë me dy ose më shumë gjymtyrë që formohet nga afrimi i dy ose më shumë fjalëve në procesin e përdorimit të tyre të gjatë dhe nga ngjitja e tyre në një fjalë të vetme. Zakonisht secila prej këtyre fjalëve ruan jo vetëm kuptimin e saj por edhe trajtën e saj flektive. ... Pra, këto fjalë nuk përbëjnë tjetër veçse ngjitjen e sintagmës, e cila jep si rezultat një njesi të vetme fonetiko-morfologjike, por si rregull semantikisht është e barabartë me shumën e kuptimeve të gjymtyrëve të bashkangjitura, të cilat nuk bashkohen gjithnjë vetëm me pjesët “sinjifikative” të ligjeratës, por lidhen edhe me pjesëzat e ligjeratës.”³¹⁸ Por në punimin tjetër “Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes”, punim në të cilin Kostallari bën ndarjen e kompozitave dëshirore mbi bazën e strukturës në fjalë të përbëra dhe fjalë të përngjitura³¹⁹, fjalët e përngjitura dëshirore emra, si p.sh. *ndjesëpast-i, qoftëlarg-u* apo *largnesh-i*, i shqyrton si fjalë të formuara me një mënyrë të përzier, nga përngjitja dhe njëfjalëzimi i fjalive dëshirore dhe njëkohësisht emërzimi i tyre³²⁰, duke e parë në këtë mënyrë përngjitjen në një marrëdhënie të ngushte me konversionin, një tjetër mënyrë jomorfologjike.

Por ndërsa Kostallari i sheh fjalët e përngjitura të formohen në procesin e përdorimit të gjatë duke përbërë kështu dhe një nga tiparet dalluese të tyre me fjalët e përbëra, të cilat

³¹⁶ K. Cipo, Gramatika shqipe, Tiranë, 1949, f. 43.

³¹⁷ A. Xhuvani, Kompozitat, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972, f. 69

³¹⁸ A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972, f.84-85

³¹⁹ A. Kostallari, Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972, f. 155

³²⁰ A. Kostallari, po aty. f. 167

formohen në procesin e krijimit të fjalëve mbi bazën e modeleve ekzistuese të gjuhës, Hysa e trajton më gjerë çështjen e përngjitjes dhe fjalëve të përngjitura duke ndarë të njëjtin mendim me Kostallarin vetëm sa u takon disa prej fjalëve të përngjitura, të cilat ai i quan “*tipe të thjeshta të përngjitjes*”³²¹ si në rastet e fjalëve *gjitmonë, atëherë, gjithnjë, sivjet* etj. Ndërsa në rastet e fjalëve si *i deritanishëm* apo *i pashkollë*, ku përngjitja bashkëvepron me mënyra të tjera fjalëformuese, ai nuk pranon të jenë formuar në procesin e përdorimit, por i motivon “*mbi bazën e togjeve që formojnë një përngjitje si akt krijimi*.”³²² Ky qëndrim mbështetet edhe nga Buxheli³²³, e cila kombinimin e përngjitjes me mënyrat e tjera fjalëformuese morfologjike, pikërisht prapashtesimin dhe nyjëzimin, në formimin e fjalëve të përngjitura të tipit *i përdyjavshëm*, e sheh si një akt krijimi. Madje si një akti krijimi sheh Buxheli edhe formimin e fjalës së përngjitur “*togfjalësh*”, në formimin e së cilës, përngjitja nuk bashkëvepron me ndonjë mënyrë tjetër fjalëformuese, duke vërejtur se kjo fjalë gjen përdorim edhe e ndarë, pra edhe në formen tog fjalësh, dhe se ajo ashtu sikurse dhe fjalët e tjera të përngjitura nuk mund të motivohet me çfarëdolloj togu fjalësh. Me rëndësi në krijimin e fjalëve të tilla Buxheli sheh dendurinë “*e përdorimit të togjeve me të cilat motivohen ato*”.³²⁴

IV.2. Përngjitja si mënyrë fjalëformuese

*“Përngjitja është një mënyrë fjalëformimi, me anë të së cilës formohen fjalë të reja nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi, i një togu parafjalor ose i një grupi fjalësh në përgjithësi.”*³²⁵

Si fjalë të përngjitura klasifikohen fjalët: *bardhezi, dymbëdhjetë, farëefis, faleminderit, gjëegjzë, gjithmonë, gjithnjë, kuqezi, kushedi, megjithëse, ndonjëherë, nëntëmbëdhjetë, paradite, përreth, tungjatjeta* etj.

Siç mund të vihet re si nga përkufizimi ashtu edhe nga shembujt, nëpërmjet përngjitjes formohen fjalë të reja pa pjesëmarrjen e mjeteve fjalëformuese siç janë ndajshitesat, nyjat e përparme apo temat fjalëformuese, duke bërë që kjo mënyrë fjalëformimi të klasifikohet si mënyrë jomorfologjike krahas konversionit me të cilin ka lidhje të ngushtë për vetë faktin se, në momentin që leksikalizohet një togfjalësh, një tog parafjalor, një grup fjalësh apo edhe një fjali e tërë, siç ndodh në rastin e “*tungjatjeta*”, togfjalëshi, grupi i fjalëve apo dhe vetë fjalia merr vlerën e një pjese ligjrate të caktuar. Ajo sipas rastit emërzohet “*thashethem*”, mbiemërzohet “*bardhezi*”, ndajfoljëzohet “*githmonë*”, foljëzohet “*vërej*” e kështu me rradhë. Kur ndodh procesi i përngjitjes, i shkrirjes së gjymtyrëve të togfjalëshit, apo pjesëve të fjalisë në një njësi të vetme, pra kur ndodh njëfjalëzimi, togu i fjalëve formësohet gramatikisht duke marrë trajtëformime të veçanta nëse fiton vlerën e një pjese të ndryshueshme të ligjeratës. Ai sillet si emër, folje apo mbiemër, sipas rastit, ose si pjesë e pandryshueshme e ligjeratës kur fiton vlerën e njërës

³²¹ E. Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, Tiranë, 1975, f. 66

³²² E. Hysa, po aty, f. 66

³²³ L. Buxheli, Rreth fjalëve të përngjitura në gjuhën e sotme shqipe, në: SF 4/ 1986, f. 61

³²⁴ Buxheli, po aty, f. 61

³²⁵ Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 75

prej tyre. Pra fjalët e përngjitura shprehin një kuptim leksikor të caktuar, i cili si rregull është i barabartë me kuptimin e togut nga ka dalë fjala e përngjitur dhe nëse ajo është një fjalë kuptimplotë atëherë ajo përdoret si gjymtyrë me vetë në fjali. Edhe në planin sintaksor fjalët e përngjitura kryejnë të njëjtat funksione sintaksore si dhe pjesët e ligjeratës ku ato bëjnë pjesë. Karakteristikë e tyre është edhe theksi i vetëm që ato kanë, i cili pavarësisht nga numri i njësive përbërëse të fjalës së përngjitur bie gjithnjë në elementin e fundit, duke e formësuar kështu gjithë fjalën e përngjitur edhe nga pikëpamja fonetike.

Fjalët e përngjitura formohen nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi, si p.sh. *gjithmonë*, i një togu parafjalor, si p.sh. *pasdite*, i një grupi fjalësh, si p.sh. *thashethem*, ose edhe i një fjalie të tërë, si p.sh. *mirupafshim*, si pasojë e përdorimit të tyre për një kohë të gjatë. Por kjo nuk do të thotë se nga çdo grup fjalësh apo nga çdo togfjalësh mund të krijohen fjalë të përngjitura. Që të ndodh diçka e tillë kërkohet që gjymtyrët e togfjalëshit, apo togut të formojnë një lidhje të qëndrueshme, dhe gjatë procesit të gjatë të përdorimit ato e humbasin karakterin e tyre si fjalë të veçanta brenda togut dhe shkrihen duke formuar edhe nga ana formale një fjalë të vetme. Në disa raste fjalët e përngjitura motivohen me fjali. Edhe këto nuk mund të jenë të çfarëdollojshme. Zakonisht bëhet fjalë për fjali dëshirore apo urdhërore, të cilat përdoren prej kohësh në formën e formulave të urimit apo mallkimit apo dhe dëshirës, si p.sh.: *largnesh*, *qoftëlargu* etj. Në disa raste fjalët e përngjitura motivohen edhe me fjali pyetëse si p.sh. *kushdo* apo *cilido* etj.

Kur togu parafjalor, grupi i fjalëve apo togfjalëshi leksikalizohet, lidhjet sintaksore midis gjymtyrëve të togfjalëshit apo togut ruhen zakonisht të qarta edhe në fjalën e re të krijuar, pra në fjalën e përngjitur: *farëefis* (farë e fis), *gjëegjëzë* (gjë e gjëzë), *gjithandej* (gjithë andej), *askush për kra* (për kra), *padashur* (pa dashur), *falemnderit* (falem nderit), *shtatëmbëdhjetë* (shtatë mbë dhjetë), *drejtpërdrejt* (drejt për drejt), *domosdo* (do mos do), *asnjëherë* (as një herë), *vëmendje* (vë mendje) etj. Kjo gjë bën që fjalët e përngjitura të jenë të motivueshme edhe nga pozitat e shqipes së sotme edhe pse shpesh krijimi i tyre është rezultat i një procesi përdormi të gjatë. Kjo gjë bëhet e qartë veçanërisht në rastet kur fjala e përngjitur e formuar ruan të fosilizuar edhe treguesit morfologjikë si p.sh.

para dite → *paradite*
(fjalë e përngjitur në të cilën vazhdon të ruhet elementi flektiv i rrjedhores)

Ka fjalë të përngjitura në të cilat vetëm ndonjëra nga njësitë e saj ka pësuar ndryshime fonetike, si p.sh.:

gjithë motnë → *gjithmonë*
shtoi zot vallet → *shtojzovalle*

Por ka dhe fjalë, të cilat sot tingëllojnë si fjalë të pamotivueshme, pasi koha e përdorimit të elementëve përbërës së tyre është shumë e lashtë dhe ato nuk mund të motivohen me shqipen e sotme, si p.sh.

kushtrim → kush je ti o trim

Nisur nga sa u analizua më lart, mund të themi se fjala e formuar me përngjitje është një fjalë e re jo vetëm parë nga pikëpamja leksikore, por edhe nga ajo fonetiko-morfologjike. Në grupin e fjalëve të përngjitura gjejmë shumë të tilla të cilat kanë në përbërjen e tyre një element të përbashkët, si p.sh.:

kushdo, cilido, çfarëdo, ngado, kudo, kurdo, tekdo, sado, sido, të gjitha fjalë të përngjitura me elementin e dytë të përbashkët;

asfare, asfarëgjë, asgjë, asgjëkafshë, asgjëkundi, asgjëmangut, asgjësend, të gjitha fjalë të përbëra me element të parë të përbashkët;

gjëgjëzë, thashethem, ecejak, farëefis, shkeleshko, të gjitha fjalë të përngjitura me element të përbashkët elementin lidhëzën *e* që bashkon gjymtyrët e fjalës së përngjitur;

njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, katërmëdhjetë, pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë; të gjithë numërorë të përngjitur me element të përbashkët *mbë* (mbi) dhe *dhjetë*.

Shembujt e mësipërm tregojnë se ka fjalë të përngjitura, të cilat nga pikëpamja strukturore kanë afri me njëra tjetrën, madje bëhet fjalë për fjalë të përngjitura që i përkasin së njëjtës pjesë ligjerate. A kemi të bëjmë në këto raste me formime analogjike? Analogjia është karakteristike për mënyrat fjalëformuese morfologjike, pasi këto mënyra ndajshesimi dhe kompozimi, veprojnë mbi bazë modelsh, janë të hapura dhe mbështeten në anën strukturore dhe atë semantiko-funksionale, ndërsa fjalët e përngjitura janë të mbyllura dhe mbështeten vetëm në anën strukturore³²⁶. Por gjithsesi ajo vepron edhe te fjalët e përngjitura. Për Buxhelin këto raste nuk janë të gjitha rezultat i përngjitjes së togjeve në një proces të gjatë përdorimi. Me të drejtë një pjesë të tyre ajo i sheh të krijuara sipas një modeli strukturor të gatshëm, siç është rasti i numërorëve. Ndaj mund të themi se edhe brenda fjalëve të formuara me përngjitje është krijuar një model, i cili ka lejuar formimin e fjalëve të tjera.

Fjalët e përngjitura janë më tepër karakteristike e pjesëve të pandryshueshme të ligjeratës, pasi ndeshen më shumë mes tyre, por jo vetëm. Ato mund të jenë:

ndajfolje: *gjithmonë, gjithnjë, gjithkund, gjëkundi, asgjëkundi, kurdo, sido, ngado, kurdoherë, ngandonjëherë, diku, dikur, asnjëherë, menjëherë, matanë* etj.;

parafjalë: *përmbi, nëpër, përveç, sipas, simbas, ndërmmjet, nëpërmjet* etj.;

lidhëza: *gjersa, derisa, porsa, sesa, kurse, nëse, ndonëse, sikurse, pasi, meqë, meqenëse, mirëpo, megjithatë, megjithëkëtë* etj.;

pjesëza: *pale, posi, siç, thujajse, kushedi* etj.;

pasthirrma: *faleminderit, tungjatjeta, mirupfshim* etj.

Por me anë të përngjitjes janë formuar edhe

disa përmra të pacaktuar: *kushdo, cilido, çdo, çfarëdo, ndokush, ndonjëri, ndonjë, sekush, akëcili, askush, asnjë, asgjë, kurrkush, kurgjë, gjithëkush, gjithsecili, tjetërkush, shumëkush, gjësendi, gjëkafshë* etj.

numërorët: *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, katërmëdhjetë, pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë*


pak emra: *farëefis, gjëgjëzë, thashethem, ecejake* etj.

shumë pak folje si *bëzaj, vërej* apo *përsëdyt* si dhe


³²⁶ L. Buxheli, Rreth fjalëve të përngjitura në gjuhën e sotme shqipe, në: SF 4/1986, f. 61

ndonjë mbiemër si *kuqezi*


Siç mund të vihet re edhe nga shembujt e mësipërm, elementet përbërëse të fjalëve të përngjitura mund të jenë vetëm fjalë të ndryshueshme të ligjeratës, si p.sh:



ose vetëm fjalë të pandryshueshme të ligjeratës, si p.sh.:



ose edhe një kombinim mes tyre si p.sh.:



Elementet përbërëse të fjalëve të përngjitura mund të jenë emra, folje, numërorë, përemra dëftorë, përemra pyetës, përemra të pacaktuar, ndajfolje dhe vetëm në rastin e mbiemrave të përngjitur mbiemra, si dhe mund të jenë fjalë shërbyese si: parafjalë, lidhëza, pjesëza e pasthirrma.

Siç është theksuar edhe më lart, fjalët e përngjitura mund të jenë dygjymtyrëshe ose mund të jenë edhe me më shumë se dy gjymtyrë, kjo gjë varet nga numri i pjesëve përbërëse të tyre, çka përbën një tjetër ndryshim me fjalët e përbëra, të cilat pavarësisht nga numri i temave motivuese pjesëmarrëse në formimin e kompozitës, janë gjithnjë dygjymtyrëshe. Zakonisht numri i gjymtyrëve të fjalës së përngjitur përkon me numrin e

elementeve përbërëse së saj. Kështu këmi fjalë të përngjitura dygjymtyrëshe, trigjymtyrëshe dhe më pak katërgjymtyrëshe:

dygjymtyrëshe

kushdo	=	kush + do
sesi	=	se + si
njëherë	=	një + herë

trigjymtyrëshe

drejtpërdrejt	=	drejt + për + drejt
menjëherë	=	me + një + herë
megjithëse	=	me + gjithë + se

katërgjymtyrëshe

sidokudo	=	si + do + ku + do
ngandonjëherë	=	nga + ndo + një + herë

Duke u nisur nga analiza e mësipërme mund të thuhet se përngjitja dhe kompozimi, fjalët e përngjitura dhe kompozitat, pavarësisht rasteve të ndërmjetme apo vështirësisë në përcaktimin e përkatësisë në këtë apo atë grup fjalëformues të ndonjë fjale të veçantë, shfaqin dallime thelbësore mes njëra-tjetrës.

Kompozimi si mënyrë fjalëformimi mbetet një akt krijimi, ndërsa përngjitja në shumicën dërrmuese të saj vepron në një proces të gjatë përdorimi. Kompozimi është një mënyrë morfologjike fjalëformimi, pasi realizohet nëpërmjet bashkimit të temave motivuese, sipas modeleve ekzistuese në gjuhë, të cilat pavarësisht nga numri i temave pjesëmarrëse në krijimin e fjalës së përbërë, formojnë gjithnjë vetëm dy gjymtyrë, ndërsa përngjitja është një mënyrë jomorfologjike, e cila realizohet, nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi të qëndrueshëm dhe brenda fjalës së formuar, secila fjalë krijon një gjymtyrë të fjalës së përngjitur.

Një rol të rëndësishëm të fjalët e përngjitura luan theksi, i cili është një i vetëm dhe bie në pjesën e fundit përbërëse të fjalës së përngjitur, ndërsa te kompozitat theksi shoqërohet nga faktori morfologjik, i cili është shumë i rëndësishëm.

Një ndryshim tjetër vihet re midis fjalëve të përngjitura dhe kompozitave sa i takon prodhimtarisë së tyre, pjesëve të ligjeratës të formuar nëpërmjet tyre si dhe pjesëve të ligjeratës që marrin pjesë në formimin e fjalëve të përngjitura dhe kompozitave. Kompozimi bashkë me ndajshitesimin janë njohur dhe pranuar nga të gjithë gjuhëtarët si dy mënyrat më prodhimtare të pasurimit të leksikut dhe fjalorit të gjuhës shqipe. Pra mund të themi se dhe për vetë natyrën dhe mënyrën e formimit të fjalëve nëpërmjet

përngjitjes nevojitet kohë për t'u formuar fjalë të reja, ndërkohë që kompozimi duke qenë akt krijimi që vepron mbi bazën e modeleve, e ka shumë më të lehtë të prodhojë fjalë të reja. Por nga ana tjetër kompozimi vepron vetëm në pjesë të caktuara të ligjeratës. Nëpërmjet tij formohen kryesisht mbiemra dhe emra dhe me pak folje e ndajfole, ndërsa edhe pse përngjitja vepron në të gjitha pjesët e ligjeratës, fjalë të përngjitura janë edhe disa emra dhe nja dy mbiemra e folje, ajo ndeshet më tepër te pjesët e pandryshueshme të ligjeratës si dhe te një numër i konsiderueshëm përemrash të pacaktuar dhe ndajfoljesh. Në formimin e kompozitave marrin pjesë tema fjalëformuese emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore si dhe tema numërorësh e përemrash, ndërsa te fjalët e përngjitura përveç këtyre fjalëve gjejmë edhe parafjalë, pjesëza dhe lidhëza.

IV.3. Përngjitja dhe bashkëveprimi i saj me mënyrat e tjera fjalëformuese

Përngjitja është parë nga Kostallari³²⁷ si një mënyrë fjalëformuese, nëpërmjet së cilës formohen fjalë të përngjitura në një proces të gjatë përdorimi, duke përbërë në këtë mënyrë dhe një nga ndryshimet kryesore me mënyrën tjetër fjalëformuese të kompozimit, e cila përbën një akt krijimi, çka do të thotë se fjalët e përbëra janë krijime në bazë modelesh. Ky qëndrim pranohet deri diku nga Hysa, i cili në punimin e tij "*Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*"³²⁸ me të drejtë vëren se një gjë e tillë mund te thuhet për ato fjalë të përngjitura, të cilat ai i quan të mirëfillta si *gjithëfarë, anëmbanë* apo *gjithnjë*, ndërsa në rastin e fjalëve të tipit *i mëtejshëm* apo *i deritanishëm* nuk mund të pohohet një gjë e tillë. Fjalë të tilla nuk mund te motivohen si të formuara nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi të qëndrueshëm në një proces të gjatë përdorimi. "*Këto njësi motivohen mbi bazën e togjeve që formojnë një përngjitje si akt krijimi*"³²⁹ Në këto raste njësia e formuar motivohet mbi bazën e bashkëveprimit të përngjitjes dhe mënyrave të tjera fjalëformuese.



Përngjitja gërshetohet jo vetëm me një mënyrë të vetme fjalëformuese për të formuar fjalë të reja, por edhe më shumë se një në të njëjtën kohë, duke formuar mënyra të përziera dhe duke dhënë ndihmesën e saj në krijimin e një sistemi fjalëformimi të pasur dhe të shumëllojshmëm.

Përngjitja bashkëvepron me prapashtesimin. Nga përngjitja e një togu parafjalor apo i një trajtë foljore analitike dhe bashkimi me një parapashtesë formohen në shqipe ndajfolje dhe emra, si p.sh. *njëherazi, papritmas, përgjumësh, pakujtimas* etj.; *mëditje, përsheptje, pagjumësi, mëkëmbës, nëndetëse, pakujdesi* etj.


³²⁷ A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972, f.75 - 94

³²⁸ Vepër e cituar


³²⁹ E. Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme* II, Tiranë, 1975, f. 66



Përngjitja bashëkvepron edhe me *nyjëzimin* ose më saktësisht paranyjëzimin duke formuar një mënyrë të përzier prodhimtare me anë të së cilës formohen mbiemra, nga bashkimi i një togu parafjalor dhe nyjës. Si temë prodhuese në një rast të tillë shërben togfjalëshi i përngjitur pa + emër në rasën kallëzore të pashquar, dhe jo vetëm si p.sh. *i paanë, i pabesë, i pacipë, i pafuqi, i pafytyë, i pakohë, i papunë, i pashkollë, i pashpirt, i pashhtëpi, i paraluftës* etj.



Në shfaqjen e fundit *përngjitjen* e gjejmë të kombinuar me *paranyjëzimin* dhe *prapashtesimin*, ku si rezultat i këtij bashkeveprimi formohen mbiemra, të cilët kanë në përbërën e tyre një tog parafjalor, ku si parafjalë merr pjesë vetëm parafjala *për*, dhe prapashtesën *-shëm*, si në rastet: *i përbotshëm, i përditshëm, i përdyjavshëm, i përmuajshëm, i përfundshëm, i përkohshëm, i përmothëm, i përmallshë, i përvojshëm* etj.



KREU V. Përngjitja në gjermanishte

V.1.Përngjitja dhe vendi i saj në teorinë e ndryshme të fjalëformimit

Përngjitja, e cila në gjuhën gjermane njihet me emrin *Zusammenrückung*, dhe fjalët e përngjitura (*Zusammenrückungen*) i gjejmë të interpretuara në mënyra të ndryshme në teorinë e fjalëformimit gjerman.

Paul-i në vëllimin e pestë të veprës së tij “Deutsche Grammatik”, i cili i kushtohet fjalëformimit, dallon një tip të veçantë kompozitash për të cilat thotë: “*Mit den Bahuvrihizuss. verwandt sind die aus Imperativsätzen entstandenen, die erst im Nhd. häufiger geworden sind. / Me kompozitat e tipit Bahuvrihi afrojnë edhe ato që kanë lindur nga fjali urdhërore dhe janë shtuar gjatë gjermanishtes së re të lartë.*”³³⁰ Grupin më të madh të këtyre fjalëve sipas tij e përbëjnë emërtimet e personave si *Taugenichts*, *Habenichts*, *Springinsfeld*, *Gottseibeius* etj. Gjithashtu në këtë grup fjalësh, të cilat edhe pse nuk i quan *Zusammenrückungen* i dallon si një tip të veçantë dhe pranon prejardhjen e tyre nga fjalitë urdhërore, klasifikon edhe emra dhe mbiemra njerëzish si *Greifzu* apo *Traugott*, emra qensh si dhe emërtime bimësh e “*leblose Gegenstände oder Vorgänge / objekte pa jetë apo procese*”³³¹, si p.sh. :

Wendehals, Packan, Stehaufmännchen, Vergißmeinnicht, Rührmichnichten, Stelldichein etj.

Edhe Henzen-i klasifikon fjalët e përngjitura brenda kompozitave duke i quajtur ato “*unechte Komposita / kompozita jo të mirfillta.*”³³² Si karakteristikë të kompozitave të këtij tipi ai vlerëson rendin e fjalëve të fjalisë fillestare nga janë formuar fjalët e reja si dhe formimin e një fjale të re edhe nga pikëpamja leksikore. Kështu nga fjalia urdhërore “*Rühr mich nicht an*” është formuar emri i bimës *Rührmichnichten* (lule mosmëprek). Njëfjalëzimi i kësaj fjalie urdhërore ruan të njëjtin rend fjalësh duke formuar një njësi të re leksikore, emrin e bimës. Edhe Henzen-i e lidh njëfjalëzimin e këtyre fjalëve, të cilat në teorinë e fjalëformimit njihen me emrin *Satznamen* (emra fjalish), me kompozitat pronësore.

Edhe Erben-i e klasifikon njëfjalëzimin e një grupi sintaksor (*Zusammenrückung einer syntaktischen Gruppe*) brenda kompozitave duke shënuar: “*Von Zusammenrückungen kann als Sonderfall der Zusammensetzung dort gesprochen werden, wo eine syntaktische Gruppe – unter Beibehaltung der Wortfolge und eventueller flexivischer Relationsmorpheme – zu einem Wort bzw. zum Kompositionsglied eines neuen Wortes “zusammengerückt” worden ist / Kemi të bëjmë me fjalë të përngjitura si kompozita të një tipi të veçantë, atëherë kur një grup sintaksor – duke ruajtur rendin e fjalëve dhe eventualisht edhe morfemat trajtëformuese – bashkohet në një fjalë apo në gjymtyrë kompozite të një fjale të re.*”³³³ Për të fjalët *Lange-weile* apo *Saure-gurken-zeit* janë fjalë të përngjitura. Edhe për Erben-in ekziston një lidhje mes fjalëve të përngjituara dhe

³³⁰ H. Paul, Deutsche Grammatik, Band V, Wortbildungslehre, Halle, 1920, f. 31

³³¹ po aty

³³² W. Henzen, Deutsche Wortbildung, Tübingen, 1957, f. 37

³³³ J. Erben, Einführung in die deutsche Wortbildungslehre, Berlin 2006, f.37

kompozitave pronësore (Bahuvrihi), të cilat, sipas tij i afrohen funksionalisht këtyre të dytave. Për Erben-in emrat shumëgjymtyrësh, të cilët gjymtyrën e fundit nuk e kanë emër, “*stimmen überhaupt nicht mehr der üblichen Bauform der Zusammensetzung*” / nuk i përmbahen më mënyrës së ndërtimit të fjalëve të përbëra,³³⁴ dhe i klasifikon si Zusammenrückungen (fjalë të përngjitura).

Jung-u³³⁵ i pranon fjalët e përngjitura (Zusammenrückungen), të cilat në punimin e tij gjenden të klasifikuara brenda grupit të kompozitave. Jung-u bën edhe një përcaktim të termit “*Zusammenrückung*”, sipas të cilit ato janë njësi gjuhësore komponenti i fundit i të cilave nuk e përcakton gjithë njësinë. Jung-u e kufizon grupin e fjalëve të përngjitura në emra dhe ndajfolje dhe liston si të tilla fjalë si:

ermrat: *Dreikäsehoch, Gernegroß, Handvoll, Taugenichts* etj.

ndajfoljet: *derart, dergestalt, daher, dorthin, hierher, zeitlebens* etj.

Por Jung-u pak faqe më tej, teksa trajton një çështje tjetër të quajtur “*Besondere Arten der Wortbildung*” / *Mënyra të veçanta fjalëformimi*, pranon si të tillë krahas konversionit, prejardhjes prapavepruese, shkurtesave dhe kontaminacionit edhe “*Satznamen*” (emra prej fjalish), për të cilat thotë: “*Sätze, darunter Imperativsätze, können zur Worteinheit zusammenrücken und als Ganzes substantiviert werden. / Fjalitë, ato urdhërore, mund të njëfjalëzohen dhe të emëzohen si një e tërë.*”³³⁶

Ky qëndrim nuk është i qartë, pasi ai këto fjalë të formuara nga njëfjalëzimi i fjalive nga njëra anë i quan *Zusammenrückungen* (fjalë të përngjitura) dhe nga ana tjetër pranon emëzimin e tyre dhe e trajton mënyrën e formimit të tyre me një tjetër emër dhe si një mënyrë të veçantë fjalëformimi.

Kuhn-i duke iu referuar marrëdhënieve midis gjymtyrëve të kompozitës dallon tri lloje kompozitash:

Kompozita përcaktore / Determinativompozita

Kompozita këpujore / Kopulativkomposita

Fjalë të përngjitura / *Zusammenrückungen*

Këto të fundit ajo i përkufizon si togfjalësha ose fjali urdhërore të emëruara, përkatësia në pjesë ligjerate e të cilave nuk përcaktohet nga gjymtyra e dytë e kompozitës.³³⁷ Si të tilla ajo liston: *Taugenichts, Stelldichein, Vergißmeinnicht*. Me sa duket edhe nga shembujt, Kuhn-i e kufizon grupin e fjalëve të përngjitura vetëm në klasën e emrave.

Interesant mbetet qëndrimi i Fleischer-it lidhur me çështjen e fjalëve të përngjitura, i cili sipas Donalies-it³³⁸ përcaktoi termin “*Zusammenrückung*”, term që gjeti më pas përdorim të gjerë në teorinë e fjalëformimit. Fleischer-i³³⁹ fillimisht tërheq vëmendjen për një trajtim jo fort të qartë dhe përkufizim të panjësuar të kësaj çështje në teorinë e deriatëhershme. Ai edhe pse pranon se “*Prinzipiell die so bezeichneten Bildungen nichts anders als Zusammensetzungen / parimisht formime të emëruara në këtë mënyrë nuk*

³³⁴ Po aty, f.77

³³⁵ W. Jung, Grammatik der deutschen Sprache, Leipzig, 1988, f. 380

³³⁶ Po aty, f. 387

³³⁷ I. Kuhn, Lezikologie: Eine Einführung, Tübingen, 1994, f. 26-27

³³⁸ E. Donalies, Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick, Tübingen, 2002, f. 93

³³⁹ W. Fleischer, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Leipzig, 1983, f.61-63

janë gjë tjetër veçse fjalë të përbëra,” i dallon këto fjalë dhe e kufizon grupin e tyre duke përfshirë në të “*substantivierte Sätze und Wortgruppen, bei denen die zweite unmittelbare Konstituente nicht Wortart der ganzen Konstruktion bestimmt*” / fjali dhe togfjalësha të emëruar, gjymtyra e dytë e të cilave nuk përcakton se cilës pjesë ligjrate do t’i përkasë fjala e re që formohet. Gjithashtu si karakteristikë të fjalëve të përngjitura (*Zusammenrückungen*) për Fleischer-in është edhe fakti se marrëdhëniet semantike mes gjymtyrëve të këtyre ndërtimeve janë të shprehura në mënyrë eksplicite. Pra edhe Fleischer-i i klasifikon fjalët e përngjitura brenda kompozitave, duke pranuar ndryshime thelbësore mes tyre në strukturë dhe marrëdhënie mes gjymtyrëve. Emrat e përngjitur ai i ndan në dy grupe, grupi pa formë foljore, ku përfshin emra të përveçëm dhe të përgjithshëm njerëzish si: *Durchdenbusch, Dreikäsehoch*, emra bimësh si: *Immergrün* apo dhe erma të tjerë si: *Dankeschön*. Grupi i dytë përbëhet nga emra që përmbajnë një formë foljore dhe që e kanë burimin të fjalitë urdhërore si *Rührmichnichtan*.

Një vëmendje të veçantë Fleischer-i i kushton në këtë punim klasës së ndajfoljeve ku dallimin mes ndajfoljeve të përbëra dhe atyre të përngjitura për të e përbën gjymtyra e dytë. Nëse kjo gjymtyrë është një ndajfolje atëherë fjala është kompozitë, nëse ajo nuk është ndajfolje atëherë kemi të bëjmë me një fjalë të përngjitur si në rastet: *derart, dergestalt, jederzeit, keineswegs, beiseite, zugusten, anstatt, imstande, trotzdem, außerdem, indem* etj. Siç mund të vihet re edhe nga shembujt në grupin e fjalëve të përngjitura shfaqen edhe lidhëza e parafjalë.

Por Fleischer-i ndryshon qëndrim lidhur me fjalët e përngjitura. Nëse në punimin e tij “*Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*”³⁴⁰ ai edhe pse brenda grupit të kompozitave i njeh fjalët e përngjitura (*Zusammenrückungen*), më pas, fillimisht në punimin “*Deutsche Sprache. Kleine Enzyklopädie*”³⁴¹ si dhe në punimin e përbashkët me Barz-in³⁴² “*Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*”, heq dorë nga ky term dhe i shqyrton fjalët e tilla si *Handvoll, Dreikäsehoch* apo *Tunichtgut* si fjalë të formuara me konversion. Edhe ndajfoljet që dikur njiheshin si fjalë të përngjitura, shqyrtohen si fjalë të formuara nga konversioni i togfjalëshave.³⁴³

Kundër përdorimit të termit “*Zusammenrückung*” është edhe Donalies-i³⁴⁴, e cila e sheh si të tepërt përngjitjen si një mënyrë të veçantë fjalëformimi. Për të ato fjalë që në teorinë e fjalëformimit kanë zënë vend si *Zusammenrückungen* (fjalë të përngjitura) janë fjalë formuar nëpërmjet konversionit të togfjalëshave dhe fjalive nga kanë dalë.

Duden-i³⁴⁵ i shqyrton “*Zusammenrückungen*” bashkë me “*Zusammenbildungen*” (kompozim e prapashtesim), “*Kontamination*” (përzjerja e fjalëve) dhe “*Reduplikation*” (dyfishimin) si një mënyrë të veçantë fjalëformimi. Për të ato janë “*Übergangsformen, die weder Präfix- oder Suffixbildungen, noch typische Komposita darstellen* / njësi në

³⁴⁰ Ky punim në vitin 1983 njihet botimin e tij të pestë, por për herë të parë ai doli në shtyp në vitin 1969

³⁴¹ “*Deutsche Sprache. Kleine Enzyklopädie*”, Leipzig 1983, Fleischer harton kapitullin e fjalëformimit, f. 237-273

³⁴² Fleischer/Barz, *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen 2007, f. 49. Botimi i parë i këtij punimi daton në vitin 1990.

³⁴³ Po aty, f. 279

³⁴⁴ E. Donalies, *Die Wortbildung des Deutschen: Ein Überblick*, Tübingen, 2002, f. 93-94

³⁴⁵ Duden, *Die Grammatik, Band 4*, Mannheim, 1998, f. 439

shndërrim të cilat nuk janë as formime me parashtesa apo prapashtesa dhe as kompozita tipike.”³⁴⁶ Ato janë fjalë që kanë cilësi të kompozitave, por shfaqin njëkohësisht edhe karakteristika të grupeve sintaksore. Qëndrim jo i qartë mbahet lidhur me ndajfoljet të cilat quhen gjysmëkompozita (*Halbkomposita*) gjymtyra e dytë e të cilave nuk është një ndajfolje, dhe pranohet të jenë formuar me konversion. Ndërkohë që në çështjen kushtuar formimit të ndajfoljeve pranohet një grup ndajfoljesh të përngjitura leksikalizimi i të cilave është një proces i përfunduar. Si të tilla listohen: *vorderhand, keineswegs, jederzeit, kurzerhand, heutigentags, allemal*.

V.2. Përngjitje, kompozim apo konversion?

Nga sa pamë më lart mund të themi se në teorinë e fjalëformimit gjejmë dy qëndrime lidhur me fjalët e përngjitura (*Zusammenrückungen*). Në punimet disi më të hershme fjalët e përngjitura janë shqyrtuar brenda kompozitave edhe pse në disa raste duke u theksuar karakteri i tyre si kompozita jo të mirëfillta, ose si kompozita të një tipi të veçantë. Ndërsa në punimet më të vonshme fjalët e përngjitura shihen si fjalë formuar me konversion nga togfjalësha ose fjali. Por edhe sa i takon punimeve që mbrojnë të njëjtën tezë vihen re paqartësi dhe kontradikta veçanërisht sa i takon shembujve të përmendur.

Por cilat janë karakteristikat e fjalëve të përngjitura, dhe a mund të themi se ato janë vërtet një tip i veçantë kompozite, apo duhet të pranohen si produkt i një mënyre krejt të veçantë fjalëformimi? Mos ndoshta duhen parë si fjalë formuar me konversion?

Për t’i kthyer përgjigjë këtyre pyetjeve është e nevojshme të nxirren karakteristikat e këtij grupi fjalësh.

Si fjalë të përngjitura janë shqyrtuar fjalë si:

Dreikäsehoch, Rührmichnichtan, Dankeschön, Tunichtgut, Gottseibeius, Lebewohl, Möchtegern, Nimmersatt, Springinsfeld, Stelldichein, Vaterunser, Vergißmeinnicht, keineswegs, jederzeit, heutigentags, allemal etj.

Por këto fjalë nuk mund të quhen kompozita pasi marrëdhëniet sintaksore midis gjymtyrëve të togfjalëshit ruhen edhe kur realizohet njëfjalëzimi i togfjalëshit apo fjalisë, gjë që nuk ndodh në rastin e fjalëve të përbëra, të cilat formohen nga bashkimi i temave fjalëformuese, madje edhe kur gjymtyra e parë ka ende të ruajtur formën e saj të eptimit ajo është pranuar në teorinë e fjalëformimit si element lidhës:

Tu-nicht-gut	→	Tunichtgut (arrakat)
Kind(es) + Alter	→	Kindesalter (fëmijëri)

Kuptimi i fjalëve të përngjitura, veçanërisht atyre që e kanë prejardhjen nga fjalitë urdhërore, zakonisht nuk mund të nxirret nga gjymtyrët përbërëse. Edhe në ato raste kur kjo gjë ndodh, nëpërmjet tyre emërtohet diçka jashtë fjalës. Kjo gjë i afron këto fjalë me

³⁴⁶ Po aty

kompozitat, dhe pikërisht me ato të tipit pronësor, me anë të të cilave emërtohet dikush apo diçka jashtë kompozitës.

Dreikäsehoch (drei-Käse-hoch)	→	gishto, xhuxh
Gottseibeius (Gott-sei-bei-uns)	→	djalli
Dickkopf (dick – Kopf)	→	person kokëfortë
Rotkehlchen (rot-Kehlchen)	→	gushkuq (zog)

Por nga ana tjetër fjalët e përngjitura mund të përbëhen nga dy ose edhe më shumë gjymtyrë, ndërsa kompozitat përcaktore dhe ato pronësore përbëhen vetëm nga dy gjymtyrë, nga të cilat e dyta është e përcaktuara dhe luan një rol shumë të rëndësishëm, pasi përcakton klasën dhe kategoritë gramatikore të gjithë kompozitës.

gerne groß = der Gernegroß	→	jemand, der mehr gelten möchte (mendjemadh)
das Haus + die Tür = Haustür	→	Tür des Hauses (dera e shtëpisë)

Shumëgjymtyrësia i afron ato me kompozitat këpujore, por ndërsa kompozitat këpujore i kanë gjymtyrët nga e njëjta pjesë ligjrate dhe pranojnë ndryshimin e rendit të tyre të paktën teorikisht, gjymtyrët e fjalëve të përngjitura zakonisht përbëhen nga pjesë të ndryshme të ligjeratës dhe rendi i tyre është i ngulitur. Ndryshimi i tyre apo zëvendësimi i goftë edhe njëres prej tyre është i pamundur.

jederzeit	(jeder/përemër-zeit/emër)
Strumpfhose	(Strumpf/emër + Hose/emër)
Rührmichnichtan	*Michrührnichtan
Guckindieluft	*Guckindenhimmel
Hosenrock	Rockhose

Po si produkt të procesit të konversionit a mund të pranohen këto fjalë? Konversioni është formimi i fjalëve të reja duke i kaluar ato nga një pjesë ligjrate në një tjetër³⁴⁷ (*Wortartwechsel*). Por fjalët e përngjitura (*Zusammenrückungen*) formohen nga një strukturë sintaksore e cila mund të jetë togfjalësh ose fjali, pra në këtë rast nuk kemi kalim të një pjese ligjrate në një tjetër, ndaj dhe konversioni nuk mund të pranohet si procesi nga i cili kanë dalë fjalët e tipit *Vergißmeinnicht* apo *jederzeit*.

Nga analiza e bërë më lart del se fjalët e përngjitura ndryshojnë në disa pika të rëndësishme nga fjalët e përbëra, ndaj ne mendojmë se ato nuk mund të klasifikohen si kompozita, as si kompozita të një lloji të veçantë.

Në këtë punim për arsyt e përmendura më lart këto fjalë ndonëse të pakta në numër, krahasuar me grupin e kompozitave apo fjalëve të formuara me konversion, do të pranohen dhe shqyrtohen si fjalë të përngjitura.

³⁴⁷ M. Lohde, *Wortbildung des modernen Deutschen: Ein Lehr-und Übungsbuch*, Tübingen, 2006, f. 45


KREU VI. Fjalët e përbëra dhe të përngjitura në shqipe dhe gjermanishte, të përbashkëtat dhe ndryshimet

Në vijim do të analizojmë fjalët e përbëra dhe të përngjitura të korpusit. Do të vështrohet struktura e tyre, përbërësit, lidhjet e këtyre të fundit me njëri-tjetrin dhe kompozitën apo fjalën e përngjitur në tërësi. Në pjesën e fundit do të bëhet krahasimi i kompozitave dhe fjalëve të përngjitura në shqipe dhe gjermanishte për të parë si shprehen dhe ndërtohen ato, si dhe për të nxjerrë të përbashkëtat dhe ndryshimet mes tyre.

VI.1. Fjalët e përbëra në “Fjalorin e shqipes së sotme”, struktura dhe përbërësit e tyre

Ashtu siç është përmendur edhe më lart, në kreun përkatës, kompozimi në gjuhën shqipe nuk vepron të gjitha pjesët e ligjeratës. Nëpërmjet tij formohen kryesisht emra dhe mbiemra si dhe pak folje e ndajfolje. Në “Fjalorin e shqipes së sotme”, botim i vitit 2002, gjejmë 3384 kompozita, të cilat përbëjnë më pak se 10% të fjalëve të këtij fjalori. Mes tyre, siç tregohet edhe në grafikun e mëposhtëm, vendin kryesor e zënë mbiemrat dhe emrat me numrin më të madh të kompozitave, ndërsa grupi më i vogël është ai i ndajfoljeve me gati 20 kompozita më pak se grupi i foljeve:

Emra (1)	1539 = 45.38%
Mbiemra (2)	1703 = 50.43%
Folje (3)	78 = 2.30%
Ndajfolje (4)	64 = 1.89%
Gjithsej	3384 100%



Pjesa dërrmuese e fjalëve të përbëra në veprën “Fjalori i shqipes së sotme”, botim i vitit 2002, janë fjalë të formuara nga bashkimi i dy temave motivuese. Numri i kompozitave të përbëra me më shumë se dy tema motivuese është i pallogaritshëm. Në këtë fjalor gjejmë vetëm 35 fjalë të tilla, nga të cilat 16 janë emra dhe 20 mbiemra:

emra: *aktmarrëveshje, atdhedashuri, atdhedashje, bashkëmarrëdhënie, bishtfurkabukur, dymbëdhjetënuse, lulekëmbëpulë, njëqindvjetor, pesëdhjetëvjetor, vajgursjellës, shtatëpëllëmbëmjekër, zhytkryekuqe, zëvendës drejtor, zëvendëskomandant, zëvendëskryetar, zëvendësministër*

mbiemra: *aeroplanmbajtës, atdhedashës, derëbabëshuar, dykryegjymtyresh, dymbëdhjetëballësh, gjashtëdhjetëfaqësh, gjashtëmbëdhjetërrokësh, gjashtëdhjetëvjeçar, njëkryegjymtyrësh, njëmbëdhjetërrokësh, njëmijëlekësh, njëqindgradësh, njëqindlekësh, pesëdhjetëlekësh, pesëdhjetëqindarkësh, pesëmbëdhjetëditësh, pesëdhjetëvjeçar, shtatëdhjetëvjeçar, tridhjetëvjeçar, vajgurbajtës*

Duke u nisur nga marrëdhëniet që kanë gjymtyrët e kompozitës mes tyre dallohen kompozitat me marrëdhënie bashkërenditëse, ose kompozitat këpujore, dhe ato me marrëdhënie nënrenditëse, ose kompozitat përcaktore të cilat përbëjnë dhe shumicën dërrmuese të kompozitave të këtij fjalori me rreth 98,5% të gjithë kompozitave. 60 kompozitat këpujore, i gjejmë të shpërndara si më poshtë vijon:

Emra	Mbiemra	Ndajfolje
32	23	8

Edhe pse në Gramatikën e gjuhës shqipe³⁴⁸ pranohen më shumë kompozita këpujore mbiemërore sesa emërore, “*Kjo mënyrë fjalëformimi është bërë shumë prodhimtare në lëmin e mbiemrave*”³⁴⁹, “Fjalori i shqipes së sotme” na paraqet të tjera shifra.

Në përbërjen e kompozitave të gjuhës shqipe marrin pjesë kryesisht pjesë të ndryshueshme të ligjeratës si: emra, mbiemra dhe folje; dhe më pak pjesë të pandryshueshme të saj si: ndajfolje, numëror apo përemëra të pacaktuar, siç do të shqyrtohet edhe në nënçështjet në vijim.

Gjithashtu mes kompozitave emërore dhe mbiemërore gjejmë edhe shumë kompozita, kryesisht emërore, të formuara nga të paktën një temë e huaj me burim nga greqishtja e vjetër apo latinishtja. Tema të tilla “Fjalori i shqipes së sotme” numëron 23 duke dhënë dhe shpjegimin përkatës, për secilën prej tyre, por vihet re se si të tilla gjejmë vetëm ato tema që marrin pjesë si gjymtyrë të para kompozitash, ndërsa temat e tipit *-graf, -graf* apo *-log* si në rastet e fjalëve *kristalograf, skenograf, gjeolog, biolog* etj. nuk i gjejmë të paraqitura më vete në këtë fjalor, duke na bërë të mendojmë se numri i temave të tilla është edhe më i madh.

Këto janë tema të cilat kanë hyrë në gjuhën shqipe si huazime bashkë me fjalën e huaj apo të huazuar. Në disa raste është bërë shqipërimi i gjymtyrës me të cilën janë bashkuar këto tema të huaja, si në rastin e kompozitës *termonuklear / termobërthamor*. Në raste të

³⁴⁸ Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002, f. 71

³⁴⁹ Po aty, f.197

tjera ato janë bashkuar edhe me tema motivuese të gjuhës shqipe duke formuar kompozita të tjera, fenomen gjuhësor të cilin e gjejmë edhe në gjermanishte me të njëjtat tema fjalësh apo dhe të njëjtat fjalë: biolog – Biologe; pseudoshkrimtar – pseudowissenschaftlich; termorregullator - Thermomantel

VI.1.1. Kompozitat emërore në “Fjalorin e shqipes së sotme”

Siç është paraqitur grafikisht edhe në nënçështjen e mësipërme, rreth 45% të kompozitave të shqipes i përbëjnë ato emërore, të cilat në pjesën dërrmuese të tyre janë përcaktore. Në Fjalorin e shqipes së sotme, botim i vitit 2002, gjejmë të listuara vetëm 32 kompozita emërore këpujore, pikërisht kompozitat e mëposhtme:

anarkosindikalist, anarkosindikalizëm, bar-bufe, bardhëkuq, deledash, dritëhije, empiriokriticizëm, fakirfukara, gazavaj, gurapeshë, gushtovjeshtë, hekurbeton, hijedritë, hyrje-dalje, lakadredhë, juglindje, jugperëndim, marrëdhënie, molladardhë, mollaftua, ngarkim-shkarkim, peshkaqen, postë-telegraf, radiotelevizion, socialdemokrat, socialdemokrati, shitblerje, tragjikomedi, vajtje-ardhje, verilindje, veriperëndim, veshmbathje

Në formimin e kompozitave emërore përcaktore të gjuhës shqipe marrin pjesë tema emërore, mbiemërore, ndajfoljore, foljore, përemërore si dhe numërorë.


Duke iu referuar strukturës së gjymtyrëve përbërëse të kompozitës nga pikëpamja e fjalëforimit vëmë re se ato janë si më poshtë vijon:

1. të dyja gjymtyrët janë të shprehura me tema fjalësh të parme. Ky tip përfshin një numër të madh kompozitash emërore:
atdhe, bar-bufe, barkartë, bashkautor, bashkëqenie, bishtaqen, bregdet, dasmatrand, farëkuq, fjalëkryq, gjeldet, gjithëfuqi, gjuhëdele, gjysmëhije, kryeplak, luftanije, lulepatate, mëmëdhe, pulëbardhë, puthador, sqepgjatë, syviç, truprojë, tredhe, vargmal etj.
2. njëra nga gjymtyrët, kryesisht e dyta dhe rrallëherë e para, është një fjalë e prejardhur. Ky tip përbën dhe pjesën dërrmuese të kompozitave emërore:
akthetim, akullçarës, arkërkues, bashkëpronësi, bashkëqytetar, besëlidhje, bukurshqiptim, cigarepërdredhës, datëlindje, drejtrreshtim, dhenxjerrëse, ëndërrshpjegues, fletëlavdërim, golashënues, gurgdhëndës, historishkrues, insektevrasës, kartëpostale, keqadministrim, këndvështrim, kryegjahtar, letërkëmbim, mbarështues, mikpritje, ndihmësmjek, njeriingrënës, organizatë-bazë, pikëmbërritje, qendërmbrojtës, qiellgërvishtës, shumëgarist, shtypshkrim, truparmatë, thjeshtligjërimit, ujësjellës, vetëkënaqësi, vetëhelmin, vendgrumbullim etj.
3. njëra nga gjymtyrët është fjalë e përbërë, ndërsa tjetra fjalë e parme. Në këtë tip përfshihen shumë pak kompozita emërore:

bishtfurkabukur, lulekëmbëpulë, zhytkryekuqe, aktmarrëveshje, bashkëmarrëdhënie, shtatëpëllëmbëmjekër, dymbëdhjetënuse

4. njëra nga gjymtyrët e kompozitës është fjalë e përbërë, ndërsa tjetra fjalë e prejardhur. Edhe ky tip përfshin pak kompozita:
atdhedashuri, atdhedashje, vajgursjellës

Gjithashtu në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjendet edhe një grup kompozitash emërore të formuara nga tema me burim nga latinishtja apo greqishtja e vjetër. Grafiku i mëposhtëm paraqet në përqindje tipat e kompozitave emërore përcaktore të gjuhës shqipe:



Grupi i parë i kompozitave emërore:

temë me burim nga greqishtja e vjetër/latinishtja + emër

mikrobotë:

Siç tregohet edhe në grafik, grupin më të madh të kompozitave përcaktore emërore e përbëjnë ato të formuara nga dy tema emërore. Si të tilla gjenden 1024 nga të cilat 213


janë kompozita emërore të përbëra me të paktën një temë me burim nga greqishtja e vjetër apo latinishtja. Tema të tilla “Fjalori i shqipes së sotme” numëron 23 si:

aero-, auto-, bio-, hidro-, centi-, filo-, kilo-, hekto-, foto-, gjeo-, helio-, hiper-, hipo-, makro-, mega-, mikro-, mono-, neo-, pan-, pseudo-, radio-, termo- dhe ultra-

Më poshtë disa nga emrat e përbërë formuar me këto tema fjalëformuese:

areodinamikë, aeromekanikë, autograf, autokritikë, automobil, autoportret, autotransport, autovinç, biofiltër, biofizikë, centimetër, decilitër, fotoaparati, fotoelement, fotokimi, fotokopje, gjeofizikë, gjeokimi, gjeolog, hidrocentral, hidrosferë, hipertension, kilolitër, makrobotë, makrosistem, mikrobus, mikroelement, pansllavizëm, pseudoshkrimtar, pseudoatdhetar, radiofizikë, radiografi, termocentral, termometër, termorregullator, ultratingull etj.

Grupi i dytë i kompozitave emërore:



Në “Fjalorin e shqipes së sotme” 795 kompozita emërore përbëjnë tipin e formuar nga **dy tema emërore**, duke përbërë kështu dhe grupin më të madh të kompozitave emërore. Brenda këtij tipi dallohen tri nëntipa të tjerë.

Nëntipi i parë përfshin kompozitat emërore gjymtyra e dytë e të cilave është gjymtyra e përcaktuar dhe shprehet me një emër prejfoljor vepruesi, i cili tregon zakonisht një person sipas profesionit apo një objekt sipas punës apo funksionit që kryen. Gjymtyra e parë është gjymtyrë përcaktuese dhe si e tillë përcakton gjymtyrën e dytë duke shërbyer si objekt veprimi mbi të cilën bie puna e kryer nga veta e shprehur nëpërmjet gjymtyrës së dytë. Më poshtë disa shembuj kompozitash emërore të këtij nëntipi:

arkërkues, blindëshpues, borëpastrues, bravandreqës, çanaklëpirës, ditërrëfenjës, drugdhëndës, druprerës, erëpritis, ëndërrshpjegues, fatrrëfyes, femohues, gazetashpërndarës, gurskalitës, hekurthyes, insektevrasës, jorganpunues, kafshërritës, kamatëpagues, këpucëbërës, kohëshënues, letërrshpërndarës, llaçpërzierës, metalshkrirës, minandezës, mishshitës, njeriingrënës, pijeshitës, qiellgërvishtës, raketahedhës, rrobalarës, rrobaqepës, rrufepritis, sahanlëpirës, taksambledhës, tatimpagues, tymthithës, udhëpërshkrues, udhërrëfyes, ujësjellës, voltmatës, xhamprerës, xhokapunues, zëmatës, zjarrfikës etj.

Siç mund të kuptohet dhe nga shembujt, kompozitat e formuara nga një emër dhe një emër prejfoljor vepruesi ose emërtojnë një person sipas profesionit apo punës që ai kryen,

si në rastin e kompozitës *shpendërritës*, nëpërmjet së cilës emërtohet personi që merret me rritjen e shpendëve, ose një vegël apo objekt si në rastin e kompozitës *flakëhedhëse*, e cila emërton një armë zjarri (objekt) që e asgjëson objektivin me flakë³⁵⁰.

Kompozitat emërore formuar nga dy tema emërore të *nëntipit të dytë* kanë si gjymtyrë të parë një emër dhe si gjymtyrë të dytë një emër prejfoljor që shpreh veprim dhe përbëjnë grupin më të vogël të këtyre kompozitave. Edhe në këtë rast është gjymtyra e parë ajo që përcakton gjymtyrën e dytë, në këtë rast emrin prejfoljor që shpreh veprim. Kjo gjymtyrë shërben edhe si objekt i veprimit të shprehur nga gjymtyra e dytë, nga emri prejfoljor, si ndodh në shembujt e mëposhtëm:

armëpushim, atëvrasje, botëkuptim, botëndijim, dëmshpërblim, fjalëformim, gjakderdhje, gjakrrjedhje, huadhënie, huamarrje, jetëshkrim, letërkëmbim, mikpritje, njeridashje, qiradhënie, qiramarrje, shtetrrëthim, trajtëformim, vendimmarrje, vëllavrasje etj.

Në fjalët *besëlidhje* (*lidhje* e besës) apo *mirëdashje* (*dashje* e së mirës) gjymtyra e dytë shpreh një veprim, ndërsa gjymtyra e parë e cila përcakton atë të dytën shërben njëkohësisht edhe si objekt mbi të cilin bie ky veprim.

Kompozitat e këtij nentipi tregojnë veprime abstraktë.

Kompozitat e *nëntipit të tretë* formohen nga bashkimi i një emri me një emër tjetër çfarëdo. Këto kompozita janë emra me kuptime të ndryshme. Një tjetër tipar që i dallon nga dy nentipat e sipërshqyrtuar është fakti se në këtë grup ka fjalë që si gjymtyrë përcaktuese kanë të dytën, por ka edhe fjalë të cilat gjymtyra e dytë përcaktohet nga gjymtyra e parë.

Pjesa më e madhe e këtyre kompozitave ka si fjalë përcaktuese gjymtyrën e dytë:

aktbesim, bregdet, datëlindje, ditëvdekje, fletëarrestim, fletudhëtim, grykëderdhje, gjeldeti, lejehyrje, luledele, luledielli, mandatarkëtim, mandatpagesë, peshk-sharrë, pikëpamje, pikëpyetje, projektvendim, punëdore, rrugëdalje, sypallua, urdhërshërbim, vargmal, vendbanim, vendkalim, vendndodhje, vendqëndrim, votëbesim etj.

Në kompozitat *ditëlindje* apo *peshk-sharrë*, gjymtyrët e dyta, përkatësisht *lindje* dhe *sharrë* përcaktojnë llojin e ditës dhe peshkut, duke i dalluar ato nga ditët apo peshqit e zakonshëm.

Në këtë grup bëjnë pjesë edhe të ashtuquajturat kompozita pronësore emra, të cilat janë shqyrtuar dhe analizuar për herë të parë nga Kostallari³⁵¹, si:

ballëhënë, barkdreq, bishtagyp, bishtagjel, bishtaqen, bishtdac, bishtdhel për, bbuzëdele, buzëlepur, buzërripë, buzësumbull, bythëkromë, bythëqiqër, bythëpulë, dorëzonjë, gjuhëdele, gjuhëlopë, gjuhënuce, këmbëdele, këmbëpat, këmbëqiri, sqepkryq, sqeplugë, syka, sygjarpër, veshflori, veshgomar, zorrëpulë etj.

³⁵⁰ Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë, 2002

³⁵¹ A. Kostallari, Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I*, Tiranë, 1972, f. 142

Këto kompozita emërore me gjymtyrë gjithashtu emërore, emërtojnë kryesisht një qënie, e cila është një bimë ose shpend a kandërr dhe më rrallë njeri (*barkdreq* = ai që rron në kurriz të të tjerëve), objekt (*buzësumbull* = shishe e rrumbullakët me grykë të ngushtë) apo sëmundje (*buzëlepur* = e çarë në buzën e sipërme të njeriut që mbetet që nga lindja; sëmundja që lë këtë shenjë). Emërtimi nuk bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet një tipari dallues që e zotëron qënia apo sendi, i cili është dhe tipari mbizotërues i saj apo i tij. Të gjitha kompozitat kanë si gjymtyrë të parë një emër që emërton një element fizik të qënies. Por mënyra sesi ky tipar apo element bëhet pjesë e kompozitës për t'u bashkuar me gjymtyrën përcaktuese mund të jetë e drejtpërdrejtë ose jo. Kështu në rastin e kompozitës *këmbëqiri* (= *shpend i kënetave i ngjashëm me lejlekun, me këmbë të gjata, të holla e të drejta në ngjyrë të verdhë*), është përdorur drejtpërdrejtë një pjesë e qënies, e shpendit, pikërisht këmbët, të cilat krahasohen me gjymtyrën e dytë të kompozitës. Ndërsa në rastin e kompozitës *këmbëpatë* (= *bimë barishtore me gjethë si këmbë pate...*) gjymtyra e parë, *këmbë*, nuk përbën një pjesë konkrete të qënies që shënohet nëpërmjet kompozitës, por e zëvendëson atë, bimën në rastin konkret, nëpërmjet ngjashmërisë që ka me një pjesë apo element dallues së saj, siç janë *gjethet* në këtë rast, dhe atyre u bëhet krahasimi me një tjetër objekt apo element të ngjashëm, i cili shprehet përmes gjymtyrës së dytë të kompozitës. Pra emërtimi bëhet jo drejtpërdrejt, por në mënyrë të ndërmjetësuar.

Kompozitat e mëposhtme emërore të këtij tipi kanë si fjalë përcaktuese gjymtyrën e parë:

atdhe, çerekfinale, dorëshkrim, elektroteknikë, gjysmëbosht, gjysmëfinale, gjysmëkoloni, hekurudhë, kinooperator, kinoteatër, kryeartikull, kryebandit, kryefamiljar, kryekomandant, kryekonsull, kryeqytet, luftanije, mëmëdhe, postkomandant, qarkkomandë etj.

Në rastin e këtyre kompozitave si *kryeqytet* apo *luftanije*, janë gjymtyrët e para, përkatësisht *krye* dhe *luftë*, ato që përcaktojnë qytetin dhe anijen.


Brenda këtij tipi kompozitash emërore përfshihet edhe një grup me gjashtëmbëdhjetë emra të përbërë me gjymtyrë të shprehura me tema emërore, nga të cilat e dyta përcakton të parën:

ditë-punë, grup-armatë, grup-moshë, kalë-fuqi, kilovat-orë, organizatë-bazë, peshk-sharrë, peshk-shpatë, qen-ujk, qytet-muze, shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, shtëpi-muze, vinç-urë, vinç-kullë, vit-dritë

Këto kompozita kanë lidhje përcaktore-ndajshimore mes gjymtyrëve të tyre dhe janë të një tipi të veçantë, pasi te disa prej tyre tema mbështetëse, ajo që e formëson dhe gramatikisht kompozitën nuk është gjymtyra e dytë, siç ndodh rëndom me fjalët e përbëra, por gjymtyra e parë, e cila ndryshon gjatë lakimit të kompozitës apo formimit të numrit shumës (*kalë-fuqi – kuaj-fuqi*). Duhet thënë se grupi i këtyre kompozitave në shqipë është edhe më i gjerë. Në "*Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*", botim i vitit 1980,

gjejmë edhe disa kompozita të këtij tipi, si: *peshk-kavallë, orë-njeri, dhomë-muze peshk-shigjetë* etj.

Grupi i tretë i kompozitave emërore:




Grupin e dytë më të madh të kompozitave emërore e përbëjnë ato të formuara nga bashkimi i **një teme ndajfoljore** dhe **një teme emërore** (ndajfolje + emër), duke numëruar 238 kompozita të tilla. Më poshtë gjejmë disa prej tyre:

baraslargësi, baraspeshim, barasvlerë, bashkëfolës, bashkëjetesë, bashkëkryetar, drejtshkrim, drejtshqiptim, drejtvendosje, dyshkolonë, gjysmëhije, gjysmëmbrojtës, gjysmëmugëtitirë, jashtëqitje, keqbesim, keqkuptim, mbarështim, mbarështues, mbarëvajtje, miradministrim, mirëbesim, mirëmbajtje, mirëqenie, njëshkolonë, plotfuqi, plotpjestim, plotpjesëtues, poshtëshënim, poshtëshkrim, tejbartje, tejdet, tejlumë, tejshkrim, tejshpim etj.

Gjymtyra e dytë e kompozitave emërore të këtij tipi është e shprehur kryesisht me një emër i cili emërton një veprim ose edhe vepruesin si në rastet e kompozitave *bashkëngjitje* apo *plotpjesëtues*, gjymtyrët e dyta të të cilave shprehin përkatësisht veprimin e ngjitjes në rastin e parë dhe vepruesin, atë që kryen veprimin e pjesëtimit, në rastin e dytë. Por emri i dytë mund të jetë edhe një emër çfarëdo, pa emërtuar domosdoshmërisht veprim apo veprues si në rastet e kompozitave *bashkatdhetar, bashkudhëtar, dyshkolonë, paraluftë* etj. Ku duhet thënë se kompozitat e këtij tipi janë më të rralla.

Si gjymtyrë të parë për kompozitat e këtij tipi në "Fjalorin e shqipes së sotme" gjejmë ndajfoljet: *baras, bashkë, drejt, dysh, gjysmë, jashtë, keq, mbarë, mbas, mirë, njëshplot, poshtë* dhe *tej*.

Grupi i katërt i kompozitave emërore:



Edhe pse tipi i kompozitave të formuara nga një emër dhe një mbiemër është mjaft prodhimtar në formimin e mbiemrave, në "Fjalorin e shqipes së sotme" gjejmë 92 kompozita emërore të këtij tipi. Në pjesën më të madhe të rasteve këto kompozita emërtojnë bimë e shpendë dhe më rrallë veta apo objekte, si në rastet: *belamadh, borëbardhë* e *rrezikzi* apo *furnaltë, gjuhëçarë* e *kartëpostale* si dhe ndonjë veprim siç

është kompozita *bukurshkrim*, për të cilën ne ndajmë të njëjtin mendim me gjuhëtarët e Akademisë së Shkencave³⁵² duke e trajtuar gjymtyrën e parë si mbiemër dhe jo ndajfolje, kjo edhe për faktin se perifrazimi apo shpjegimi i kësaj kompozite edhe në “Fjalorin e shqipes së sotme” bëhet duke e trajtuar gjymtyrën e parë si mbiemër³⁵³. Në këto kompozita përcaktore është gjymtyra e dytë ajo që përcakton gjymtyrën e parë. Bimët, shpendët apo objektet e emërtuara nga këta emra kanë një tipar dallues, i cili i karakterizon dhe mbi bazën e të cilit është bërë gjithë emërtimi duke shënuar vetë qënien apo sendin. Kështu p.sh. *gushbardh* është një lloj zogu i cili e ka gushën e bardhë, ndërsa *gjuhëçarë* është një vegël e thjeshtë muzikore, e cila përbëhet nga një shkop i çarë në mes, ku vendoset një fletëz thekre, nga kjo ngjashmëri ka marrë emrin dhe vegla muzikore. Edhe në këtë rast, ashtu sikurse e shpjeguem pak më sipër, kur folëm për kompozitat pronësore emërore me të dyja gjymtyrët emërore, gjymtyra e parë e cila është edhe pjesë e qënies apo sendit të emërtuar nga kompozita, mund të dalë drejtpërdrejt si pjesë konkrete që e zotëron qenia apo objekti i shënuar, si në rastin e kompozitave *gushkuq* apo *gushbardhë*, ose edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, por mbi bazën e ngjashmërisë së një elementi apo pjese konkrete të qënies apo objektit me atë që emërton gjymtyra e parë e kompozitës, si në rastin e kompozitës *gjuhëçarë* (= vegël muzikore) apo *grykëhollë* (= lloj pushke)


Më poshtë disa shembuj:

barkgjerë, *bishtagjatë*, *bishthollë*, *brikeqe*, *bollëverbët*, *botëbardhë*, *buzëdjegur*, *buzëmadhe*, *drufrutor*, *farëhumbur*, *ferrëbardhë*, *fierkuqe*, *fshikartë*, *grurëzi*, *grykalarmë*, *grykëhollë*, *gushëkuq*, *gjakfalur*, *gjembbardhë*, *hënëplotë*, *hithërbutë*, *kashtëbardh*, *kësulëkuq*, *kryegjatë*, *lulëbardhë*, *pulëbardhë*, *sqepthatë*, *shkozëbardhë*, *thanëkeq*, *virmëkeqe* etj.

Pesë kompozita emërore janë formuar me rend të përkundërt, nga një mbiemër dhe një emër:

bukurshkrim (shkrim i bukur), *bukurshqiptim* (shqiptim i bukur i fjalëve apo fjalive), *bukurtingëllim* (tingëllim i bukur i fjalëve apo fjalive), *thjeshtligjërëm* (ligjërëm i thjeshtë), *tretënatë* (nata e tretë pas lindjes së fëmijës), *tamblaoriz* (lloj ëmbëlsire që bëhet me oriz qumësht e sheqer, ndaj dhe oriz i ëmbël)

Grupi i pestë i kompozitave emërore përfshin ato kompozita të cilat formohen nga:



³⁵² Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002, f. 150


³⁵³ Në “Fjalorin e shqipes së sotme”, botim i vitit 2002, shpjegimi i fjalës “*bukurshrim*” jepet si vijon: *Bukurshkrim*: 1. *Mënyrë shkrimi e bukur, shkrim i bukur*.

Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjenden 71 kompozita të këtij lloji formuar kryesisht me pjesëmarrjen e përemrit vetvetor “*vetë*”. Kompozitat që kanë gjymtyrë të parë këtë përemër përbëjnë dhe rreth 90% të këtij tipi. Pjesa tjetër e kompozitave emërore të këtij tipi formohet nga përemrat e pacaktuar “*gjithë*” dhe “*shumë*”. Vihet re se kompozitat emërore me gjymtyrë të parë përemrin e pacaktuar “*shumë*” në pjesën më të madhe të rasteve shoqërohen edhe nga prapashtesa *-sh* me burim nga rrjedhorja e shumësit:

gjithanësi, gjithëfuqi, shumëgarësh, shumëgarist, shumëkëmbësh, shumëpikësh, vetadministrim, vetëbindje, vetëdemaskim, vetëdënim, vetëdije, vetëgjykim, vetëhipnotizim, vetëkënaqësi, vetëkënaqje, vetëkomandim, vetëkontroll, vetëmjekim, vetëngarkim, vetëpëlqim, vetëpërbuzje, vetëpërmbajtje, vetëpërtëritje, vetëpunësim, vetëshërbim, vetëshkrues, vetëshlyerje vetëvrasje etj.

Në këtë tip kompozitash emërore është gjymtyra e parë ajo që përcakton të dytën, e cila për kompozitat me gjymtyrë të parë përemrin vetvetor “*vetë*” është një emër prejfoljor që shpreh në pjesën dërrmuese të rasteve veprimin (*vetëmbrojtje* = mbrojtje e vetes) dhe më pak vepruesin (*vetëvrasës* = dikush që vret veten), ndërsa për kompozitat e tjera një emër i çfarëdoshëm (*gjithëfuqi* = fuqi, pushtet i pakufishëm, *shumëkëmbësh* = kafshë e vogël me shumë këmbë)


Shumë pranë këtyre kompozitave janë edhe ato të **grupit të gjashtë**, të cilat përbëhen nga:



Gjymtyra e parë e këtij grupi, i cili është i përbërë nga 50 kompozita, është gjithnjë një numëror dhe përcakton gjymtyrën e dytë e cila në pak raste është një emër çfarëdo, si në rastin e kompozitave *dypushtet, dymbëdhjetënuse, pesëgisht* apo *treçerek*, ndërsa në pjesën më të madhe të rasteve një emër i formuar me prapashtesën *-sh* dhe më pak me prapashtesën *-or*:

dygjymtyrësh, dylekësh, dyluftim, dymbëdhjetënuse, dymbëdhjetëgishtore, dypushtet, dyzetvjetor, dhjetëgarësh, gjashtëkëndësh, gjashtëmbëdhjetëmetërsh, gjashtëmujor, njëanshmeri, njëgjymtyrësh, njëshkronjësh, pesëgisht, tetëfaqësh, tetëkëmbësh, treçerek, trehapsh, tregjysh, trekëmbësh etj.

Grupi i shtatë i kompozitave emërore formuar sipas skemës së mëposhtme përbën edhe grupin e fundit të këtij tipi kompozitash:



Ky nëntip kompozitash nuk është fort prodhimtar. Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë 32 kompozita emërore të formuara nga një folje dhe një emër. Në këto kompozita përcaktuese është gjymtyra e dytë. Mes tyre gjejmë edhe katër kompozita me rend të përkundërt. Kështu kompozitat emërore bukëpërmbys, dasmatrand, luleshtrydhe dhe ujëvarë, janë formuar nga një emër dhe një folje. Në disa raste gjymtyrët e kompozitës lidhen mes tyre me një element lidhës si p.sh. *bjerramot, çartabesë, dashakeq, djegagur, marramend, puthador, rrahaderë, shkundadimër* etj.

Tri emra formohen edhe me prapashtesën –ës: *bjerraditës, bjerrakohës, heqkeqës, shkelbaltës*

Më poshtë disa nga kompozitat emërore formuar nga një folje dhe një emër:

bjerraditë, brellis, bukëpërmbys, çartabesë, çartaqejf, çartaujk, dasmatrand, dashakeq/dashakeqës, dashamirë/dashamirës, dredhalesh, fikaplëng, hapagojë, luleshtrydhe, marramend, puthador, rrahaderë, shprishalesh, shtypshkrim, shtypshkronjë, tret dhe, thithëlopë, thirravajë, ujëvarë, vëmendje etj.

VI.1.2. Kompozitat mbiemërore në “Fjalorin e shqipes së sotme”

Mbiemrat me 1710 të tillë, përbëjnë dhe grupin më të madh të fjalëve të përbëra të gjuhës shqipe. Nga shqyrtimi i mbiemrave të përbërë që ndodhen në “Fjalorin e shqipes së sotme”, botim i vitit 2002, del se me përjashtim të shumë pak rasteve, 20 të tilla, ata formohen nga bashkimi i dy temave motivuese duke u ndarë në dy nëntipa kryesorë, në mbiemra të përbërë me lidhje bashkërenditëse, pra mbiemra këpujorë dhe mbiemra të përbërë me lidhje nënrenditëse ose përcaktorë. Nëntipi i fundit përbën dhe pjesën dërrmuese të mbiemrave të përbërë.

Duke iu referuar sturkturës së gjymtyrëve përbërëse të kompozitave mbiemërore nga pikëpamja e fjalëformimit vëmë re se ato janë si më poshtë vijon:

1. të dyja gjymtyrët e kompozitës janë shprehur me tema fjalësh të parme. Ky tip përmbledh shumë kompozita mbiemërore:

afatgjatë, bakeq, balukecjav, ballëgreq, bjallëgjerë, ballëhark, barkbosh, barkthatë, belunazë, buzëkuq, besëqen, bojëgjak, brihell, buzësheqer, cipëhollë, farëvogël, fikaderë, gojëkuti, hallëshumë, hundëdash, kokëlopë, veshgjatë, syrrush, shpirtqen, turimi etj.

2. njëra nga dy gjymtyrët është një fjalë e parme, gjymtyra e parë dhe rrallë gjymtyra e dytë, ndërsa tjetra është shprehur me një temë të prejardhur. Edhe ky tip është mjaft i pasur:

ajërnxjerrës, briartë, barkpangopur, bashkëluftues, bishtpërdredhur, buzëpaqeshur, bukurtingëllues, dhembjemadh, gjumëndjellës, dritargjendtë, dritëndjeshëm, dirtëpërshkrueshëm, farëzhveshur, fjalëmprehtë, flokëpakrehur, gjysmëshekullor, keqbërës, lavdidashës, mirëdashës, i plotpjesëtueshëm, zhurmëmbytës etj.

3. të dyja gjymtyrët janë të shprehura me tema fjalësh të prejardhura. Krahasuar me dy të më sipërm, ky tip përfshin shumë më pak kompozita:


bujqësor-industrial, ekonomikofinanciar, evropianolindor, gjuajtës-bombardues, kërkimor-shkencor, monarkofashist, teknikoshkencor, nacionalçlirimtar, vendimmarrës, vdekjesjellës, vdekjeprurës etj.

4. dallohet dhe grupi i kompozitave mbiemërore me njërën gjymtyrë të shprehur me një fjalë të përbërë dhe tjetrën me një fjalë të prejardhur, i cili nuk është i madh. Në këtë tip mbiemrash të përbërë dallohen ato me gjymtyrët të parë një numëror si dhe pak kompozita me më shumë se dy tema motivuese:

aeroplanmbajtës, vajgurmbajtës, atdhedashës, pesëdhjetëvjeçar, tridhjetëvjeçar, shtatëdhjetëvjeçar etj.

VI.1.2.1. Kompozitat mbiemërore këpujore

Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë 23 mbiemra të përbërë, gjymtyrët e të cilëve janë në marrëdhënie bashkërenditëse me njëri-tjetrin. Duke qenë të tillë ato janë edhe të barazvlershëm si nga pikëpamja kuptimore ashtu edhe nga ajo sintaksore duke plotësuar reciprokisht njëri-tjetrin. Janë që të gjithë mbiemra të panyjshëm, si gjymtyrët ashtu edhe kompozita që ato formojnë, duke i dhënë kësaj të fundit një kuptim thuajse të barabartë me shumën e kuptimeve të gjymtyrëve përbërëse. Pra mbiemrat e përbërë këpujorë formohen sipas skemës së mëposhtme:



Brenda këtij grupi mbiemrash gjejmë nga ata, gjymtyrët e të cilëve lidhen me një element lidhës. Si e tillë shfaqet zanorja *o* (*termobërthamor*) ose edhe viza lidhëse (*bujqësor-industrial*). Por në shumë raste i gjejmë të dyja këto elemente lidhëse të shprehura në të


njëtin mbiemër të përbërë këpujor (*politiko-shkencor*). Për këtë çështje është mbajtur qëndrim në nënçështjen II.2.1. të këtij punimi, në faqen 46.

Më poshtë mbiemrat e përbërë këpujorë:

administrativotokësor, agraroindustrial, bardhëkuq, bujqësor-industrial, ekonomikofinanciar, ekonomikoshoqëror, eterovajor, feudal-borgjez, gjuajtës-bombardues, indoevropian, juglindor, jugperëndimor, kërkimor-shkencor, monarkofashist, nacionalçlirimtar, politikoshoqëror, shkencor-popullor, shurdhmemec, tekniko-shkencor, tragjikomik, verilindor, veriperëndimor, termobërthamor


VI.1.2.2 Kompozitat mbiemërore përcaktore

Tipi i mbiemrave të përbërë me lidhje nënrenditëse shfaqet si tipi më prodhimtar i mbiemrave të përbërë edhe në “Fjalorin e shqipes së sotme”, ku nga 1676 mbiemra të përbërë me dy tema fjalëformuese, 1657 janë me lidhje nënrenditëse. Karakteristikë e këtyre mbiemrave është përcaktimi që i bëjnë njëri-tjetrit gjymtyrët përbërëse të tyre. Përcaktuese mund të jetë gjymtyra e parë, por edhe e dyta. Karakteri përcaktues bën që gjymtyrët e kompozitës ta saktësojnë e konkretizojnë kuptimisht njëri-tjetrin. Në formimin e mbiemrave të përbërë përcaktorë marrin pjesë si pjesë të ndryshueshme të ligjeratës ashtu edhe pjesë të pandryshueshme të saj, duke formuar tipa të ndryshëm dhe të larmishëm kompozitash përcaktore mbiemërore. Grafiku i mëposhtëm hedh dritë mbi grupet më të mëdha të këtyre tipave:



Kolona e parë përfaqëson tipin e parë të kompozitave emërore, formuar nga dy tema emërore, kolona e dytë tipin e formuar nga një temë emërore dhe një temë mbiemërore, e treta tipin e formuar nga një ndajfolje e një emër, kolona e katërt është për tipin me temë ndajfoljore dhe temë mbiemërore. Në kolonën e pestë gjejmë kompozitat mbiemërore formuar nga një numëror apo përemër dhe një mbiemër, ndërsa në të gjashtën ato të formuara nga një numëror ose përemër, një emër dhe prapashtesa *-sh*. Kolona e fundit përfshin dy tipe kompozitash mbiemërore, atë të formuar nga dy tema mbiemërore si dhe tipin e formuar nga një temë foljore dhe një temë ndajfoljore

Tipi i parë i kompozitave mbiemërore formuar nga dy tema emërore sipas modelit:



Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë 404 kompozita të këtij lloji, të cilat ndahen në dy grupe. *Grupi i parë* përbëhet nga ato kompozita të cilat kanë si gjymtyrë përcaktuese të dytën dhe si gjymtyrë të përcaktuar gjymtyrën e parë, si p.sh. kompozita *zemërgur*.

Grupi i dytë përfshin kompozitat mbiemërore në të cilat elementi i parë përcakton të dytin, si p.sh kompozita *liridashës*.

Kompozitat mbiemërore të grupit të parë, me gjymtyrë përcaktuese të dytën, përbëjnë rreth 60% të kompozitave të tipit emër + emër. Të dyja temat prodhuese janë emra të çfarëdoshëm. Duke qenë mbiemra ato shërbëjnë për të emërtuar një tipar ose cilësi të sendit apo qenies dhe jo vetë sendin apo qenien si në rastin e kompozitave pronësore emra, trajtuar më lart në nënçështjen përkatëse. Por ky tip kompozitash mbiemërore nuk e emërton tiparin apo cilësinë drejtpërdrejtë. Emërtimi bëhet nëpërmjet krahasimit. Një element i sendit apo qenies krahasohet me një send tjetër. Pra tipari i sendit apo qenies që karakterizohet nëpërmjet mbiemrit të përbërë jepet përmes krahasimit me sendin e dytë, i cili përbën dhe gjymtyrën e dytë të kompozitës mbiemërore duke e përcaktuar gjymtyrën e parë që është tipari apo elementi i përzgjedhur i sendit apo qenies. Kështu p.sh. për formimin e kompozitës mbiemërore *kokëshkëmb* (= që e ka kokën si shkëmb) është marrë një element, tipar i qenies apo vetës, pikërisht koka, dhe është krahasuar me një send tjetër me të cilin ka ngjashmëri në një tipar dallues të tij, për të dhënë një karakteristikë të qenies apo vetës, e cila shpreh një shumë tiparësh të emërtuara nga temat fjalëformuese. Tipari dallues i shkëmbit është fortësia, ndaj dhe *kokëshkëmb* përdoret për të karakterizuar njerëz që nuk u mbushet mendja lehtësisht, njerëz që janë kokëfortë. Pra, cilësimi i personit apo sendit që karakterizon ky mbiemër bëhet nëpërmjet cilësimit të një element të këtij personi apo sendi, të kokës në rastin konkret.

Këto lloj mbiemrash të përbërë ruajnë deri diku ngjyrimet kuptimore dhe sintaksore të togfjalëshave përgjegjës: *bishtgërshërë* = që e ka bishtin si gërshërë; *brisorkadhe* = që i ka brirët si të sorkadhes; *dhëmbëunazë* = që i ka dhëmbët si unazë; *zemërgur* = që e ka zemrën gur etj.

Më poshtë disa shembuj:

ballëhark, ballukecjav, barkderr, belunazë, bishtgërshërë, brisorkadhe, brishul, buzëqumësht, bythëturtull, degëtendë, duarflori, dhëmbëbrisk, faqezjarr, fatkob, flokëdrizë, frymëqen, fytyrëhënë, gojëpiperkë, gushëmermer, gjuhëbilbil, gjumëlepur, hundëkërrabë, këmbëters, kokëmushkë, kryearushë, lafshëgjak, mendjelaraskë, mesunazë, mjekërcjav, mustaqegjemb, qafësorkadhe, sqepgjilpërë, sybajame, shpirtkazmë, shtatselvi, shtatvigan, trupeshk, turispec, veshopingë, vetullkalem, zemërluan etj.

Në pjesën më të madhe të rasteve gjymtyra e parë shprehet nëpërmjet një emri i cili emërton pjesë trupore. Ky tip kompozitash mbiemërore cilëson kryesisht persona, por jo vetëm, si p.sh. *bricjav* (dhi bricjape) apo *degëtendë* (bredh degëtendë) etj.

Ka disa raste kompozitash mbiemërore formuar nga dy tema emërore me gjymtyrë përcaktuese të dytën, të cilat nuk janë formuar mbi bazën e krahasimit. Në këto raste elementi i shprehur nga gjymtyra e parë zotëron atë të shprehur nga gjymtyra e dytë, si p.sh. në rastet *këmbëlesh* (= që i ka këmbët me qime të dendura e të gjata, me lesh), *qafëlesh*, *sylesh*, *faqetul* (= që i ka faqet me tul), *këmbëtul*, *kokëlesh*, *kokëtul* etj. Gjithashtu këtu përfshihen edhe mbiemrat që kanë si element të parë emrat “*bojë*” dhe “*ngjyrë*”:

bojëfinjë, *bojëgrurë*, *bojëgjak*, *bojëkafe*, *bojëshegë*, *bojëtullë*, *bojëthull*, *ngjyrëkafe*, *ngjyrëmanushaqe*, *ngjyrëmjalte*, *ngjyrëtrëndafil* etj.

Kompozitat e këtij tipi mund të shprehin një cilësi fizike ose shpirtërore:

fizike: *buzëkuti*, *buzëburbuqe*, *dhëmbërruaz*, *dhëmbëshatë*, *faqemollë*, *flokëgështenjë* etj.


shpirtërore: *gojënpërkë*, *gjuhëbilbil*, *mendjefludur*, *shpirtqen*, *zemërgur*, *zemërflori* etj.

Grupi i dytë i kompozitave mbiemërore emër + emër përfshin ato me element përcaktues gjymtyrën e parë, e cila shprehet me një emër çfarëdo, ndërsa si gjymtyrë e dytë, gjymtyrë e përcaktuar, është një emër vepruesi prejfoljor³⁵⁴, si p.sh. *armbajtës* = që përmban ar; *kandërrngrënës* = që ha kandrra etj.

acidedashës, *ajërftohës*, *akullthyes*, *baktermbytës*, *barngrënës*, *borëpastrues*, *dëmprurës*, *dritëlëshues*, *duajlidhës*, *dhembjeqetësues*, *fitimprurës*, *flakvënës*, *frytdhënës*, *gjumëndjellës*, *hekurmbajtës*, *hijedashës*, *insektembytës*, *kanalgërmues*, *kufindarës*, *luftënxitës*, *minakërkues*, *pluhurthithës*, *vendimmarrës*, *zindjellës*, *zjarrduries*, *zhurmëthithës* etj.

Tipi i dytë i kompozitave mbiemërore përcaktore është tipi:

³⁵⁴ Lidhur me këtë çështje është mbajtur qëndrim në faqen 67 të këtij punimi.



Ky është dhe tipi më prodhimitar i mbiemrave të përbërë. Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë 833 kompozita mbiemërore formuar nga një temë emërore dhe një temë mbiemërore. Gjymtyra e dytë që është një temë mbiemërore, përcakton gjymtyrën e parë, e cila shprehet nëpërmjet një emri çfarëdo. Ky emër është pjesë përbërëse e sendit apo vetës së cilësuar nga kompozita mbiemërore, ose edhe një send i çfarëdoshëm por që lidhet me të. Në vijim disa shembuj kompozitash mbiemërore të këtij tipi:

ballargjend, derëzi, ditëshkurtër, ditëzi, dorëmbarë, dorërendë, dritëmekët, dhëmbëprishur, erëkëndshëm, faqekuq, faqefishkur, fatmjerë, fjalëbutë, fletëngushtë, flokëderdhur, flokëgjatë, fytyrëvrenjtur, gojëartë, gjakpastër, gjetheimët, gjuhëmprehtë, halëbardhë, hijerëndë, hundështypur, lëkurëhollë, mendjemprehtë, mustaqekuq, ngjyrëçelët, punëshpejtë, qafëshkurtër, qimeashpër, rrezeartë, trutharë, thonjgjatë, zemërgjerë, zëmbël, zhurmëmadh etj.


Edhe këta mbiemra ashtu sikurse edhe mbiemrat e formuar nga dy tema emërore me përcaktuese gjymtyrën e dytë, duke qenë të përbërë edhe tiparin e sendit apo vetës e shprehin si një nocion të përbërë, dhe ruajnë deri diku lidhjet semnatike dhe sintaksore të togfjalëshave nga kanë dalë, por në ndryshim nga të parët këta mbiemra të përbërë e shënojnë tiparin apo cilësinë e sendit apo vetës në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këta mbiemra cilësinë e shprehin nëpërmjet një pjese që zotëron sendi ose qenia dhe karakteristikës së tij e cila mund të jetë me kuptimin e saj të parë por edhe me kuptim të figurshëm, si p.sh. mbiemri *vetullzi* përdoret për njerëz që i kanë vetullat e zeza, ndërsa *duarartë* për njerëz me duar të arta, por mbiemri në këtë rast mbart kuptim figurativ (= njeri i zoti, që nxjerr nga duart punime të një cilësie të lartë).

Cilësia e shprehur përmes këtyre mbiemrave mund të jetë cilësi fizike ose edhe shpirtërore:

fizike: *belhollë, buzëtrashë, faqekuq, farëbardhë, fijehollë, flokërenë, gushëkuq, kallimadh, këmbëhollë, kokërrimët, lëkurëtrashë, mjekërbardhë, mustaqezi, qimekuq, syzezë etj.*

shpirtërore: *buzëplasur, dorëlëshuar, gojëmbël, gjaknxehët, gjuhëgjarpër, kokëfortë, kokëkrisur, mendjetrashë, sedërmadh, sypatrembur, shpirtzi, zemërthyer etj.*

Tipi i tretë i mbiemrave të përbërë me marrëdhënie nënrenditëse formohet sipas skemës:



Tipi i mbiemrave të përbërë nga dy tema mbiemërore është pak prodhimtar dhe përbën një nga grupet më vogla të kompozitave mbiemërore. Në “Fjalorin e shqipes së sotme” numërohen vetëm njëmbëdhjetë të tillë:


agroteknik,, agrokimik, elektroteknik, elektromagnetik, evropianolindor, evropianoperëndimor, hidroenergjitik, hidrometeorologjik, hidroteknik,i parëlindur, mjekoligjor

Mbiemri i dytë përcakton mbiemrin e parë, me përjashtim të mbiemrit *i parëlindur*, në të cilin është gjymtyra e parë ajo që përcakton të dytën duke treguar se i sati ka lindur personi që cilësohet përmes këtij mbiemri.

Gjymtyrët e këtyre kompozitave mbiemërore kanë edhe një element lidhës, pikërisht zanoren *o*, e cila bën që të dy mbiemrat të shkrihen në një fjalë të vetme e të pazbërthyeshme.

Nëpërmjet këtyre mbiemrave shprehet prejardhja e një sendi apo vete si në rastin e kompozitave *evropianoperëndimor* apo *evropianolindor*, si dhe lidhjen e sendit që cilësohet nga mbiemri me një fushë të caktuar siç ndodh me mbiemrat *elektroteknik* apo *hidroenergjitik*.

Tipi i katërt i kompozitave mbiemërore përfshin mbiemrat e përbërë formuar nga



Edhe tipi i katërt i mbiemrave të përbërë përcaktorë nuk është fort prodhimtar. Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë 56 mbiemra të tillë, 73% të të cilëve janë formuar nga një temë emërore e një ndajfoljore dhe vetëm 27% me rend të anasjelltë.

Për kompozitat mbiemërore me gjymtyrë të parë një temë ndajfoljore dhe gjymtyrë të dytë një temë emërore, si tema motivuese shërbejnë një ndajfolje çfarëdo dhe një emër prejfoljor që shpreh veprues. Gjymtyra e parë, tema ndajfoljore përcakton atë emërore:


bashkëluftues, bashkëpërgjegjës, bashkëmoshatar, bashkërenditës, bashkëshoqërues, bashkëveprues, keqbërës, keqdashës, kundërthënës, largpamës, mirëbërës, mirëdashës, mirënjohës, mirëpritës, shqipfolës

Tipari i shprehur nëpërmjet këtyre mbiemrave e kryen sipas ndajfoljes përkatëse veprimin që mbart emri i vepruesit. Kështu *keqbërës* = që të bën keq apo *shqipfolës* = që flet shqip, *mirëbërës* = që bën mirë etj.

Edhe kompozitat mbiemërore të këtij tipi me rend të anasjellë, gjymtyrë të parë emër dhe gjymtyrë të dytë ndajfolje nuk janë të shumta. Në “*Fjalorin e shqipes së sotme*” numri i tyre arrin në 41. Edhe në këtë lloj kompozitash gjymtyra e shprehur me ndajfolje, e dyta, është elementi përcaktues. Tema emërore është gjithnjë një pjesë e sendit apo qenies që karakterizon apo cilëson gjithë kompozita mbiemërore, si p.sh. *barkjashtë* (= që e ka barkun jashtë): me këtë mbiemër karakterizohen persona që e kanë barkun të zbuluar, janë të zhveshur. Ndajfoljet që marrin pjesë në formimin e këtyre mbiemrave janë kryesisht: *jashtë, përpjetë, bosh, plot, shumë* e ndonjë tjetër.

barkbosh, barkplot, bishtcakërr, bishtpërpjetë, besëplotë, brengëplot, bukëplotë, brengëshumë, brinjëjashtë, bythëjashtë, dorëjashtë, durimshumë, dhëmbëjashtë, festemënjane, fjalëpak, grykëpërpjetë, grykëposhtë, gjumëshumë, halleshumë, hundëpërpjetë, llërëjashtë, mendjeshumë, valëshumë, zorrëbosh, zhurmëshumë, degëplotë, magjiplotë, mëshirëplotë, rrezeplotë etj.

Në **tipin e pestë** të kompozitave mbiemërore përcaktore, i cili përbën rreth 6% të gjithë kompozitave mbiemërore përcaktore, në fjalor numërohen 98 të tilla, përfshihen mbiemrat e përbërë formuar nga një temë ndajfoljore dhe një temë mbiemërore sipas skemës:




Gjymtyra e shprehur me ndajfolje përcakton gjymtyrën e dytë, e cila shprehet me një mbiemër të çfarëdoshëm. Ndër ndajfoljet që formojnë mbiemra të tilla përmendim: *bashkë, drejt, gjysmë, jashtë, larg, lart, tej, shumë, plot* e ndonjë tjetër, siç e tregojnë edhe shembujt e mëposhtëm:

bashkëkohor, bashkëqendror, bashkëshoqërues, bashkëtingëllor, bashkëveprues, bashkëluftues, brendafisnor, i brendashkruar, drejtboshtor, drejtkëndor, gjysmanalfabet, gjysmendacak, gjysmëgjallë, gjysmëkodrinor, gjysmëmamor, gjysmëshekullor, gjysmëzejtari, gjysmëzyrtar, jashtëbuxhetor, jashtëfisnor, jashtëgjinor, jashtëgjyqësor, jashtëkohor, i jashtëligjshëm, jashtëmartesor, i jashtënatyrshëm, jashtëparlamentar, jashtëqendror, jashtëshkollor, i jashtëshkruar, jashtëtokësor, i jashtëzakonshëm, i lartëpërmendur, mbarëkombëtar, i mirënjohur, i plotfuqishëm, i plotpjesëtueshëm, i

plotpushtetshëm, i poshtëshënuar, i posablerë, i porsalindur, i sipërpërmendur, i sipërshënuar, tejbartës, i tejudkshëm, i tejpashëm, i tejshkruar etj.

Tipi i gjashtë i mbiemrave të përbërë përcaktorë formohet nga:



Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë 112 kompozita mbiemërore të këtij tipi, nga të cilat gati 20% kanë si gjymtyrë të parë një përemër të pacaktuar dhe 57% një numëror. Si gjymtyrë e parë shërbejnë një numër çfarëdo ose një përemër i pacaktuar. Kjo gjymtyrë përcakton gjymtyrën e dytë të shprehur me një mbiemër çfarëdo:

Mbiemra të përbërë me gjymtyrë të parë një numër çfarëdo:

dyanësor, dyatomik, dyballor, dybarkor, dyboshtor, dybuzor, dyfazor, dykrenor, i dykuptimshëm, i dylugët, dypolar, dyqelizor, dythelbor, dyvalent, dyvjeçar, i dyvlershëm, dyzanor, dyzetvjeçar, dhjetëditor, mijëvjeçar, i njëanshëm, njëbazik, njëboshtor, njëbuzor, njëgjethor, njëjavor, njëkuptimor, njëqelizor, njëqendror, njëseksor, njëvetor, njëvalent, njëvjetor, i njëvëllimshëm, njëvjeçar, njëzetvjeçar, pesëdhjetëvjeçar, qindvjeçar, shtatëdhjetëvjeçar, shtatëvjeçar, tetëvjeçar, trefazor, tremujor, trevjeçar, tridhjetëvjeçar etj.

Në pjesën më të madhe të rasteve mbiemrat e përbërë me gjymtyrë të parë një numëror dhe të dytë një mbiemër shprehin marrëdhënie kohore ose moshë, ndaj dhe shumë shpesh shfaqen si gjymtyrë e dytë mbiemrat të tipit “ditor”, “mujor” apo “vjeçar”.

Mbiemra të përbërë me gjymtyrë të parë një përemër të pacaktuar:

i gjithëfuqishëm, gjithëkombëtar, shumatomik, i shumëanshëm, shumëbazik, shumëbërthamor, i shumëdashur, i shumëdëshiruar, shumëfazor, i shumëkuptimshëm, i shumënderuar, i shumëpritur, shumëqelizor shumëshekullor, i shumëtrajtshëm, shumëvalent, shumëvjeçar, i shumëvuajtur i tërëfuqishëm etj.


Si gjymtyrë të parë në këtë nëntip mbiemrash të përbërë gjejmë përemrat e pacaktuar “*gjithë*”, “*shumë*” dhe “*tërë*”. Bie në sy mospasqyrimi në këtë fjalor i mbiemrave të përbërë me gjymtyrë të parë përemrin e pacaktuar “*disa*”.

Në tipin e gjashtë kemi përfshirë edhe një nëntip të veçantë të mbiemrave të përbërë me gjymtyrë të parë një përemër. Bëhet fjalë pikërisht për ato mbiemra të përbërë, të cilët gjymtyrën e parë e kanë të shprehur me përemrin vetvetor “vetë”, ndërsa gjymtyra e dytë shprehet nga një mbiemër ose emër vepruesi. Rolin e gjymtyrës përcaktuese edhe për këtë nëntip e luan përemri vetvetor. Duke qenë se përcaktuese është gjymtyra e shprehur me këtë përemër, kompozitat mbiemërore të këtij nëntipi karakterizojnë një send apo një qenie, i cili apo e cila cilësinë e shprehur nga gjymtyra e dytë e kompozitës e kryen ose e realizon vetë: *vetëlëvizës* = që lëviz vetë, *i vetkënaqur* = që është i kënaqur me atë që ka bërë vetë etj. Mendojmë se këmi të bëjmë me formime mbështetur në modelit ekzistues të kompozitës me gjymtyrë të dytë një emër prejfoljor vepruesi.

“Fjalori i shqipes së sotme” numëron 26 mbiemra të tillë, 8 prej të cilëve kanë si gjymtyrë të dytë një emër vepruesi, duke dëshmuar kështu për një prodhimtari jo fort të madhe të këtij nëntipi.

vetadministrues, vetëmbushës, vetëndezës, vetëngritës, vetërrëshqitës, vetëspërkatës, vetëshkarkues, vetëvrasës, vetecës, i vetëdijshëm, i vetëdukshëm, i vetëjetuar, i vetëkënaqur, vetëlëvizës, i vetëlindur, vetëmbrojtës, i vetëmjaftueshëm, vetëmohues, vetëngarkues, vetëqeverisës, i vetëquajtur, vetërrrotullues, i vetëshpallur, vetëveprues, vetushqyes, vetvetor

Një grup të veçantë kompozitash mbiemërore përcaktore përbëjnë ato që formohen nga:



Pjesën dërrmuese të këtij tipi kompozitash emërore e përbëjnë ato me gjymtyrë të parë një numëror me rreth 83% të numrit të përgjithshëm të mbiemrave të këtij tipi që në fjalor arrijnë në rreth 130. Lidhur me nëntipin me përemër mund të themi se si të tillë marrin pjesë vetëm përemrat e pacaktuar. Në “Fjalorin e shqipes së sotme” janë vetëm dy përemrat e pacaktuar që shfaqen si gjymtyrë të para në formimin e këtij tipi mbiemrash të përbërë, përemri i pacaktuar “*shumë*” dhe vetëm në dy raste “*gjithë*”. Bie në sy edhe në këtë rast, mospasqyrimi i përemrave të përbërë me gjymtyrë të parë përemrin e pacaktuar “*disa*”.

Numërori ose përemri i pacaktuar përbën gjymtyrën e parë të kompozitës dhe është njëkohësisht edhe elementi përcaktues i saj. Si gjymtyrë të dytë gjejmë një emër, i cili shoqërohet nga formanti *-sh*. Ky formant, i cili e ka burimin te rrjedhorja e pashquar shumës, gjatë procesit të njëfjalëzimit të togfjalëshit numëror/përemër i pacaktuar + emër në rrjedhore shumës të pashquar, e humbi funksionin e saj si ndajshitesë trajtëformuese duke kaluar në ndajshitesë fjalëformuese dhe kryen funksionin prapashtesës në formimin e mbiemrave të përbërë të këtij tipi. Ky tip mbiemrash e ka burimin e tij te përngjitja e togfjalëshit dhe më pas, nëpërmjet formimit të drejtpërdrejtë të mbiemrave sipas modelit ekzistues është kaluar nga përngjitja në kompozim. Më poshtë disa shembuj kompozitash të këtij tipi:


dybërthamësh, dyfazësh, dygrykësh, dygjuhësh, dyherësh, dykohësh, dykuroresh, dylojesh, dymotorësh, dyngjyrësh, dypalësh, dypjesësh, dhjetëkëmbësh, dhjetëkëndësh, dhjetëlekësh, dhjetëqindarkësh, gjashtëdhjetëfaqësh, gjashtëmbëdhjetërrrokësh, gjashtëmuajsh, katërgrykësh, katërmotorësh, katërvargjesh, katërvendësh, njëaktësh, njëanësh, njëdegësh, njëdynmësh, njëkuroresh, njëlitërsh, njëmbëdhjetërrrokësh, njëmijëlekësh, njëngjyrëshnjëvëllimësh, pesëdhjetëqindarkësh, pesëmbëdhjetëditësh, shtatëballësh, tetëkëndësh, trepalësh etj.

gjithëarmësh, gjithëfarësh, shumëdegësh, shumëformësh, shumëfrymësh, shumëgjymtyrësh, shumëkombësh, shumëkuroresh, shumëmilionësh, shumëngjyrësh, shumëpalësh, shumëpjellësh, shumërrrokësh, shumëshkallësh, shumëtrajtësh, shumëvendësh, shumëzërësh etj.

Këto mbiemra shprehin sasi. Numërori përcakton se sa nga sendi apo sendet e shprehura nëpërmjet gjymtyrës së dytë emërore përmban sendi i karakterizuar nga gjithë kompozita mbiemërore: *katërfletësh* = që ka katër fletë, *dypjesësh* = që ka dy pjesë, *shumëvëllimësh* = që ka shumë vëllime etj.

Në këtë nëntip bëjnë pjesë edhe mbiemrat *gjysmëkilësh, gjysmëlitërsh, gjysmokësh* edhe pse gjymtyrën e parë e kanë të shprehur me një emër, por semantika, mbiemrat shprehin sasi, e lejon klasifikimin e tyre brenda këtij grupi.

Tipi i shtatë, njëkohësisht edhe i fundit i mbiemrave të përbërë përcaktore ndonëse i vogël është i rëndësishëm nisur nga elementet përbërës:



Në “*Fjalorin e shqipes së sotme*” gjejmë pak kompozita mbiemërore, të cilat gjymtyrën e parë e kanë të shprehur me një temë foljore, ndërsa gjymtyrën e dytë me një temë ndajfoljore e cila është edhe gjymtyra përcaktuese. Në disa raste përdoret edhe pjesorja e foljes si gjymtyrë e parë: *dashamir, dashakeq, ngrënëkeq*.

Në disa nga këto kompozita mbiemërore shfaqet si element lidhës zanorja a: *ndjellakeq, ndjellamirë, ndjellazi, prishaqejf*.

Në fjalor gjejmë 15 kompozita të tilla, nga të cilat *fikaderë*, *fikapläng*, *hapaçel* kanë si gjymtyrë të dytë, përcaktuese jo një ndajfolje por një emër, madje kompozita e fundit është me rend të përkundërt (emër + folje).

Kompozitat *dashamir* dhe *dashakeq* i gjejmë edhe në variantet me prapashtesën *-ës*. Madje vetëm në këtë variant gjejmë edhe dy kompozita të tjera, kompozitën *bamirës* dhe *dashaligës*.

Kompozitat e këtij tipi i veshin një tipar sendit apo qenies që karakterizojnë, i cili tregon se si është veprimi i shprehur nga gjymtyra e parë e kompozitës. Kështu *ngrënëkeq* karakterizon qenie që hanë keq, hanë pak e me naze, ndërsa *shtiekeq*, karakterizon dikë që fut të keqen, shkakton sherr. Ndërsa në rastin e mbiemrit të përbërë lehaqen karakterizimi i qenies bëhet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, por përmes krahasimit, *lehaqen* = që flet shumë e kot.

Më poshtë gjejmë kompozitat mbiemërore të këtij tipi që ndodhen në fjalor:

bakeq, *bamirës*, *dashamir*, *dashakeq*, *fikaderë*, *fikapläng*, *hapaçel*, *hekakeq*, *lehaqen*, *ndjellakeq*, *ndjellamirë*, *ndjellazi*, *ngrënëkeq*, *prishaqejf*, *shtiekeq*

VI.1.3. Kompozitat foljore në “Fjalorin e shqipes së sotme”

Kompozimi nuk është një mënyrë shumë prodhimtare për foljet e gjuhës shqipe. Për këtë flet edhe fakti se kompozitat foljore përbëjnë rreth 2% të të gjitha fjalëve të përbëra të gjuhës shqipe.


Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë 78 kompozita foljore, të cilat janë të gjitha kompozita foljore përcaktore, kanë si gjymtyrë të dytë një folje e cila përcaktohet nga gjymtyra e parë.

Lidhur me strukturën morfologjike të temave motivuese përmes së cilave shprehen gjymtyrët e kompozitave foljore, vihet re se gjymtyra e parë shprehet me një fjalë të parme, ndërsa e dyta mund të jetë fjalë e parme ose edhe e prejardhur:

keqkuptoj, *bashkëlidh*, *jashtëqit*, *buzëqesh* etj.; *keqpërdor*, *drejtvendos*, *plotpjesëtoj* etj.

Dallohen dy tipa kompozitash foljore.

Tipi i parë foljeve të përbëra formohet nga:



Siç u tha dhe pak rresht më lart, është gjymtyra e parë, e shprehur me ndajfolje ajo që përcakton gjymtyrën e dytë, duke përcaktuar kështu mënyrën e kryerjes së veprimit që shpreh gjymtyra e dytë e cila mund të jetë e keqe, e mirë, e mbarë, mund të bëhet jashtë


apo brenda, para apo bashkë e kështu me rradhë, sipas kuptimit të ndajfoljes që e përcakton. P.sh.:

mirëkuptoj = kuptoj mirë e drejt – *keqkuptoj* = kuptoj keq, jo drejt

Ky është edhe tipi më prodhimtar i foljeve të përbëra, duke përbërë dhe rreth 85% të kompozitave foljore që gjenden në “*Fjalorin e shqipes së sotme*”. Më poshtë disa prej tyre:

bashkëbisedoj, bashkëjetoj, bashkëlidh, bashkëluftoj, bashkëmbart, bashkëmyll, bashkëpunoj, bashkërendit, bashkësundoj, bashkëshoqëroj, bashkëveproj, bashkudhëtoj, brendashkruaj, drejtrreshtoj, drejtpeshoj, drejtvendos, jashtëqit, jashtëshkruaj, keqinterpretoj, keqkuptoj, keqpërdor, keqtrajtoj, kundërpërgjigjem, kundërsulmoj, kundërveproj, kundërvë, mbarështoj, mirëkuptoj, mirëmbaj, mirëpres, mirërrit, plotpjesëtoj, tejbart, tejçoj, tejduket, tejkaloj, tejpiqet, tejshpoj etj.

Tipi i dytë i foljeve të përbëra është më i kufizuar dhe formohet sipas skemës:



Gjymtyra e parë e këtyre kompozitave foljore shprehet me një temë emërore, e cila përcakton edhe veprimin e shprehur nga gjymtyra e dytë, e cila është një temë foljore. Kështu *buzëqesh* = vë buzën në gaz, qesh me buzë; *dëmshpërblej* = i shpërblej dikut dëmin e bërë; *hakmerrem* = marr hak, shpaguhem për një të keqe të bërë etj. Në të gjitha këto raste duke u përcaktuar folja përmes gjymtyrës emërore, i jepet edhe një kuptim i ri, plotësues gjithë kompozitës.

Në fjalor gjejmë pak foljë të tilla, gjithsej 12:

buzëqesh, bythëprapsem, dëmshpërblej, duartrokas, hakmerrem, këmbëngul, krahëmarr, kryeshtroj, pajambaj, pikësynoj, rrethshkruaj, udhëheq

VI.1.4. Kompozitat ndajfoljore në “*Fjalorin e shqipes së sotme*”

Kompozimi nuk është një mënyrë prodhimtare për formimin e ndajfoljeve të gjuhës shqipe, ndaj dhe numri i tyre është i pakët. Kështu në “*Fjalorin e shqipes së sotme*” gjejmë 62 ndajfolje të cilat në kushtet e sotme mendojmë se duhen trajtuar si ndajfolje të përbëra. Këto ndajfolje e kanë burimin te përngjitja e togfjalëshave, sintagma është shndërruar në një fjalë të vetme. Më pas është kaluar nga përngjitja në kompozim duke u formuar fjalë ndajfoljore në një pjesë të mirë të rasteve sipas modelit ekzistues.

ballafaqe, ballëçelur, ballëhapët, ballëhapur, ballëlart, ballëngrehur, ballëplot, ballulur, barkpërpjetë, bashkëlidhur, bashkëngjitur, bukagjellë, bythakrej, bythëpërpjetë, bythëzbuluar, duarbosh, duarkryq, duarlidhur, duarplot, duarthatë, duarzbrazët/duarzbrazur, dymendjesh, fytafyty, fytaqafë, gojëhapur, gjysmanash, gjysmëdjathtas, gjysmëmajtas, gjysmëndenjur, gjysmështrirë, hapakrah, hënabrenda, hënajashhtë, hënakeq, hënarapë, kalakryq, kalëshalë, kaliqafë, katërlëmsh, këmbëkithi, këmbëkryq, këmbëkular, këmbëmbledhur, këmbëpërpjetë, këmbëzvarrë, kokëmënjanzë, kokëposhtë, kokëtatëpjetë, krahaqafë, krahëhapur, kryengul, kryekëput, kryekreje, kryepari, kryepicingul, kryeshtruar, lesheli, marramendsh, pikëgjallë, pikëpesë, rrallëherë, shpeshherë, sypërmbysur, turravrap


Siç mund të kuptohet edhe nga shembujt e mësipërm, në formimin e kompozitave ndajfoljore marrin pjesë si tema pjesësh të ndryshme të ligjeratës, ashtu edhe tema pjesësh të pandryshueshme të ligjeratës. Janë kryesisht emra, mbiemra, ndajfolje dhe në ndonjë rast edhe numërorë.

Gjithashtu vihet re se gjymtyrët e kompozitave ndajfoljore qëndrojnë në marrëdhënie të ndryshme me njëra-tjetrën. Kështu pjesën më të madhe të kompozitave ndajfoljore e përbëjnë ato përcaktore, ndërsa kompozita me marrëdhënie bashkërenditëse në fjalor gjejmë vetëm 7. Këto ndajfolje të përbëra kanë si temë fjalëformuese dy tema emërore, të cilat lidhen me njëra-tjetrën me një element lidhës shprehur përmes zanores *a* (*bukagjellë*). Në një rast të vetëm këtë funksion e kryen zanorja *e* (*lesheli*). Në ndonjë rast njëra nga temat emërore të kompozitës ka pësuar edhe ndonjë ndryshim fonetikor siç ka ndodhur me ndajfoljen e përbërë *bythakrej* (*krye* → *krej*). Si në çdo kompozitë këpujore ashtu edhe gjymtyrët e ndajfoljeve të përbëra këpujore as varen nga njëra-tjetra dhe as përcaktojnë njëra-tjetrën, por thjeshtë plotësojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën, çka pasqyrohet edhe në kuptimin e gjithë kompozitës e cila mund të kuptohet deri diku si shumë e kuptimeve të temave fjalëformuese. Kështu *bukagjellë*, kompozitë ndajfoljore këpujore, karakterizon veprimin e shprehur nga folja “*luaj*” me kuptimin *luaj sikur gatuaj bukë e gjellë*; ndajfolja e përbërë *krahaqafë*, cilëson mënyrën si vendoset diçka duke i përfshirë të dyja gjymtyrët trupore që emërtojnë temat fjalëformuese emërore. Më poshtë lista e kompozitave ndajfoljore këpujore:

ballafaqe, bukagjellë, bythakrej, fytafyty, fytaqafë, krahaqafë, lesheli dhe pikëpesë

54 është numri i kompozitave përcaktore ndajfoljore që gjenden në “*Fjalorin e shqipës së sotme*”. Në të gjitha rastet gjymtyrë përcaktuese është gjymtyra e dytë, dhe në pjesën më të madhe të rasteve, këto kompozita emërtojnë një qëndrim apo veprim të një vete, duke përdorur e përcaktuar nëpërmjet gjymtyrës së dytë një element të kësaj vete.


Bie në sy tipi i ndajfoljeve të përbëra sipas skemës:



Gjymtyra e dytë, e shprehur nëpërmjet një teme ndajfoljore është edhe gjymtyra përcaktuese. Këto ndajfolje duke përcaktuar gjymtyrën e parë, e cila në pjesën më të madhe të rasteve është pjesë trupore e një qenie, karakterizojnë e cilësojnë një rrethanë apo gjendje të kësaj qenie, p.sh. nëpërmjet kompozitës ndajfoljore *ballëplot* karakterizohet një qëndrim i cili bën të mundur nxjerrjen në pah të ballit të personit. Po kështu edhe në rastet e ndajfoljeve të përbëra: *ballëplot*, *ballëlart*, *barkpërpjetë*, *bythëpërpjetë*, *duarbosh*, *duarplot*, *këmbëpërpjetë*, *këmbëzvarrë*, *kokëmënjane*, *kokëposhtë*, *kokëtatëpjetë*, *kryepicingul*


Ndërsa ndajfoljet *hëna Brenda*, *hëna jashtë*, *hëna e qenit*, *hëna e parë* shënojnë rrethana kohore dhe mënyrore.

Një tjetër tip kompozitash ndajfoljore përcaktore përbëhet nga:



Edhe në këtë tip kompozitash ndajfoljore, i cili përfaqësohet vetëm nga gjashtë ndajfolje të tilla: *duarkryq*, *kalakryq*, *kalëshalë*, *kaliqafë*, *këmbëkryq*, *këmbëkular*, përcaktuese është gjymtyra e dytë e kompozitës. Edhe nëpërmjet këtyre ndajfoljeve emërtohet një mënyrë qëndrimi. *Këmbëkryq* tregon mënyrën e të ndenjurit duke kryqëzuar këmbët, ndërsa në rastin e ndajfoljes *kaliqafë* emërtimi i mënyrës së të ndenjurit, ulur mbi qafën e dikujt shoqërohet edhe me krahasim që shprehet përmes temës emërore të gjymtyrës së parë.

Një tjetër tip përbëjnë ndajfoljet e përbëra përcaktore formuar sipas skemës:



Gjymtyrë përcaktuese është gjymtyra e dytë shprehur me pjesoren e një foljeje:

ballëçelur, *ballëhapur*, *ballëngrehur*, *ballulur*, *duarlidhur*, *gojëhapur*, *këmbëmbledhur*, *krahëhapur*, *kryeshtruar*, *sypërmbysur*

Siç mund të vihet re edhe nga shembujt, gjymtyra e parë, gjymtyra e përcaktuar shprehet me një emër i cili tregon pjesë trupore vete. Edhe në këtë rast, siç është theksuar më lart, këto ndajfolje emërtojnë një qëndrim apo veprim të kryer nga vetë duke përcaktuar një element të saj. Kështu *gojëhapur* tregon një veprim që kryhet nga personi apo veta duke mbajtur gojën hapur, *sypërmbysur* emërton një qëndrim të vetës me kokën ulur dhe pa e parë tjetrin në sy.

Të përbëra janë edhe ndajfoljet:

<i>bashkëlidhur, bashkëngjitur, gjysmëndenjur, gjysmështrirë</i>	(ndajfolje + pjesore)
<i>gjysmëanash, gjysmëdjathtas, gjysmëmajtas</i>	(ndajfolje + ndajfolje)
<i>duarthatë, pikëgjallë</i>	(emër + ndajfolje)
<i>rallëherë, shpeshherë</i>	(ndajfolje + emër)
<i>kryekëput, kryengul</i>	(emër + folje)
<i>marramendsh, turravrap</i>	(folje + emër)
<i>dymendjesh, katërlëmsh</i>	(numëror + emër + -sh)

por vihet re se ato nuk përbëjnë ndonjë tip të veçanatë mbi bazën e të cilit të zhvillohen edhe ndajfolje të tjera.


Në gjuhën shqipe krahas kompozitave emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore ekzistojë edhe numërorët e përbërë, të cilët janë të kufizuar në numër. Të dyja gjymtyrët e numërorëve të përbërë të shqipes shprehen me numërorë. Si gjymtyrë të dytë gjejmë “*dhjetë*” dhe “*qind*”, ndërsa si gjymtyrë të parë numërorët e thjeshtë nga *një* deri në *nëntë*:

tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë, tetëdhjetë, nëntëdhjetë, njëqind, dyqind, treqind, katërqind, pesëqind, gjashtëqind, shtatëqind, tetëqind dhe nëntëqind

VI.2. Fjalët e përbëra në fjalorin “Deutsches-Universalwörterbuch”, struktura dhe përbërësit e tyre

Në të gjitha gramatologjitë dhe teoritë e fjalëformimit të konsultuara për hartimin e këtij punimi, theksohet rëndësia që zë kompozimi në sistemin fjalëformues të gjuhës gjermane. Kompozimi bashkë me prejardhjen, cilësohen si dy mënyrat kryesore të fjalëformimit. 52 071 kompozita ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*” botim i vitit 2002, të cilat përbëjnë rreth 37% të fjalëve të këtij fjalori. Ky fakt vërteton edhe një herë rëndësinë që zë kompozimi si proces dhe kompozitat si produkt i këtij procesi në gjuhën gjermane, të cilat në pjesën dërrmuese të tyre janë emërore, më pak mbiemërore e foljore dhe shumë më pak ndajfoljore, siç e tregohet edhe në vijim:

Emra	44930 = 86.3%
Mbiemra	4157 = 8%
Folje	2777 = 5.3%
Ndajfolje	207 = 0.4%
Gjithsej	52071 100%



Numri i kompozitave këpujore të “*Deutsches Universalwörterbuch*” është thujse i papërfillshëm krahasuar me numrin e kompozitave përcaktore. Ato përbëjnë rreth 0.1% të gjithë kompozitave që gjenden në këtë fjalor. Një karakteristikë e kompozitave përcaktore të gjuhës gjermane ka të bëjë me gjymtyrën e dytë, e cila ashtu siç është trajtuar edhe në nënçështjen përkatëse, jo vetëm formëson gramatikisht kompozitën, por përcakton dhe kategorinë leksikogramatikore të saj. Për këtë arsye të gjitha kompozitat emërore kanë për gjymtyrë të dytë një emër, ato mbiemërore një mbiemër, foljoret një folje dhe ndajfoljoret një ndajfolje.

VI.2.1. Kompozitat emërore

Kompozimi është veçanërisht prodhimtar në formimin e emrave, pasi shumica e dërmuese e fjalëve të përbëra që gjenden në “*Deutsches Universalwörterbuch*”, rreth 86 %, janë kompozita emërore. Brenda tyre dallohen tipa të ndryshëm si nga pikëpamja e marrëdhënieve sintaksore mes gjymtyrëve të kompozitave, ashtu nga pikëpamja e përkatësisë leksikogramatikore të gjymtyrës së parë.



Mund të themi se numri i kompozitave emërore me marrëdhënie bashkërenditëse mes gjymtyrëve të tyre në këtë fjalor është shumë i vogël, thujse i papërfillshëm krahasuar me numrin e kompozitave me marrëdhënie nënrenditëse. Kompozitat emërore këpujore nuk e arrijnë numrin 30. Por ky fakt nuk do të thotë se gjuha gjermane është e varfër dhe i formon me vështirësi kompozitat emërore këpujore. Shumë kompozita të këtij tipi gjenden në fjalorë terminologjikë apo në tekste specifike, si p.sh. kompozitat këpujore të tipit *arsenwasserstoff*, *natriumchlorid* e *bariumsulfat* gjenden në tekste biologjike, apo *Sprecher-Hörer* të cilën e gjejmë në materiale mbi shkencën e komunikimit. Kompozitat

emërore këpujore i gjejmë edhe brenda grupit të emrave të përveçëm, në emërtimet e personave apo vendeve, si p.sh.: *Garmisch-Partenkirchen, Nordrhein-Westfalen, Karl-Heinz Rummenigge, Klaus-Dieter Lehmann* etj.



Edhe në literaturën e fjalëformimit numri i kompozitave këpujore paraqitet i kufizuar, dhe ato shihen më tepër si pjesë e fjalorit terminologjik dhe si formime rastësore.³⁵⁵ Më poshtë kompozitat këpujore që gjenden në “*Deutsches Universalwörterbuch*”:

Deutschamerikaner, Fürstinmutter, Gräfinwitwe, Herzoginmutter, Hemdbluse, Hemdhose, Gewitterstrum, Hosenrock, Kaiserinmutter, Königinmutter, Königinwitwe, Mantelkleid, Marxismus-Leninismus, Nordost, Nordwest, Österreich-Ungarn, Serbokroatisch, Südost, Südwest, Tragikomödie, Uhrenradio, Schrankbett, Schrankwand, Strichpunkt, Strumpfhose, Jackenkleid, Waisenkind

Pjesa dërrmuese e kompozitave emërore janë formuar nga bashkimi i dy temave motivuese, ndërsa kompozitat emërore formuar nga më shumë se dy tema motivuese përbëjnë rreth 9% të kompozitave emërore të këtij fjalori. Ato në pjesën dërrmuese përbëhen nga tri tema motivuese. Si gjymtyra e parë ashtu edhe e dyta mund të jenë të shprehura me një fjalë të përbërë:



Kompozitat me më shumë se tri tema motivuese janë më të rralla. Ato mund t'i kenë të dyja gjymtyrët e shprehur me një kompozitë, siç ndodh në pjesën më të madhe të rasteve, ose edhe vetëm njërën prej tyre:



Kompozita emërore me tri tema motivuese:

³⁵⁵ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 481; Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 129

Altenwohnheim, Bauhandwerk, Dickdarmkrebs, Edelsteinschliff, Grünflächenamt, Güterbahnhof, Giftmülldeponie, Handelsgesetzbuch, Heißluftgerät, Heldenfriedhof, Herrenoberbekleidung, Hotelfachschule, Kehlkopfspiegel, Kraftstoffanzeiger, Lautsprecheranlage, Lebensmittelabteilung, Mittelmeerraum, Musikfestspiele, Nebelscheinwerfer, Nervenheilkunde, Orangenblütenöl, Ortskrankenkasse, Papierhandtuch, Postleitzahl, Querbahnsteig, Qualitätsbewusstsein, Rauschgifthandel, Rechtsanwaltsbüro, Sauerstoffzelt, Schülerfahrkarte, Tischtennisball, Trinkwasserversorgung, Uhrarmband, Umstellbahnhof, Vogelschutzgebiet, Warmwasserheizung, Zentralnervensystem etj.

Kompozita emërore me katër tema motivuese:


Außenhandelskauffrau, Eisenbahnknotenpunkt, Feuerwehrfahrzeug, Fußballweltmeisterschaft, Großhandelkaufmann, Selbstbedienungsgaststätte, Magenschleimhautentzündung, Mundartwörterbuch, Taschenspielerkunststück, Nebenerwerbslandwirtschaft, Rechtschreibwörterbuch, Schaufensterwettbewerb, Seeschiffahrtsstraße etj.

Kompozitat me më shumë se katër tema motivuese janë shumë të rralla. Në këtë fjalor gjejmë kompozitën emërore “*Fluorchlorkohlenwasserstoff*” e cila përbëhet nga pesë tema motivuese si dhe kompozitën “*Kraftfahrzeugreparaturwerkstatt*”. Kjo kompozitë emërore përbëhet nga gjashtë tema motivuese.

Pjesa më e madhe e kompozitave emërore përbëhet nga kompozitat emërore përcaktore formuar nga dy tema motivuese. Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” numërohen 40 424 kompozita të tilla. Gjymtyra e dytë e këtyre kompozitave, ashtu sikurse e të gjitha kompozitave emërore, shprehet nga një temë emërore, e cila mund të jetë fjalë e thjeshtë (*Abendbrot*), ose edhe e prejardhur (*Abstimmungsergebnis*). Kur kjo gjymtyrë shprehet nga një tjetër kompozitë emërore (*Altersruhegeld*), atëherë kemi të bëjmë me një kompozitë e cila në përbërje të saj ka disa tema motivuese, siç ishin dhe rastet e shqyrtuara pak më lart.


E ndërsa gjymtyra e dytë është e shprehur gjithnjë me një temë emërore, gjymtyra e parë mund të jetë emër, mbiemër, ndajfolje, parafjalë, përemër a numëror. Grafiku³⁵⁶ i mëposhtëm paraqet shpërndarjen e kompozitave sipas temës motivuese më anë të së cilës shprehet gjymtyra e parë e tyre:

³⁵⁶ Ne kolonën e fundit të këtij grafiku të quajtur “të ndryshme” është paraqitur numri i përbashkët i kompozitave emërore me gjymtyrë të parë një temë ndajfoljore, parafjalore, përemërore dhe numërore.



Sipas grafikut të mësipërm mund të thuhet se nisur nga përkatësia leksikogramatikore e temës motivuese të gjymtyrës së parë të kompozitave përcaktore me dy tema motivuese, dallohen disa tipa kompozitash.

Tipi i parë, i cili numëron 31 701 kompozita, është ai i formuar sipas modelit:



Ky tip është edhe më prodhimtari brenda kompozitave emërore të “*Deutsches Universalwörterbuch*”. Duke iu referuar strukturës morfologjike të temave përbërëse të këtyre kompozitave vihet re se ato janë

të dyja fjalë të parme:

Achswelle, Brillenglas, Drogenpflanze, Eiskaffee, Hausfrau, Kinderwagen, Landkarte, Marktfräulein, Notarzt, Platzangst, Regenwolke, Schiffsbrücke, Weinfass, Zuckerstück etj.

të dyja fjalë të prejardhura

Abdampfwärme, Behandlungsverfahren, Durchblutungsstörung, Entwicklungsfähigkeit, Flugeigenschaft, Gefühlsüberschwang, Handlungsverlauf, Informationsgespräch,

Leitungstätigkeit, Mannschaftsführung, Schönheitsempfinden, Überraschungserfolg, Wirtschaftsförderung, Zufallsversuch etj.

vetëm njëra fjalë e tparme ndërta tjetra e prejardhur:

Ausgangspunkt, Bindungsangst, Dichtungsform, Empfangsbüro, Fahrtenbuch, Griffbret, Hinweistafel, Kompositionsglied, Mörderhand, Neigungsehe, Regierungskrise, Sängerknabe, Wohnungsgeld, Zufluchtsort etj.

Abenddämmerung, Bergbewohner, Dorfgemeinschaft, Fußschaltung, Geldknappheit, Hautmalerei, Körperbewegung, Luftveränderung, Musterzeichnung, Nachtausbage, Planfeststellung, Reisekrankheit, Schlangenbiss, Viehzüchter, Windstärke, Zeitgefühl etj.

Gjymtyra e parë mund shprehet edhe me një emër të përveçëm, i cili është një emërtim gjeografik ose emër njeriu:

Europapokal, Grönlandwall, Manchesterhose, Manilafaser, Münsterkäse, Nilpferd, Panamahut, Rheinfall, Virginiatabak etj.

Flobertgewehr, Hanswurst, Hitlergruß, Jakobusbrief, Kolpinghaus, Marienbild, Mozartkugel, Peterspfennig, Valentinstag etj.

Njëra nga gjymtyrët e kompozitës emërore mund të jetë shkurtesë. Numri i kompozitave të tilla është shumë i kufizuar në “*Deutsches Universalwörterbuch*”:

Dampflok (Lok = Lokomotive), *Mathearbeit* (Mathe = Mathematik), *Tintenkuli* (Kuli = Kugelschreiber), *Gestapomethoden* (Gestapo = Geheime Staatspolizei), *DDR-Bürger* (DDR = Deutsche Demokratische Republik), *Lkw-Fahrer* (Lkw = Lastkraftwagen), *KZ-Häftling* (Konzentrationslager), *KZ-Gedenkstätte*, *NS-Diktatur* (*NS* = Nazionalsozialismus), *NS-Herrschaft*, *NS-Regime*, *NS-Verbrechen*, *NS-Zeit*, *ZK-Mitglied* (ZK= Zentralkomitee).

Kuptimi i kompozitave emërore të gjermanishtes motivohet nga kuptimi i përbërësve të tyre. Një nëntip të veçantë përbëjnë kompozitat me gjymtyrë të parë një emër i cili kryen funksion zmadhues ose përshkallëzues. Kështu p.sh. kompozita “*Riesenerfolg*” është formuar nga dy tema emërore, nga “*Riese*” (gjigant) dhe “*Erfolg*” (sukses). Përcaktimi që i bën gjymtyra e parë të dytës në këtë kompozitë është e një lloji të veçantë, pasi përmes saj zmadhohet kuptimi i gjymtyrës së parë dhe “*Riesenerfolg*” ka kuptimin “*sehr großer Erfolg*” (sukses shumë i madh). Temat emërore që shërbejnë për të zmadhuar, përforcuar apo intensifikuar, pozitivisht ose edhe negativisht, kuptimin e shprehur nga gjymtyra e dytë e kompozitës kanë formuar vargje të gjata kompozitash emërore, si p.sh.:

zmadhim: **Riese(n)**:- *Riesendummheit, Riesenerfolg, Riesenschlange* etj.; **Bomben**:- *Bombenerfolg, Bombenform* etj; **Heide(n)**:- *Heidenangst, Heidenarbeit, Heidenläm* etj.

përforcim pozitiv: **Spitze(n)**:- *Spitzenerzeugnis, Spitzenkandidat, Spitzenqualität, Spitzenspieler* etj.; **Traum**:- *Traumberuf, Traumfrau, Traummann* etj.; **Meister**:- *Meisterleistung, Meisterschuss, Meisterwerk* etj.

përforcim negative: **Dreck(s)**:- *Drecksarbeit, Dreckloch, Drecknest, Dreckwetter* etj.; **Scheiß**:- *Scheißarbeit, Scheißding, Scheißkramm* etj.

intensifikim, parapëlqim: **Liebling(s)**:- *Lieblingsbeschäftigung, Lieblingsfarbe, Lieblingslied* etj.

përforcim dhe rëndësi: **Haupt**:- *Hauptattraktion, Hauptsorge, Hauptbedeutung* etj.; **Grund**:- *Grundbetrag, Grundgedanke, Grundfrage, Grundidee* etj.

Përdorimin e gjymyrëve të kompozitive në një funksion të tillë, gjuhëtarët e shpjegojnë me mungesën e prapashtesave me kuptim zmadhues e përforcues në gjermanishte.³⁵⁷

Lidhur me prirjen e këtyre elementeve drejt ndjashtesimit është mbajtur qëndrim në nënçeshjten përkatëse të këtij punimi.

Por marrëdhëniet semantike mes gjymtyrëve të kompozitive emërore përcaktore janë nga më të ndryshmet. Gjithsesi në të gjitha rastet është gjymtyra e parë ajo që përcakton nga afër gjymtyrën e dytë dhe krijon me të marrëdhënie:

vendore duke treguar se: objekti i shprehur nga gjymtyra e dytë ndodhet brenda objektit të shprehur përmes gjymtyrës së parë (*Waldwiese = Wiese in einem Wald*); aktiviteti i shprehur nga gjymtyra e dytë zhvillohet në ambjentin e shprehur nga gjymtyra e parë (*Betriebsunfall = Unfall im Betrieb*); gjymtyra e parë shpreh prejardhjen e së dytës (*Südfrucht = Frucht aus dem Süden*); gjymtyra e dytë shpreh drejtim drejt së parës (*Terrasantür = Tür, die auf eine Terrasse führt*). Këto marrëdhënie semantike shprehin edhe kompozitat e mëposhtme:

Gebirgsdorf, Nordseite, Bankkonto, Büroarbeit, Gartentür, Raumflug, Hotelbett, Gartenbeet, Kellertreppe, Küchengerät, Wandtafel, Strandhotel, Dachgeschoß, Mondlandung, Bergbauer, Landbevölkerung, Gartenmöbel, Zahnücke, Nackenhaar, Brusttasche, Straßenschmutz, Inselklima, Feldarbeit, Eckfenster, Kirchenbank, Mauerloch, Wassersport etj.

kohore: ajo që shpreh gjymtyra e dytë ndodh, gjendet ose vepron në periudhën kohore që shprehet përmes emrit të gjymtyrës së parë (*Morgengebet = Gebet am Morgen*); gjymtyra e parë shpreh, kohëzgjatjen ose një vlerë kohore të veprimit apo objektit të shprehur nga gjymtyra e dytë (*Monatskarte = Karte die für einen Monat gilt*):

Morgenandacht, Morgenkaffee, Abendbrot, Abenddämmerung, Winterabend, Osterwoche, Frühlingsblume, Nachtluft, Monatsplan, Pfingstzeit, Tagesdienst, Tagesfahrt, Tagesheim, Sommerhitze, Tagestemperatur, Nachtsgedanken, Nachtcreme, Nachtflug, Herbstsonne, Herbstwind, Nachttier, Herbstregen, Jugendsünde, Pausenbrot, Jahresabonnement, Nachttarif etj.

qëllimore: gjymtyra e parë shpreh se për çfarë ose për kë përdoret apo është e përshtatshme ajo që shpreh gjymtyra e dytë (*Blumentopf = Topf für Blumen*):

Abendkleid, Winterreifen, Strandanzug, Damenkleid, Hustentee, Herrenbekleidung, Sonnenbrille, Regenschirm, Sonnenschutz, Teekanne, Feuerschutz, Eisbecher, Eisbeutel, Küchenmaschine, Kinderbuch, Fensterglas, Weinfass, Krankenwagen, Mädchensport, Sportanzug, Hitzeschild, Kälteschutz, Temperaturregler, Aktentasche, Weinglas etj.

³⁵⁷ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen 2007, f. 100; M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, ein Lehr- und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f. 64

shkakore: ajo që shpreh gjymtyra e dytë shkaktohet nga emri i shprehur përmes gjymtyrës së parë (*Freudenschrei = Schrei aus Freude*):

Schmerzenruf, Überschwemmungskatastrophe, Kälteschauer, Unfalltod, Schmerzenschrei, Angstschweiß, Hagelschaden, Reflexbewegung, Angstschrei, Liebesheirat, Angstkauf, Freundschaftspreis, Liebeskummer, Viruserkrankung, Gewissensangst, Altersbeschwerden, Dienstfahrt, Geschäftsreise, Triumphgeschrei, Wärmegewitter etj.

Disa kompozita emërore janë krijuar mbi bazën e *krahasimit*. Ato tregojnë se njëra gjymtyrë është e ngjashme me tjetrën në një tipar të caktuar (*Pulverzucker = Zucker wie Pulver*):

Butterbirne, Drahthaar, Mandelauge, Glockenblume, Neonfisch, Igelkaktus, Goldkäfer, Fadenwurm, Kirschenaugen, Netzhaut, Blattfeder, Rubinglas, Steinobst, Beifallsturm, Marmorkuchen, Donnerstimme, Eierpflaume etj.

Të tjera kompozita emërore shprehin marrëdhënie *pronësie*, gjymtyra e parë tregon se kujt i përket gjymtyra e dytë, ose se ka në pronësi atë që shpreh gjymtyra e dytë (*Staatseigentum = Eigentum des Staates*):

Elternhaus, Stadtgebiet, Direktorzimmer, Kapitalgesellschaft, Stadtbibliothek, Stadtpark, Landesamt, Schulhof, Hausbesitzer, Schiffseigner, Anwaltsbüro etj.

Nëpërmjet gjymtyrës së parë shprehet *materiali* nga i cili përbëhet gjymtyra e dytë e kompozitës, ndaj dhe gjymtyra e parë e kompozitave emërore të këtij lloji emërton lëndë (*Seidenkleid = Kleid aus Seide*):

Granitfelsen, Lederjacke, Holzhütte, Steinhaus, Lehm Boden, Schlammlawine, Kiesboden, Felsblock, Kalkgebirge, Stahlbau, Eisendraht, Kreidefelsen, Golduhr, Silberkette, Bretterzaun, Plastikbeutel, Marmorplatte, Glasauge, Wollsachen etj.


Të tjera kompozita emërore tregojnë se gjymtyra e parë prodhon të dytën (*Bienenhonig = Honig wird von der Biene geliefert*), gjymtyra e dytë bën diçka me gjymtyrën e parë (*Handleser = Leser der die Hand liest*), gjymtyra e parë shërben si mjet për të dytën (*Faustschlag = Schlag mit der Faust*), gjymtyra e parë është pjesë përbërëse e së dytës (*Apfelkuchen = Kuchen mit Apfel*), gjymtyra e parë shpreh temën që trajton gjymtyra e dytë (*Liebesgeschichte = Geschichte die Liebe zum Thema hat/die über Liebe spricht*).

Kuptimi i disa kompozitave, gjymtyra e dytë e të cilave shprehet me një emër prejfoljor, motivohet me kuptimin e togefjalëshit përkatës, ku rol të rëndësishëm luan parafjala të cilën e përcakton folja nga e ka burimin emri prejfoljor:

Erfolgsbeteiligung = Beteiligung am Erfolg (sich beteiligen an), Wohnungssuche = Suche nach einer Wohnung (suchen nach), Unfehlbarkeitsglaube = Glaube an Unfehlbarkeit (glauben an), Befreiungskampf = Kampf um Befreiung (kämpfen um), Zukunftshoffnung = Hoffnung auf die Zukunft (hoffen auf), Drogenabhängigkeit = Abhängigkeit von Drogen (abhängen von) etj.

Pra, siç mund të kuptohet edhe nga shembujt e mësipërm, marrëdhëniet kuptimore që vendosen mes gjymtyrëve të kompozitave janë shumë të larmishme, por dhe mjaft të rëndësishme për të kuptuar semantikën e gjithë kompozitës.

Tipi i dytë i kompozitave emërore është shumë më pak i përhapur se tipi i parë. Ai përbën rreth 7.6% të gjithë kompozitave emërore që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*”. Ky tip ka për gjymtyrë të parë një temë mbiemërore dhe është formuar sipas modelit:



Lidhur me strukturën morfologjike të fjalëve, me anë të të cilave shprehen gjymtyrët e 3102 kompozitave emërore më gjymtyrë të parë një temë mbiemërore, mund të thuhet se ato mund të jenë fjalë të parme: *Flachkopf, Bleichgesicht, Dünndarm, Leichtbeton* etj.; njëra fjalë e parme dhe tjetra e prejardhur: *Neuinszenierung, Kleinanzeige, Kurzmeldung, Schnellverbindung* etj.; *Partizipialgruppe, Territorialheer, Regionalbahn, Flüssigseife* etj.; ose të dyja të prejardhura: *Adverbialbestimmung, Differenzialschaltung, Disziplinarverfahren, Nationalversammlung* etj.

Vetëm në tri raste gjymtyra e parë është e shprehur me një mbiemër prejpjesor: *Gebrauchtwagen, Lebendgewicht* dhe *Liegendkampf*.

Në pjesën dërrmuese të rasteve në formimin e kompozitave emërore marrin pjesë mbiemra të shprehur në shkallën positive, por nuk mungojnë dhe rastet kur gjymtyra e dytë shprehet përmes një mbiemri në formën e tij krahasore apo sipërore:

Höherentwicklung, Höhergruppierung, Mehrarbeit, Mehraufwand, Mehrbelastung, Mehrehe, Mehrleistung, Mehrkosten, Mehrkampf, Minderzahl, Mindergeböt etj.
Bestform, Bestleistung, Bestwert, Bestzustand, Bestzeit, Höchstalter, Höchtsbetrag, Höchtsform, Höchstgewicht, Höchstgrenze, Höchstgeschwindigkeit, Höchstzahl, Höchstmenge, Mindestabstand, Mindestanfroderung, Mindesthöhe, Mindestpreis, Mindeststrafe, Tiefstpreis, Tiefsttemperatur, Tiefstwert etj.

Edhe kuptimi këtij tipi kompozitash motivohet nga kuptimet e përbërësve të kompozitës, por nuk mungojnë rastet e leksikalizimit të plotë. Kështu *Jungfrau* (virgjëreshë) nuk ka kuptimin “*junge Frau*” (grua e re), edhe *Schöngeist* (artdashës) ka një kuptim krejt tjetër nga togfjalëshi përkatës “*schöner Geist*”.

Gjymtyra përcaktuese, e cila shprehet me temën mbiemërore, shërben për të theksuar një karakteristikë apo tipar të emrit që shpreh gjymtyra e dytë (*Kleinkind = kleines Kind*): *Fremdsprache, Frischluft, Freikirche, Altbau, Billigware, Blödmann, Feinarbeit, Flachland, Glatteis, Steilkurve, Trocckenobst, Breitwand, Buntstift, Kleingebäck, Kurzstrecke, Niedriglohn, Schnellbahn, Wildpferd* etj.

Ky tipar mund të ketë lidhje me vendndodhjen e sendit të shprehur nga gjymtyra e dytë (*Hochtal = hoch gelegenes Tal*):

Tiefgarage, Tiefland, Tiefpunkt, Tiefstand, Hochgarage, Hochbahn, Mittellinie, Mittelkreis, Mittelfinger, Vorderachse, Vorderfront, Vordertreppe, Hinterausgang, Hinterflügel, Fernreise etj.

Ai mund të tregojë kohën kur vepron emri i shprehur nga gjymtyra e dytë (*Spätfrost = Frost der spät einsetzt*):

Spätfrucht, Spätgeburt, Spätherbst, Spätschicht, Spätvorstellung, Spätprogramm, Frühapfel, Frühdiagnose, Frühdienst, Frühgeburt, Frühobst, Frühphase, Frühhachrichten etj.

Të përcaktojë formën, ngjyrën ose edhe shijen e sendit që shpreh gjymtyra e dytë (*Spitzbogen = nach oben spitz zulaufender Bogen; Weißwurst = Wurst von weißlicher Farbe; Bitterstoff = Stoff der bitter schmeckt*):

Flachdach, Flachglas, Rundbeet, Rundbogen, Rundholz, Rundbürste, Schrägbalken, Schrägstrich, Schrägschnitt, Spitzbart etj.

Braunbär, Braunalge, Gelblicht, Gelbrübe, Grauton, Graupapagei, Grauschimmel, Grünkohl, Grünfläche, Rotkappe, Rotwein, Weißwein, Schwarzbrot etj.

Süßkartoffel, Süßkirsche, Süßspeise, Süßwaren, Süßwein, Sauerkirsche, Sauerkraut etj.

Gjymtyra e parë mund të tregojë edhe mënyrë (*Barzahlung = Zahlung die bar erfolgt*):

Adoptivkind, Alleinbesitzer, Alleinreisende, Barkauf, Privatsammlung, Geheimabkommen, Geheimrezept, Gratisprobe, Gratisvorstellung, Direktsendung etj.


Edhe te ky tip kompozitash emërore gjymtyra e parë mund të ketë karakter përforcues ose zmadhues. Këtë funksion e kryejnë gjymtyrët e para të këtyre kompozitave të shprehura me mbiemrat “hoch” (*Hochleistung = sehr große Leistung*) dhe “groß” (*Großcomputer = Computer mit hoher Kapazität*):

Großeinkauf, Großabnehmer, Großaktion, Großalarm, Großauftrag, Großeinsatz, Großfamilie, Hochgeschwindigkeit, Hochsaison, Hochverrat, Hochbetrieb etj.

Ndërsa mbiemrat “kurz”, “klein” dhe “schwach” kanë karakter zvogëlues e dobësues: *Kurzfilm, Kurzfassung, Kurzmeldung, Kleinindustrie, Kleinkredit, Kleinhandel, Schwachstelle, Schwastrom, Schwapunkt* etj.

Mbiemri “voll”, i cili e përforcon duke e plotësuar në tërësi kuptimin e gjymtyrës së dytë, është treguar shumë aktiv në formimin e kompozitave emërore, duke formuar 47 kompozita të tilla: *Vollidiot, Volljurist, Vollgefühl, Volldünger, Vollverb, Vollverpflegung* etj. Diçka më shumë produktiv shfaqet mbiemri “halb”, i cili ka formuar 54 kompozita emërore, disa prej të cilave i kundërvihen atyre të formuara me “voll”, si p.sh. *Vollglatze – Halbglatze, Vollpension – Halbpension, Vollwaise – Halbwaise* etj.

Gjymtyra e parë e **tipit të tretë** të kompozitave emërore shprehet me një temë foljore. Ky tip përbën rreth 9.4% të gjithë kompozitave emërore dhe formohet sipas modelit:



Në formimin e kompozitave të këtij tipi zakonisht bie mbaresa foljore *-en* duke bërë që tema foljore nga ana formale të jetë e njëjtë me atë emërore (*lauf-en* dhe *der Lauf*, *schlag-en* dhe *der Schlag*, *ruf-en* dhe *der Ruf* etj.). Kjo gjë vështirëson përcaktimin e kategorisë leksikogramatikore të elementit me anë të të cilit shprehet gjymtyra e parë e kompozitës. Në këtë punim ky përcaktim është bërë duke u bazuar në funksionin sintaksor që kryen ky element gjatë perifrazimit në togfjalësh apo fjali: *Kochecke = Ecke*, *in der man kocht*.

Duke analizuar përbërësit e kompozitave të këtij tipi sipas strukturës morfologjike, vëmë re se ato mund të jenë:

të dyja fjalë të parme: *Sammelpunkt*, *Schwimmbad*, *Füllfeder*, *Heizwerk*, *Hörnerv*, *Lehrjahr*, *Malkunst*, *Putzzeug*, *Stellplatz*, *Tanzbär*, *Weckuhr* etj

njëra prej tyre e thjeshtë ndërsa tjetra e prejardhur: *Lehrveranstaltung*, *Leihbücherei*, *Merkfähigkeit*, *Nährlösung*, *Schadwirkung*, *Schwebezustand*, *Backmischung*, *Waschanleitung* etj; *Einschreibelliste*, *Umspannwerk*, *Auswechselbank*, *Ansteckblume*, *Begleitmusik*, *Bestellnummer*, *Einholtasche*, *Einleitewort*, *Experimentierbühne*, *Zerreißprobe* etj.

Më të pakta janë kompozitat të dyja gjymtyrët e të cilave shprehen me fjalë të prejardhura: *Vorschaltwiderstand*, *Überholvorgang*, *Einfüllöffnung*, *Austauschschüler*, *Ebtsendegesetz*, *Bestelleingang*, *Begleiterscheinigung*, *Ausreißversuch*, *Abmelkwirtschaft* etj.

Edhe kuptimi i këtij tipi kompozitash motivohet nga kuptimi i përbërësve dhe lidhja semantike mes tyre.

Gjymtyra e dytë tregon vendin se ku ndodh apo përfundon veprimi i shprehur nga gjymtyra e parë (*Ladefläche = Fläche auf die man etwas lädt*):

Impfstation, *Schlafzimmer*, *Wohnzimmer*, *Badezimmer*, *Wechselstube*, *Sendebereich*, *Wickelkommode*, *Wartezimmer*, *Wartesaal*, *Wartehalle*, *Schwimmbecken*, *Parkplatz*, *Lesehalle*, *Klärgrube*, *Kaufladen*, *Füllort*, *Haltestelle*, *Kochtopf*, *Prüfstelle*, *Abholmarkt* etj.

Gjymtyra e dytë përcakton kohën e kryerjes së veprimit të shprehur nga gjymtyra e parë (*Washtag = Tag an dem man wäscht*):

Gehminute, *Fangzeit*, *Fahrzeit*, *Anmeldefrist*, *Lehrzeit*, *Lieferzeit*, *Heizperiode*, *Wadertag*, *Liefertermin*, *Meldetermin*, *Parkdauer*, *Sendepause*, *Sterbestunde*, *Verweildauer*, *Bedenkzeit*, *Sperrfrist*, *Zahltag* etj.

Gjymtyra e dytë shpreh mjetin me anë të të cilit realizohet ose kryhet veprimi i shprehur nga gjymtyra e parë (*Klebmittel = Mittel das man zum Kleben verwendet*):

Spülwasser, Klebeband, Bindemittel, Kehrbesen, Scheuerbürste, Ausreibtuch, Prüfgerät, Kochherd, Kehrschaufel, Putzmittel, Abhöreinrichtung, Brennmaterial, Flickzeug, Stricknadel, Blinkgerät, Borhmaschine, Haltevorrichtung, Rasierapparat, Einreibemittel, Kühlanalge etj.

Gjymtyra e dytë shpreh *vepruesin*, vetën apo sendin që realizon veprimin e shprehur nga gjymtyra e parë (*Begleitperson = Person die jemanden oder etwas begleitet*)
Animierdame, Ansprechpartner, Putzfrau, Aufwartefrau, Begleittext, Begleitpersonal, Begleitworte, Bettelmann, Bettelfrau, Beugelmuskel, Lebewesen, Lieferbetrieb, Stechmücke, Stechpalme, Säugetier, Löschtaste, Singvogel, Brüllaffe, Kriechpflanze, Suchtrupp etj.

Nëpërmjet gjymtyrës e dytë shprehet objekti që *pëson* veprim e shprehur nga gjymtyra e parë (*Leihwagen = Wagen der geliehen wird*):
Wickelrock, Bratapfel, Lehrstoff, Mischgemüse, Hackfleisch, Bratwurst, Sprageld, Spritzkuchen, Umhängetasche, Wickelkind, Schlagsahne, Bratkartoffel, Mischgewebe, Wechselobjektiv, Wendemantel, Zierpuppe etj.

Marrëdhëniet mes gjymtyrëve mund të jenë edhe *shkakore*. Gjymtyra e dytë mund të jetë pasojë e veprimit të shprehur nga gjymtyra e parë (*Lachfalten = Falten, die entstehen, weil man lacht*) ose edhe e kundërta, gjymtyra e dytë bëhet shkak për veprimin e shprehur nga gjymtyra e parë (*Brechreiz = Reiz, der Brechen bewirkt*):
Auffahrnfall, Kratzwunde, Zündstoff, Niesreiz, Sprengstoff, Weinkrampf, Denkfalte Niespulver, Stickstoff etj.


Gjithashtu gjymtyra e parë mund të shprehë se cilit veprim i referohet gjymtyra e dytë: (*Badverbot = Verbot, das sich auf das Baden bezieht*):
Denkfähigkeit, Denkverbot, Meldepflicht, Gaukelkunst, Denkvermögen, Schreibverbot, Lesefähigkeit, Fechtsport, Fahrverbot, Anmeldepflicht, Malkunst, Hupverbot, Bastelarbeit, Schweigepflicht, Näharbiet, Schreibearbeit, Heizkosten, Schießübung etj.

Më të rralla janë kompozitat e këtij tipi, nëpërmjet gjymtyrës së parë të të cilave tregohet *mënyra* si realizohet ajo që shpreh gjymtyra e dytë (*Sitzbad = Bad, das man im Sitzen nimmt*): *Sitzstreik, Stehparty, Stehtisch, Liegekur* etj.

Brenda këtij tipi kompozitash vihet re tendenca për formime vargësh fjalëformuese, si p.sh. me foljet “*dauern*”: *Dauerauftrag, Dauerausstellung, Dauerbelastung, Dauererfolg, Dauerkrise* etj. (32 kompozita të tilla), “*denken*”: *Denkarbeit, Denkfähigkeit, Denkinhalt, Denkprozess* etj (37 kompozita të tilla) “*baden*”: *Badeanzug, Badekur, Bademantel, Badezimmer* etj. (24 kompozita të tilla).

Rreth 2% e kompozitave emërore kanë në përbërjen e tyre të paktën një temë të huaj me burim nga greqishtja e vjetër apo latinishtja, të cilat në gjermanishte njihen me termin “*Konfix*”. Këto kompozita përbëjnë dhe **tipin e katërt** të kompozitave emërore:

temë e huaj + emër



Me një temë të tillë mund të shprehet vetëm gjymtyra e parë e kompozitës emërore (*Biomüll*), ose edhe të dyja gjymtyrët (*Biologe*). Këto tema kanë hyrë në gjermanishte si huazime dhe më pas ato janë bashkuar edhe me emra të gjuhës gjermane duke e pasuruar edhe më shumë këtë tip kompozitash emërore.

Të shumta janë në gjermanishte fjalët e huazuara të formuara nga dy tema të tilla: *Neurologe, Geologe, Biologe, Geographi, Biologie, Lithograph, Bibliothek, Tachograph, Neuropathi, Telegraf, Telefon, Orthographie, Othographie, Pathologe, Philosoph, Pseudologie, Lithographie, Thermographie, Tytologie* etj.


Në disa raste fjalë të tipit të mësipërm janë bashkuar me fjalë gjermane duke e pasuruar klasën e kompozitave emërore: *Meeresbiologe, Telefonanschluss, Telefonbuch, Tiergeographie, Volksbibliothek, Hausbibliothek, Wirtschaftsgeographie, Lebensphilosophie, Lernpsychologie, Zimmerthermometer* etj.

Temat e huaja janë bashkuar kryesisht me fjalë të huaja (*Metallograph, Monogenese, Paläobotanik, Autosuggestion, Psychoterror* etj.), por edhe me fjalë të gjuhës gjermane (*Monoempfänger, Psychokrieg, Telearbeit, Thermohose* etj.).

Ndonjë nga këto tema të huaja përdoret edhe më vete, në rolin e një shkurtese, siç është rasti i “Vize”, e cila përdoret me kuptimin “*Stellvertreter*”/zëvendës.

Krahas këtyre temave të huaja me emrat bashkohen edhe tema gjermane, të cilat jo vetëm që janë shumë më të pakta se ato të huajat, por kanë edhe një shkallë të ulët prodhimitarë. Të tilla janë “*Schwieger-*” në formimet: *Schwiegervater, Schwiegermutter, Schwiegereltern, Schwiegersohn*, si dhe “*Stief-*” në formimet: *Stiefbruder, Stiefmutter, Stiefvater, Stiefeltern, Stiefgeschwister, Stiefkind, Stiefschwester, Stiefsohn, Stieftochter*.

Tipi i pestë i kompozitave emërore formohet sipas modelit:



Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” gjejmë 560 kompozita emërore me gjymtyrë të parë një temë parafjalore. Në formimin e kompozitave të këtij tipi nuk marrin pjesë të gjitha parafjalët e gjermanishtes. Si të tilla gjejmë kryesisht ato që kanë edhe përdorim ndajfoljor.³⁵⁸

Më poshtë gjejmë parafjalët që formojnë kompozita emërore:

ab (Abraum, Abgrund); *auf* (Auflicht, Aufwind); *aus* (Ausland, Auslinie); *bei* (Beiblatt, Beiboot); *binnen* (Binnengewässer, Binnenverkehr); *für* (Fürbitte, Fürwort), *gegen* (Gegenantrag, Gegenbesuch); *mit* (Mitverantwortung, Mitmensch); *nach* (Nachkur,

³⁵⁸ Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 116

Nachsorge); *neben* (Nebenkosten, Nebenwirkung); *über* (Überdach, Überkleid); *um* (Umkreis, Umwelt); *unter* (Unterabteilung, Unterbezirk); *vor* (Vorhof, Vormensch); *zu* (Zubrot, Zustrom); *zwischen* (Zwischenstation, Zwischenwand).


Sa i takon strukturës morfologjike mund të themi se këto parafjalë janë të gjitha fjalë të parme dhe bashkohen kryesisht me emra të parmë, por nuk janë të pakta edhe rastet kur si gjymtyrë e dytë merr pjesë një emër i prejardhur: *Zwischenvepflung*, *Zwischenlösung*, *Zwischenaufenthalt*, *Zwischenabrechnung*, *Zwischenprüfung*, *Vorübung*, *Vorprüfung*, *Vorgeschmack*, *Unterwäsche*, *Untermieter*, *Untertlänge*, *Überbeschäftigung*, *Überbevölkerung*, *Nebenvorstellung*, *Nebenordnung*, *Gegenrechnung*, *Binnenwährung* etj.

Në pjesën më të madhe të rasteve mes gjymtyrëve të kompozitive të këtij tipi shprehen marrëdhënie *vendore*, tregohet vendi ose dhe drejtimi nga lëviz ajo që shpreh gjymtyra e dytë e kompozitës: *Aufwind* (= vom Boden aufsteigende Luftbewegung); *Auslinie* (= Grenzlinie); *Binnendeich* (= innerer Deich); *Gegenverkehr* (= entgegenkommender Verkehr); *Nebenraum* (ein benachbarter Raum); *Unterkörper* (= unterer Teil des Körpers); Umgegend (= Gegend um etwas herum); *Vordach* (= Das, das vorspringt); *Zwischendecke* (= Decke zwischen zwei Stockwerke)

Mes gjymtyrëve të kompozitive me gjymtyrë të parë parafjalët “*nach*”, “*vor*” dhe “*zwischen*” mund të shprehen edhe marrëdhënie *kohore*, duke bërë që kompozita të emërtojë një periudhë kohore: *Nachkur* (= Zeit der Erholung nach einer Kur), *Vormonat* (= voriger Monat), *Zwischenzeit* (= Zeitraum zwischen zwei bestimmten Zeitpunkten) etj.

Por këto nuk janë marrëdhëniet e vetme kuptimore që krijohen mes gjymtyrëve të kompozitive emërore me gjymtyrë të parë një temë parafjalore. Kështu, p.sh. kompozitat me gjymtyrë të parë “*gegen*” shprehin kuptim të kundërt me kuptimin e shprehur nga gjymtyra e dytë e kompozitës (*Gegenkraft* = *Kraft, die einer anderen Kraft entgegenwirkt*); ato me “*mit*” shprehin bashkëpërfshirje (*Mitbegründer* = *jemand, der mit anderen etwas begründet hat*); “*vor*” dhe “*zwischen*” i japin një vlerë të përkohshme kuptimit të gjymtyrës së dytë (*Vorvertrag* = *vorläufiger Vertrag*; *Zwischenbericht* = *vorläufiger Bericht*); “*über*” dhe “*unter*” shprehin një nocion që qëndron më lart ose më poshtë nga i njëjti nocion shprehur nga gjymtyra e dytë (*Übergewicht* = *über dem normalne Gewicht*; *Untergewicht* = *unter dem normalen Gewicht*); ndërsa “*neben*” zhvlerëson rëndësinë e asaj që shpreh gjymtyra e parë (*Nebenrolle* = *eine nicht so wichtige Rolle*).

Tipi i gjashtë i kompozitive emërore ka për gjymtyrë të parë një temë ndajfoljore:



Temat ndajfoljore janë më pak aktive në formimin e kompozitave emërore. Kompozitat me gjymtyrë të parë një temë ndajfoljore përbëjnë rreth 0.5% të kompozitave emërore.

Më shumë prodhimtare janë treguar ndajfoljet e vendit “*außen*” (36 kompozita të formuara), “*innen*” (28 kompozita të formuara), më pak “*links*” (22 kompozita të formuara) dhe “*rechts*” (18 kompozita të formuara), të cilat shprehin marrëdhënie *vendore* mes gjymtyrëve të kompozitës, tregojnë drejtim ose vendin ku ndodhet ose vepron emri që shpreh gjymtyrën e dytë: *Außenantenne* (= Antenne, die außen, an einem Gebäude angebracht ist) *Außentreppe*, *Außentemperatur*, *Außentür*, *Außenwand*, *Außenlinie* etj.; *Innenarbeiten* (= Arbeiten, die innen ausgeführt werden), *Innenausstattung*, *Innenhof*, *Innenseite*, *Innentür*, *Innenbeleuchtung*, *Innendruck* etj.; *Linksdrehung* (= Drehung nach links), *Linkskurs*, *Linkskurve*, *Linksradikale*, *Linksverkehr* etj.; *Rechtswendung* (= Wendung nach rechts), *Rechtspartei*, *Rechtspolitik*, *Rechtsstellung*, *Rechtsverkehr* etj.

Marrëdhënie të tilla vendore shprehin edhe mes gjymtyrëve të kompozitave emërore me gjymtyrë të parë ndajfoljet e prejardhura: “*abwärts*” (*Abwärtsbewegung* = Bewegung nach unten), “*aufwärts*” (*Aufwärtsbewegung* = Bewegung nach oben), “*auswärts*” (*Auswärtsspiel* = Spiel das an einem anderen Ort ausgetragen wird), “*rückwärts*” (*Rückwärtsbewegung* = Bewegung nach hinten), “*seitwärts*” (*Seitwärtshaken* = Schlag auf der Seite) dhe “*vorwärts*” (*Vorwärtsdrall* = Drall nach vorne). Ndajfolja “*zurück*”, kur bashkohet me emra për të formuar kompozita të këtij tipi paraqitet në formën e shkurtuar “*Ruck-*” si në rastet *Rückfahrt* e *Rückweg*. Edhe kompozita emërore *Obdach* është formuar nga një formë e shkurtuar ndajfoljore *ob(en)* + *Dach*. Kjo kompozitë është leksikalizuar dhe sot ka kuptimin “*Unterkunft*”/strehim.

Mes gjymtyrëve të këtij tipi kompozitash në disa raste shprehin edhe marrëdhënie *kohore*. Në të tilla raste gjymtyra e parë shprehet me ndajfoljen e kohës “*jetzt*”, si p.sh. *Jetztmensch* (= Mensch der in den heutigen Tagen lebt), apo *Jetztzeit* (= gegenwärtige Zeit); si dhe me kompozitën ndajfoljore “*voraus*”, si p.sh.: *Vorauskasse* (= vorherige Bezahlung).

Vargje të tëra kompozitash emërore janë formuar nga ndajfolja “*nicht*”, e cila formon një kompozitë që mohon kuptimin e emrit me të cilin shprehet gjymtyra e dytë (*Nichtmetall* = chemisches Element, das kein Metall ist) *Nichtraucher*, *Nichtschwimmer*, *Nichttänzer* etj.

Kompozitat me gjymtyrë të parë “*wieder*” tregojnë se veprimi i shprehur nga gjymtyra e dytë përsëritet (*Wiederabdruck* = erneuter Abdruck) *Wiederanspiel*, *Wiederanpffif*, *Wiederanstoß* etj..

Ndajfolja “*wohl*” krijon marrëdhënie mënyrore me gjymtyrën e dytë të kompozitës: *Wohlgeruch* (= angenehmer Geruch), *Wohllaut*, *Wohlklang*, *Wohlverhalten*, *Wohlbefinden*, *Wohlsein*, *Wohlbehagen*, *Wohlsein* etj.


Në fjalor gjejmë një rast të vetëm të formuar me ndajfoljen e prejardhur “*unwohl*” e cila shpreh të kundërtën e ndajfoljes “*wohl*”: *Unwohlsein*.

Lidhur me strukturën morfologjike të gjymtyrëve të këtij tipi kompozite vihet re se ato mund të shprehin të dyja me fjalë të prejardhura (*Abwärtsentwicklung*), vetëm njëra me

fjalë të prejardhur (*Linkspartei*, *Innenbeleuchtung*), të dyja me fjalë të thjeshta (*Außenwand*), vetëm gjymtyra e parë me një kompozitë (*Vorauskommando*), vetëm gjymtyra e dytë me një kompozitë (*Nurhausfrau*).

Në formimin e kompozitave emërore kanë marrë pjesë edhe ndajfolje të huaja, si p.sh. “*quasi*” në kompozitën *Quasisteuer*; “*brutto*”: *Bruttoeinkommen*, *Bruttogehalt* etj. dhe “*netto*”: *Nettogewicht*, *Nettopreis* etj.;

Edhe më i vogël në numër është **tipi i shtatë** kompozitave emërore formuar sipas modelit:




Këto kompozita përbëjnë rreth 0.3% të kompozitave emërore që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*”. Numërorë themelorë dhe rreshtorë bashkohen me emra të parme (*Dreibein*, *Einbaum*, *Millionending*, *Fünfeck*, *Neunauge*, *Nulldiät*, *Sechsstern*, *Siebenzahl* etj.; *Zweitwagen*, *Erststimme*, *Zweitgerät*, *Drittland*), si edhe me emra të prejardhur (*Millionenauftrag*, *Nullstellung*, *Nullwachstum*, *Siebenschläfer*, *Tausendkünstler*, *Zehnkämpfer* etj.; *Zweitschlüssel*, *Zweitwohnung*, *Erstsendung*, *Erstaufführung*, *Erstausstrahlung* etj.).

Kompozitat emërore me gjymtyrë të parë një numëror themelor përbëjnë rreth 66% të këtij tipi kompozitash. Marrin pjesë numërorët “*eins*”/një deri në “*zwölf*”/dymbëdhjetë si dhe numërorët “*hundert*”/njëqind, “*tausend*”/njëmijë dhe “*million*”/milion. Ndërsa si numërorë rreshtorë gjejmë “*erst*”/i pari, “*zweit*”/i dyti dhe “*dritt*”/i tretë.

Një pjesë e mirë e kompozitave të formuara me gjymtyrë të parë një numëror janë pjesë e fjalorit terminologjik: *Dreieck*, *Vierflach* (geometrische Figuren), *Nullmeridian* (geografischer Begriff), *Fünfkampf*, *Zwölfkampf* (sportlicher Begriff), *Drittmittel* (finanzielle Mittel) etj.

Kuptimi i këtyre kompozitave motivohet nga kuptimi i gjymtyrëve përbërëse: *Millionenauftrag* = Auftrag in Höhe von mehr als einer Million; *Nulltarif* = der Tarif ist kostenlos, kostet null Geld; *Erstaufführung* = die erste Aufführung etj.

Tipi i fundit, **tipi i tetë** i kompozitave emërore ka për gjymtyrë të parë një temë përemërore:



Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” nuk gjenden më shumë se 134 kompozita emërore me gjymtyrë të parë një temë përemërore. Vihet re se në formimin e kompozitave emërore nuk marrin pjesë shumë përemra. Nga kjo klasë kompozita emërore formojnë: përemrat e pacaktuar “*all*” (Allerbarmer, Allgewalt, Allmacht), “*alles*” (Allesfresser, Alleskleber, Alleskönner), “*nichts*” (Nichtsnutz, Nichtstun). “*niemand*” dhe “*ander*” kanë formuar nga një kompozitë, *Niemandland* dhe *Anderkonto*; përemri vetor përfaqësohet vetëm me përemërin e vetës së parë të numrit njëjës, “*ich*”: *Icherzähler, Icherzählung, Ichform, Ichlaut, Ichmensch, Ichroman* dhe *Ichsucht*; përemri pyetës “*wer*” merr pjesë në formimin e kompozitave emërore me formën e rasës emërore *Werfall*, me formën e rasës kallëzore *Wenfall*, me formën e rasës dhanore *Wemfall* si dhe me formën e rasës gjinore, e cila paraqitet e shkurtuar *Wesfall*. Por 84% e këtyre kompozitave kanë për gjymtyrë të parë përemrin dëftor “*selbst*”:

Selbstanklage, Selbstbedienung, Selbstbeherrschung, Selbstbetrug, Selbsterzeuger, Selbstgefühl, Selbstgespräch, Selbsthypnose, Selbstmord, Selbstlob, Selbstreflexion, Selbstreinigung, Selbstschuss, Selbststudium, Selbstüberschätzung, Selbstüberwindung, Selbstverantwortung etj.

Në pjesën më të madhe të rasteve përemrat bashkohen me emra të prejardhur, siç e tregojnë edhe të gjithë shembujt e kompozitave të mësipërme me gjymtyrë të parë përemrin “*selbst*”. Në pak raste gjymtyra e dytë është një emër i pamë, si në rastet *Niemandland, Selbsttor, Ichlaut, Ichform* apo *Anderkonto* e ndonjë tjetër. Elementet lidhëse nuk janë karakteristikë e këtij tipi kompozite. Megjithatë në kompozitën *Niemandland*, gjejmë elementin lidhës –s, i cili e ka burimin në formën e gjinore të përmrit “*niemand*”, i cili sot përdoret edhe në formë të palakuar. Edhe kuptimi i kompozitave të këtij tipi motivohet nga kuptimi i gjymtyrëve përbërëse. Por kemi edhe raste leksikalizimi, si p.sh.: *Allerbarmer* = Gott, Christus.

VI.2.2. Kompozitat mbiemërore

4157 kompozitat mbiemërore përbëjnë rreth 8% të kompozitave që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*”. Disa mbiemra, të cilët në kompozitë përbëjnë gjymtyrën e dytë të saj, formojnë vargje të gjata kompozitash mbiemërore. Por këta mbiemra edhe pse kanë një prirje drejt kalimit në prapashtesë, vazhdojnë të trajtohen si gjymtyrë të dyta të mbiemrave të përbërë, pasi jashtë kompozitës ato janë mbiemra dhe kryejnë funksionin e mbiemrit duke ruajtur të njëjtin kuptim leksikor sikurse kanë edhe brenda kompozitës.³⁵⁹ Të tillë janë mbiemrat “*frei*” (gjymtyrë e dytë e 97 kompozitave mbiemërore), “*fähig*” dhe “*unfähig*” (e para gjymtyrë e dytë e 80 kompozitave mbiemërore, ndërsa e dyta e 13 të tillave), “*reich*” (gjymtyrë e dytë e 84 kompozitave

³⁵⁹ M.Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen – Ein Lehr-und Übungsbuch, Tübingen , 2006, f. 158

mbiemërore), “*arm*” (gjymtyrë e dytë e 27 kompozitive mbiemërore), “*bereit*” (e 24 të tillave) etj.

Mbiemri nëpërmjet të cilit shprehet gjymtyra e dytë e kompozitës mbiemërore mund të jetë fjalë e parme (*betriebsblind*, *altrosa*, *hellgrau*, *gattungsfremd*, *abmarschbereit*, *kochfest* etj.) ose fjalë e prejardhur (*gutbürgerlich*, *alkoholabhängig*, *angriffslustig*, *hellhaarig*, *schwerbehindert* etj.). Në grupin e kompozitive mbiemërore me gjymtyrë të dytë një fjalë të prejardhur vërehet se në pjesën më të madhe ato janë formime prapashtesore, kryesisht me prapashtesën **-ig** (*süchtig*, *würdig*, *lustig*, *haltig*, *beständig*, *bedürftig*, *aufwendig* etj.) dhe **-ich** (*feindlich*, *freundlich*, *tauglich*, *verträglich*, *wirtschaftlich*, *sprachlich* etj.)

Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” gjejmë vetëm dy kompozita mbiemërore me gjymtyrë të dytë një mbiemër të përbërë: *funkelnagelneu* dhe *pechrabenschwarz*



Wellmann-i në pjesën e parë të punimit “*Deutsche Wortbildung 5- Adjektivkomposita*”, shprehet se formime të tilla “*fast alle sind Gelegenheitsbildungen / janë thuajse të gjitha formime të rastësishme*”³⁶⁰ dhe jep si shembuj kompozita si *olivengelbgrün* apo *tintenblauschwarz*, *hellrubinrot*.

Në pjesën dërrmuese të tyre kompozitat mbiemërore janë formuar nga bashkimi i dy temave motivuese. Mbiemrat e këtij lloji përbëjnë rreth 97% të kompozitive mbiemërore. Ndërsa pjesa tjetër, 130 mbiemra, kanë në përbërje të tyre tri tema motivuese. Me përjashtim të dy rasteve të sipërpërmendura, pjesa tjetër ka për gjymtyrë të parë një kompozitë, si p.sh.:

fischgräteähnlich, *haftpflichtversichert*, *heimwehkrank*, *kernwaffenfrei*, *krankenhausreif*, *nährstoffarm*, *regenbogenfarbig*, *schadenersatzpflichtig* etj.

Në të gjitha këto raste gjymtyra e parë është një kompozitë emërore.

Lidhja sintaksore mes gjymtyrëve të kompozitive mbiemërore në pjesën dërrmuese të kompozitive mbiemërore që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*” është e tipit nënrenditës, duke bërë që kompozitat këpujore të zënë një vend thuajse të papërfillshëm në këtë fjalor. Ato përbëjnë rreth 0.6% të kompozitive mbiemërore formuar nga dy tema motivuese. Më poshtë disa shembuj:

³⁶⁰ L. Ortner, M.Pümpel-Mader, E. Gassner-Koch, H. Wellmann, *Deutsche Wortbildung, Typen und Tendenzen in der Gegenwartssprache*, Band 5, Adjektivkomposita, Berlin, 1992, f. 12

berühmt-berüchtigt, afroamerikanisch, deutsch-deutsch, dummdreist, dummfrech, manisch-depressiv, medizinisch-technisch, pharmazeutisch-technisch, audiovisuell, bitter-süß, finnisch-ugrisch/finnougrisch, gelb-rot, labiovelar, öffentlich-rechtlich, feuchtheiß, feuchtkalt, feuchtärm, schäerz-rot-gold, nasskalt, taubstumm, taubblind etj.

Të dyja gjymtyrët e këtyre kompozitive shprehen me mbiemra, të cilët janë në lidhje sintaksore bashkërenditëse me njëri-tjetrit, ndaj dhe mund të zërthehen në një togfjalësh me lidhëzen *dhe*.

dummdreist = *dumm* und *dreist* zugleich

audiovisuell = zugleich *hörbar* und *sichtbar*

(Deutsches-Universalwörterbuch)

Siç mund të vihet re edhe nga shembujt e dhënë, në disa raste gjymtyrët e këtyre kompozitive lidhen me njëra-tjetrën me anë të vizës lidhëse, e cila në këtë rast luan edhe një rol të rëndësishëm, pasi shpreh karakterin kopulativ të këtyre kompozitive. Kështu nëpërmjet vizës lidhëse, e cili është element lidhës, bëhet dallimi mes kompozitës përcaktore *gelbrot* (një ngjyrë e kuqe që ka nuancë të verdhë) dhe asaj këpujore *gelb-rot* (me ngjyrë të verdhë dhe të kuqe)

Në ndonjë rast gjymtyrët e kompozitive lidhen me anë të elementin lidhës “o”, siç është në rastin e kompozitës *finnougrisch*, të cilën e gjejmë edhe në variantin *finisch-ugrisch*, duke na bërë të mendojmë se këto dy elemente lidhëse zëvendësojnë njëra-tjetrën, pa u përdorur bashkë.

Sa u takon grupeve semantike të mbiemrave pjesëmarrës vihet re se marrin pjesë mbiemra të ndryshëm, si p.sh. mbiemra që emërtojnë ngjyra (*gelb-rot*), gjuhë (*deutsch-deutsch*), cilësi të ndryshme vetash dhe sendesh (*dummfrech*), marrëdhënie përkatësie (*medizinisch-technisch*) etj. Nuk mungojnë dhe rastet kur bashkohen antonime (*bittersüß*).

Por gjithsesi në gjuhë numri i kompozitive mbiemërore këpujore është shumë më i lartë, nëse i referohemi veçanërisht kompozitive mbiemërore që shprehin marrëdhënie mes dy shteteve apo kombinime ngjyrash, si p.sh. *deutsch-polnische* Beziehungen (marrëdhëniet gjermanopolake) apo *grün-weiß-rot* (ngjyrat e flamurit italian).

Një pjesë e kompozitive mbiemërore përcaktore kanë si gjymtyrë të dytë një mbiemër prejpjesor, i cili formohet nga pjesorja e së tashmes (Partizip Präsens/Partizip I³⁶¹) ose nga pjesorja e së shkuarës (Partizip Perfekt/Partizip II). Këto të fundit përbëjnë gati 60%

³⁶¹ “Partizip I” është një formë e pashtjelluar foljore e cila formohet duke i shtuar *-d* paskajores së foljes (Infinitiv). Duke u përdorur me një emër ajo merr tiparet e mbiemërit duke u lakuar dhe kryer funksionet e tij në fjali (*der entscheidende Augenblick*). Kur nuk përdoret me emrin ajo emërton një tipar të veprimit apo gjendjes (*Sie spricht zögernd*). (Helbig/Buscha: Deutsche Grammatik, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Langenscheidt, 1996, f.110-111)

të këtij tipi kompozitash. Në fjalor gjejmë 701 mbiemra të tillë, të cilët njihen me termin “Partezipialkompozita / Kompozita prejpjesore)³⁶². Më poshtë disa prej tyre:

aufsichtsführend, abscheuerregend, berufsbildend, energiesparend, feuerhemmend, gewinnbringend, goldglänzend, gluckstrahlend, herzbrechend, lebensbedrohend etj.; anlagebedingt, anstverzerrt, altersbedingt, computergesteuert, erfolgsorientiert, fachbezogen, freifinanziert, gedankenverloren, hausgemacht, ideologiegebunden, lichterfüllt, zielgerichtet etj.


Pjesa dërrmuese e këtyre kompozitave ka për gjymtyrë të parë një temë emërore, por nuk mungojnë as temat mbiemërore (*freischaffend, hochfliegend, schwerbehindert, neuvermählt*), ndajfoljore (*rechtsdrehend, wohkliengend, wohlgeraten*), përemërore (*allwissend, vielsagend, selbstverliebt*) parafjalore (*überqualifiziert, unterprivilegiert*) dhe shumë pak foljore (*lernbehindert, schreibgewandt*)

Kuptimi i këtyre kompozitave është lehtësisht i motivueshëm nga kuptimi i gjymtyrëve të tyre (*arbeitssuchend* = eine Arbeit suchend; *fettglänzend* = von Fett glänzend; *goldglänzend* = wie Gold glänzend; sachbezogen = auf die Sache bezogen)


Disa prej mbiemrave prejpjesorë janë bërë prodhimtare duke formuar disa kompozita mbiemërore, si p.sh. –orientiert (me 14 kompozita të formuara: *zukunftsorientiert, zielorientiert, wachstumsorientiert, rechtsorientiert, leistungsorientiert etj.*), –bedingt (me 12 kompozita të formuara: *anlagebedingt, berufsbedingt, gefühlsbedingt, konjunkturbedingt, situationsbedingt etj.*), –erregend (me 15 kompozita të formuara: *abscheuerregend, besorgniserregend, ekelerregend, grauenerregend, krankheitserregend etj.*) apo –hemmend (me 10 kompozita të formuara: *krebshemmend, schweißhemmend, wachstumshemmend, entwicklungshemmend etj.*

Ndërsa gjymtyra e dytë e kompozitave mbiemërore është gjithnjë një mbiemër, gjymtyra e parë mund të shprehet me një emër, mbiemër tjetër, folje, ndajfolje, numëror, përemër apo parafjalë. Shpërndarja e kompozitave mbiemërore përcaktore formuar nga bashkimi i dy temave motivuese, sipas llojit të temës së parë tregohet në grafikun e mëposhtëm:

³⁶² Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 245; M.Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr- und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f. 167



Ashtu siç ndodh me emrat e përbërë edhe brenda kompozitave mbiemërore merr pjesë si gjymtyrë e parë një temë me burim nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja. Në këtë punim këta mbiemra përbëjnë edhe **tipin e parë** të kompozitave mbiemërore përcaktore të gjermanishtes.




Numri i kompozitave të këtij lloji nuk është shumë i madh. Ato nuk e kalojnë shifrën 74. Më poshtë disa shembuj:

autosuggestiv, autodynamisch, bilingual, bimetallich, biquadratisch, elektroakustisch, elektromagnetisch, polyzyklisch, polyvalent, pseudowissenschaftlich, thermoelektrisch, thermodynamisch, photomechanisch etj.

Veçanërisht prodhimitare janë temat “*mono*” (16 kompozita): *monoton, monovalent, monosemantisch, monogenetisch* etj. dhe “*multi*” (10 kompozita): *multidimensional, multidisziplinär, multifunktional, multimedial, multinational* etj.

Vihet re se gjymtyrë e dytë e këtyre kompozitave në pjesën më të madhe të rasteve është një mbiemër i huaj. Mendojmë se këto kompozita janë huazuar nga gjuhë të tjera, më pas tema është bashkuar edhe me mbiemra të gjuhës gjermane duke e pasuruar edhe më shumë këtë tip kompozitash mbiemërore.

Tipi i dytë i kompozitive mbiemërore është formuar sipas modelit:



Gjymtyrët e këtyre kompozitive mund të shprehen me fjalë të parme (*todkrank, tierlieb, olivbraun*) ose edhe me tema fjalësh të prejardhura (*gesundheitsschädlich, verfügbungsberechtigt, zustimmungsbedürftig*). Njëra nga gjymtyrët mund të jetë fjalë e parme dhe tjetra e prejardhur (*zweckentshprechend, hauptberuflich, luftdurchlässig; erwartungsvoll, abbruchreif, verfassungstreu*).

Ky është edhe tipi më i pasur i kompozitive mbiemërore.

Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” numërohen 2941 mbiemra të përbërë me gjymtyrë të parë një emër. Ky emër mund të jetë i parme (*aalglat, armlang, atombetrieben, kaffeearun, nadelfein*) ose i prejardhur me parashtesë apo prapashtesë (*unheilverkündet, unglücklich, abschreibungsfähig, bedienungsfreundlich, bevölkerungs politisch, zerstörungswütig*).

Ky tip kompozitash mbiemërore shpreh marrëdhënie të ndryshme semantike.

Disa prej tyre kanë karakter *krahasues*. Ato e emërtojnë tiparin duke i veshur sendit apo vetës që karakterizojnë, tiparin e një sendi tjetër, si p.sh. *aalglatt* = glatt wie ein Aal, *baumstark* = stark wie ein Baum. Po kështu: *nachtblau, bildhübsch, himmelblau, kreisförmig, butterweich, eigroß, eirund, erdbraun, eisenhart, bärenstark, federleicht, parkähnlich, goldglänzend, grasgrün, eselgrau, feuerrot, honiggelb, jägergrün, kirschgroß, kugelrund, nadelfein, olivgrün, kreidebleich, faustdick, wieselflink* etj.

Në këtë grup bëjnë pjesë të gjitha kompozitat mbiemërore me gjymtyrë të parë një emër dhe gjymtyrë të dytë temën mbiemërore –*farbig*: *orangerfarbig, rosafarbig, olivenfarbig, goldfarbig, silberfarbig, rubinfarbig* etj.

Nga formimet me karakter krahasues kanë dalë edhe kompozita mbiemërore me gjymtyrë të parë një temë emërore, e cila *përforcon* cilësinë apo tiparin e shprehur nga gjymtyra e dytë me temë mbiemërore. Këto kompozita mbiemërore janë pjesërisht të leksikalizuara dhe zërthehen në togfjalësha me gjymtyrë ndajfoljen e “*sehr/shumë*” apo “*äußerst/tepër, jashtë mase*”³⁶³:

blitzschnell (= sehr schnell) po kështu edhe: *blitzblank, blitzgescheit, blitzsauber*;

blutarm (= sehr arm) po kështu edhe: *blutjung, blutleer, blutrot*;

brandaktuell (= sehr aktuell) po kështu edhe: *brandeilig, brandgefährlich, brandneu*;

saudumm (= sehr dumm) po kështu edhe: *saublöd, saufrech, saukalt*;

³⁶³ M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr- und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f. 163

stockbetrunken (= stark betrunken) po kështu edhe: *stockdunkel*, *stockduster*, *stockkatholisch*, *stockkonservativ*, *stocknüchtern*, *stocksauer* etj.

Më prodhimitare në fjalor me këtë funksion është gjymtyra e parë e shprehur me emrin “*Tod*” *todelened* (= sehr elend) po kështu edhe: *todernst*, *todlangweilig*, *todmüde*, *todschick*, *todsicher*, *todtraurig*, *todunglücklich*.

Karakter *zmadhues* apo *zvogëlues* kanë edhe kompozitat mbiemërore të tipit: *eisenreich* (reich an Eisen), *leistungsschwach* (schwach in der Leistung), *leistungsstark* (sehr leistungsfähig), *alkoholarm* (arm an Alkohol) etj. Sendi apo veta e karakterizuar nga këta mbiemra zotëron në sasi të mëdha apo të pakta sendin e shprehur nga gjymtyra e parë emërore, ndaj dhe si gjymtyrë të dyta marrin pjesë mbiemrat *-arm* (i varfër), *-reich* (i pasur), *-schwach* (i dobët) apo *-stark* (i fortë).

Por jo të gjitha kompozitat mbiemërore me gjymtyrë të parë një nga emrat e shqyrtuar më sipër i japin këtë kuptim kompozitës. Kështu p.sh. kompozita “*todbringend*” ka kuptimin “*den Tod herbeiführend*” (që shkaktonte vdekje); po kështu edhe *blutbefleckt* = *mit Blut befleckt* (me njolla gjaku), *blutvoll* = *lebendig* (plot jetë), *blitzblau* = *leuchtend blau* (që ndriçon në ngjyrë blu).

Në disa raste marrëdhëniet mes dy gjymtyrëve janë marrëdhënie *vendore*. Përmes gjymtyrës së parë shprehet vendi se ku ka ndikim cilësia e shprehur nga mbiemri, si p.sh. *weltberühmt* = *berühmt in der ganzen Welt/i famshëm në të gjithë botën*, ose deri ku arrin tipari i shprehur nga mbiemri, si p.sh. *bodenlang* = *bis zum Boden/deri në tokë*. Po kështu edhe mbiemrat e mëposhtëm:

weltberühmt, *ortsfremd*, *ortsüblich*, *stadtbekannt*, *wandhängend*, *beinamputiert*, *halsnah*, *halsfern*, *brusthoch*, *knietief*, *kniehoch*, *knielang*, *lungenkrank*, *nervenkrank*, *nierenkrank*, *randvoll*, *schulterhoch* etj.

Marrëdhëniet mes gjymtyrëve të kompozitës mund të kenë karakter *kohor*, *shkakor* apo *qëllimor*. Sendi apo veta e karakterizuar nga kompozita mbiemërore e zotëron tiparin e shprehur nga gjymtyra e dytë mbiemërore në periudhën kohore të shprehur nga gjymtyra e parë emërore: *tagaktiv* = *aktiv am Tag*, *nachtaktiv*, *monatelang*, *wochenlang*, *nachtblind*, *nachtschlafend*, *tagesaktuell*, *dämmerungsaktiv* etj.;

Gjymtyra e dytë mbiemërore shpreh një tipar apo cilësi të sendit apo vetës që karakterizon, i cili *shkaktohet* nga tema emërore me të cilën shprehet gjymtyra e dytë: *taunass* = *nass von Tau*, *regennass*, *angsverzerrt*, *altersschwach*, *tränenüberströmt*, *freudestrahlend*, *sturmzerzaust*, *systembedingt*, *stressgeplagt*, *schweißbedeckt*, *schneeerhell*, *machtbesessen* etj.


Tema emërore e gjymtyrës së parë shpreh *qëllimin* që ka sendi apo veta që zotëron tiparin e karakterizuar nga gjymtyra e dytë mbiemërore e kompozitës, duke ia veshur të tërën si një tipar të vetëm sendit apo vetës: *hilfsbereit* = *bereit zu helfen/i gatshëm për të ndihmuar*. Po kështu edhe: *abfahrtbereit*, *anbaufähig*, *betriebssicher*, *publikationsreif*, *opferbereit*, *wasserdicht*, *feuersicher*, *rostbeständig*, *wärmebeständig*, *dienstbereit*, *empfangsberechtigt*, *ertragssicher*, *erziehungsberechtigt*, *flugtauglich*, *konzentrationsfähig*, *kompromissbereit* etj.

Të tjera kompozita mbiemërore tregojnë një tipar të sendit apo vetës që ato karakterizojnë kundrejt asaj që shpreh gjymtyra e parë me temë emërore e kompozitës, si p.sh.:

ausländerfeindlich = *feindlich den Ausländern gegenüber/armiqësor ndaj të huajve* (që nuk i do të huajt).

Po kështu edhe: *kinderfreundlich*, *wesensfremd*, *steuerpflichtig*, *technikfeindlich*, *medienwirksam*, *maschinenlesbar*, *lärmempfindlich*, *klassenbewusst*, *schreibgewandt*, *geschlechtsreif* etj.

Tipi i tretë i kompozitave emërore ka për gjymtyrë temat motivuese të mëposhtme:



Ky është dhe tipi i dytë më prodhimtar i kompozitave mbiemërore, me 600 të tilla, duke përbërë 15% të kompozitave mbiemërore që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*”

Duke iu referuar strukturës morfologjike të fjalëve me anë të të cilave shprehën gjymtyrë e këtij tipi kompozitash mbiemërore, vihet re se ato mund të jenë të shprehura me fjalë të parme (*hellwach*, *dummstolz*, *blässrosa*), gjymtyra e parë me një mbiemër të parme ndërsa e dyta me një mbiemër të prejardhur (*hochsommerlich*, *fernmündlich*, *verschiedengeschlechtlich*). Shumë të rralla janë kompozitat mbiemërore formuar nga dy tema mbiemrash të prejardhur (*geheimnisumwoben*, *griechisch-katholisch*).

Gjymtyra e parë mund të shprehet edhe me një mbiemër në shkallën sipërore, si p.sh.: *bestbekannt*, *größtmöglich*, *höchstpersönlich*, *kleinstmöglich*, *längerfristig*, *meistgekauft*, *nächstfolgend* etj.

Në ndonjë rast gjymtyra e dytë mund të shprehet me një formë të krahasores (*nächsthöher*, *nächstbesser*) apo sipërores (*nächstbeste*).

Rreth 17% e kompozitave mbiemërore të këtij tipi kanë për gjymtyrë të dytë një mbiemër prejpjesor: *altvertraut*, *bestbezahlt*, *freischaffend*, *hochgewachsen*, *hochverdient*, *lautmalend*, *meistgelesen*, *schäerwiegend*, *neuvermählt*, *kleindenkend* etj.


Shumë prodhimtar në formimin e kompozitave mbiemërore të këtij tipi është treguar mbiemri “*hoch*”. Numërohen 68 kompozita mbiemërore me gjymtyrë të parë këtë mbiemër, i cili në katër raste mërr pjesë me formën e shkallës sipërore (*höchstentwickelt*, *höchstpersönlich*, *höchstrichterlich* dhe *höchstzulässig*). 33 kompozita mbiemërore kanë për gjymtyrë të parë mbiemërin “*halb*” (*halbstark*, *halbrund*, *halbherzig*)

Kuptimi semantik i kompozitave mbiemërore formuar nga dy mbiemra zakonisht motivohet nga kuptimi i gjymtyrëve të saj:

altbekannt = *seit langem bekannt*/i njohur prej shumë kohësh; *jungverheiratet* = seit kurzem verheiratet/i martuar prej pak kohësh, i sapomartuar; *braunhaarig* = mit braunen Haaren/me flokë ngjyrë kafe etj.

Në disa raste kompozitat mbiemërore me gjymtyrë të dytë një mbiemër që shënon një ngjyrë kanë për gjymtyrë të parë një mbiemër, i cili shpreh theksim apo zbehje të kësaj ngjyre: *dunkelrot*, *dunkelviolet* etj. *hellgelb*, *hellgrau* etj. *blassblau*, *blassrosa* etj. Ka raste kur gjymtyra e parë e zmadhon ose e zvogëlon kuptimin e shprehur nga gjymtyra e dytë, si p.sh.: *hochmodisch* = *sehr modisch*/shumë modern, *meistgelesen* = *sehr gelesen*/shumë i lexuar; *blindwütend* = *sehr wütend*/shumë i inatosur; *halbwild* = *nicht so wild*/jo aq i egër etj.

Tipi i katërt i kompozitave mbiemërore, gjymtyra e parë e të cilit shprehet me një temë foljore është më i vogël në numër se dy tipat pararendës dhe përbën më pak se 5% të kompozitave mbiemërore të “*Deutsches Universalörterbuch*”. Këto kompozita formohen sipas modelit:



Gjymtyra e parë mund të shprehet me një rrënjë foljore: *strafwürdig*, *schaulustig*, *rutschfest*, *kratzfest*, *kochfertig*, *hörbehindert*, *gefähig*, *fangfrisch* etj., ose edhe me formën e paskajores (Infinitiv): *beklagenswert*, *schaffensfreudig*, *schreckensbleich*, *sterbenselend*, *bemerkenswert*, *überlebensgroß*, *überlegenswert* etj. Në rastin e dytë gjymtyrët e kompozitës lidhen me elementin lidhës –s.

Gjymtyra e parë mund të jetë fjalë e parme (*trinkfest*, *schreibgewandt*, *lesenswert*) ose e prejardhur (*manövrierfähig*, *gebrauchstüchtig*, *einbaufertig*). Edhe gjymtyra e dytë mund të jetë mbiemër i parme (*denkfaul*, *fahrbereit*, *lehrreich*) ose edhe i prejardhur (*lernbegierig*, *manövrierunfähig*, *anmeldepflichtig*).


Një numër i kufizuar kompozitash mbiemërore të këtij tipi kanë për gjymtyrë të dytë një mbiemër prejpjesor: *hörgeschädigt*, *hörbehindert*, *isolierversglast*, *schreibgewandt*, *wohnberechtigt*, *sehbehindert*, *sehgeschädigt*

Edhe kuptimi i kompozitave mbiemërore të këtij tipi është i motivueshëm nga kuptimet e gjymtyrëve të kompozitës. Pjesa më e madhe e tyre emërtojnë të njëjtin tipar sikurse mbiemri përmes së cilit shprehet gjymtyra e dytë, por në lidhje me veprimin që shpreh gjymtyra e parë e saj. Kështu përmes mbiemrit “*lernfähig*” emërtohet aftësia e një vete për të mësuar (*lernfähig* = *fähig zu lernen*).

Në raste të tjera tipari i shprehur nga gjymtyra e dytë shkakton e veprimin e shprehur nga gjymtyra e parë. Kështu mbiemri “*siedeheiß*” tregon se diçka është aq e nxehtë saqë vlon (*siedeheiß* = *so heiß, dass e siedet*).

Ndërsa rrënja e foljes “*stinken*” përforcon kuptimin e mbiemrit me anë të së cilit shprehet gjymtyra e dytë e kompozitave: *stinkreich* = *sehr reich*/shumë i pasur

Tipi i pestë i kompozitave mbiemërore formohet sipas modelit:



Kompozitat mbiemërore të këtij tipi përbëjnë rreth 1.5% të gjithë kompozitave mbiemërore që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*”. Ndajfoljet që bashkohen me tema mbiemërore për të formuar kompozitat e këtij tipi janë ndajfolje të parme, si “*viel*” (*vielversprechend*, *vielsagend*), “*nicht*” (*nichtamtlich*, *nichtzielend*), “*wohl*” e cila është mjaft prodhimtare në formimin e këtij tipi kompozitash, nëpërmjet saj janë formuar 26 kompozita mbiemërore, si p.sh.: *wohlanständig*, *wohlbehalten*, *wohlgemut*, *wohlgeboren*, *wohlverdient*, *wohlverstanden*, *wohlschmeckend* etj., e ndonjë ndajfolje tjetër (*quasioptisch*, *mindersinnig*), por edhe të prejardhura, si në rastin e ndajfoljeve “*links*” (*linksgerichtet*, *linksorientiert*), “*rechts*” (*rechtsdrehend*, *rechtsgerichtet*).


Temat mbiemërore me të cilat bashkohen këto ndajfolje për të formuar mbiemrat e përbërë të këtij tipi janë kryesisht të prejardhura (*rechtsradikal*, *nichtchristlich*, *quasioffiziell*, *wohlanständig*). Në rastet “*linksextrem*” dhe “*rechtsextrem*” kemi të bëjmë me një temën mbiemërore të parme. Në pjesën më të madhe të rasteve gjymtyra e dytë është një mbiemër prejpjesor (*linksorientiert*, *rechtsgerichtet*, *wohlgenährt*, *wohlklingend*).

Në një pjesë të mirë të rasteve kuptimi i kompozitat mbiemërore motivohet nga kuptimi i gjymtyrëve përbërëse (*linksorientiert* = orientiert nach links; *nichtamtlich* = nicht amtlich; *quasioptisch* = quasi/fast optisch etj.).

Ndajfoljet “*wohl*” dhe “*viel*” kanë funksion zmadhues, pasi tregojnë se tipari i shprehur përmes temës mbiemërore zotërohet në një sasi të madhe nga veta apo sendi që karakterizon gjithë kompozita: *wohlerzogen* = sehr gur erzogen, *vielversprechend* = verspricht vieles.

Në ndonjë rast kemi të bëjmë dhe me kompozitë të leksikalizuar, siç ka ndodhur me *wohlfeil* = billig/i lirë (feil=käuflich)

Tipi i gjashtë i kompozitave mbiemërore ka për gjymtyrë të parë një temë parafjalore dhe formohet sipas modelit:



Edhe pse janë pak parafjalët që bashkohen me tema mbiemërore për të formuar mbiemra të përbërë, duhet thënë se ato kanë formuar vargje të tëra kompozitash. Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” numërohen 81 kompozita të tilla.

Parafjala e thjeshtë “*über*” është bashkuar me mbiemra të thjeshtë e të prejardhur:

übergroß, überlang, überklug, überhell, überhart, überbreit, übervoll, überweit, überwach etj.; *übervorsichtig, überstaatlich, überprivilegiert, übermächtig, überdurchschnittlich, überempfindlich, überängstlich* etj.


Ndërsa parafjalët “*unter*”, “*vor*”, “*zwischen*” dhe “*mit*” janë bashkuar vetëm me mbiemra të prejardhur: *unterdurchschnittlich, unteridisch, unterprivilegiert, vorwissenschaftlich, vorindustriell, vorfristig, zwischenmenschlich, zwischenzeitlich, zwischenstaatlich, mitverantwortlich* etj.

Në pak raste mbiemrat me të cilët janë bashkuar parafjalët janë prejpjesor: *unterprivilegiert, unterrepräsentiert, überqualifiziert, überbesetzt, unterbeschäftigt*.

Parafjalët “*über*” dhe “*unter*” zmadhojnë ose zvogëlojnë kuptimin e mbiemrit me anë të të cilit shprehet gjymtyra e dytë: *überhell* = äußerst hell; *unterbeschäftigt* = nicht voll beschäftigt.

Parafjala “*vor*” shpreh marrëdhënie kohore, *vorchristlich* = vor Christi Geburt, por në rastin e mbiemrit “*voreilig*” ajo përforcon kuptimin gjymtyrës së dytë (*voreilig* = zu schnell und unüberlegt)

Tipi i shtatë i kompozitave mbiemërore është formuar sipas modelit:



Edhe përemri, ashtu sikurse ndajfolja, nuk është shumë aktiv në formimin e mbiemrave të përbërë. Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” numërohen 40 kompozita mbiemërore të këtij tipi. Me tema mbiemërore të prejardhura dhe shumë pak të parme bashkohet kryesisht përemri “*selbst*”, i cili është dhe më prodhimtari brenda këtij tipi me 24 kompozita mbiemërore të formuara, si dhe përemri “*all*”:


allbekannt, allgütig, allliebend, allmonatlich, alltäglich, allumfassend, allwissend, allfällig etj.; *selbstbewusst, selbstgerecht, selbstklebend, selbstreinigend, selbstsicher, selbstvergessen, selbsverliebt, selbstverständlich, selbstzufrieden, selbsverantwortlich* etj.

Në një rast të vetëm është bashkuar përemri “*dies(er)*” me një temë mbiemërore duke formuar kompozitën *diesbezüglich* = in Bezug auf dieses.

Siç mund të vihet re edhe nga shembujt e mësipërm, si tema mbiemërore marrin pjesë edhe mbiemra prejpjesorë, nga pjesore të së tashmes (Partizip Päsens: *selbsttragend*) dhe të së shkuarës (Partizip Pperfekt: *selbsvergessen*).

Edhe kuptimi i këtyre kompozitave motivohet nga kuptimi i gjymtyrëve përbërëse: *alleswissend* = alles wissend, *selbstverliebt* = in sich selbst verliebt. Por kemi dhe raste leksikalizimi: *selbstgercht* = keiner Kritik zugänglich.

Tipi i tetë dhe i fundit i kompozitave mbiemërore ka për gjymtyrë të parë një numër dhe për gjymtyrë të dytë një mbiemër:



Ky tip është shumë i kufizuar, përbëhet vetëm nga gjashtë kompozita, nga të cilat katër kanë për gjymtyrë të dytë temën mbiemërore të prejardhur “-dimensional”: *eindimensional*, *zweidimensional*, *dreidimensional* dhe *vierdimensional*. Dy mbiemrat e tjerë kanë të përbashkët gjymtyrën e parë, e cila shprehet me anë të numërorit “*drei*”: *dreieinig* dhe *dreigestrichen*.


Kuptimi i katër kompozitave të para motivohet nga ai i gjymtyrëve përbërëse, ndërsa dy kompozitat e fundit janë leksikalizuar: *dreieinig* = Gott Vater, Sohn und Heiliger Geist in sich vereinigen; *dreigestrichen* = in der dritten Oktava liegend

VI.2.3. Kompozitat foljore.

Foljet si fjalë të përbëra në gjuhën gjermane janë shume më të pakta në numër sesa dy pjesët e tjera të ndryshueshme të ligjeratës trajtuar në nënçështjet e mësipërme. Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” numërohen 2777 folje të tilla, të cilat përbëjnë rreth 5.3% të kompozitave që ndodhen në këtë fjalor.

Gjymtyrët e foljeve të përbëra janë kryesisht fjalë të parme (*brustschwimmen*, *freihalten*, *dableiben* etj.). Në disa raste gjymtyra e dytë e tyre është një folje e prejardhur (*grunderneuen*, *kleinbekommen*, *weiterverkaufen* etj.). Rreth 58% e foljeve të përbëra kanë si gjymtyrë të parë një tjetër kompozitë, e cila me përjashtim të dy rasteve (*vollkaskoversichern* dhe *teikaskoversichern*, në të dyja rastet gjymtyra e parë e kompozitës është një emër i përbërë) është një ndajfolje, si p.sh: *davonlaufen*, *dabeihaben*, *dafürsprechen*, *zuvortun*, *hinzugeben*, *hinterherlaufen*, *hinunterbewegen*, *herüberkommen* etj.


Kompozimi te foljet jo vetëm që është më pak produktiv, por vihet re gjithashtu se fjalët me të cilat bashkohen foljet për të formuar kompozita janë nga një grup i kufizuar pjesësh ligjrate.



Siç mund të vihet re edhe nga grafiku, në përbërjen e kompozitave foljore si gjymtyrë të para marrin pjesë tema ndajfoljore, mbiemërore dhe emërore. Në të vërtetë në gjermanishte ka edhe kompozita foljore me gjymtyrë të parë një folje, por duke qenë se në korpusin tonë ndeshim vetëm në një të tillë (*gefriertrocknen*), përqindja e saj karshi kompozitave të tjera foljore është e papërfillshme ndaj dhe nuk është pasqyruar në këtë grafik.

Lidhjet sintaksore mes gjymtyrëve të kompozitave foljore me gjymtyrë të parë një ndajfolje, një mbiemër dhe një emër janë nënrenditëse duke bërë që këto kompozita të jenë përcaktore.

Kompozitat foljore të tipit:




me gjymtyrë të parë një folje tjetër janë shumë të rralla. Në literaturën e fjalëformimit³⁶⁴ ato njihen si formime rastësore në lëmin e letërsisë artistike dhe të gjuhës teknike. Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” gjendet vetëm një kompozitë të tillë: *gefriertrocknen*. Kompozitat e këtij lloji mund të interpretohen edhe si përcaktore edhe si këpujore.³⁶⁵ Ne

³⁶⁴ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 450; M.Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr- und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f. 228

³⁶⁵ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 292

mendojmë se qëndrimi i Lohde-s³⁶⁶ lidhur me raportin që ekziston midis gjymtyrëve të këtyre kompozitave foljore është me i drejtë, ndaj dhe në këtë punim këto ndajfolje të përbëra klasifikohen si përcaktore, pasi edhe për ne mes dy foljeve (*gefrieren* dhe *trocknen*), e dyta ka një rëndësi më të madhe, duke qenë se kompozita zërthehet në një grup fjalësh nga të cilat folja e parë përdoret në formën e pjesores dhe me funksion ndajfoljor duke përcaktuar më nga afër procesin e shprehur nga folja që është dhe gjymtyra e dytë e kompozitës foljore: *gefriertrocknen* = gefroren *trocknen*. Kjo kompozitë motivohet me kuptimet e gjymtyrëve të saj përbërëse, siç ndodh në pjesën më të madhe të kompozitave foljore.

Tipin e parë të kompozitave foljore e përbëjnë ato formuar sipas modelit:



Këto kompozita përbëjnë dhe shumicën dërrmuese të foljeve të përbëra. 42% e kompozitave foljore kanë për gjymtyrë të parë një temë ndajfoljore të parme, ndërsa pjesa tjetër e kompozitave ka për gjymtyrë të parë një ndajfolje të përbërë. Janë 1597 kompozitë foljore të tilla, nga të cilat më pak se 20% kanë për gjymtyrë të parë një ndajfolje përemërore (Pronominaladverbien), pjesa tjetër përbëhet nga kompozitat ndajfoljore me një të gjymtyrë të shprehur me ndajfoljen “*her*” ose “*hin*”. Më poshtë disa shembuj:

Kompozita foljore gjymtyra e parë e të cilave shprehet me një ndajfolje të parme: *dabehalten, dableiben, daliegen, dalassen, dasitzen, dastehen, fortbilden, fortdenken, fortführen, gegenrechnen, gegesprechen, emporarbeiten, emporschäeben, emportauschen, geradestehen, wegarbeiten, wegblicken, weggehen, weitemarschieren, weiterräumen, weiterreden, wiederverheiraten, wiedersehen, zurückbehalten, zurückentwickeln, zurückholen, zusammenhalten, zusammenkleben, zusammenpacken* etj.

Kompozita foljore gjymtyra e parë e të cilave shprehet me një kompozitë ndajfoljore: *dabeistehen, dafürsprechen, dagegensetzen, danebenliegen, danebenraten, daranwenden, daranmachen, dareinreden, dareinmischen, darumkommen, darumlegen, davonfahren, davonkommen, dazusagen, dazukommen, dazwischenhauen, dazwischentreten, daherfliegen, dahinbewegen* etj. *hinaufbringen, hinaufklettern, heraufsetzen, heraufnehmen, hinunterführen, hinunterlaufen, herunterspringen, heruntersehen, hineinfahren, hineinfliegen, herausbrechen, heruashalten, hinausfinden, hinausheben, hervoranglen, hervorblicken, herumdrehen, herumgehen, hindurchziehen, hindurchfließen, herabschlagen,*

³⁶⁶ M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr-und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f.228

herabfallen, heranlassen, heranmachen, herbeibringen, herbeiholen, hereinkriechen, hereinsehen, herüberhelfen, herübertragen etj.

Rreth 1140 folje të këtij tipi kanë për gjymtyrë të parë një ndajfolje të përbërë me elementin “*her*” dhe “*hin*”, të cilat shprehin lëvizje drejt një drejtimi. Këto ndajfolje bashkohen me folje nga më të ndryshmet. Duke qenë ndajfolje që shprehin kryesisht marrëdhënie vendore, ato e kanë shumë të lehtë të bashkohen pikësëpari me folje që shprehin lëvizje. Në këto raste edhe kompozitat e foljore shprehin një lëvizje apo një zhvendosje drejt një vendi. Pra, gjymtyra e parë e shprehur me një kompozitë ndajfoljore të tillë, i jep një drejtim të caktuar veprimit të shprehur nga gjymtyra e dytë e foljes. Më poshtë paraqiten disa nga kuptimet që i japin foljeve ndajfoljet që shprehin marrëdhënie vendore:

një lëvizje me drejtim lart

hinaufbegleiten = nach oben begleiten,
hinaufkommen = nach oben kommen

heraufarbeiten = von einer Stelle nach oben arbeiten
heraufklettern = von dort unten hierher nach oben klettern

një lëvizje me drejtim poshtë

hinunterbeugen = nach unten beugen
hinunterjagen = nach unten jagen

herunterfliegen = von dort oben hierher nach unten fliegen
heruntergeben = von dort oben hierher nach unten geben

herniederfallen = von dort oben hierher nach unten fallen
herniederprasseln = von dort oben hierher nach unten prasselnd fallen

herabsehen = von dort oben hierher nach unten sehen
herabkommen = von dort oben hierher nach unten kommen

herunterdrücken = nach unten drücken
herunterholen = von dort oben hierher nach unten holen

një lëvizje me drejtim nga jashtë brenda ose nga brenda jashtë, nga përpara

herausdrücken = von dort drinnen hierher nach draußen drücken
herausgehen = von dort drinnen hierher nach draußen gehen

hinausdringen = aus einem Bereich nach außen dringen
hinausführen = nach draußen führen

hervorkommen = aus etwas nach draußen kommen
hervorwaschen = aus etwas nach draußen wachsen

hineinbewegen = in etwas bewegen
hineinführen = in etwas führen

vorangehen = vorne, an der Spitze gehen
vorankommen = sich nach vorne bewegen

një lëvizje përmes apo përreth diçkaje

hindurchschauen = durch etwas sehen
hindurchzwängen = durch etwas zwängen

herumdrehen = um eine Drehachse drehen
herumreisen = von einem Ort zum anderen reisen

afrim ose largim

heranbringen = in die Nähe einer Sache/Person bringen
herantreten = in die Nähe einer Sache/Person treten

herbeilaufen = von einer Stelle, die entfernt liegt, zum Sprechenden laufen
herbeifliegen = von einer Stelle, die entfernt liegt, zum Sprechenden fliegen

hinwegsehen = über jemanden/etwas sehen
hiwegbewegen = sich über jemanden/etwas bewegen und ihn/es hinter sich lassen

vorbeigehen/vorübergehen = sich gehend entfernen
vorbeiziehen/vorüberziehen = auf eine Person/Sache zuziehen und dann in gleicher Richtung weiterziehen

Kompozitat ndajfoljore të këtij tipi bashkohen edhe me folje të tjera, të cilat nuk shprehin lëvizje, si p.sh. *hinein**be**mühen*, *hinein**den**ken*, *heraus**bi**lden*, *heraus**ken**nen*, *herbe**sei**hnen*, *herbe**iz**aubern*, *voran**ma**chen* etj. Edhe kuptimi i këtyre foljeve zgjerohet në aspektin e zhvendosjes apo drejtimit në varësi të asaj që shpreh ndajfolja me të cilën bashkohen.

Më prodhimtare në formimin e kompozitave foljore të këtij tipi janë ndajfoljet: *herum* (182 kompozita foljore), *heraus* (142 kompozita foljore), *hinein* (126 kompozita foljore), *herunter* (92 kompozita foljore) ndajfolja e thejshtë *hin* (85 kompozita foljore) etj. Ndërsa nga ndajfoljet përemërore (*Pronominaladverbien*) më aktive në formimin e kompozitave foljore janë treguar *davon* (me 26 kompozita foljore) si dhe *dazu* dhe *dazwischen* (me nga 16 të tilla)

Gjymtyrët ndajfoljore të këtyre kompozitave nuk shprehin vetëm marrëdhënie vendore. Ato kanë fituar edhe kuptime të tjera, duke shprehur kështu edhe marrëdhënie të ndryshme, si marrëdhënie kohore (*vorausgehen* = früher als die anderen her irgendwohin gehen; *vorbeigehen* = zu Ende gehen; *dahingehen* = vergehen etj.). “dazu” dhe “hinzu”


shprehin një kuptim shtesë (*hinzubekommen* = zusätzlich bekommen; *dazulernen* = zusätzlich lernen). “daneben” veç kuptimit të afrimit tregon se diçka është bërë gabim (*danebengehen* = das Ziel verfehlen). “herum” shpreh jo vetëm kuptim vendor por edhe se diçka bëhet kot, pa arritur ndonjë rezultat konkret (*herumfliegen* = ohne bestimmtes Ziel fliegen), gjithashtu shpreh edhe kuptim kohor (*herumbummeln* = über längere Zeit bummel).

Marrëdhënie *vendore* shprehin edhe ndajfoljet e thjeshta “*fort*”, “*empor*”, “*weg*” dhe “*zurück*”, të cilat janë shumë aktive duke formuar një numër të madh kompozitash foljore (vetëm ndajfolja e fundit merr pjesë në formimin e rreth 130 foljeve të tilla), kuptimi i të cilave përcaktohet nga kuptimi i ndajfoljes me të cilën është shprehur gjymtyra e parë e tyre. Kështu, të gjitha foljet me gjymtyrë të parë ndajfoljen “*zurück*” shprehin një veprim që të kthen në pikën e nisjes (*zurückbringen* = zurück an den Ausgangspunkt bringen)

Si gjymtyrë të parë të kompozitave foljore gjejmë edhe ndajfolje që nuk shprehin marrëdhënie kohore, si “*mit*”, “*zusammen*” apo “*zurecht*”. Kështu, p.sh.: “*mit*” i jep kuptimin e bashkautorësisë një veprimi (*mitmachen* = an etëas aktiv teilnehmen); “*zurecht*” kur diçka kryhet në formën e duhur (*zurechtbringen* = in Ordnung bringen). Ndërsa “*zusammen*” shpreh kuptime të ndryshme:

<i>zusammenarbeiten</i>	= gemeinsam arbeiten (përfshirjeje)
<i>zusammenbinden</i>	= durch Binden vereinigen (bashkim)
<i>zusammendrücken</i>	= auf etwas drücken und dadurch kleiner machen (zvogëlim)
<i>zusammenhauen</i>	= zerschlagen (dëmtim)

Tipi i dytë i kompozitave foljore është formuar sipas modelit



Krahasuar me tipin e parë të kompozitave foljore, ky tip është shumë më pak prodhimtar. Numërohen rreth 330 folje të tilla, duke përbërë kështu rreth 12% të kompozitave foljore. Por gjithsesi ky tip kompozitash është pasuruar veçanërisht shekujt e fundit.³⁶⁷ Këtë fakt Fleischer-i/Barz-i³⁶⁸ e shpjegojnë me ndryshimet semantike që kanë pësuar togjet e fjalëve. Këto ndryshime kanë pasur “*nicht selten auch formativstrukturelle Konsequenzen. / jo rrallë edhe pasoja në formë e strukture*”³⁶⁹. Ja disa prej kompozitave foljore:

³⁶⁷ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 450

³⁶⁸ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 298

³⁶⁹ Fleischer/Barz, po aty, f. 6

dicktun, stillschweigen, bereithalten, blankziehen, blaumachen, bloßliegen, breitwalzen, dichthalten, fernheizen, flachlegen, flottkriegen, freigeben, freimachen, freistellen, gesundmachen, glattstellen, gleichschalten, gleichziehen, großschreiben, gutheißen, heißlaufen, hellsehen, hochbringen, hochjagen, hochnehmen, irreggehen, kaltmachen, kaputtgehen, klarstellen, kleinschreiben, klugreden, neubauen, krummlachen, kurzarbeiten, liebäugeln, rechtschreiben, rundfragen, schön tun, schwarzarbeiten, stillbleiben, totärgern, totlaufen, trockenfallen, vollenden, warmhalten etj.

Sa i takon strukturës morfologjike, gjymtyra e parë e këtyre kompozitive shprehet me një mbiemër të parmë: *dicktun, freihalten, blaumachen, flachliegen, gleichsetzen, hochsehen, klarmachen, rundgehen, schönreden, vollenden* etj. Edhe gjymtyra e dytë e tyre shprehet kryesisht me një folje të parmë (*wahrhaben, trockenlegen, wehtun* etj.). Vetëm në pak raste gjejmë një folje të prejardhur (*fernbedienen, fernübermitteln, flottbekommen, freibekommen, generalüberholen, kleinbekommen, runderneuern*).

Në formimin e kompozitive foljore të këtij tipi marrin pjesë rreth 64 mbiemra, por jo të gjithë janë njësoj prodhimtarë. Pjesa dërrmuese e tyre, rreth 70%, janë bashkuar me shumë pak folje, duke formuar kështu një numër të vogël foljesh të përbëra. Ndërsa mbiemrat “hoch” (*hochtragen, hocharbeiten*), “fest” (*festlegen, festbinden*), “frei” (*freisprechen, freikaufen*) dhe “tot” (*totschweigen, totlachen*) kanë formuar vargje të gjata kompozitash foljore, veçanërisht “hoch”, nëpërmjet të cilit janë formuar 64 foljore, apo “fest” me 45 të tilla.

Raportet semantike mes gjymtyrëve të kompozitive foljore të këtij tipi kushtëzohen nga raportet sintaksore mes gjymtyrëve të fjalisë në të cilën zërthehet kjo kompozitë. Pra dy gjymtyrët e foljes së përbërë, mbiemri dhe folja, janë të lidhura me njëra-tjetrën në varësi të funksioneve sintaksore që kanë ato në fjali. Në pjesën më të madhe të rasteve marrëdhëniet e tyre janë të karakterit kallëzuesor. Kështu, mbiemri përshkruan gjenden që shkakton veprimi i shprehur nga folja: *trockenlegen = etwas trocken machen* *totmachen, tiefbohren, freischufeln, stillschweigen, heißlaufen, festfahren, trockenlegen, wachrufen, klarkommen, krankärgern* etj.


Më të rralla janë rastet kur mbiemri përshkruan gjendjen e shprehur nga folja: *festsitzen = etwas ist fest*

stillsitzen, freikommen, bloßliegen, bereitliegen, fernbleiben etj.;

si dhe kur ai merr funksion ndajfoljor dhe e përcakton foljen si një ndajfolje:

hochbringen = nach oben bringen, hochtragen, hochwerfen, hochfahren

Tipi i tretë i kompozitive foljore ka për gjymtyrë të parë një temë emërore dhe formohet sipas modelit:



Ky tip kompozitash foljore është më i kufizura në numër krahasuar me tipat e mësipërm, por gjithsesi shumë më prodhimtar se ai i formuar sipas modelit folje+folje. Në “*Deutsches Universalwörterbuch*” numërohen 112 kompozita foljore të këtij tipi.

Emri përmes së cilit shprehet gjymtyra e parë e kompozitës, në pjesën dërrmuese të rasteve është një emër i pamë:

bauchtanzen, bergsteigen, blutunterlaufen, brustschwimmen, ehebrechen, handstoppen, h ausschlachten, heimführen, katzbalgen, nachtwandeln, notoperieren, seiltanzen, etj.

Në pak raste ai është i prejardhur:

brandschatzen, bruchlanden, bruchrechnen, strafversetzen, wetteifern, zwangsbeglucken, blutunterlaufen

Në ndonjë rast si gjymtyrë e parë merr pjesë edhe një emër i përbërë: *teilkaskoversichern* dhe *vollkaskoversichern*.

Ndërsa si gjymtyrë të dyta marrin pjesë folje me strukturë të ndryshme morfologjike: folje të parme, të cilat përbëjnë edhe shumicën (*stattfinden, lobsingeln, heimsuchen* etj.), folje të prejardhura, të cilat ndeshen më rrallë (*kaskoversichern, strafversetzen, zwangsbeurlauben*). Në një rast të vetëm gjymtyra e dytë e kompozitave foljore të këtij tipi shprehet me një kompozitë *stabhochspringen*.

Gjymtyra e shprehur me temë emërore e këtyre kompozitave përcakton më nga afër veprimin e shprehur nga folja si gjymtyrë e dytë duke treguar *vendin* ku ndodh veprimi: *seiltanzen = auf dem Seil tanzen; mjetin* përmes së cilit realizohet veprimi: *bruchrechnen = mit Brüchen rechnen; arsyen* pse kryhet veprimi i shprehur nga folja *schutzimpfen = zum Schutz impfen; gjendjen* në të cilin kryhet veprimi *schlafwandeln = im Schlaf wandeln*; në raste të tjera luan edhe funksionin e një *kundrinori*: *danksagen = Dank sagen*.

VI.2.4. Kompozitat ndajfoljore

Ndajfoljet e përbëra e kanë origjinën e tyre te përngjitja, por në ndryshim nga ndajfojet e përngjitura, gjymtyra e dytë e këtyre kompozitave është një ndajfolje.³⁷⁰ Siç do të trajtohet edhe në analizën e mëposhtme, disa nga 207 kompozitat ndajfoljore kanë si gjymtyrë të dytë një element, i cili sot përdoret rëndom si parafjalë, si p.sh: *an, aus, auf, ab, zu* etj. Për Fleischer-in/Barz-in një element i tillë është “*präpositional-adverbiale Zweitglied / gjymtyrë e dytë parafjalorondajfoljore*”³⁷¹ pasi përdoret edhe si parafjalë edhe si ndajfolje.

Kompozitat ndajfoljore përbëjnë rreth 0.4% të kompozitave të “*Deutsches Universalwörterbuch*”. Por pavarësisht numrit shumë të vogël të tyre, krahasuar me kompozitat e pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës, shqyrtuar më lart, ato paraqesin numrin me të madh të modeleve mbi bazën e të cilave formohen. Numërohen 11 tipa

³⁷⁰M. Lohde, Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr-und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f. 288; Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 280

³⁷¹ Fleischer/Barz, po aty, f. 282

kompozitash ndajfoljore, nga të cilët më prodhimtari është tipi i “Pronominaladverbien/ndajfoljeve përemërore”³⁷², me plot 58 të tilla. Ndërsa më pak produktiv si tip është bashkimi i një mbiemri me një ndajfolje. Vetëm 3 kompozita janë formuar sipas këtij modeli.

Gjymtyrët e pjesës dërrmuese të kompozitave ndajfoljore janë fjalë të parme (*dorthin*), në raste të rralla kemi të bëjmë më ndonjë gjymtyrë të prejardhur (*spätnachts*), ndërsa kompozitat me gjymtyrë të përbërë janë 44, duke përbërë gati 22% të gjithë kompozitave ndajfoljore (*linksherum, rechtsherum, obenhinaus, nirgendwoher, irgendwohin, sowieso, anderswoher, dahinunter, hierherauf, überübermorgen, vorvorgestern* etj.)

Veçanërisht prodhimtare janë ndajfoljet “*hin*” dhe “*her*”, të cilat duke u bashkuar me ndajfolje të tjera kanë formuar 93 kompozita ndajfoljore.

Dallohen tri grupe të mëdha brenda kompozitave ndajfoljore. Në grupin e parë bëjnë pjesë tipat me gjymtyrë të dytë ndajfoljen “*her*” ose “*hin*”. Grupi i dytë përbëhet nga kompozitat me gjymtyrë të dytë një element i cili gjen përdorim ndajfoljor dhe parafjalor, ndërsa në grupin e tretë bëjnë pjesë kompozitat e tjera ndajfoljore me gjymtyrë të dytë një ndajfolje të çfarëdoshme.

Kompozitat me gjymtyrë të dytë ndajfoljet –hin dhe –her:

Tipi i parë i këtyre kompozitave ndajfoljore ka si gjymtyrë të dytë një nga dy ndajfoljet e mësipërme, ndërsa si gjymtyrë të parë një ndajfolje tjetër, kryesisht vendore:

ndajfolje + -hin/-her

hierher, daher, dorther überallher, woher, wohin, hierhin, dorthin, dahin, überallhin, immerhin, untenhin, untenher, obenhin

Me përjashtim të ndajfoljes *immerhin*, e cila nuk shpreh marrëdhënie vendore, por është leksikalizuar dhe shpreh marrëdhënie të ndryshme si kufizim apo referim, gjithë ndajfoljet e tjera shprehin kuptim vendor.

Gjymtyra e parë e **tipi të dytë** të këtyre kompozitave ndajfoljore është një element, i cili gjen përdorim parafjalorondajfoljor.

element parafjalorondajfoljor + -hin/-her

Janë formuar 11 ndajfolje me këto gjymtyrë.

anhin, aufhin, überhin, nebenhin, nebenher, mithin, hinterher, bisher, ohnehin, vorher, vorhin

³⁷² Në *Duden-Deutsches Universalwörterbuch* gjejmë këtë shpjegim për termin “Pronominaladverb”: ndajfolje e formuar nga një rrënjë e vjetër përemërore e një parafjalë, dhe përdoret në vend të togut të përbërë nga një parafjalë dhe një përemër, p.sh: *darüber = über es*

Ndajfolja –hin dhe më pak ajo –her, bashkohen edhe me mbiemra duke formuar 9 ndajfoljet e përbëra të tipit të tretë:

mbiemër + -hin/-her

späterhin, fernerhin, fernhin, weiterhin, schlechthin, letzthin, gemeinhin, künftighin dhe *weiterher*

Siç mund të kuptohet edhe nga shembujt e mësipërm, ndajfolja “her” është shumë më pak aktive se ndajfolja “hin”. Nëpërmjet saj është formuar vetëm kompozita ndajfoljore *weiterher*. Vihet re gjithashtu se në tri raste, si gjymtyrë e parë merr pjesë forma e shkallës krahasore të mbiemrit: *späterhin* (spät – später), *fernerhin* (fern – ferner) dhe *weiterhin* (weit – weiter). Gjymtyra e dytë nuk krijon ndonjë ndryshim semantik, ajo thjesht u jep një kuptim ndajfoljor mbiemrave.³⁷³ Kompozitat ndajfoljore kanë kuptim vendor dhe kohor (*fernerhin, weiterhin, späterhin*). Ndërsa ndajfolja *schlechterhin* është krejtësisht e leksikalizuar (*schlechterhin* = geradezu, ganz einfach; absolut).

Kompozitat ndajfoljore, gjymtyra e dytë e të cilave është e shprehur me një element i cili përdoret edhe si parafjalë edhe si ndajfolje:

Tipi i parë i këtyre ndajfoljeve të përbëra ka për gjymtyrë të parë ndajfoljen “her” ose “hin”

hin-/her- + element parafjalor/ndajfoljor

Numërohen 22 ndajfolje të tilla:

hinab, hinauf, hinan, hinaus, hindurch, hinein, hingegen, hinüber, hinunter, hinzu, herab, heran, herauf, heraus, herbei, herein, herfür, herüber, herum, herunter, hervor, herzu

Kompozitat ndajfoljore të formuara me këto elemente kanë kryesisht kuptim vendor. Gjithashtu vihet re se ndajfoljet *hin* dhe *her* bashkohen vetëm me elemente të caktuara. Kështu p.sh.: “her” bashkohet me “bei”(herbei), por jo me “durch”, ndërkohë që “hin” bashkohet me “durch” (hindurch) por jo me “bei”.

Tipi i dytë i këtij grupi përbën dhe shumicën e kompozitave ndajfoljore. Gjymtyra e parë e tyre shprehet me ndajfoljet “da(r)”, “hier” dhe “wo”, ndërsa gjymtyra e dytë shprehet me një element që gjen përdorim ndajfoljor dhe parafjalor. Kompozitat ndajfoljore të këtij tipi njihen si ndajfolje përemërore (Pronominaladverbien):

da(r): *daran, darauf, daraus, darin, danach, darüber, darum, davon, davor, dazu, dazwischen, dahinter* etj.

hier: *hierauf, hieraus, hierbei, hierdurch, hiererein, hierhinter, hiernach, hierneben, hierüber, hierum, hierunter, hierzu* etj.

³⁷³ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f.281

wo: *wodurch, wobei, wohinter, wonach, woraus, worum, wovon, worunter, wozu, woneben, worin* etj.

Tipin e tretë e përbëjnë kompozitat e përbëra nga bashkimi i një parafjale me një ndajfolje cila ka përdorim parafjalor. Ky tip nuk është shumë prodhimtar. Numërohen 9 kompozita të tilla:

durchaus, inzwischen, mitunter, nebenan, voran, vorbei, überaus, zuvor, zwischendurch

Nga bashkimi i këtyre dy elementeve, parafjala humbet karakterin e saj dhe ndajfolja e krijuar është krejtësisht e leksikalizuar.³⁷⁴ Kështu nga parafjala *durch* (përmes) dhe ndajfolja *aus* (jashtë) është formuar ndajfolja *durchaus* me kuptimin *völlig* (krejtësisht) (Das ist *durchaus* richtig)

Tipi i katërt i këtyre ndajfoljeve ka si gjymtyrë të parë një mbiemër. Edhe ky tip kompozitash ndajfoljore është i kufizuar:

weitab, vollauf, kurzum, geradeaus, frisch auf, hell auf, weitaus, rundum, schräg über, nahezu

Ndërsa në **tipin e pestë** gjymtyra e parë shprehet me një ndajfolje, e cila motivon nga ana semantike gjithë kompozitën. 16 janë kompozitat e këtij tipi:

heimzu, hintenzu, oben zu, oben an, oben auf, obendurch, immerzu, vorne an, untendurch, fortan, linksum, querdurch, wohlan, wohlauf, somit, sonach

Tipi i gjashtë i këtij grupi kompozitash ndajfoljore ka për gjymtyrë të parë një element të shprehur me emër. Ky emër motivon kuptimisht gjithë kompozitën dhe ajo mund të zërthehet në një grup fjalësh, i cili përbëhet nga emri me të cilin shprehet gjymtyra e parë e kompozitës dhe një ndajfolje që shpreh lëvizje në një drejtim, si p.sh.: *talaus = aus dem Tal hinaus*.

bergan, bergab, landauf, landab, fluß auf, fluß ab, straß auf, straß ab, tags über, tagaus, tagein, kopf über, reihum, himmeln, nachts über

Grupi i ndajfoljeve me gjymtyrë të dytë një ndajfolje tjetër:

Në këtë grup dallojmë dy tipa kompozitash ndajfoljore:

Tipi i parë ka për gjymtyrë të parë një ndajfolje. Ky përbën tipin e dytë më prodhimtar mes gjithë kompozitave ndajfoljore. Numërohen 38 të tilla. Një pjesë e mirë e këtyre kompozitave janë leksikalizuar krejtësisht, si p.sh.: ndajfoljet *immerfort, gleichwohl* etj., apo dhe ndajfoljet me gjymtyrë të parë, më rrallë gjymtyrë të dytë, ndajfoljen “so”:

³⁷⁴ Fleischer/Barz, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007, f. 281

sofort, geradeso etj. Në pjesën dërrmuese të tyre këto ndajfolje shprehin marrëdhënie vendore, dhe më pak marrëdhënie kohore:

sodann, soeben, sofort, sogar, sogleich, sohin, ebenso, geradeso, wieso, hinein, hinfort, hinweg, immerfort, nunmehr, nimmermehr, gleichwohl, anderswo, woanders, wofern, höchstwahrscheinlich, nunmehr, linksrum, zugleich etj.

Tipi i dytë përbëhet vetëm nga tri kompozita ndajfoljore të cilat kanë për gjymtyrë të parë një mbiemër. Kuptimi i këtyre kompozitave motivohet lehtësisht nga gjymtyrët përbërëse:

spätabends, frühmorgens dhe *spätnachts*

Ndërsa ndajfoljet *übermorgen* dhe *vorgestern* janë formuar nga bashkimi i një parafjale dhe një ndajfoljeje.

VI.3. Përqasja e kompozitave në shqipe dhe gjermanishte

Pasi u analizuan kompozitat e “*Fjalorit të shqipes së sotme*” dhe “*Deutsches Universalwörterbuch*”, në vijim do të shohim të përbashkëtat dhe ndryshimet që dalin nga krahasimi i tyre. Krahasimi i kompozitave të këtyre gjuhëve do të bëhet në tri aspekte, në atë morfologjik, sintaksor dhe semantik.

E para që të bie më shumë në sy teksta krahason kompozitat e shqipes me ato të gjermanishtes, është numri shumë më i lartë i kompozitave të gjuhës gjermane, jo vetëm kundrejt atyre të shqipes por edhe në raport me tërësinë e fjalëve që ndodhen në fjalorët përkatës. Kompozitat e gjermanishtes përbëjnë rreth 40% të fjalëve që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*”, duke e nxjerr në pah edhe njëherë aftësinë dhe lehtësinë e kesaj gjuhe për të formuar fjalë të përbëra. Kjo aftësi nuk ka lidhje vetëm me strukturën e gjuhës gjermane, e cila duke qenë një gjuhë analitikosintetike nga njëra anë zotëron një sistem të zhvilluar ndajshitesash, por nga ana tjetër bën që rendi i ngulitur i gjymtyrëve në fjali të krijojë mundësi për formime tipash të ndryshëm kompozitash. Një ndikim të veçantë ka luajtur edhe parimi i ekonomizimit të gjuhës (*Prinzip der Univerbierung*) dhe të shprehurit në mënyrë sa më përmbledhëse dhe të shkurtër,³⁷⁵ çka ka bërë që kuptimi i një sintagme të tërë të shprehet përmes një kompozite. Por, ky parim krijon dhe vështirësi, pasi jo rrallëherë krijohen kompozita, kuptimi të cilave qartësohet vetëm në kontekstin në të cilin përdoren.

Shifra 10% që përbën tërësinë e kompozitave të shqipes në “*Fjalorin e shqipes së sotme*” është modeste karshi asaj 40% të kompozitave gjermane. Por ne mendojmë se numri i kompozitave të gjuhës shqipe është edhe më i madh, pasi shumë prej tyre janë pjesë e gjuhës terminologjike, krijimtarisë artistike dhe publicistikës.

³⁷⁵ P.Polenz, *Deutsche Sprachgeschichte vom Spätmittelalter bis zur Gegenwart*, Band I, Berlin, 2000, f. 33

Të dyja gjuhët krijojnë kompozita emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore. Por teksa në shqipe kompozitat mbiemërore dhe emërore përbëjnë dy tipat më të pasur, me një diferencë shumë të vogël në numër kompozitash mes tyre, në gjermanishte është i padiskutueshëm vendi dominues i kompozitave emërore, të cilat përbëjnë mbi 85% të gjithë kompozitave të kësaj gjuhe. Kompozitat ndajfoljore janë më pak në të dyja gjuhët krahasuar me tipat e tjerë.

Në gjermanishte gjymtyra e dytë e kompozitës është ajo që e formëson gramatikisht atë dhe përcakton përkatësinë e saj në pjesë ligjrate duke përbërë në këtë mënyrë dhe një nga tiparet që e dallojnë atë nga fjala e përngjitur. Për këtë arsye gjymtyra e dytë e kompozitave emërore është gjithnjë një emër, e atyre mbiemërore një mbiemër, e foljoreve një folje, ndërsa e ndajfoljeve një temë ndajfoljore, ose me përdorim ndajfoljor. Me këtë të fundit kemi parasysh të ashtuquajturat "*Präpositionaladverbien*" të cilat janë shqyrtuar bashkë me kompozitat ndajfoljore. Edhe në gjuhën shqipe është gjymtyra e dytë ajo që shpreh kategoritë gramatikore të kompozitës, por kjo gjë ndodh në pjesën dërrmuese të rasteve, pasi te disa kompozita këtë funksion e kryen gjymtyra e parë (*vinçurë / vinçi-urë*). Gjithashtu në shqipe gjymtyra e dytë nuk përcakton domosdoshmërisht se cilës pjese ligjrate i përket kompozita. Kështu ka shumë kompozita mbiemërore, të cilat kanë për gjymtyrë të dytë një emër (*zemërgur*).

Nisur nga pikëpamja e marrëdhënieve sintaksore që ekzistojnë mes gjymtyrëve të kompozitave si në shqipe dhe në gjermanishte, ato mund të jenë bashkërenditëse, duke formuar kështu kompozita këpujore, ose nënrenditëse, në rastin e kompozitave përcaktore.

Edhe pse të dyja gjuhët i njohin kompozitat këpujore dhe nuk kanë vështirësi në formimin e tyre, veçanërisht kompozitat këpujore mbiemërore, numri i këpujoreve të listuara në fjalorët e të dyja gjuhëve është i papërfillshëm krahasuar me numrin e kompozitave përcaktore. Në të dyja gjuhët mund të formohen kompozita këpujore me më shumë se dy gjymtyrë, por në "*Fjalorin e shqipes së sotme*" nuk gjejmë asnjë të tillë, ndërsa në "*Deutsches Universalwörterbuch*" gjejmë vetëm mbiemrin këpujor "*schwarzrot-golden*", i cili i referohet ngjyrave të flamurit gjerman. Nisur nga ky fakt mendojmë se ky tip kompozite mbetet më tepër një krijim rastësor për të dyja gjuhët.

Si shqipja dhe gjermanishtja formojnë kompozitat këpujore emërore dhe mbiemërore (*tragjikomedi, kërkimor-shkencor*). Në "*Deutsches Universalwörterbuch*" si kompozita këpujore gjejmë edhe emërtime gjeografike, ndërsa në gjuhën shqipe ka dhe kompozita këpujore ndajfoljore:

*Garmisch-Partenkirchen,
Baden Württemberg
ballafaqe, bukagjellë*

Kompozitat përcaktore janë ato që zënë peshën kryesore në kompozimin e të dyja gjuhëve. Por, ndërsa në shqipe gjymtyrë përcaktuese mund të jetë edhe e para (*atdhe*) edhe e dyta (*pikëvështrimi*), në gjermanishte, me një përjashtim të vetëm (*Vierteljahr*),

përcaktuese është vetëm gjymtyra e parë (*Kriegsende = Ende des Krieges*). Ndaj dhe në rastet e kompozitave me rend të përmbysur gjymtyrësh kemi të bjmë me dy fjalë të ndryshme:

Filmmusik (= Musik eines Filmes) është një muzikë, pikërisht muzika e një filmi, ndërsa

Musikfilm (= Film mit vielen musikalischen Darbietungen) është një film, i përcaktuar si film muzikor nga gjymtyra e parë e kompozitës.

Si shqipja edhe gjermanishtja krijojnë kompozita pronësore (*Possessivkomposita*), apo ekzocentrike, të cilat shprehin një kuptim metaforik, jashtë kompozitës. Si në shqipe edhe në gjermanishte këto kompozita emërtojnë persona e gjallësa duke përdorur një pjesë trupore apo një karakteristikë tjetër të tyre, por, teksa në shqipe kompozitat e tilla janë kryesisht kompozita mbiemërore, në gjermanishte janë emërore, pasi ato mbiemërore janë zëvendësuar nga ndërtime të tjera:

zemërgur, shpirtzi, gushkuq
Schönggeist, Milchgesicht, Löwenzahn

Kompozitat përcaktore përbëhen gjithnjë nga dy gjymtyrë, por ato mund të kenë në përbërje të tyre më shumë se dy tema motivuese. Kompozita të tilla në gjuhën shqipe janë të rralla. Në fjalor gjejmë 36 të tilla (*atdhedashuri, bishtfurkabukur, atdhedashës*). Ndërsa në gjermanishte ato përbëjnë mbi 10% të gjithë kompozitave që ndodhen në "*Deutsches Universalwörterbuch*". Ndonëse gjermanishtja është një gjuhë e njohur për formimin e kompozitave me shumë tema motivuese, në këtë fjalor pjesën dërrmuese e përbëjnë kompozitat përcaktore me dy tema të tilla. Më i pakët është numri i kompozitave më tri elemente, ndërsa kompozitat me më katër tema motivuese janë shumë të rralla. Por në këtë fjalor gjenden edhe dy kompozita "të gjata". Njëra ka në përbërje të saj pesë komponentë (*Fluorchlorkohlenwasserstoff*), ndërsa tjetra gjashtë (*Kraftfahrzeugreparaturwerkstatt*)

Duke iu referuar strukturës morfologjike të gjymtyrëve të kompozitave në të dyja gjuhët, vëmë re se si në shqipe dhe në gjermanishte, ato mund të jenë fjalë të parme (*barkdreq; Augenarzt*), fjalë të prejardhura (*organizatë-bazë, armëpushim, bujqësor-industrial; Handarbeiter, Bearbeitungszeit, Handlungsverlauf*) dhe në rastin e kompozitave me më shumë se dy tema motivuese edhe fjalë të përbëra (*atdhedashuri, lulekëmbepulë; Hausarbeitstag, Handlungsspielraum*). Në shqipe bie në sy se në raste të rralla gjymtyra e parë e kompozitës shprehet me një fjalë të prejardhur. Në gjermanishte si gjymtyrë e fjalës së përbërë merr pjesë edhe një shkurtësë (*DDR-Bürger, Mathearbeit*) dhe në raste të rralla edhe një fjalë e përngjitur (*vergissmeinnichtblau*). Ndërsa në shqipe nuk ndeshim raste të tilla.

Në të dyja gjuhët **kompozitat emërore përcaktore** kanë për komponent të dytë një emër, ndërsa komponenti i parë i tyre shprehet me një temë emërore, ndajfoljore, mbiemërore, foljore, një konfiks, një përemër të pacaktuar ose edhe një numëror:

<i>hekurudhë</i>	<i>Hauseingang</i>
<i>keqbesim</i>	<i>Außenwand</i>
<i>tretënatë</i>	<i>Großtante</i>
<i>brellis</i>	<i>Schwimmbad</i>
<i>mikrobotë</i>	<i>Geowissenschaft</i>
<i>gjithëfuqi</i>	<i>Allmacht</i>
<i>dyluftim</i>	<i>Dreieck</i>

Ndryshe nga shqipja në gjermanishte si gjymtyrë e parë merr pjesë edhe përemri vetor e ai pyetës: *Icherzähler*, *Wemfall*, ndërsa numërori mund të jetë edhe një numëror rreshtor, jo vetëm themelor: *Erstaufführung*

Por kompozitat emërore të shqipes dhe gjermanishtes formojnë edhe tipa specifike. Kështu në shqipe gjymtyrë e dytë mund të shprehet edhe me anë të një mbiemri:

bishtollë, barkgjerë

Ndërsa në gjermanishte formohen kompozita emërore me gjymtyrë të parë një parafjalë:

Nebenraum, Zwischenzeit

Tipi i kompozitave përcaktore emërore *emër + emër* është më prodhimtari në të dyja gjuhët. Në shqipe ky tip kompozitash përbën rreth 54% të gjithë kompozitave emërore, ndërsa në gjermanishte ky tip është edhe më domethënës, pasi ato përbëjnë 78% të gjithë kompozitave.

Duke iu referuar strukturës së gjymtyrëve përbërëse të kompozitave emërore përcaktore nga pikëpamja e fjalëformimit, vëmë re se në të dyja gjuhët ato shprehen me fjalë të parme, njëra me fjalë të parme dhe tjetra me fjalë të prejardhur, njëra kompozitë dhe tjetra fjalë e parme si dhe njëra kompozitë dhe tjetra fjalë e prejardhur:

<i>atdhe, syviç</i>	<i>Hausfrau</i>
<i>akthetim</i>	<i>Körperbewegung</i>
<i>ndihmësmjek</i>	<i>Dichtungsform</i>
<i>lulekëmbëpulë</i>	<i>Fingerhandschuh</i>
<i>vajgursjellës</i>	<i>Umstellbahnhof</i>

Në ndryshim nga shqipja, në gjermanishte, gjymtyrët e kompozitës emërore mund të shprehen të dyja me një emër të prejardhur, gjymtyra e parë mund të jetë një emër i përveçëm, por njëra prej tyre mund të jetë edhe një shkurtesë:

Entwicklungsfähigkeit, Handlungsverlauf
Münsterkäse, Mozartkugel
Dampflok, Mathearbeit, NS-Herrschaft

Të dyja gjuhët formojnë kompozita me konfikse. Si në shqipe dhe në gjermanishte këto elemente me burim në latinishte dhe në greqishten e vjetër janë bashkuar si me tema të huaja ashtu dhe me tema të vetë gjuhës, apo me njëra-tjetrën.

<i>biofizikë</i>	<i>Psychoterror</i>
<i>diskotekë</i>	<i>Thermographie</i>
<i>pseudoshkrimtar</i>	<i>Lebensphilosophie</i>

Në ndryshim nga shqipja gjermanishtja zotëron edhe vetë tema të tilla, pikërisht *Schwieger-* (*Schwiegereltern*) dhe *Steif-* (*Stiefvater*).

Lidhur me prodhimtarinë e tipave të kompozitave emërore vihet re se si në shqipe dhe në gjermanishte në vend të parë renditet tipi emër + emër, epërsia e të cilit në prodhimtari në të dyja gjuhët është ndjeshëm më e dukshme se e tipave të tjerë. Në shqipe rreth 30% e kompozitave kanë për gjymtyrë të parë një ndajfolje ose një konfiks, ndërsa në gjermanishte dy tipat pasues më prodhimtarë kanë për gjymtyrë të parë një folje ose një mbiemër. Këto kompozita përbëjnë rreth 15% të gjithë kompozitave emërore.

Kompozitat mbiemërore përcaktore përbëjnë grupin më të madh të kompozitave të gjuhës shqipe, ndërsa në gjermanishte ato klasifikohen të dytat për nga prodhimtaria, por me një diferencë shumë të madhe nga grupi i parë, ai i kompozitave emërore. Në të dyja gjuhët ekziston një numër relativisht i madh tipash, sipas të cilëve formohen këto kompozita.

Bazuar në përkatësinë leksikogramatikore të fjalës me anë të së cilës shprehen gjymtyrët e kompozitave mbiemërore përcaktore në shqipe dhe gjermanishte vihen re disa të përbashkëta. Teksa në të dyja gjuhët gjymtyra e dytë shprehet me një mbiemër, e para mund të shprehet me një emër, një mbiemër tjetër, një ndajfolje, një numëror ose një përemër të pacaktuar:

<i>faqekuq</i>	<i>kupferbraun</i>
<i>gjermanolindor</i>	<i>mittelschwer</i>
<i>jashtëmartesor</i>	<i>wohlanständig</i>
<i>dhjetëjavor</i>	<i>vierdimensional</i>
<i>shumatomik</i>	<i>allmonatlich</i>

Në gjuhën gjermane gjymtyra e parë e këtyre kompozitave mund të shprehet edhe me një mbiemër në shkallën sipërore apo krahasore, fenomen gjuhësor që nuk vërehet te kompozitat mbiemërore të shqipes:

bestbekannt, längerfristig

Ndërsa në shqipe në këtë tip kompozitash merr pjesë si gjymtyrë e parë edhe përemëri vetvetor “*vetë*”, në gjermanishte ajo mund të shprehet edhe me përemrin dëftor “*selbst*” dhe “*dies(er)*”:

vetëmohues
selbstverliebt, diesbezüglich

Në të dyja gjuhët veprojnë tipa të ndryshëm kompozitash mbiemërore. Në shqipe gjymtyra e dytë mund të shprehet edhe me një emër, i cili në këtë rast bashkohet me një emër tjetër (*kokëshkëmb*) dhe përbën tipin e dytë më prodhimtar të këtyre kompozitave, ose dhe me një ndajfolje (*mirëbërës*). Por gjymtyra e dytë mund të jetë edhe një ndajfolje. Në këto raste gjymtyra e parë shprehet me një emër (*kokëjashtë*) ose një folje (*ndjellakeq*). Një tip interesant të kompozitave mbiemërore përbën ai me gjymtyrë të parë të shprehur me një numëror apo përemër të pacaktuar, kryesisht “shumë” dhe një emër i cili përban një formant me burim te rrjedhorja e pashquar e shumësit (*dhjetëkëmbësh, shumëkombësh, gjitharmësh*). Ndërsa në gjermanishte me gjymtyrën e dytë, e cila shprehet gjithnjë me një mbiemër, bashkohen edhe tema foljore, si rrënjë të tyre ashtu edhe forma të paskajores (*trinkfest, sterbenskrank*), si dhe parafjalë (*unterdurchschnittlich*). Një grup të vogël përbëjnë kompozitat mbiemërore të gjermanishtes me gjymtyrë të parë një konfiks. Gjejmë mes tyre edhe pak raste kur këto elemente me burim në latinishte dhe greqishten e vjetër, bashkohen edhe me mbiemra të gjuhës gjermane (*pseudowissenschaftlich*).

Rreth 17% e kompozitave mbiemërore në gjermanishte shprehen me një mbiemër prejpjesor, formuar kryesisht nga pjesorja e së shkuarës (Partizip Perfekt) dhe më pak nga pjesorja e së tashmes (Partizip Präsens), duke formuar të ashtuquajturat “Partizipialkompozita” / kompozitat prejpjesore. Ky tip kompozitash ka për gjymtyrë të parë një emër (*herzbrechend, hausgemacht*), një mbiemër (*freischaffend, schwerbehindert*), një ndajfolje (*rechtsdrehend, wohlgeraten*), një përemër (*vielsagend, selbstverliebt*), një parafjalë (*überqualifiziert, unterprivilegiert*) ose një folje (*lernbehindert, schreibgewandt*).

Edhe në gjuhën shqipe gjymtyra e dytë kompozitave mbiemërore mund të shprehet me një mbiemër prejpjesor, por duhet thënë se ai nuk është aq aktiv sa në gjermanishte. Këto kompozita kanë si gjymtyrë të parë një emër (*buzëplatur, kokëkrisur*), një mbiemër tjetër (*i parëlindur*), një ndajfolje (*i poshtëshënuar, i sipërpërmendur*) ose një përemër (*i shumëpritur, i shumënderuar*), sikurse në gjermanishte, por jo një parafjalë.

Nga përqsja e analizës së strukturës morfologjike të elementeve me të cilat shprehen gjymtyrët e kompozitave mbiemërore në shqipe dhe gjermanishte, arrihet në përfundimin se të dyja gjymtyrët e kompozitave në të dyja gjuhët mund të shprehen me fjalë të parme, me fjalë të prejardhura, njëra gjymtyrë me një fjalë të parme dhe tjetra me një fjalë të prejardhur, e para me një kompozitë dhe e dyta me një fjalë e prejardhur. Tipi i fundit ndeshet rrallë në shqipe.

besëqen
gjumëndjellës
dhembjemadh,
evroplanolindor

aalglat
luftdurchlässig
schwerbehindert
bedienungsfreundlich

Në ndryshim nga shqipja në gjermanishte njëra nga gjymtyrët mund të shprehet me një kompozitë dhe tjetra me një fjalë të parme, si në rastet: *krankenhausreif* apo *pechrabenschwarz*.

Për një tjetër veçanti të gjermanishtes flet edhe fakti se gjymtyra e parë e një kompozite mbiemërore mund të shprehet edhe me një fjalë të përngjitur si në rastin e mbiemrit “*vergissmeinnichtblau*”.

Nga analizmi i kompozitave mbiemërore në shqipe dhe gjermanishte, bie në sy se tipi emër + mbiemër është më prodhimtari në të dyja gjuhët. Në shqipe ky tip pasohet nga tipi emër + emër, i cili është dy herë më pak prodhimtar se i pari. Ky tip nuk vepron në gjermanishte. Është tipi miemër + mbiemër ai që në këtë gjuhë renditet i dyti për nga prodhimtaria, por me një diferencë shumë të madhe më tipin e parë i cili është pesë herë më prodhimtar.

Në të dyja gjuhët kompozimi vepron më pak në formimin e foljeve dhe ndajfoljeve. Në fjalorët përkatës të gjuhëve kompozitat foljore dhe ato ndajfoljore përbëjnë, në shqipe rreth 4%, ndërsa në gjermanishte më pak se 6% të numrit të përgjithshëm të kompozitave.

Si në shqipe dhe në gjermanishte **kompozitat foljore** janë të gjitha kompozita përcaktore. Sa i takon përkatësisë leksikogramatikore të fjalëve me anë të të cilave shprehen gjymtyrët e këtyre kompozitave, vihet re se si në shqipe edhe në gjermanishte gjymtyra e dytë e kompozitës foljore shprehet me një folje, ndërsa e para me një temë ndajfoljore ose emërore:

<i>mirëkuptoj</i>	<i>dableiben</i>
<i>rrethshkruaj</i>	<i>bergsteigen</i>

Por, teksa në shqipe këto janë dy pjesët e vetme të ligjeratës që marrin pjesë në formimin e kompozitave foljore, në gjermanishte gjymtyra e parë mund të shprehet edhe me një mbiemër (*freihalten*) dhe në raste të rralla edhe me një folje (*gefrieretrocknen*)

Si në shqipe edhe në gjermanishte më prodhimtari është tipi i kompozitave foljore formuar nga një ndajfolje dhe një emër. Në të dyja gjuhët 85% e kompozitave foljore janë formuar sipas këtij tipi. Në gjermanishte në vendin e dytë renditet tipi mbiemër + folje prodhimtaria e të cili është rritur shikujt e fundit.

Lidhur me strukturën morfologjike të temave motivuese përmes të cilave shprehen gjymtyrët e kompozitave foljore, vihet re se në të dyja gjuhët gjymtyra e parë e kompozitës shprehet me një fjalë të parme, ndërsa e dyta mund të jetë fjalë e parme ose edhe e prejardhur:

<i>keqkuptoj</i>	<i>weggehen</i>
------------------	-----------------

Por në gjermanishte, ndryshe nga shqipja gjymtyra e parë, më rrallë e dyta, e kompozitave foljore mund të jetë edhe një kompozitë (*hinausbringen, stabhochspringen*).

Akoma më pak vepron kompozimi në formimin e ndajfoljeve të shqipes dhe gjermanishtes, çka dëshmohet edhe nëpërmjet shifrave, sipas të cilave **kompozitat ndajfoljore** përbëjnë 1.7% të gjithë kompozitave të shqipes, ndërsa në gjermanishte kjo shifër është edhe më e vogël, rreth 0.4%. Por pavarësisht këtyre shifrave të ulëta, në të dyja gjuhët ato paraqesin numrin më të madh të modeleve mbi bazën e të cilave ndërtohen kompozitat. Duhet thënë gjithashtu se një tjetër karakteristikë e përbashkët e ndajfoljeve të të dyja gjuhëve lidhet me faktin se ato e kanë origjinën e tyre te përngjitja dhe vonë është pranuar kalimi i tyre nga përngjitja në kompozim, ndaj dhe në shumë raste modelet e krijuara janë pak prodhimtare.

Teksa në gjermanishte gjymtyra e dytë e kompozitës ndajfoljore shprehet ose me një ndajfolje (*dahin*) ose me një element, i cili gjen përdorim ndajfoljor e parafjalor dhe njihet në gjuhësi me termin “Präpositionaladverb” (*darauf*), në gjuhën shqipe ajo veçse me ndajfolje (*ballëllart*) mund të shprehet edhe me një emër (*shpeshherë*) apo folje (në pjesore) (*duarlidhur*).

Kompozitat ndajfoljore të shqipes dhe gjermanishtes kanë vetëm dy tipa të përbashkët. Bëhet fjalë për kompozitat e formuara sipas modelit ndajfolje + ndajfolje, i cili në shqipe nuk është prodhimtar dhe modelit emër + ndajfolje, i cili është i kufizuar në gjermanishte:

gjysmëdjathtas	immerfort
<i>duarplot</i>	<i>bergab</i>

Ndërsa gjymtyra e parë e ndajfoljeve të shqipes shprehet me një folje (*marramendsh*) ose një numëror (*katërlëmsh*), raste këto gjithsesi shumë pak prodhimtare, në gjermanishte ajo shprehet nëpërmjet një parafjale (*durchaus, vorgestern*), ose një mbiemri të cilin e gjejmë edhe në shkallën krahasore (*frühmorgens, weiterhin*).

Lidhur me strukturën morfologjike të gjymtyrëve të kompozitave ndajfoljore mund të thuhet se në të dyja gjuhët ato shprehen me fjalë të parme, ose me një fjalë të parme dhe një të prejardhur:

hëna Brenda	hinweg
<i>sypërmbysur</i>	<i>höchstwahrscheinlich</i>

Në gjuhën shqipe tipi më prodhimtar i kompozitave ndajfoljore formohet nga një emër dhe një ndajfolje duke u ndjekur nga kompozitat e formuara me një emër dhe një pjesore. Ndërsa në gjermanishte shumicën e kompozitave ndajfoljore e përbëjnë të ashtuquajturat “Pronominaladverbien”, të cilat formohen nga ndajfoljet “da(r)”, “hier” dhe “wo” + një Präpositionaladverb.

Si në shqipe edhe në gjermanishte gjymtyrët e kompozitave mund të lidhen me *elemente lidhëse* të cilat në gjermanishte njihen me emrin “*Fugenelemente*”. Në gjermanishten e sotme ato shihen si elemente ortografike, duke mos mbartur as kuptim gramatikor dhe as kuptim semantik. Gjithsesi këto elemente origjinën e kanë te morfemat trajtëformuese dhe kanë mbetur si “*mbaresa eptimi të ngurrosura*”. Edhe në gjuhën shqipe këto elemente kryejnë thjesht një funksion lidhës. Por teksa në gjermanishte ato i gjejmë gati në 30% të kompozitave, duke lidhur kryesisht gjymtyrët e kompozitave përcaktore, në shqipe kompozitat me element lidhës janë të pakta. Ato shfaqen kryesisht te kompozitat këpujore dhe rrallë te ato përcaktore.

Vihet re se elementet lidhëse, me përjashtim të atyre të huazuara, si në shqipe dhe në gjermanishte shfaqet pas atyre gjymtyrëve të para që shprehen me një emër ose një folje:

molladardhë	Kinderarzt
dashakeq	Badeanzug

Në të dyja gjuhët elementet lidhëse shfaqen te kompozitat emërore dhe mbiemërore si dhe te ndonjë ndajfoljore:

peshkaqen	Handlungsfähigkeit
fikaderë	atmungsaktiv
ballafaqe	tagsüber

Në të dyja gjuhët vepron elementi lidhës “o”, të cilin e gjejmë te kompozitat mbiemërore, si dhe në kompozitat me gjymtyrë të parë një konfiks. Ky tip mbiemrash është i huazuar dhe ndeshet më shumë në formime terminologjike:

teknikoshkencor	audiovisuell
Elektromekanikë	Elektromechanik

Një tjetër element lidhës është viza lidhëse, e cila në gjermanisht njihet me emrin “*Bindestrich*”. Ne mendojmë se viza lidhëse duhet të vendoset vetëm atëherë kur nuk ka një element tjetër lidhës dhe lidhja kuptimore mes gjymtyrëve të kompozitës është e dobët (feudal-borgjez)

Në mjaft raste kompozitat mbiemërore këpujore të të dyja gjuhëve i lidhin gjymtyrët e tyre me vizën lidhëse, e cila në gjermanisht shpreh qartë se gjymtyrët janë në raport bashkërenditës me njëra-tjetrën.

kërkimor-shkencor	schwarz-rot-golden
-------------------	--------------------

Në shqipe viza lidhëse bashkon edhe gjymtyrët e kompozitave përcaktore-ndajshimtare (*peshk-shpat*). Edhe në gjermanishte atë e gjejmë edhe në tipa të tjerë kompozitash, si p.sh. kompozitat me gjymtyrë të parë një shkurtesë (*EU-Bürger*), kompozitat me gjymtyrë të parë një gjermë (*x-Achse*) etj.

Gjuha gjermane zotëron më shumë elemente lidhëse sesa shqipja. Në shqipe veç vizës lidhëse dhe elementit “o” vepron edhe elementi lidhës “a” (*bukagjellë*), ndërsa në

gjermanishte **-e-** (*Badeanzug*), **-(e)s-** (*Handelsvertrag, tagesaktuell*), **-(e)n-** (*rentenpflichtig, Soldatenfriedhof*), **-er-** (*Kinderfilm*), **-ens-** (*Namensschild*).

Në pjesën më të madhe të rasteve kuptimi i kompozitave si në shqipe dhe në gjermanishte motivohet nga kuptimi dhe lidhja semantikosintaksore e gjymtyrëve të tyre. Në gjermanishte kjo gjë bëhet më se e dukshme te kompozitat që kanë në përbërje të tyre disa tema motivuese, të cilat mund të kuptohen nëse bëhet zberthimi në gjymtyrët përbërëse dhe temat motivuese:

Hauptschifffahrtsstraße = besonders wichtige Straße, die beim Fahren von Schiffen benutzt wird

Në rastin e kompozitave këpujore, në të dyja gjuhët kuptimi i tyre është pak a shumë i barabartë me shumën e kuptimeve të gjymtyrëve të tyre:

bujqësor-industrial (= bujqësor dhe industrial në të njëjtën kohë)
dummdreist (= dumm und dreist gleichzeitig)

Sa i takon mërrëdhënieve kuptimore mes gjymtyrëve të kompozitave përcaktore, ato janë të lidhura me karakteristikat leksikore dhe semantike të gjymtyrës përcaktuese dhe asaj të përcaktuar. Është shumë e rëndësishme të gjendet gjymtyra përcaktuese dhe ajo e përcaktuar për të realizuar interpretimin e drejtë të kuptimit të kompozitës. Kjo vlen veçanërisht për kompozitat e shqipes, pasi në gjermanishte, gjymtyra e përcaktuar është gjithnjë gjymtyra e dytë. Duke qenë se modelet që qëndrojnë në bazë të formimit të kompozitave në të dyja gjuhët janë të shumta, si dhe karakteristikat semantike të gjymtyrëve të tyre janë të shumëllojshme, është e vështirë të ngrihen modele semantike mbi bazën e të cilave të bëhen më pas klasifikimet e marrëdhënieve semantike të çdo modeli. Gjithsesi nisur nga perifraximi që i bëhet kompozitës në të dyja gjuhët vihet re se ka modele të përbashkëta. Mw poshtw po parashtrajmw disa nw formw shembulli. Si në shqipe dhe në gjermanishte ka kompozita mbiemërore, të cilat emërtojnë tiparin duke i veshur sendit apo vetës që karakterizojnë tiparin e një sendi tjetër:

kokëshkëmb = që e ka kokën si shkëmb
eirund = rund wie ein Ei

kompozita emërore që shprehin përkatësi, pronësi:

atdhe = dheu i atit
Elternhaus = Haus der Eltern

kompozita emërore gjymtyra e parë e të cilave jo vetëm që përcakton të dytën por shërben edhe si objekt veprimi:

orëndreqës = ai që ndreq orën
Handleser = eine Person die die Hand liest

Duhet thënë se në gjermanishte marrëdhëniet dhe lidhjet semantike mes gjymtyrëve janë nga më të ndryshmet, nga kohoret e vendoret deri te përkatësoret.

Por ka raste kur interpretimi i një kompozite bëhet i vështirë, pavarësisht se elementet përbërse janë lehtësisht të kuptueshëm. Vështirësia në këtë rast qëndron në marrëdhëniet e ndryshme semantike që krijojnë gjymtyrët e kompozitës.

Fischfrau = eine Frau die Fisch verkauft oder die Frau des Fisches?

Ndryshe nga shqipja, në gjermanishte temat emërore me të cilat shprehen gjymtyrët përcaktuese, mund të shërbejnë për të zmadhuar, përforcuar apo intensifikuar pozitivisht, ose dhe negativisht kuptimin e shprehur nga gjymtyra e dytë e kompozitës emërore ose mbiemërore:


Riesenerfolg = sehr großer Erfolg
blitzschnell = sehr schnell

Në gjermanishte ka dhe kompozita të cilat janë leksikalizuar dhe zbërthimi i kuptimit të tyre përmes kuptimit të gjymtyrëve është i pamundur, si në rastin e emrit “*Jungfrau*”

VI.4. Fjalët e përngjitura në “Fjalorin e shqipes së sotme”, struktura dhe përbërësit e tyre

Nga analiza që u është bërë fjalëve të përngjitura në “*Fjalorin e shqipes së sotme*”, botim i vitit 2002, vihet re se përngjitja është një mënyrë fjalëformimi që vepron në të gjitha pjesët e ligjeratës. Por ajo nuk duket të jetë dhe aq prodhimtare, pasi fjalët e përngjitura përbëjnë 0.9% të gjithë fjalëve të këtij fjalori. Kjo gjë është më se e kuptueshme duke qenë se fjalët e përngjitura lindin kryesisht si rezultat i përdorimit të gjatë pranë njëra-tjetrës në një togfjalësh apo fjali. Nga 311 fjalët e përngjitura që gjejmë të listuara në fjalor, gati gjysmën e përbëjnë ndajfoljet, 153 të tilla. Më pas vijojnë përemrat e pacaktuar, të cilët përbëjnë 22% të fjalëve të përngjitura të këtij fjalori, si dhe lidhëzat e përngjitura, të cilat nuk e kalojnë shifrën 43. Ndërsa pjesët e tjera të ligjeratës marrë sëbashku përbëjnë 15% të fjalëve të përbëra të shqipes, ku më pak të përfaqësuar janë mbiemri (tre të tillë) dhe folja (tri të tilla). Më poshtë paraqitja grafike e fjalëve të përngjitura të shqipes sipas prodhimtarisë së tyre për çdo pjesë ligjerate:

Ndajfolje	153
Përemra	66
Lidhëza	43
Pasthirrma	9
Numërorë	9
Parafjalë	9
Pjesëza	8
Emra	7
Folje	3
Mbiemra	3
GJITHSEJ	311



VI.4.1. Ndajfoljet e përngjitura

Siç mund të kuptohet edhe nga të dhënat e tabelës dhe grafikut të mësipërm, një pjesë e mirë e ndajfoljeve të gjuhës shqipe janë formuar nga njëfjalëzime fjalësh. Ato kanë në përbërje të tyre e dy ose edhe më shumë elemente. 93 ndajfolje të përngjitura janë dygjymtyrëshe (*ngaherë, sakaq, tjetërkund, aspak* etj.), 53 trigjymtyrëshe (*kurdoherë, anembanë, dosido, drejpdrejtë* etj.) dhe vetëm 7 ndajfolje janë formuar nga përngjitja e

katër elementeve, janë ndajfoljet: *anepërqark, asndonjëherë, ngandonjëherë, përmbipardje, asndonjëherë, sidokudo* dhe *përmbipasnesër*.

Brenda ndajfoljeve të përngjitura dallohen disa tipe stukturore:

Tipi i parë i ndajfoljeve të përngjitura të formuara nga:

përemri *gjithë* + një pjesë tjetër ligjrate

Numërohen 10 ndajfolje të tilla:

gjithë + emër: *gjithherë, gjithkah, gjithmonë*

gjithë + ndajfolje: *gjithandej, gjithaq, gjithashtu, gjithkund, gjithqysh, gjithsesi*

gjithë + përemër i pacaktuar: *gjithnjë*

Tipi i dytë ka në strukturën e tij një folje që mund të dalë si element i parë ose si element i dytë. Si element i dytë del folja *do*, e cila bashkohet me një ndajfolje përemërore pyetëse:

ndajfolje pyetëse + *do*

Numërohen 6 ndajfolje të tilla: *kudo, kurdo, ngado, sado, sido, tekdo*.

Por foljen *do* e gjejmë si element të parë dhe të tretë edhe te disa ndajfolje të përngjitura trigjymtyrëshe: *dokudo, dokurdo, domosdo, dosido*. Në këto raste ajo është bashkuar me ndajfolje përemërore dhe pjesëza. Gjithashtu elementi “*do*” gjendet bashkuar me pjesë të ndryshme ligjrate edhe në ndajfolje të tjera: *herëdokur, kurdoherë, sadopak, sidozot* si dhe në ndajfoljen katërgjymtyrëshe *sidokudo*. Forma e ngurosur *ndo*, e cila e ka origjinën e saj në bashkimin e lidhëzës *në* me formën foljor *do*, bashkohet me formën *kund* të ndajfoljes *ku*, për të formuar ndajfoljen e përngjitur *ndokund*, në të cilën vihet re një rend i përmbysur i gjymtyrëve. Në këtë ndajfolje elementi foljor nuk është në fund të fjalës, sikurse edhe në rastet e ndajfoljeve *ndonjëherë, asndonjëherë* dhe *ngandonjëherë*.

Me rend të përmbysur dhe të bashkuar me ndajfoljen *pak* e gjejmë elementin foljor në ndajfoljen e përngjitur *ndopak*.

Ndërsa folja *di* shfaqet si element i parë, teksa bashkohet edhe ajo me ndajfolje përemërore pyetëse:

di + ndajfolje pyetëse

Në këtë mënyrë janë formuar katër ndajfolje të përngjitura: *diku, dikur, diqysh* dhe *disi*.

Tipi i tretë i ndajfoljeve të përngjitura ka si gjymtyrë të dytë ndajfoljen *ku* në formën *kund* apo *kundi*, ndërsa gjymtyrë e parë mund të jetë një ndajfolje, një përemër ose dhe një pjesëz:

ndajfolje/përemër/pjesëz + *kund/kundi*

Janë 5 ndajfolje të tilla:
ndajfolje + kund: *kurrkund, rrallëkund*
përemër + kund: *gjëkund(i), tjetërkund*
pjesëz + kund: *askund*

Po në këtë grup përfshihen edhe ndajfoljet e tjera disagjymtyrëshe me gjymtyrë të fundit formën *kund/kundi* të ndajfoljes *ku*: *askurrkund, asgjëkundi, hiçgjëkund*

Në **tipin e katërt** të ndajfoljeve gjejmë si element të dytë emrin *herë*, i cili bashkohet me përemra, ndajfolje apo pjesëza për të formuar ndajfolje të përngjitura dygjymtyrëshe edhe trigjymtyrëshe:

përemër/ndajfolje/parafjalë + herë

Janë 7 ndajfolje dygjymtyrëshe të formuara me elementin *herë*:

përemër + *herë*: *atëherë, çdoherë, gjithherë, njëherë*
ndajfolje + *herë*: *shpeshherë, rrallëherë*
parafjalë + *herë*: *përherë, ngaherë*

Emri *herë* është bashkuar edhe me disa elemente, si forma foljore, ndajfolje e lidhëza, për të formuar ndajfolje të përngjitura me më shumë se dy gjymtyrë: *kurdoherë, menjëherë, ndonjëherë, nganjëherë, ngandonjëherë, sakaqherë dhe asnjëherë*. Në të gjitha rastet ai është gjymtyra e fundit e fjalës së përngjitur. Vetëm në një ndajfolje emri *herë* shfaqet si element i parë, në rastin e ndajfoljes *herëdokur*.

Nga njëfjalëzimi i përemrit të pacaktuar *një* dhe emrave *lloj* e *mend* janë formuar ndajfoljet *njëlloj* dhe *njëmend*.

Tipin e pestë e përbëjnë ndajfoljet e përngjitura formuar nga një parafjalë dhe një emër në trajtë të pashquar, i cili është në formë të ngurosur bashkë me mbaresën rasore, si në rastin e ndajfoljes *parasysh*:

parafjalë + emër

Numërohen 24 ndajfolje të tilla:³⁷⁶

ngaditë, ndoresh, ndërkohë, paradite, paradreke, parasysh, pasdarke, pasdreke, pasdite, përballë, përberi, përdhe, përditë, përfaqe, përfund, përgjysmë, përherë, përjetë, përkrah, përmes, përnatë, përqark, përreth, përskaj, përtokë

Edhe pse formime të tipit *për + emër* “nga pikëpamja e sotme shkojnë drejt formimeve *parashtesore dhe mund të trajtohen si të tilla*”³⁷⁷, ne mendojmë se ato duhen parë si

³⁷⁶ Ndonjë ndajfolje mund të shfaqet në disa tipe për shkak të elementeve përbërëse, siç ndodh në këtë rast me ndajfoljen *përherë* të cilën e pamë edhe te tipi i katërt, kur u morën në shqyrtim ndajfoljet e përngjitura me gjymtyrë të dytë emrin *herë*.

ndajfolje formuar me përngjitje, pasi elementi *për* i ka ende të forta lidhjet me parafjalën dhe rruga e vërtetë e formimeve të tilla është përngjitja. Parafjala duke u përdorur para një emri është bashkuar me të në një njësi të vetme të re leksikogramatikore. Nuk kemi të bëjmë më me emra por me ndajfolje. Ndaj dhe këto formime motivohen si të formuara me përngjitje. Në këto raste “...parafjala, duke u përdorur shpesh pranë emrave u ngjiz me to dhe formoi një njësi të re leksikore.”³⁷⁸ Mendojmë se kemi të bëjmë me formime mjaft të rëndësishme, të cilat jo vetëm që hedhin dritë mbi vështirësitë e përcaktimit të kufijve të prerë mes përngjitjes dhe parashtesimit, por flasin dhe për rastet e kalimit nga njëra mënyrë fjalëformimi në tjetrën.

Gjithashtu i bashkohemi qëndrimin të Hysës sa i takon ndajfoljeve *përgjithmonë, përgjithnjë, përmatanë, përngaherë, përnjëherë, përnjëmend, përplot, përndryshe, përpara, përtej, përposhtë, përbrenda, përkëtej, përjashtë, përkundrejt* dhe *përsipër*, të cilat parashtesa me origjinë parafjalore *për-* është bashkuar me ndajfolje për të formuar ndajfolje të reja, por pa u dhënë atyre ndonjë vlerë të re kuptimore të ndryshme nga ajo e para, por thjesht një kuptim më intensiv.³⁷⁹ Për këtë arsye ato nuk janë pjesë e këtij korpusi.

matanë – në anën tjetër të diçkaje, përtej diçkaje (Fjalori i shqipes së sotme, botim i vitit 2002, f.738)

përmatanë – në anën e përtejme, *matanë* (Fjalori i shqipes së sotme, botim i vitit 2002, f.981)

Tipi i gjashtë i ndajfoljeve të përngjitura përbëhet nga ndajfolje të cilat si element të parë kanë përemrin *ai* ose *ky* në rasën rrjedhore e kallëzore, ndërsa element të dytë kanë një emër:

ai/ky + emër

Si të tillë në “Fjalorin e shqipes së sotme”, botim i vitit 2002, gjejmë 7 ndajfolje: *asokohe, asohere, atëbotë, atëherë, atëkohë, kësisoj dhe kësodore*

Tipi i shtatë përbëhet nga tri ndajfolje, të cilat janë formuar nga forma e ngurosur *akë*-dhe një ndajfolje:

akë + ndajfolje

akëku, akëqysh, akëseku

³⁷⁷ E. Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II*, Tiranë, 1975, f. 69

³⁷⁸ E. Hysa, Formimi i ndajfoljeve, në: *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, I*, Tiranë, 1972, f. 294

³⁷⁹ E. Hysa, Formimet me parashtesën *për-* në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II*, Tiranë, 1975, f. 91; E. Hysa, Formimi i ndajfoljeve, në: *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, I*, Tiranë, 1972, f. 293

Tipin e tetë të ndajfoljeve të përngjitura e përbëjnë ndajfoljet e formuara nga përngjitja e togut element trajtëformues dhe pjesore:

pa + pjesore

Ndajfolje të tilla gjejmë vetëm 5 në “Fjalorin e shqipes së sotme”, botim i vitit 2002.
padashur, pakujtuar, pandërprerë, papandehur dhe papritur

Në **tipin e nëntë** do të klasifikojmë ndajfoljet e formuara nga dy ndajfolje të tjera:

ndajfolje + ndajfolje

andepari, këtejpari, këtupari, atypari, paksëpaku, tekandej

Ndajfolje formohen edhe nga pjesëza mohuese *as* dhe një ndajfolje tjetër, të cilat i japin kuptim mohues ndajfoljeve të formuara: *aspak, askund, askurrë* dhe *asfare*

Vihet re se jo të gjitha ndajfoljet mund të ndahen në tipe sipas strukturës së formimit të tyre, pasi disa janë formime të një lloji. Një grup interesant përbëjnë ndajfoljet e formuara nga përngjitja e një togu me element të parë dhe të tretë të njëjtën fjalë e cila mund të jetë një emër (*anëpëranë, tehemteh*), numëror (*njëpërnjë, njëmenjë*) apo ndajfolje (*brendapërbrenda, hëpërhë, prapëseprapë, tejetej*). Elementi tjetër është një parafjalë ose një lidhëz.

Më përngjitje janë formuar edhe ndajfoljet:

pardje, pasnesër dhe *përmbipardje* janë formuar nga togu parafjalë + ndajfolje, ndajfolja e ka dy elemente të shprehura me parafjalë dhe elementin e fundit ndajfolje
anekënd, aneqark dhe *anepërqark* formuar nga togu emër + lidhëz + emër
anembanë formuar nga togu emër + lidhëz + ndajfolje
tejefund formuar nga togu ndajfolje + lidhëz + emër
tejembanë formuar nga njëfjalëzimi i togut ndajfolje + lidhëz + ndajfolje
tejendanë formuar nga njëfjalëzimi i togut *tej e në anë*
tekefundit formuar nga njëfjalëzimi i togut parafjalë + mbiemër i emëruar
matanë formuar nga njëfjalëzimi i togut *më atë anë*
mënjane formuar nga njëfjalëzimi i togut *më një anë*.

Gjymtyrët e një togfjalëshi apo elementet e një grupi fjalësh, të cilat njëfjalëzohen duke u shkruirë në një njësi të vetme, kryesisht si rezultat i përdorimit të tyre për një kohë të gjatë pranë njëra-tjetrës, i ruajnë zakonisht lidhjet sintaksore mes tyre edhe në strukturën e fjalës së re të formuar. Edhe kuptimi i fjalës së re të formuar në disa raste mund të nxirret qartë nga kuptimi i gjymtyrëve përbërëse siç ndodh me një pjesë të mirë të ndajfoljeve të shqyrtuara më lart, si p.sh.: ndajfoljet e tipit *çdoherë, paradite, pardje* etj. Por në disa

raste kuptimi i fjalës së përngjitur mund t'i humbasë me kohë kuptimet e elementëve që e përbëjnë, ose format e ngurtësuara janë të tilla që e bëjnë të vështirë zbërthimin e fjalës në përbërësit e saj, si në rastin e ndajfoljes *matanë*, apo *ditemdrekë* kuptimi i të cilës është i vështirë të nxirret vetëm duke e zbërthyer atë në elementet përbërëse: *dit e m(ë) drake*, ndërkohë që kuptimi i kësaj ndajfoljeje është “*shumë vonë*”

VI.4.2. Përemrat e përngjitur

Përemri i pacaktuar tregon sende ose frymorë në mënyrë të pacaktuar, ose edhe sasi të pacaktuar të tyre. Pjesa më e madhe e përemrave të pacaktuar të gjuhës shqipe është formuar me përngjitje.³⁸⁰ Në “Fjalorin e shqipes së sotme” numërohen 66 përemra të përngjitur të këtij lloji, të cilët në pjesën dërrmuese të tyre janë dygjymtyrësh, vetëm disa janë trigjymtyrësh si *pakundshoq*, *hiçgjëkafshë*, *hiçgjësend*, *hiçmosgjë* e ndonjë tjetër. Dallohen disa tipa strukturorë kryesorë përemrash të përngjitur:

Tipi i parë përbëhet nga përemra të pacaktuar të formuar me elementin foljor *do*, i cili në këto formime paraqitet i ngurosur. Elementi i ngurosur përbën gjymtyrën e dytë të përemrit të përngjitur, ndërsa si gjymtyrë të parë gjejmë një përemër tjetër:

përemër + -do

Katër janë përemra të tillë: *cilido*, *çdo*, *çfarëdo* dhe *kushdo*

Këtij tipi i bashkangjiten edhe: *çdofarë*, *çdokush*, *çdolloy*, *çdonjeri* dhe *çfarëdolloy*, të cilët në përbërje të tyre kanë përemrin e pacaktuar *çdo* dhe *çfarëdo* dhe një përemër pyetës apo një emër.

Vetëm në një rast elementi i ngurosur i bashkangjitet përemrit *kushdo* duke formuar përemrin *dokushdo*. Në këtë rast gjymtyra e ngurosur *do* thjesht përforcon kuptimin e përemrit *kushdo*, pa sjellë ndryshime kuptimore për përemrin e ri.

Tipi i dytë i përemrave të pacaktuar të përngjitur është formuar nga një tjetër formë foljore e ngurosur, nga elementi *di-*, i cili përbën dhe gjymtyrën e parë të përemrit të përngjitur, dhe nga një përemër tjetër:

di- + përemër

Janë katër përemra të pacaktuar të përngjitur formuar sipas këtij tipi: *diç*, *diçka*, *dikush*, *disa*

Tipi i tretë përbëhet nga përemrat e pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur *ndo-*, i cili e ka burimin e tij te lidhëza nënrenditëse kushtore *në*, në formën *n-*, dhe forma *do* e

³⁸⁰ Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002, f.250-251

foljes *dua*. Ky element i ngurosur përbën gjymtyrën e parë të përemrave të përngjitur dygjymtyrësh, ndërsa elementi i dytë është një përemër tjetër:

ndo- + përemër

Katër janë përemrat e këtij tipi: *ndokush, ndonjë, ndonjëri dhe ndopak*.

Përemra të pacaktuar janë formuar edhe nga forma e ngurosur *akë-*, e cila nuk ekziston jashtë fjalëve të përngjitura që formon. Ky element i ngurosur bashkohet me përmra duke formuar **tipin e katërt** të përemrave të pacaktuar të formuar me përngjitje:

akë- + përemër

Janë katër përemrat e këtij tipi: *akëcili, akëkush, akësekush dhe akësecili*.

Tipin e pestë të përemrave të pacaktuar të përngjitur e përbëjnë ata që janë formuar nga elementi i ngurosur *as*, i cili e ka burimin te pjesëza mohuese *as* dhe përbën gjymtyrën e parë të përemrit, si dhe një përemër tjetër:

as- + përemër

Ky përbën dhe një nga tipat më të gjerë të përmrave të pacaktuar të përngjitur, duke përfshirë 13 të tillë, dy- dhe trigjymtyrësh. Elementi *as* bën që këta përemra të kenë kuptim mohues ose përjashtues.

asgjë, askush, asnjë, asnjëri, asgjëkafshë, asgjësendi, askurrgjë, askurrkush, asndonjë, asndonjëri, asnjëfarë, askurrfarë, asfarëgjë

Tipi i gjashtë i përemrave të pacaktuar të përngjitur përfshin gjithashtu një numër jo të vogël përemrash. Ato janë formuar nga bashkimi i elementëve *gjithë-*³⁸¹, *tjetër-* ose *shumë-* si element të parë të fjalës së përngjitur, të cilët e kanë prejardhjen të përemrat e pacaktuar përkatës. Si element të dytë kanë një përemër tjetër:

gjithë-/tjetër-/shumë- + përemër

gjithçka, gjithëfarë, gjithkush, gjithsecili, gjithsekush, gjithmbarë, gjithçmos, tjetërkush, shumëkush

Dy përemrat e pacaktuar *gjithëfarëlloj e gjithëfarsoj* e kanë origjinën në togjet *gjithë farë lloj dhe gjithë farë soj*, elementet e fundit të të cilëve janë emra.

³⁸¹ Elementi *gjithë-* është dhe më prodhimtari, ndërkohë në nga dy elementet e tjetë janë formuar vetëm dy përemra të pacaktuar.

Përemra të pacaktuar janë formuar edhe nga përngjitja e elementit të ngurosor *se*, i cili e ka burimin te pjesëza *se* dhe një përemër. Tre përemra të pacaktuar formuar sipas kësaj strukture përbëjnë dhe **tipin e shtatë** të përemrave të përngjitur:

se- + përemër

seç, secili dhe *sekush*

Tipi i tetë i përemrave të përngjitur është formuar nga elementi i ngurosor *kurr-*, që e ka burimin te ndajfolja *kurrë* dhe një përemër:

kurr- + përemër

Tre janë përemrat e këtij tipi: *kurrkush, kurrfarë* dhe *kurrgjë*.

Një tip të veçantë përbëjnë përemrat *farëgjëje* (emri i dytë në rrjedhoren e ngurosor), *farësendi, gjëkafshë* dhe *gjësendi* formuar nga dy emra, rasti i fundit nga dy emra sinonimë.

Përemrat *hiçgjë, hiçasgjë, hiçgjësendi, hiçgjëkafshë* dhe *hiçmosgjë* kanë si element të parë përemrin *hiç-*, ndërsa elementet e tjerë janë përemra a emra.

Formime të veçanta janë edhe përemrat:

njëfarë (nga përemri *një* dhe emri *farë*)

pakkush (nga përemrat e pacaktuar *pak* dhe *kush*)

rrallëkush (nga ndajfolja *rrallë* dhe përemri *kush*)

sikush (nga lidhëza *si* dhe përemri *kush*)

pakundshoq (nga pjesëza mohuese *pa*, forma e ngurosor *kund* e ndajfoljes “ku” dhe forma e ngurosor *shoq* e emrit “shok”)

Duke analizuar ndërtimin strukturor të përemrave të pacaktuar të përngjitur vëmë re se ato në pjesën dërrmuese të tyre përbëhen nga një element i ngurosor, i cili me përjashtim të elementeve *as-* dhe *kurr-*, që e kanë burimin, e para në pjesëzën mohuese *as* dhe e dyta te ndajfolja *kurrë*, të dyja me kuptim mohues, është i çsemantizuar. Është gjymtyra tjetër ajo që e ruan më qartë kuptimin leksikor. Kështu, p.sh. përemrat e pacaktuar *askush, asnjë, asnjeri, asgjë, kurrgjë, hiçgjë, hiçmosgjë* e përemra të tjerë të këtyre tipave, përjashtojnë një frymor apo një send të pacaktuar. Frymori apo sendi i pacaktuar shprehet përmes elementit të dytë, ndërsa elementi i parë, duke mbartur një kuptim mohues (*as, kurrë, hiç*) i jep kuptim përjashtues fjalës së përngjitur. Kuptimet e elementeve përbërëse ruhen deri diku te përemrat e tipit *tjetërkush, gjithkush, njëfarëlloj*. Por të çsemantizuara duket të jenë ato në rastet e përemrave, si p.sh.: *çdo, çfarëdo, secili sekush* etj.

VI.4.3. Lidhëzat e përngjitura

Në “Fjalorin e shqipes së sotme” ndodhen 47 lidhëza të cilat janë formuara me përngjitje nga dy ose edhe tri elemente. Lidhëzat e përngjitura me dy elemente përbejnë gati 65% të grupit të lidhëzave të formuara me përngjitje.

Duke iu referuar strukturës së lidhëzave të përngjitura dallojmë tre tipa kryesorë. Dy tipat e parë, njërin nga elementet përbërëse e kanë lidhëz, ndërsa tipi i tretë përfshin lidhëza të formuara pa pjesëmarrjen e ndonjë lidhëze.

Tipi i parë i lidhëzave të përngjitura ka për element të dytë një lidhëz të thjeshtë, ndërsa si element të parë mund të ketë:

- a) një lidhëz tjetër: *kurse, nëse, po(r)sa, pors, porse, saqë, sesa, teksa, tekqë, veçse, veçqë;*
- b) një parafjalë: *mbasi, meqë, ngaqë, ngase, ndërsa, përveçqë, përveçse;*
- c) një parafjalë + një përemër: *megjithëse, megjithëqë;*
- d) një pjesëz: *derisa, gjersa;*
- e) një ndajfolje: *mirëpo;*
- f) një formë foljore: *meqenëse, meqenëqë;*

Me përngjitje nga lidhëza e lokucione lidhëzore janë formuar edhe lidhëzat trigjymtyrëshe *posikur, sikurse, qëkurse* dhe *ndonëse*.

Tipi i dytë i lidhëzave të përngjitura ka një numër të kufizuar lidhëzash, të cilat si gjymtyrë të parë kanë një lidhëz, ndërsa si të dytë mund të kenë:

- a) një përemër: *siç, sepse;*
- b) trajtë foljore: *ndo* (në + do)
- c) një ndajfolje: *sikundër*

Nga përngjitja e lokucionit lidhëzor *sikundër që* dhe *sikundër se* janë formuar edhe lidhëzat përkatëse *sikundërqë* dhe *sikundërse*.

Tipi i tretë i lidhëzave të përngjitura nuk ka në përbërje të tij asnjë element lidhëzor. Të tilla kemi lidhëzat:

- megjithatë* (formuar nga përngjitja e parafjalës *me* dhe përemrit të pacaktuar *gjithë me* përemrin dëftor *atë*)
- megjithëkëtë* (formuar nga përngjitja e parafjalës *me* dhe përemrit të pacaktuar *gjithë me* përemrin dëftor *këtë*)
- gjithsaherë* (formuar nga përngjitja e përemrit të pacaktuar *gjithë me* përemrin pyetës *sa* dhe emrin *herë*)
- domethënë* (formuar nga përngjitja e formës foljore të ngurosur *do me thënë*)
- asgjëmangët* (formuar nga përngjitja e përemrit të pacaktuar *asgjë* dhe formës së ngurosur *mangut me burim nga ndajfolja mangët*)

Duke pasur parasysh se disa lidheza të përngjitura janë formuar si pasojë e përngjitjes së një lokucioni lidhëzor, mendojmë se këtë prirje e kanë edhe lokucione të tjera lidhëzore, ndoshta për analogji me lidhëza të krijuara tashmë.³⁸² Kështu, jo vetëm në forume në faqe të ndryshme internet, por edhe në gazeta elektronike dhe faqe elektronike lajmesh, ndeshim lokucionin lidhëzor *duke qenë se* të shkruar si një fjalë e vetme, si një fjalë të përngjitur:

“Gjithsesi *dukeqenëse* materialet nuk ishin të gjitha gati, Fieri është shtyrë sërish me një ditë” marrë nga gazeta Shekulli³⁸³

“Sipas zëdhënësve të bordit turistik të Neë Yorkut, megjithse qyteti është një destinacion i mirë për turizmin e biznesit, përsëri numri i udhëtareve të huaj që qëndrojnë në hotelet e vendit ka rënë ndjeshëm në krahasim me vitet e kaluara, *dukeqenëse* shumica e tyre nuk duan të shpenzojnë më shumë para për qëndrimin.”³⁸⁴

Kjo ndoshta ndikuar nga lidhëza “*meqenëse*”.

Edhe në më shumë shkrime gjejmë lokucionin lidhëzor “qysh se” të njëfjalëzuar. Më poshte disa prej tyre:

“*Qyshse* nisën shkrimet, të gjithë njerëzit e shkrimeve, të të gjitha vendeve, edhe ata të kombeve të tjerë të ardhur në këto anë, pohuan vetëm atë çka pat thënë Zoti.” - gazeta “55”, dt. 24.11.2012

“Ne mes te Europes ne kushtet kur Shqiperia duhet te shkoje perpara kur sapo kemi humbur trenin me te rendesishem ne rrugen e integrimit *qyshse* kemi filluar apo rifilluar kete rruge pas shembjes se shtetit ne vitin 1997...” - “Neës of Albania”, dt. 26.11.2010

“Në Evropën Qendrore që është shtëpia e saj *qyshse* mërgoi si opozitare e regjimit të Llukashenkos, Svetllanën e vlerësojnë për dinjitetin njerëzor të shkrimeve të saj.” – gazeta “Shekulli”, dt. 07.12.2011

³⁸² Përngjitja analogjike njihet dhe pranohet nga gjuhëtarët. L. Buxheli në punimin e saj “*Rreth fjalëve të përngjitura në gjuhën e sotme shqipe*”, botuar në SF4, 1986, f.58, citon nga “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe” (1976): “edhe në fjalët e përngjitura ka formime analogjike, që bëhen sipas një modeli, p.sh. nuk duhet menduar që për secilën nga fjalët *kushdo, cilido, ngado, kudo, kurdo, tekdo, sado, çfarëdo* ka ekzistuar një togfjalësh që me kohë u shndërrua në një fjalë;...”

³⁸³ Shiko: <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/271160/titulli/Kutite-e-Fierit-shtyhen-per-neser-KQZ-perfshihet-nga-debatet>

³⁸⁴ Shiko: http://www.radiotravel.al/index.php?option=com_content&view=article&id=13476&catid=47

VI.4.4. Të tjera pjesë ligjerate të përngjitura në “Fjalorin e shqipes së sotme”

15% të fjalëve të përbëra të “Fjalorit të shqipes së sotme” e përbëjnë pasthirrat, parafjalët, numërorët, pjesëzat, emrat, foljet dhe një mbiemër. Përngjitja si mënyrë fjalëfomimi duket të veprojë më pak te pjesët e ndyshueshme të ligjeratës, emri, folja dhe mbiemri, duke formuar respektivisht nga gjashtë, tri dhe një fjalë.

VI.4.4.1. Pasthirrat e përngjitura

Në gjuhën shqipe numërohen 9 pasthirra të formuara “nga njëfjalëzime fjalësh, me përngjite të gjymtyrëve të një fjalie, të plotë a mungesore, për shkak të përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm si formula stereotipe urimi a përshëndetjeje.”³⁸⁵

Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë pasthirrat e përngjitura si më poshtë vijon:

faleminderit, falëmeshëndet, lamtumirë, mirupafshim, mirmëngjes, mirëdita, mirëmbërma, tumirëmbëç dhe tungjatjeta

Pavarësisht ndryshimeve fonetike, lidhjet sintaksore mes gjymtyrëve të fjalive apo togfjalëshave nga vijnë këto fjalë, ruhen deri diku të qarta në strukturën e tyre. Kështu, p.sh. në pasthirmën *tungjatjeta* është e qartë fjalia dëshirore “t’u ngjattë jeta”, nga e cila ka marrë formë. Po kështu edhe *faleminderit* nga togu “falem nderit”. Por, ndonëse gjymtyrët përbërëse të këtyre fjalëve të përngjitura nuk e kanë humbur krejtësisht kuptimin leksikor, ato kanë formuar një fjalë të re, si nga pikëpamja leksikore ashtu edhe nga ajo fonetikomorfologjike. Ato si pjesë të pandryshueshme ligjerate nuk kanë paradigmë dhe kanë vlerë thirrmore, përdoren me ngjyrim emocionues dhe shprehin përshëndetje a mirënjohje.

VI.4.4.2. Numërorët e përngjitur

Në gjuhën shqipe numërorët janë fjalë të thjeshta, të përbëra, të përngjitura dhe lokucione. Të përngjitur janë vetëm nëntë numërorë:

njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, katërmëdhjetë, pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë

Këta numërorë emërtojnë numra dyshifrorë sipas strukturës:

shifrën e njësheve + elementin e ngurtësuar *mbë* (që e ka origjinën te parafjala *mbi*) + shifrën e dhjetësheve

³⁸⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002, f.431

VI.4.4.3. Parafjalët e përngjitura

Parafjalët e përngjitura që gjenden në “Fjalorin e shqipes së sotme” janë nëntë³⁸⁶:

nëpër, nëpërmjet, nëpërmes, ndërmjet, përgjatë, përmbi, përmbas, përveç, simbas, sipas

Sipas elementeve përbërëse dallojmë tre tipa strukturorë parafjalësh të përngjitura:

Tipi i parë përbëhet nga parafjalët e formuara nga përngjitja e dy parafjalëve, si:

nëpër, përmbi, përmbas, përgjatë dhe përveç

Tipi i dytë përbëhet vetëm nga dy parafjalë të cilat janë formuar nga përngjitja e lidhëzës si dhe parafjalës *pas* e *mbas*:

sipas dhe simbas

Në **tipin e tretë** bëjnë pjesë parafjalët e formuara nga përngjitja e një parafjale me një emër:

nëpërmjet (nëpër + mjet)

nëpërmes (nëpër + mes)

Parafjalët e përngjitura kanë një kuptim leksikor dhe më konkret sesa parafjalët e thjeshta. Ky kuptim del zakonisht nga togu nga ka dalë parafjala, veçanërisht në rastet kur kanë element një fjalë emërtuese siç ndodh me parafjalët e tipit të tretë.

VI.4.4.4. Pjesëzat e përngjitura

Edhe numri i pjesëzave formuar “nga bashkimi në një fjalë të vetme i dy ose më shumë fjalëve për shkak të përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm të tyre pranë njëra-tjetrës”³⁸⁷ është i vogël:

<i>pale:</i>	formuar nga pjesëza <i>pa</i> dhe folja <i>le</i>
<i>posi:</i>	formuar nga pjesëza <i>po</i> dhe ndajfolja <i>si</i>
<i>thujajse:</i>	formuar nga folja <i>thujaj</i> dhe lidhëza <i>se</i>
<i>pothujajse:</i>	formuar nga forma foljore <i>po thujaj</i> dhe lidhëza <i>se</i>
<i>aspo:</i>	formuar nga lidhëza <i>as</i> dhe pjesëza <i>po</i>
<i>sidomos:</i>	formuar nga ndajfolja <i>si</i> , folja <i>do</i> dhe pjesëza <i>mos</i>
<i>kushedi:</i>	kjo pjesëz është formuar nga njëfjalëzimi i një fjalie të tërë “ <i>kush e di</i> ”

³⁸⁶ Këtu nuk janë marrë parasysh parafjalët e formuara me konversion nga ndajfolje të përngjitura

³⁸⁷ E. Angoni, Pjesëzat, në: *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme I*, Tiranë, 1972, f. 311

Kur formojnë pjesëzat, elementët e zbehin kuptimin e tyre por nuk e humbasin krejtësisht atë, veçanërisht ato foljorë. Kjo vlen veçanërisht për pjesëzën *kushedi* e cila i ka ende të forta lidhjet me fjalinë nga ka dalë.

VI.4.4.5. Emrat e përngjitur

Numri i emrave të formuar me përngjitje është shumë i kufizuar. Në “Fjalorin e shqipes së sotme” gjejmë shtatë emra të përbërë dhe kjo është e kuptueshme pasi emri është një pjesë ligjerate e cila zgjerohet përmes ndajshitesimit dhe kompozimit. Përngjitja vepron mbi bazën e një përdorimi të gjatë të fjalëve në togfjalësha a fjali. Kështu janë formuar emrat:

gjëgjëzë, thashetheme, ecejak, farefis, mirëseardhje, shtojzovalle dhe shtojzorreshat

Edhe pse togfjalëshi apo fjalia nga e kanë burimin këta emra të përngjitur është leksikalizuar duke formuar këta emra, lidhjet sintaksore mes gjymtyrëve të togfjalësit apo fjalive ruhen deri diku të qarta edhe te emri i ri, edhe pse ndonjëra prej tyre mund të ketë pësuar ndryshime fonetike. Ruajta e këtyre marrëdhënieve bën që këta emra të jenë të motivueshëm edhe nga pozitat e shqipes së sotme.

Katër emrat e parë janë formuar nga togfjalësha me gjymtyrë dy emra ose folje dhe lidhëza “e”. Emri mirëseardhje e ka origjinën në togfjalëshin “*mirë se ardhët*”, ndërsa dy emrat e fundit janë formuar nga fjalitë urdhërorë që shprehin urim:

shtojzovallet - Shtoju **o** zot vallet!
shtozorradhët - Shtoju **o** zot rradhët!

Siç mund të vihet re të gjymtyrët e të dy emrave kanë pësuar ndryshime fonetike.

VI.4.4.6. Foljet e përngjitura

Edhe numri i foljeve të përngjitura është shumë i kufizuar. Si të tilla gjejmë vetëm tri në “Fjalorin e shqipes së sotme”:

bëzaj, formuar nga togfjalëshi *bëj za*; *vërej*, formuar nga togfjalëshi *vë re*, të dy togfjalësha folje + emër, dhe folja *përsëdy* formuar nga togfjalëshi parafjalor *për së dyti*. Këto folje janë lehtësisht të motivueshme nga këta togfjalësh, pasi dhe kuptimi i tyre del qartë nga kuptimi i këtyre togfjalëshave.

Në “Gramatikën e gjuhës shqipe, 1”, botim i vitit 2002, si folje të formuara me përngjitje interpretohen edhe foljet e tipit *përkrah* e *përshat* nga “*për krah*” dhe “*për shtat*”. Për këtë çështje është mbajtur qëndrim në faqen 8 të këtij punimi.

VI.4.4.7. Mbiemrat e përngjitur

Janë tre mbiemrat e përngjitur në “Fjalorin e shqipes së sotme”. Bëhet fjalë për mbiemrin *kuqez* formuar nga njëfjalëzimi i togfjalëshit “*kuq e zi*”, i cili mendojmë se duhet të ketë lidhje me ngjyrat e flamurit kombëtar. Ndërsa dy mbiemrat e tjerë, *mosmëprek* dhe *mosmëharro*, janë formuar nga njëfjalëzimi i fjalive përkatëse “Mos më prek!” dhe “Mos më harro!” me të cilat janë dhe lehtësisht të motivueshme. Këto dy mbiemra emërtojnë lule.


VI.5. Fjalët e përngjitura në “Deutsches Universalwörterbuch”

Përngjitja në gjermanishte shihet si një mënyrë fjalëformimi “*aktiv, aber unproduktiv / që vepron por nuk është prodhimtare*”³⁸⁸. Për këtë gjë dëshmon edhe fakti se numri i fjalëve të përngjitura që ndodhen në “*Deutsches Universalwörterbuch*” nuk e arrin shifrën 200, një shifër kjo e pallogaritshme krahasuar me numrin në total të fjalëve që përmban ky fjalor. Vërehet se përngjitja nuk vepron në çdo pjesë ligjrate. Numrin më të madh të fjalëve të përngjitura e gjejmë te ndajfoljet, të cilat përbëjnë dhe gjysmën e fjalëve të përngjitura, ndjekur nga 40 emra të përngjitur, ndërkohë që parafjalët, lidhëzat, përemrat, mbiemrat, pasthirrat dhe pjesëzat, të gjitha bashkë, përbëjnë 26% të fjalëve të përngjitura.

Ndajfolje	109
Emra	40
Parafjalë	16
Lidhëza	12
Përemra	13
Mbiemra	2
Pasthirra	2
Pjesëza	1
GJITHSEJ	194

Më poshtë paraqitja grafike e fjalëve të përngjitura të gjermanishtes sipas prodhimtarisë së tyre:

³⁸⁸ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f.439



VI.5.1. Ndajfoljet e përngjitura

Siç vihet re edhe nga grafiku i mësipërm, ndajfoljet e përngjitura përbëjnë grupin më të madh të fjalëve të përngjitura në gjermanishte. Këto ndajfolje do të ishin edhe më shumë, por një pjesë e madhe e ndajfoljeve që e kanë burimin te përngjitja³⁸⁹, kanë krijuar modele duke kaluar në formime me përbërje dhe sot shqyrtohen si kompozita.³⁹⁰ Këto ndajfolje e kanë burimin e tyre në togfjalësha emërorë e parafjalorë, por jo vetëm, siç do të shihet dhe më poshtë. Në pjesën më të madhe të rasteve gjymtyrët e togfjalëshave nga e kanë origjinën ndajfoljet e përngjitura, janë çsemantizuar dhe fjala e re ka fituar një kuptim të ri. Ato janë kryesisht ndajfolje të përngjitura dygjymtyrëshe por ka edhe ndajfolje të përngjitura me më shumë elemente.

Duke u bazur në strukturën e togfjalëshave nga kanë dalë ndajfoljet e përngjitura dallojmë disa tipa.

Tipi i parë është formuar nga njëfjalëzimi i togfjalëshit:

përemër + emër

dhe përbëhet nga 22 ndajfolje:

³⁸⁹ M. Lohde Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr- und Übungsbuch, Tübingen, 2006, f 288

³⁹⁰ Qëndrime që i gjejmë te Duden, Fleicher-i/Barz-i, Erben-i, Lohde, Donalies-i, Eisenberg-u etj.

derart, allerart, dergestalt, solchergestalt, solcherart, solchergestalt, derzeit, jederzeit, seinerzeit, diesmal, anderentags, allerorten, allerwegen, allezeit, manchmal, jedesmal, allemal, jedermann, vielerorten, jedenfalls, keinesfalls dhe *keineswegs*

Si gjymtyrë e parë e këtyre ndajfoljeve të përngjitura marrin pjesë përemra të pacaktuar, dëftor dhe pronorë në forma të ngurosura sikurse edhe emrat, disa prej të cilëve i kanë të ngurosur treguesit gramatikorë.

Tipi i dytë është formuar nga njëfjalëzimi i togfjalëshit me gjymtyrë mbiemërore dhe emërore:

mbiemër + emër

Ky tip është shumë i kufizuar. Përbëhet nga 4 ndajfolje, nga ndajfolja *heutigentags, lauthals mittlerweile* (forma e ngurosur e shkallës krahasore të mbiemrit *mittel* dhe emri *Weile*) dhe ndajfolja *kurzerhand* (forma e ngurosur e shkallës krahasore të mbiemrit *kurz* dhe emri *Hand*). Të dyja me kuptim krejtësisht të semantizuar.

Tipi i tretë është nga më prodhimtarët. Ndajfoljet e këtij tipi janë formuar nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi emëror me parafjalë sipas strukturës:

parafjalë + emër

beiseite, beizeiten außerstande, überhaupt, unterflur, zuhauf, zumal, zuschanden, zumal, zutage, zuteil, zuwege, zuweilen, vonstatten (= von der Stelle), *bisweilen, überhaupt, zugrunde, zulande, zuzeiten*

Disa prej tyre kanë ruajtur formën rasore të ngurosur, si p.sh.: *zuweilen* (*Weilen* në dhanore shumë), apo *zuschanden* (*Schanden* gjithashtu në dhanore shumë)

Në disa raste është ruajtur edhe nyja shquese: *unterderhand* (unter der Hand) dhe *vorderhand* (vor der Hand), *zurzeit* (zu der Zeit) *imstande* (in dem Stand)

Edhe **tipi i katërt** i ndajfoljeve të përngjitura është i pasur dhe ka për burim sërish një togfjalësh me parafjalë, por me gjymtyrë të dytë një përemër:

parafjalë + përemër

Këtu bëjnë pjesë 33 ndajfoljet e mëposhtme:

außerdem, ehedem, indem, nachdem, seitdem, trotzdem, nächstdem, vordem, zudem; indessen, infolgedessen, unterdessen, stattdessen währenddessen; überdies; beieinander, durcheinander, gegeneinander, hintereinander, miteinander, nebeneinander, füreinander, zueinander, aneinander, aufeinander, übereinander, untereinander, nacheinander, voneinander, voreinander; ohnedies, überdies

Është edhe ndonjë rast me rend të përmbysur si ndajfolja *demnach* apo *demzufolge*. Parafjala *nach* me të cilën është formuar kjo ndajfolje është një parafjalë që gjen përdorim në togfjalësh jo vetëm para emrit por edhe pas tij, si në rastin “*meiner Meinung nach*/sipas mendimit tim”, ndaj mendojmë se kjo është arsyeja pse këtë ndajfolje e gjejmë me rend të përmbysur.

Siç mund të vihet re edhe nga shembujt një nga përemrat që merr pjesë në formimin e ndajfoljeve të këtij tipi është përemri dëftor “*der*”, të cilin e gjejmë në formën e ngurosur të dhanores dhe të gjinores.

Disa ndajfolje janë formuar edhe nga togfjalësha mbiemërorë, duke përbërë kështu **tipin e pestë** të ndajfoljeve të përngjitura, ku dallohen:

ndajfoljet e formuara me elementin e ngurosur *ins*, e cila e ka burimin te parafjala *in* dhe nyja e shquar e gjinisë asjnanëse, dhe një *mbiemër* të emëruar: *insgeheim*, *insgemein*, *insgesamt*, *insbesondere*;

ndajfoljet me elementin *so* dhe *wie* mes parafjalës dhe mbiemrit të emëruar, të cilat e kanë burimin te ndajfoljet përkatëse: *insoweit*, *insofern*, *inwieweit* dhe *inwiefern*

si dhe ndajfoljet e formuara nga togfjalëshi me gjymtyrë një *parafjalë* dhe një *mbiemër*: *bislang*, *fürbass*, *fürwahr*, *vorletz*, *beinahe* dhe *vorlieb*. Këtu bën pjesë dhe ndajfolja *nahezu*, formuar nga togu me rend të përmbysur.

Një tip më vetë përbëjnë 3 ndajfoljet e përngjitura mbi bazën e togfjalëshave emërorë me parafjalë të zgjeruara si:

dortzulande, *hierzulande* dhe *querfeldein*, e cila e ka dalë nga togfjalëshi “*quer (in das) Feld (hin)ein*”

Ndajfolja *zeitlebens* përbën një ndajfolje të veçantë, e cila është formuar nga togfjalëshi me emër + emër në gjinore (in der Zeit des Lebens)

Një tip të veçantë përbëjnë ndajfoljet *meinetwegen*, *meinethalben* dhe *meinetwillen*, të cilat janë formuar nga togu *von* (parafjalë) *meinet* (meinen)(përemër) *wegen/halben* dhe *um meinet* (meinen) *willen*, të cilave u ka rënë gjymtyra e parë e parafjalës dygjymtyrëshe, ndërsa gjymtyra e dytë e tyre, e cila përbën dhe elementin e dytë të ndajfoljes së përngjitur e ka origjinën në formën e ngurosur të dhanores se emrave përkatës. Po kështu edhe *allenthalben*.

Janë edhe dy ndajfolje të veçanta të cilat janë formuar nga njëfjalëzimi i fjalive urdhërore, e para eliptike: *gottlob* (= Gott sei Lob) dhe *gottbewahre* (= Gott bewahre uns)

VI.5.2. Emrat e përngjitur

Në “Deutsches Universalwörterbuch” ndodhen 40 emra të përngjitur. Kjo gjë mendojmë se ka lidhje jo vetëm me faktin se klasa e emrave të gjuhës gjermane shtohet veçanërisht përmes formimeve të reja mbi bazë modelesh ekzistuese, pra përmes kompozimit, por edhe për veçantitë që e karakterizojnë përngjitjen si mënyrë fjalëformimi.

Këta emra të përngjitur janë formuar nga njëfjalëzimi i togfjalëshave dhe fjalive, ndaj dhe mes tyre gjejmë emra të përngjitur dygjymtyrësh, trigjymtyrësh dhe katërgjymtyrësh.

22 nga këta emra të përngjitur:

Dankeschön, Gottseibeius, Guckindieluft, Guckindiewelt, Fingerzeig, Habenichts, Kehraus, Lebewohl, Möchtegern, Nichtsnutz, Reißaus, Rührmichnichtan, Springinsfeld, Stehaufmännchen, Stelldichein, Störenfried, Taugenichts, Tunichtgut, Zeitvertreib, Saufaus, Tischleindeckdich dhe Vergissmeinnicht;

janë formuar si pasojë e njëfjalëzimit të një fjalisë dëshirore (*Gottseibeius*), urdhërore (*Rührmichnichtan*) apo dhe dëftore (*Möchtegern*). Por pavarësisht se elementet e tyre i ruajnë ende të qarta marrëdhëniet sintaksore mes tyre, këta emra në pjesën më të madhe të rasteve kanë fituar një kuptim krejt të ri, i cili nuk mund të nxirret nga kuptimi i fjalisë nga kanë dalë. Kështu *Gottseibeius* nuk ka më kuptimin e fjalisë “*Gott sei bei uns! / Zoti qoftë me ne*”, por emërton *djallin/Teufel*. *Rührmichnichtan* nuk ka më kuptimin e fjalisë urdhërore “*Rühr mich nicht an!/Mos më prek*”, por emërton një bimë.

12 prej tyre emërtojnë persona: *Gottseibeius, Guckindieluft, Guckindiewelt, Habenichts, Möchtegern, Nichtsnutz, Springinsfeld, Stehaufmännchen, Störenfried, Taugenichts, Saufaus, Tunichtgut;*

2 emërtojnë bimë: *Rührmichnichtan* dhe *Vergissmeinnicht;*

ndërsa 8 të tjerët: *Dankeschön, Kehraus, Lebewohl, Reißaus, Stelldichein, Tischleindeckdich, Fingerzeig* dhe *Zeitvertreib* janë emra abstraktë.

Emrat e tjerë burimin e tyre e kanë në togfjalësha të ndryshëm.

Dreikäsehoch, emër i përngjitur që emërton një person, është formuar nga togfjalëshi numëror + emër + mbiemër.

Einmaleins, një tjetër emër i përngjitur trigjymtyrësh abstrakt, ka në përbërje të tij togfjalëshin numëror + ndajfolje + numëror.

Ndërsa emri i përngjitur nga katër elementet e togfjalëshit me dy pjesë krahasimi nga mbiemra në shkallën krahasore dhe paraprirë nga lidhëza krahasuese je, *Jelängerjelier* (je länger je lieber), është një emërtim bime.

Emri i fundit i përngjitur trigjymtyrësh përbëhet nga tri ndajfolje, *Sowieso*, dhe emërton person.

11 emrat e tjerë janë dygjymtyrësh dhe kanë në zanafillë të tyre togfjalësha të ndryshëm:

emër + mbiemër

Entenklein, Fussbreit, Gansklein, Handbreit, Hasenklein dhe Magenbitter

ndajfolje + mbiemër

Gernegroß, Immergrün dhe Nimmersatt

Tausendschön formuar nga një numëror dhe një mbiemër

Muttergottes formuar nga dy emra

Vaterunser formuar nga një emër dhe një përemër

Garaus formuar nga dy ndajfolje

Glückauf formuar nga një emër dhe një ndajfolje

Edhe emrat e përngjitur që e kanë burimin e tyre në togfjalësha janë emra abstraktë ose konkretë dhe kanë kuptime të ndryshme, të cilat jo gjithnjë përkojnë me kuptimin e togfjalëshit nga kanë dalë.

VI.5.3. Parafjalët e përngjitura

Parafjalët e përngjitura janë të kufizuara. Në “Duden-Universalörterbuch” gjejmë 16 parafjalë të cilat kanë dalë nga grupe sintaksore³⁹¹:

anhand, anstelle, aufgrund, aufseiten, infolge, inmitten, mithilfe, vonseiten, zufolge, zugunsten, zuliebe, zulasten, zuungunsten, außerhalb, oberhalb dhe unterhalb

13 prej këtyre parafjalëve janë formuar nga lokucioni parafjalor:

parafjalë + emër

Me përjashtim të parafjalëve *inmitten, infolge* dhe *zuliebe*, për të tjerat përdoret edhe forma paralele përkatëse:

*anhand/an Hand, anstelle/an Stelle, aufgrund/auf Grund, aufseiten/auf Seiten, vonseiten/von Seiten, mithilfe/mit Hilfe, zufolge/zu Folge, zugunsten/zu Gunsten, zulasten/zu Lasten dhe zuungunsten/zu Ungunsten*³⁹²

³⁹¹ C. Di Meloa, Die Grammatikalisierung deutscher Präpositionen, Tübingen, 2000, f.38

³⁹² Di Meloa në veprën e citur më lart, në faqet 114-118, jep shembuj të përdorimit të të dyjave formave të këtyre parafjalëve, njëherë si parafjalë të përngjitura dhe njëherë si lokucione.

Parafjalët duke qenë fjalë shërbyese kanë kuptim leksikor të kushtëzuar. Veçanërisht parafjalët e përngjitura, lokucionet dhe ato të formuara me konversion nga pjesë të tjera ligjrate, nuk janë krejt të zhveshura nga kuptimi leksikor. Fjala emërtuese që është njëri nga elementet e parafjalës së përngjitur, bën që kuptimi i gjithë parafjalës të jetë më i qartë. Për Lindqvist-in³⁹³ parafjalët e përngjitura për të cilat nuk ekziston më lokucioni përkatës (*inmitten, infolge* dhe *zuliebe*), kanë një kuptim leksikor më të përgjithshëm se parafjalët e tjera të këtij lloji.

3 parafjalët e tjera *außerhalb, oberhalb* dhe *unterhalb* janë formime të vjetra të cilat e kanë origjinën e tyre në togfjalëshin ndajfolje + -halb, e cila është formë e ngurosur e dhanores së shumësit të emrit *halba* në gjermanishten e lartë të vjetër (= *Seite*)

VI.5.4. Lidhëzat e përngjitura

Klasa e fjalëve shërbyese, veçanërisht ajo e lidhëzave³⁹⁴, shihet si një klasë e mbyllur sa i takon mundësisë për t'u pasuruar me elemente të reja. “*Bei den Funktionswörtern existiert eine stärkere Barriere zur Erweiterung . / Për fjalët shërbyese barriera që pengon zgjerimin e tyre me fjalë të reja është më e fortë.*”³⁹⁵ shprehet Di Melo, teksa i krahason fjalët shërbyese me ato emërtuese.

Edhe numri i lidhëzave të formuara me përngjitje është i kufizuar.³⁹⁶ Ai nuk e kalon shifrën 12.

Këto lidhëza janë formuar nga:

lidhëza ob + ndajfolje

obgleich, obschon dhe *obwohl*;

nga togu ndajfoljor:

ndajfolje + ndajfolje

ku në pjesën më të madhe të lidhëzave të këtij grupi gjymtyra e parë është ndajfolja *so* dhe vetëm në një rast ndajfolja *wie*:

sobald, sofern, solange, sooft, soweit, sowenig, sowohl dhe *wiewohl*

Vetëm lidhëza *hingegen* është formuar nga ndajfolja *hin* dhe parafjala *gegen*.

³⁹³ Ch. Lindqvist, Zur Entstehung von Präpositionen im Deutschen und Schwedischen, Tübingen, 1994, f. 241

³⁹⁴ Duden, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998, f. 554

³⁹⁵ C. Di Melo, Die Grammatikalisierung deutscher Präpositionen, Tübingen, 2000, f.34

³⁹⁶ Këtu do të trajtohen vetëm lidhëzat e formuara drejtpërdrejt me përngjitje dhe jo ato të ardhura me konversion nga klasa e ndajfoljeve të përngjitura.

VI.5.5. Përemrat e përngjitur

Edhe numri i përemrave të përngjitur është i kufizuar. Numërohen 13 të tillë, nga të cilët gjashtë janë të pacaktuar dhe pjesa tjetër u përket përemrave dëftorë.

Përemrat e pacaktuar janë formuar nga: ndajfolja *irgend* + një përemër i pacaktuar:

irgendein, irgendetwas, irgendjemand, irgendwas, irgendwelch dhe *irgendwer*

Ndërsa 5 përemrat dëftorë *ebendas, ebender, ebendie, ebendieser* dhe *ebenjener* janë formuar nga ndajfolja *eben* + një përemër dëftor.

Përemri dëftor *derselbe* është formuar nga përdorimi pranë njëri-tjetrit i përemrave dëftorë *der* dhe *selbe*. Ndërsa përmeri tjetër dëftor *derjenige* është formuar nga përemri *der* dhe forma e ngurosur *jenige* që e ka origjinën te përemri dëftor *jener*.

VI.5.6. Mbiemrat e përngjitur

Mbiemrat e përngjitur të gjuhës gjermane janë shumë të rrallë, madje mund t'i quajme dhe ndërtime relike në gjuhë. Si të tillë shfaqen dy mbiemra: *vorhanden* dhe *zufrieden* të cilat janë formuar nga përngjitja e parafjalës me emrin në togjet e vjetra *von den Händen* dhe *zu Frieden* + një folje.

VI.5.7. Pasthirmat dhe pjesëzat e përngjitura

Duke qenë se përngjitja përfaqësohet vetëm me shumë pak shembuj në këto dy pjesë ligjrate menduam t'i trajtojmë bashkë. Pjesa më e madhe e pasthirmave të gjuhës gjermane kanë strukturë tingëllore, përbëhen nga tinguj. Mes tyre dallohet një pasthirmë *gottverdammich*, e cila e ka burimin e saj në përngjitje e gjymtyrëve të fjalisë urdhërore "Gott verdamme mich!". Pasthirma tjetër *Mannomann* është formuar nga përngjitja e gjymtyrëve të togut "Man, o Mann".

Pjesëza e vetme formuar me përngjitje nga pjesëza *ja* dhe ndajfolja *wohl* është *jawohl*.

VI.6. Përqasja e fjalëve të përngjitura në shqipe dhe gjermanishte

Përqasja dhe krahasimi i fjalëve të përngjitura të këtyre gjuhëve do të bëhet në tri aspekte, në atë morfologjik, sintaksor dhe semantik.

VI.6.1. Analiza morfologjikosintaksore

Fjalët e përngjitura përbëjnë një përqindje relativisht të vogël të fjalorit në shqipe dhe gjermanishte, madje në këtë të fundit mund të themi se kjo përqindje është thuajse e papërfillshme, duke qenë se ato janë më pak se 0.2%.

Në të dyja gjuhët gjejmë të formuara më përngjitje, si pjesë të ndyshueshme të ligjeratës, ashtu edhe pjesë të pandryshueshme të saj, por, ndërsa në shqipe përngjitja vepron te të gjitha pjesët e ligjeratës, në gjermanishte veprimtaria e saj kufizohet vetëm në tetë prej tyre, duke përjashtuar klasën e foljeve dhe numërorëve. Edhe numri i fjalëve të përbëra është i ndryshëm nga njëra pjesë ligjrate në tjetrën. Vihet re se në të dyja gjuhët pjesën më të madhe të fjalëve të përngjitura, gati 50% të tyre, e përbëjnë ndajfoljet. Më pak përngjitja vepron në klasën e mbiemrave të të dyja gjuhëve (3 mbiemra të tillë në shqipe dhe 2 në gjermanishte). 40 emrat e gjuhës gjermane përfaqësohen mirë në klasifikimin e fjalëve të përngjitura, duke u pozicionuar menjëherë pas ndajfoljeve, ndërsa në gjuhën shqipe gjejmë vetëm 7 emra të tillë. Nga ky klasifikim vihet re gjithashtu se në gjermanishte formohen shumë më pak përemra dhe lidhëza të përngjitura sesa në shqipe.

Numri i gjymtyrëve që përbëjnë fjalët e përngjitura në të dyja gjuhëve varion nga dy deri në katër të tilla. Si në shqipe dhe në gjermanishte, dygjymtyrëshet përbëjnë dhe shumicën e fjalëve të përngjitura. Në shqipe: *kushdo, gjithmonë, sepse, mirëdita, nëpër, vërej* etj.; *shtozovallet, megjithatë, dymbëdhjetë, megjithëse* etj.; *anepërqark, sidokudo* etj.; në gjermanishte: *derart, währenddessen, zeitlebens, Immergrün, gottlob, anhand, irgendein, obgleich, barfuß* etj.; *insgesamt, inwieweit, Tischleindeckdich, vorderhand,* etj.; *Jelängerjelier, Guckindieluft, dortzulande* etj.

Mbiemrat e përngjitur të gjuhës gjermane janë vetëm dygjymtyrësh (*zufrieden* dhe *vorhanden*), ndërsa mbiemrat e përngjitur të shqipes janë trigjymtyrësh (*kuqez, mosmëharro, mosmëprek*). Mendojmë se elementi “e” te mbiemri *kuqez* e ka origjinën te lidhëza këpujore “e”. Fjalët e përngjitura katërgjymtyrëshë në gjuhën gjermane janë vetëm emra (*Guckindieluft, Gottseibeius*), ndërsa në gjuhën shqipe janë vetëm ndajfolje (*asndonjëherë, ngandonjëherë*).

Gjymtyrët e fjalëve të përngjitura janë pjesë të ndryshme ligjrate, ndërsa strukturat e togjeve nga kanë dalë këto fjalë të përngjitura janë nga më të larmishmet, si në shqipe edhe në gjermanishte.

Te fjalët e përngjitura të të dyja gjuhëve gjejmë gjymtyrë të shprehura me emra, lidhëza, ndajfolje, përemra, folje, pjesëza dhe parafjalë. Por, ndërsa në gjuhën shqipe numërori shaqet vetëm si gjymtyrë i një numërori të përngjitur (*pesëmbëdhjetë*), në gjermanishte numërori *drei/tre* është përngjitur me një emër dhe një mbiemër për të formuar emrin e përngjitur *Dreikäsehoch*.

Në shqipe mbiemri bën pjesë në trupin e një fjale të vetme të përngjitur, të mbiemrit *kuqez*, ndërsa në gjermanishte atë e gjejmë te ndajfoljet (*lauthals*) dhe emrat (*Dreikäsehoch*).

Sa i takon përemrit, në trupin e fjalëve të përngjitura të shqipes marrin pjesë vetëm përemrat e pacaktuar dhe ata dëftorë (*kushdo, kësisoj*), ndërkohë që në gjermanishte si

gjymtyrë e fjalës së përngjitur, veç tyre (*derart, allemal*), shfaqet edhe përemri pronor (*Vergissmeinnicht*) dhe ai vetor (*Rührmichnichtan*). Duhet thënë gjithashtu se në dy mbiemrat *mosmëharro* dhe *mosmëprek*, motivuar nga fjalitë “*Mos më harro!*” dhe “*Mos më prek!*”, ruhet forma e trajtës së shkurtër të përemrit vetor.

Në gjermanishte ka fjalë të përngjitura që në përbërje të tyre kanë edhe një nyje të shquar, e cila ose merr pjesë në formën e saj të plotë (*vorderhand* dhe *unterderhand*), ose e shkrirë bashkë me parafjalën, si te ndajfoljet e tipit *insgesamt* apo *imstande* (parafjala *in* dhe *s* e nyjes së shquar të gjinisë asnjane *das* në kallëzore, ose *m* e nyjes së shquar të asnjaneses dhe mashkullores në rasën dhanore)³⁹⁷.

Format e ngurosura janë pjesë e fjalëve të përngjitura, si në shqipe ashtu edhe në gjermanishte. Në gjermanishte është forma e ngurosur *halb*, e cila e ka origjinën e saj në dhanoren e shumësit të emrit “*halba*” në gjermanishten e vjetër të lartë (= Seite), e cila duke u bashkuar me ndajfolje formon parafjalë (*außerhalb*). Në shqipe gjejmë formën e ngurosur, *ndo* e cila e ka origjinën e saj te bashkimi i lidhës *në* dhe formës foljore *do*. Kjo formë e ngurosur bashkohet me elemente të tjera, si p.sh. përemra, për të formuar përemra të pacaktuar (*ndokush*) dhe ndajfolje (*ndonjëherë*). Elementi tjetër i ngurosur i shqipes është *kund*, një formë e ndajfoljes *ku*. Edhe ky element bashkohet me elemente të tjera, si p.sh. ndajfolje, e formon ndajfolje të përngjitura (*rrallëkund*).

Kombinimet e togfjalëshave që qëndrojnë në bazë të fjalëve të përngjitura në të dyja gjuhët janë të larmishme. Në shqipe larmishmërinë më të madhe të këtyre togjeve e gjejmë te ndajfoljet. Origjinën e tyre ndajfoljet e përngjitura të shqipes e kanë te 24 grupet e fjalëve e togfjalëshat e mëposhtëm:

përemër i pacaktuar + emër (*gjithherë*)
përemër dëftor + emër (*atëbotë*)
përemër + ndajfolje (*gjithandej*)
përemër + përemër (*gjithnjë*)
ndajfolje + folje (*kudo*)
folje + pjesëz + folje (*domosdo*)
folje + ndajfolje (*dikur*)
ndajfolje + ndajfolje (*kurrkund*)
pjesëz + ndajfolje (*askund*)
ndajfolje + emër (*shpeshherë*)
parafjalë + emër (*ngaherë*)
emër + folje + ndajfolje (*herëdokur*)
formë të ngurosur (*akë*) + ndajfolje (*akëqysh*)
formë të ngurosur (*ndo*) + formë të ngurosur (*kund*) (*ndokund*)
element trajtëformues (*pa*) + pjesore (*pakujtuar*)
lidhëz + ndajfolje (*sivjet*)

³⁹⁷ Disa nga parafjalët e gjuhës gjermane kanë aftësinë që të shkrihen me nyjën e shquar të gjinisë mashkullore dhe femërore në rasën dhanore dhe atë të gjinisë asnjane në kallëzore dhe dhanore, p.sh. in das = ins, in dem = im, an das = ans, zu der = zur etj.

parafjalë + ndajfolje (*pasnesër*)
emër + lidhëz + emër (*aneqark*)
emër + lidhëz + ndajfolje (*anembanë*)
ndajfolje + lidhëz + emër (*tejefund*)
ndajfolje + lidhëz + ndajfolje (*tejembanë*)
parafjalë + mbiemër i emërzuar (*tekefundit*)
parafjalë + përemër dëftor + emër (*matanë*)
parafjalë + nyjë e pashquar + emër (*mënjatë*)

Edhe në gjuhën gjermane larmishmërinë më të madhe të togfjalëshave nga dalin fjalët e përngjitura, 16 të tillë, e gjejmë te ndajfoljet, të cilat gjithsesi janë më pak se ato të shqipes:

përemër i pacaktuar + emër (*manchmal*)
përemër dëftor + emër (*derart*)
përemër pronor + emër (*seinerzeit*)
mbiemër + emër (*mittlerweile*)
parafjalë + emër (*beiseite*)
parafjalë + nyjë e shquar + emër (*unterderhand*)
emër + parafjalë (*zweifelsohne*)
parafjalë + përemër (*zudem*)
përemër + parafjalë (*demnach*)
parafjalë + formë e nyjes së shquar + mbiemër i emërzuar (*insbesondere*)
parafjalë + ndajfolje + mbiemër të emërzuar (*insoweit*)
parafjalë + mbiemër (*bislang*)
mbiemër + parafjalë (*nahezu*)
ndajfolje + parafjalë + emër (*dortzulande*)
emër + emër (*zeitlebens*)
përemër + gjymtyra e dytë e parafjalës dygjymtyrëshe (*meinetwegen*)

Në ndryshim nga gjuha shqipe, në gjermanishte gjejmë edhe dy ndajfolje të përngjitura që e kanë origjinën në një fjali. Ndajfolja *gottlob* motivohet nga një fjali eliptike, e cila e ka humbur formën foljore (Gott sei Lob!), ndërsa e dyta *gottbewahreuns* me formë foljore të ruajtur në trup të saj, motivohet nga fjalia dëshirore (Gott bewahre uns!).

Vihet re se si në shqipe, ashtu edhe në gjermanishte, janë formuar ndajfolje nga njëfjalëzimi i tre togfjalëshave të njëjtë:

përemër i pacaktuar + emër (*gjithherë, manchmal*)
përemër dëftor + emër (*atëbotë, derart*)
parafjalë + emër (*ngaherë, beiseite*)

Gjithashtu vihet re se si në shqipe, edhe në gjermanishte, janë formuar parafjalë nga njëfjalëzimi i togfjalshit parafjalë + emër (*nëpërmjet, infolge*).

Në të dyja gjuhët është formuar një pjesëz nga njëfjalëzimi i togfjalëshit pjesëz + ndajfolje (*posi, jawohl*).

Edhe disa përemra të shqipes dhe të gjermanishtes e kanë origjinën te togfjalëshat ndajfolje + përemër i pacaktuar (*kurrkush, irgendwas*)

Si në shqipe, dhe në gjermanishte, janë formuar fjalë nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi ndajfolje + ndajfolje, dhe emër + emër. Por teksa në shqipe nga njëfjalëzim i togfjalëshit të parë janë formuar ndajfolje (*andepari*), në gjermanishte është formuar vetëm emri *Garaus*. Ndërsa nga njëfjalëzimi i togfjalëshit të dytë në shqipe janë formuar përemra (*gjësendi*), në gjermanishte është formuar emri (*Muttergottes*). Në të dyja rastet gjymtyrët e dyta janë forma të ngurosuras rasore të emrave “*send*” dhe “*Gott*”

Në shqipe ka edhe fjalë të tjera të cilat janë formuar nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi, gjymtyrët e të cilit janë shprehur nga fjalë të së njëjtës pjesë ligjrate, siç është rasti i përemrave të formuar nga togfjalëshat përemër + përemër (*gjithkush*)

Një tjetër e përbashkët mes dy gjuhëve është formimi i fjalëve të përngjitura nga njëfjalëzimi i një fjalie. Por, ndërsa në shqipe nga njëfjalëzimi i një fjalie janë formuar disa pasthirra (*tumirëmbec, tungjatjeta* etj.), në gjuhën gjermane gjejmë vetëm një të tillë (*gottverdammich*). Në të gjitha rastet dallohet qartë elementi foljor. Në shqipe është formuar edhe pjesëza *kushedi* nga fjalia “*kush e di*”, me të cilën lidhjet duket të jenë ende të forta, si dhe dy mbiemrat *mosmëharro* dhe *mosmëprek*, ku ruhen të qarta si format foljore ashtu edhe lidhjet me fjalitë nga kanë dalë. Në gjermanishte janë formuar edhe dy ndajfolje nga njëfjalëzime fjalish, *gottbewahre* dhe *gottlob*, nga të cilat formën foljore e ka ruajtur vetëm e para, ndërsa e dyta në të vërtetë është formuar nga një fjali eliptike. Ndërsa në shqipe janë vetëm dy emrat që e kanë origjinën te një fjali (*shtojzovalle* dhe *shtojzorreshta*), në gjermanishte numri i këtij tipi emrash arrin shifrën 21, duke përbërë dhe 54% të emrave të përngjitur të kësaj gjuhe. Te të gjithë këta emra është ruajtur forma foljore (*Guckindieluft, Möchtegern, Rühmichnichtan, Lebewohl* etj.)

Ndërsa në gjuhën gjermane folja shfaqet si element i përngjitjes vetëm te fjalët që e kanë origjinën te fjali të njëfjalëzuara, madje jo te të gjitha rastet, kujtojmë këtu ndajfoljen *gottlob*, në shqipe ajo duket të jetë më aktive, duke marrë pjesë edhe si formë e ngurosur (*ndonjë, dikush*), edhe si pjesore (*padashur*) por edhe në formën e dëshirores (*tumirëmbec*), urdhërores (*shtojzovalle*) apo dëftores (*faleminderit*). Në gjermanishte atë e gjejmë në formën e urdhërores (*Lebewohl*) ose në dëftore (*Dankeschön*)

Pra, vihet re se në të dyja gjuhët fjalët e përngjitura e kanë origjinën e tyre në struktura të ndryshme sintaksore:

- në një togfjalësh (*gjithmonë, zeitlebens*)
- në një tog parafjalor (*pasdite, zutage*)
- në një grup fjalësh (*farefis, Mannomann*)
- në një fjali (*faleminderit, Guckindieluft*)

Në disa raste, si në shqipe dhe në gjermanishte, ruhen të qarta dhe lidhjet sintaksore mes gjymtyrëve të fjalisë nga e ka prejardhjen fjala e përngjitur:

ule mosmëharro	–	Mos më harro!
der Guckindiewelt	–	Guck in die Welt!

Në raste të tjera vërehet se mungon një gjymtyrë:

faleminderit	-	<i>Unë</i> i falem nderit.
der Habenichts	-	<i>Ich</i> habe nichts.

Si në shqipe, dhe në gjermanishte motivimi i këtyre fjalëve të përngjitura bëhet me një fjali e cila gjatë procesit të përngjitjes ka humbur kryefjalën.

Fjala e përngjitur, si çdo fjalë tjetër, ka natyrën e saj leksikogramatikore. Ajo kur është pjesë e ndryshueshme e ligjeratës lakohet (*shtojzovallja-shtojzovallen-shtojzovallet* etj.) ose zgjedhohet (*verej-vëren-vërejt* etj.). Vetëm në rastin e përemrit të pacaktuar *kushdo* dhe *cilido*, ajo që i formëson gramatikisht këto fjalë është gjymtyra e parë (*kushdo-kujtdo-këdo; cilindo, cilitdo, cilindo*), e cila e ka origjinën te përemri i pacaktuar i lakueshmë “kush” dhe “cili”. Kjo gjë është e kuptueshme, pasi gjymtyra e dytë e këtij përemri të përngjitur është një formë e ngurosur. Në gjermanishte emrat e përngjitur kanë format e tyre rasore dhe të shumësit, të cilat i tregojnë përmes mbaresave që marrin. Po ashtu edhe mbiemrat e përngjitur në gjermanishte respektojnë rregullat e lakimit të mbiemrit.

VI.6.2. Analiza semantike

Edhe pse fjalët e përngjitura janë formuar mbi bazë togfjalëshash e fjalish dhe i ruajnë deri diku të qarta marrëdhëniet sintaksore mes gjymtyrëve të tyre, këto të fundit janë çsemantizuar dhe fjala e përngjitur ka fituar kuptimin e saj semantik, i cili do të ishte e vështirë të nxirrej përmes kuptimit të elementeve përbërse, edhe pse “*kuptimi i fjalës së përngjitur, si rregull, është i barabartë me kuptimin e togut nga ka dalë ajo*”³⁹⁸. Gjithsesi ne jemi të mendimit se shkalla e çsemantizimit të gjymtyrëve të fjalës së përngjitur nuk është e njëjtë për të gjitha ato. Kështu p.sh. procesi i çsemantizimit të gjymtyrëve të mbiemrit të përngjitur *kuqez* është shumë i dobët, ndaj dhe kuptimi i këtij mbiemri të përngjitur mund të merret si shumë e kuptimeve të gjymtyrëve përbërës, kjo ndoshta edhe për faktin se kemi të bëjmë me një mbiemër të përngjitur, i cili motivohet nga një grup fjalësh, ku dy nga gjymtyrët e tij janë mbiemra. Ndryshe qëndron çështja me emrin e përngjitur *shtojzovalle*. Fjalja me të cilën motivohet ky emër, është krejtësisht e leksikalizuar, madje një dëgjues i thjeshtë do ta kishte të vështirë të arrinte te njësia motivuese e tij, dhe kjo jo vetëm për faktin se fjalja nga ka dalë ky emër ka pësuar ndryshime fonetike, por edhe sepse shuma e kuptimeve të tyre nuk do të jepte për asnjë

³⁹⁸ Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002

çast kuptimin e këtij emri që emërton një figurë të përrallave shqiptare, apo një vajzë të bukur në një kontekst tjetër.

Edhe në gjuhën gjermane ka emra me një shkallë më të lartë leksikalizimi, si p.sh. emri *Springinsfeld* (i ri i papjekur dhe pa përvojë) (*Spring ins Feld / hidhu në fushë*), apo *Guckindieluft* (dikush që nuk bën kujdes rrugës kur ecën) (*Guck in die Luft / shikon qiellin*), ndërkohë që emra të tjerë si p.sh. *Habenichts* (njeri i varfër) (*Habe nichts / S'kam asgjë*) apo *Nimmersatt* (person që ka gjithnjë uri) (*Nimmer satt / kurrë i ngopur*) shfaqin një shkallë më të ulët leksikalizimi.

Në të dyja gjuhët kemi emra të përngjitur konkretë (*shtojzovalle, Guckindieluft*), të cilët në gjermanishte janë më të shumtë se në shqipe duke përbërë 60% te emrave të përngjitur kundrejt 28.5% te emrave të përngjitur të shqipes; abstraktë (*ecejak, Zeitvertrieb*) të cilët përbëjnë shumicën e emrave të përngjitur të shqipes me 57.2%, ndërsa në gjermanishte emrat e përngjitur abstrakt përbëjnë 32.5% të gjithë emrave të përngjitur; dhe emra përmbledhës (*farefis, Gänseklein*), të cilër si në shqipe dhe në gjermanishte zënë një vend të vogël mes emrave të përngjitur.

Në shqipe emrat konkretë emërtojnë frymorë (*shtojzovalle, shtojorreshta*), ndërsa në gjermanishte, veç personave, ato emërtojnë edhe bimë (*Möchtegern, Immergrün*).

Si në shqipe ashtu edhe në gjermanishte pjesët e tjera të ligjeratës që janë fjalë të përngjitura shprehin një shkallë më të lartë leksikalizimi sese emrat dhe mbiemrat e përngjitur të këtyre gjuhëve, por edhe brenda këtyre klasave ka diferencime. Kur ato motivohen nga togje fjalësh me elemente të shprehura me fjalë emërtuese, shkalla e leksikalizimit nuk është aq e lartë.

Përfundime të përgjithshme

Në këtë pjesë të punimit do të parashtrojmë përfundimet e përgjithshme, pasi përfundimet nxjerrë nga shqyrtimi, analizimi dhe krahasimi i kompozitave dhe fjalëve të përngjitura në “*Fjalorin e shqipes së sotme*” dhe “*Deutsches Universalwörterbuch*”, janë paraqitur në një nënçështje të veçantë në kreun përkatës.

Bazuar në shqyrtimin e përgjithshëm të sistemeve fjalëformuese në shqipe dhe gjermanishte, si dhe në përjasjen e tyre me njëra-tjetrën, kemi mbërritur në përfundimin se të dyja gjuhët karakterizohen nga një *sistem i pasur fjalëformues*, i cili përbëhet jo vetëm nga një numër i konsiderueshëm mënyrash fjalëformuese, por është i pasur edhe në ndajshitesa fjalëformuese.

Në gjuhën shqipe qëndrimi i gjuhëtarëve lidhur me klasifikimin e mënyrave të fjalëformimit është më i njësuar se ai i gjuhëtarëve të gjermanishtes. Diversiteti i qëndrimi të tyre lidhet me faktin se ndarjet dhe emërtimet e mënyrave fjalëformuese janë bërë sipas kritereve të ndryshme. Bie në sy se në gjermanishte disa gjuhëtarë parashtesimin e kanë shqyrtuar si një mënyrë më vetë, duke u nisur nga fakti se fjala e re e formuar i përket të njëjtës kategori leksikogramatikore sikurse dhe fjala nga e cila formohet (*arbeiten – bearbeiten; gestern – vorgestern; Erfolg – Misserfolg*).

Në të dyja gjuhët prejardhja, në mënyrë të veçantë prapashtesimi dhe kompozimi, përbëjnë *dy mënyrat më produktive* në pasurimin e këtyre dy gjuhëve me fjalë të reja.

Si në shqipe, edhe në gjermanishte gjejmë fjalë të formuara me parashtesim (*përpunoj, verarbeiten*), fjalë të formuara me prapashtesim (*vrapim, Übung*), fjalë të formuara me parashtesim dhe prapashtesim njëkohësisht (*zbukuroj, beseitigen*) dhe fjalë të formuara pa ndonjë ndajshitesë (*mund-i, Blick*). Interesant është qëndrimi i gjuhëtarëve lidhur me *prejardhjen prapavajtëse (Rückbildung)*. Kjo mënyrë fjalëformuese u njihet të dyja gjuhëve, por ajo nuk ndihmon në analizimin e fjalëve nga pozitat e sotme të tyre. Kështu fjalët e tipit “*çudi*” dhe “*Eigensinn*” shihen si formime me prejardhje prapavajtëse vetëm duke u bazuar në analizën diakronike (*çudi* nga *çudit* dhe *Eigensinn* nga *eigensinnig*), ndërsa në sistemin e sotëm fjalëformues ato interpretohen ndryshe. Është folja *çudit* që shihet si e prejardhur nga emri *çudi*, ndërsa *Eigensinn* shihet më tepër si kompozitë.

Një tjetër mënyrë fjalëformuese që e gjejmë si në sistemin fjalëformues të shqipes ashtu edhe në atë të gjermanishtes është *konversioni*. Në të dyja gjuhët leksiku pasurohet me fjalë të reja nga kalimi i tyre në kushte të caktuara sintaksore nga një pjesë ligjerate në një tjetër. Si në shqipe edhe në gjermanishte konversioni vepron në të gjitha pjesët e ligjeratës.

Një karakteristikë e gjuhës shqipe është formimi i fjalëve të reja nga bashkëveprimi i dy mënyrave të ndryshme, madje ndonjëherë edhe tri mënyrave njëkohësisht. Në gjermanishte ky fenomen ndodh vetëm në formimin e të ashtuquajturave *Zusammenbildungen*, të cilat realizohen nga *bashkëveprimi i komozicionit dhe*

prapashtesimit, siç ka ndodhur me fjalën *Gesetzgebung*. Lidhur me këtë çështje vihen re dy qëndrime të ndryshme në gjermanishte. Disa i shohin formime të tilla si produkte të bashkëveprimit të kompozimit dhe prapashtesimit, të tjerë i shohin si fjalë të prejardhura. Në këtë punim ne kemi shprehur dhe argumentuar qëndrimin tonë, duke i shqyrtuar formime të tilla si fjalë të formuara me kompozim dhe prapashtesim. Në gjuhën shqipe kombinimet e mënyrave për të formuar fjalë të reja janë nga më të ndryshmet.

Ndërsa në gjuhën shqipe formohen mbiemra nëpërmjet *nyjzimit*, i cili është një mënyrë fjalëformimi shumë prodhimore, ose dhe nyjzimit në bashkëveprim me mënyra të tjera, në gjermanishtja, e cila këtë mënyrë fjalëformimi nuk e njeh, zotëron të tjera mënyra fjalëformuese të panjohura nga shqipja, si *kontaminimi*, shkrirja e dy fjalëve në një të vetme (*Kurlaub*), dhe *dyfishimi*, formimi i fjalëve të reja nga përsëritja e një fjale (*soso*).

Një tjetër temë e përbashkët, por që shfaq natyrisht edhe karakteristika të veçanta në të dyja gjuhët, është ajo e *shkurtesave*, të cilat i ndeshim vetëm në klasën e emrave. Në shqipe dallohen vetëm dy lloje shkurtesash, ndërsa në gjermanishte katër të tilla.

Të dyja gjuhët formojnë shkurtesa:

- rrokjesore: **Mapo** (magazine popullore), **Profarma** (prodhime farmaceutike) **KaDeWe** (Kaufhaus des Westens), **Soko** (Sonderkommission) dhe
- nistore: **SMT** (Stacioni i makinave dhe traktorëve), **TEC** (Termoelektrocentral) **DDR** (Deutsche Demokratische Republik), **Lkw** (Lastkraftwagen)

Por ndryshe nga shqipja, gjermanishtja formon shkurtesa edhe nga kombinimi i dy tipave të mësipërm (**Azubi** = **Auszubildender**), si dhe me gërmën nistore të pjesës së parë të kompozitës apo togfjalëshit dhe me gjymtyrën tyre të dytë (**U-Haft** = **Untersuchungshaft**; **H-Milch** = **haltbare Milch**). Tipi i fundit i shkurtesave shoqërohet nga viza lidhëse.

Shkurtesat në gjuhën shqipe shihen si një formë kompozitash, ndërsa në gjuhën gjermane ato përbëjnë një mënyrë të veçantë fjalëformimi. Mendojmë se ky qëndrim lidhet me faktin se shkurtesat në vetvete nuk formojnë fjalë me një përmbajtje të re. Nga njëra anë ato mbeten variante të fjalëve ekzistuese, kanë të njëjtën përmbajtje e përcjellin të njëjtin informacion sikurse edhe ato, por nga ana tjetër ato mund të krijojnë ndryshime në leksikon e gjuhës, si në rastin kur bashkohen me fjalë të tjera për të formuar kompozita (**Schuko** = **Schutzkontakt** – *Schuckosteckdose*). Ky shembull flet dhe për aftësinë e shkurtesave të gjuhës gjermane për t'u bashkuar me fjalë të tjera në një kompozitë, aftësi të cilën e gëzojnë të gjitha llojet e shkurtesave:

- njësegmentëshet: **Kombi** = **Kombination**: → *Kombizange*
- nistoret: **EDV** = **elektronische Datenverarbeitung**: → EDV-Programm
- rrokjesoret: **Kripo** = **Kriminalpolizei**: → *Kripobeamte*

- shkurtesat e kombinuara: **Azubi** = **Auszubildender**: → *Azubiportal*
- shkurtesat e pjesshme: **U-Bahn**=**Untergrundbahn**: → *U-Bahn-Station*

Një fenomen të tillë gjuhësor nuk e ndeshim te shkurtesat e gjuhës shqipe. Por në shqipe vërehet një tendencë e bashkimit të shkurtesave me prapashtesat. Ky fenomen gjuhesor ndeshet më shumë në gjuhën e folur. Në fjalor gjendet vetëm një fjalë formuar nga një shkurtesë dhe një prapashtesë, është pikërisht emri *debatikas* (DEBATIK + as).

Edhe në gjermanishte, ndonëse në pak raste, shkurtesat mund të bashkohen me prapashtesat –**i** dhe –**o** për të formuar fjalë të reja.

Ostdeutscher – Ossi
Westdeutscher - Wessi

Duhet thënë se edhe pse në të dyja gjuhët veprojnë disa mënyra fjalëformuese, për të dyja ato më të rëndësishmet, sa i takon aktivitetit dhe produktivitetit, mbeten kompozimi dhe prapashtesimi.

Përngjitja është një mënyrë që nuk është dhe aq aktive as në shqipe, as në gjermanishte. Por, teksa në shqipe pranohet nga të gjithë gjuhëtarët përngjitja si mënyrë fjalëformimi e rëndësishme, në gjermanishte qëndrimi ndaj saj ndryshon, jo vetëm mes gjuhëtarësh, por ndodh që dhe i njëjti gjuhëtar të mbaj qëndrime të ndryshme lidhur me fjalët e përngjitura, siç ka ndodhur me Fleischer-in. Disa gjuhëtarë i shohin fjalët e përngjitura si formime konversioni. Ata pak që i pranojnë, i trajtojnë më tepër si një fenomen relikto në gjuhë, nëpërmjet të cilit janë formuar kryesisht emra. Bëhet fjalë për ato emra, gjymtyra e dytë e të cilëve nuk është e shprehur nga një emër dhe si pasojë nuk mund të klasifikohet si kompozitë, pasi në gjuhën gjermane, gjymtyra e dytë e fjalës së përbërë përcakton dhe karakteristikat leksikogramatikore të gjithë kompozitës, përkatësinë e saj në një pjesë ligjerate. Si fjalë të përngjitura shihen edhe disa ndajfolje e parafjalë.

Ndryshe qëndron çështja me fjalët e përngjitura të gjuhës shqipe, të cilat veprojnë thuhet në të gjitha pjesët e ligjeratës. Gjithsesi duhet theksuar se nëpërmjet përngjitjes janë formuar kryesisht pjesë të pandryshueshme ligjerate si dhe shumë përemra.

Kompozimi është një tjetër mënyrë fjalëformimi që e njohin të dyja gjuhët dhe e përdorin masivisht për të formuar fjalë të reja, veçanërisht gjermanishtja e cila edhe për shkak të karakteristikave të strukturës së saj, krijon kompozita me shumë tema motivuese. Kompozita të tilla në shqipe ndeshen shumë rrallë, dhe në çdo rast ato nuk kanë më shumë se tri tema motivuese.

Të dyja gjuhët formojnë kompozita këpujore dhe përcaktore, të cilat përbëjnë dhe pjesën dërrmuese të gjithë kompozitave në të dyja gjuhët, duke bërë që kompozitat këpujore të jenë formime rastësore të shkrimeve letrare apo pjesë e terminologjisë.

Kompozitat pronësore janë një karakteristikë e të dyja gjuhëve. Si në shqipe dhe në gjermanishte ato emërtojnë kryesisht persona e gjallesa të tjera. Në pjesën më të madhe të rasteve njëra nga gjymtyrët e tyre shprehet përmes një emri që emërton pjesë të trupit të njeriut.

Kompozitat përcaktore të gjuhës gjermane kanë për gjymtyrë përcaktuese gjithnjë gjymtyrën e parë, me përjashtim të emrit *Vierteljahr*. Ndërsa në gjuhën shqipe në rolin e përcaktueses mund të jetë si gjymtyra e parë ashtu edhe e dyta. Gjithashtu në gjuhën shqipe gjymtyra e dytë e kompozitës e formëson gramatikisht krejt kompozitën si dhe në gjermanishte, por jo në të gjitha rastet. Ka kompozita në të cilat këtë funksion e kryen gjymtyra e parë (vinç-urë).

Të dyja gjuhët kanë formuar kompozita emërore, mbiemërore, foljore dhe pak ndajfoljore. Në shqipe numrin më të madh të kompozitave e kanë mbiemrat dhe emrat, ndërsa në gjuhën gjermane pjesa dërrmuese e tyre janë emra, më pak mbiemra e folje, ndërsa numri i kompozitave ndajfoljore është i papërfillshëm përkundrejt atyre emërore.

Të dyja gjuhët kanë zhvilluar një sistem të zhvilluar modelesh për formimin e kompozitave. Mes tyre më prodhimtari dhe aktivi është modeli emër + emër. Gjithashtu edhe modelet emër + mbiemër, mbiemër + emër, ndajfolje + folje, në gjermanishte, shfaqin një prodhimtari të lartë.

Përfundimet e mësipërme në lidhje me sistemin fjalëformues të shqipes dhe gjermanishtes në përgjithësi, dhe kompozitave e fjalëve të përngjitura në veçanti, flasin dhe një herë për parimet universale që qëndrojnë në bazë të të dyja gjuhëve si dhe për karakteristikat dhe individualitetin e secilës prej tyre. Por afritë e pjesshme të tyre lidhen edhe me karakteristikën e përbashkët tipologjike si gjuhë ende me fleksion relativisht të zhvilluar.

BIBLIOGRAFIA

- Akademia e shkencave**, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1972
- Akademia e shkencave**, Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 2002
- Akademia e shkencave**, Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1954
- Akademia e shkencave**, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980
- Akademia e shkencave**, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 1995
- Akademia e shkencave**, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002
- Akademia e shkencave**, Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976
- Angoni E.**, Pjesëzat, në: *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme I*, Tiranë, 1972
- Admoni W. G.**, Der Deutsche Sprachbau, München, 1982
- Brugmann K.**, Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen, Band 2, Teil 1, 1892
- Buxheli L.** Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe, Tiranë, 2009
- Buxheli L.**, Rreth fjalëve të përngjitura në gjuhën e sotme shqipe, në: *SF 4/ 1986*
- Buxheli L.**, Rreth formimeve paralele me prapashtesat –im dhe –je në shqipen e sotme letrare, në: *Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë, 1986
- Cipo, K.**, Gramatika shqipe, Tiranë, 1949
- Cipo K.**, Rreth disa kompozitave, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë 1972
- Cipo K.**, Kompozitat determinative, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972

- Çeliku M.**, Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe, Tiranë, 2000
- Çeliku M.** dhe të tjerë, Gramatika praktike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004
- Demiraj Sh.**, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962
- Demiraj SH.**, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, II, Tiranë 1961
- Di Melo C.**, Die Grammatikalisierung deutscher Präpositionen, Tübingen, 2000
- Donalies E.**, Die Wortbildung des Deutschen, ein Überblick, Tübingen, 2002
- Dr. Pekmezi**, Grammatik der albanesischen Sprache, Eien, 1908
- Duden**, Das Bedeutungswörterbuch, Band 10, Mannheim, 1985
- Duden**, Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 1998
- Duden**, Deutsches Universaleswörterbuch, Mannheim, 2002
- Duro A.**, Fjalët e përbëra në terminologjinë tekniko-shkencore, në: *Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë 1986
- Dhrimo A.**, Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe, *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II*, Tiranë, 1975
- Eichinger L.M.**, Deutsche Wortbildung, eine Einführung, Tübingen, 2000
- Eichler W./Bünting K.D.**, Deutsche Gramatik, Königstein, 1994
- Eisenberg P.**, Grundriss der deutschen Grammatik, das Wort, Stuttgart, 2006
- Erben J.**, Einführung in die Wortbildungslehre, Berlin, 1975
- Erben J.**, Einführung in die deutsche Wortbildungslehre, Berlin 2006
- Frashëri S.**, Shkronjëto e gjuhës shqipe, Bukuresht, 1886
- Fleischer W.**, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Leipzig, 1983

- Fleischer W./Barz I.**, Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, 2007
- Fleischer/Helbig/Lerchner**, Deutsche Sprache, kleine Enzyklopedie, Frankfurt am Main, 2001
- Gallmann P.**, Fugemorpheme als Nicht-Kasus-Suffixe, në: *Germanische Linguistik*, 1999
- Gallmann P.**, Syngrapheme an und in Wortformen – Bindestrich und Apostroph im Deutschen, në: *Germanische Studien 97, Schriftsystem und Orthographie*, Tübingen, 1989
- Hall K./Scheiner B.**, Übungsgrammatik, Deutsch als Fremdsprache für Fortgeschrittene, Max Hueber Verlag, Augsburg, 2001
- Helbig G./Buscha J.**, Deutsche Grammaik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Berlin, 1999
- Hentschel E./Weydt H.**, Handbuch der deutschen Grammatik, Berlin, 1990
- Henzen W.**, Deutsche Wortbildung, Halle/Saale, 1947
- Henzen W.**, Deutsche Wortbildung, Tübingen, 1957
- Hysa E.**, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975
- Hysa E.**, Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare, në: *Gjuha Jonë* 1/1985
- Hysa E.**, Formimet me parashtesën *për-* në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II*, Tiranë, 1975, f. 91;
- Hysa E.**, Formimi i ndajfoljeve, në: *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, I*, Tiranë, 1972
- Hysa E.**, Sindajshtesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, në: *Studime filologjike* 2, 1986
- Jung W.**, Grammatik der deutschen Sprache”, Leipzig, 1988

Kellermeier-Rehbein R., Areale Wortbildungsvarianten des Standarddeutschen, Beiuntersuchung zum Variantenwörterbuch des Deutschen, Frankfurt am Main, 2005

Kole, J., Prirje të zhvillimit të leksikut në dritën e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, në: *Studime filologjike*, 4/1986

Kostallari A., Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972

Kostallari A., Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972

Kostallari A., Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972

Kostallari A., Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I*, Tiranë, 1972

Kostallari A., Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1972

Kuhn I., Lexikologie, Eine Einführung, Niemeyer, Tübingen, 1994

Kürschner W., Zur syntaktischen Beschreibung deutscher Nominalkomposita, Tübingen, 1974

Lafe, E. Mbi disa terma të klasifikimit të fjalëve sipas përbërjes strukturore dhe sipas fjalëformimit, në: *Studime Filologjike* 1/1972

Leka F., Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore pas Çlirimit, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II*, Tiranë 1972

Leser M., Das Problem der ‘Zusammenbildungen’, Eine Lexikalistische Studie, Trier, 1990

Lindqvist Ch., Zur Entstehung von Präpositionen im Deutschen und Schwedischen, Tübingen, 1994

Lohde M., Wortbildung des modernen Deutschen, Ein Lehr- und Übungsbuch, Tübingen, 2006

Lloshi Xh., Mbi rezultatet kryesore të studimit të leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe pas Çlirimit, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972

Meibauer J.u.a., Einführung in die germanistische Linguistik, Stuttgart-Weimar, 2007

Mettke H., Mittelhochdeutsche Grammatik, Halle 1964

Metzler-Lexikon Sprache, Stuttgart, 1993

Miller G.A., Wörter: Streifzüge durch die Psycholinguistik, Heidelberg, 1993

Motsch W., Wortbildung in Grundzügen, Berlin, 2004

Naumann B., Wortbildung in der deutschen Gegenärtssprache, Niemeyer, Tübingen, 1972

Ortner L. u.a., Deutsche Wortbildung; Typen und Tendenzen in der Gegenwartssprache, 1991

Ortner L., Zur Theorie und Praxis der Kompositaforschung, 1984

Paul H., Prinzipien der Sprachgeschichte, Tübingen, 1880

Paul H., Deutsche Grammatik, Band V, Wortbildungslehre, Halle, 1920

Podgorica F., Parashtesat e huazuara; në: *Kongresi i Manastirit*, Shkkodër, 1969

Pittner R.J., Der Wortbildungstyp "Kopulativkomposition" im heutigen Deutsch, në: *Neue Fragen der Linguistik, Band I: Bestand und Entëicklung*, Tübingen 1991

P.von Polenz, Deutsche Sprachgeschichte vom Spätmittelalter bis zur Gegenärt, Band I, Berlin, 2000

Römer C./ Matzke B., Lexikologie des Deutschen: Eine Einführung, Tübingen, 2005

Samara M., Zhvillimi i leksikut politiko-shoqëror të shqipes, pas Çlirimit; në: *Gjuha Jonë*, 1/ 1985

Schippan T., Lexikologie der deutschen Sprache, Tübingen, 1992

Sommerfeldt K.H./Strake G., Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache, 1998

Sommerfeldt K.E., Zur Reihenfolge der Konstituenten kopulativer Komposita, në: *Sprachpflege – Zeitschrift für gutes Deutsch*, 1984/7

Stepanova D./Fleischer W., Grundzüge der deutschen Wortbildung, Leipzig, 1985

Starke G., Zum Problem der Zusammenbildung in der deutschen Gegenwartssprache, në: *Deutsch als Fremdsprache*, Nr. 5, Leipzig, 1968

Sheper, I.D., Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927

Shuteriqi Dh. S., Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut (879-1553), në: *Studime filologjike*, 1/1983

Thomai, J., Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011

Villiger H., Gutes Deutsch: Grammatik und Stilistik der deutschen Gegenwartssprache, Stuttgart, 1970

Volmert J., Grundkurs Sprachwissenschaft, München, 1999

Weinrich H., Textgrammatik der deutschen Sprache, Hidesheim, 2007

Welke K., Komposition und Derivation, në: *Deutsche Sprache*, 23 / 1995

Xhuvani A., Kompozitat, në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, Tiranë, 1972

Xhuvani A., Mbi prejardhjen e fjalëve, në: *Vepra I*, Tiranë, 1980

Xhuvani A., Parafjalët, në: *Vepra I*, Tiranë, 1980

Xhuvani A. / Çabej E., Parashtesat e gjuhës shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1975

Xhuvani A. / Çabej E., Prapashtesat e gjuhës shqipe, në: *Vepra I*, Tiranë 1980

Xhuvani A., Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë, 1956

Zifonun G. u.a., Grammatik der deutschen Sprache, Berlin, 1997

Faqe elektronike:

<http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/271160/titulli/Kutite-e-Fierit-shtyhen-per-neser-KQZ-perfshihet-nga-debatet>

http://www.radiotravel.al/index.php?option=com_content&vieë=article&id=13476&catid=47